

PSALMET

komentar

Agim Rama

Rruga e Paqes

2021

PSALMET

Hyrje

Titulli hebraik i librit është *tēhillim* = Libri i lavdërimeve, i cili do të thotë këngët e kënduara të shoqëruara me muzikë, ose me instrument individual ose me kor dhe orkestër. Psalmet bëjnë pjesë me ndarjen e Biblës hebraike me titull Shkrimet, të cilat karakterizohen me njeriun, nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë që i përgjigjet Perëndisë. Davidi dhe autorët e tjerë të Psalmeve ishin njerëz të tillë të frymëzuar. Për Davidin thuhet se: «Këtu vijon kënga e fundit që hartoi Davidi: Pa dëgjoni, sepse Davidi, biri i Jishait, flet tani! Perëndia më ngriti në nder më të lartë, Perëndia e Jakobit më shuguroi mbret dhe më bëri hartues të këngëve të Izraelit. Nëpërmjet meje flet Shpirti i Zotit; fjalën e tij e ka vënë në gojën time» (2 Sam 23,1-3). Shkrimet e mëvonshme bëjnë aludim për Davidin si drejtori i adhurimit muzikor në Izrael si dhe për aftësinë e tij për të luajtur instrumente të ndryshme dhe për të kompozuar: «Levitët u organizuan në grupe, nën mbikëqyrjen e Hashavjës, Jeshuas, Binuit dhe Kadmielit. Ata dhe farefisi i tyre, Matanja, Bakbukja dhe Ovadja formonin dy kore që e lavdëronin dhe e falënderonin Perëndinë me këndim antifonik sipas rregullit të Davidit, njeriut të Perëndisë. Ata përdornin instrumente me tela, siç u kishte rënë dikur Davidi, njeriu i Perëndisë. Edhe këngëtarët dhe rojtarët e portës e kryenin shërbimin e tyre sipas rregullave të caktuara nga Davidi dhe nga i biri, Salomoni. Atëherë, në kohën e Davidit, Asafi ishte kryetar i këngëtarëve që e lavdëronin dhe e falënderonin Perëndinë me këngët e tyre. » (Neh 12,24, 36, 45-46)

Tek Amos 6,5 na thuhet se Davidi madje edhe ka shpikur disa vegla muzikore: «Ju gërvalleni / çirreni me harpa dhe mendoni se mund të bëni këngë më të mira se ato të Davidit! »

Te Veprat 1,14. «Ajo që është parashikuar në Shkrimin e shenjtë për Judën, duhej të plotësohej. Atje Shpirti i Perëndisë, i

cili fliste me gojën e Davidit, e parashikoi tradhtarin, i cili ua tregoi udhën atyre që dolën për të arrestuar Jezusin. 73 prej psalmeve i atribuohen Davidit. Jezusi foli lidhur me psalmet për autorësinë e Davidit.

Psalmet ishin këngët fetare të Izraelit të lashtë dhe kështu liturgjia, shpeshherë në formë lutjesh, e caktuar për kultin e Tempullit. Kjo shpjegon udhëzimet e ndërlikuara për ekzekutimin e disave prej tyre nga koret e ndryshme. Përdorimi i tyre i përgjigjet: a) ceremonialit të shtetit, b) festave popullore, c) devocionit të individit (p. sh. me rastin e flijimeve të mirënjohjes, betimit, lutjes, ndërmjetësimit e të tjera).

Këngët fetare të Izraelit na paraqitin një mikrobotë të preokupimeve fetare të Izraelit të lashtë. Kështu ato shërbejnë si hyrje në botën e Dhiatës së Vjetër.

Psalmet citohen më shumë (rreth njëqind) në DhR se ndonjë libër tjetër i DhV. Ato përmbajnë shumë lëndë profetike që ose u plotësua në kohën e Jezusit, Mesisë së Izraelit, ose do të plotësohet në të ardhmen e afërt. Kështu dëshmojnë për karakterin e tyre të frymëzuar nga Shpirti i Perëndisë.

Mesia pasqyrohet te Psalmet si Mbreti i shuguruar (Mesia). Te Ps 110 dhe 145 flitet për Mesinë si për Perëndinë (shih zhvillimin e argumentimit tek Letra drejtuar Hebrenjve). Ai pasqyrohet gjithashtu, si Shërbëtori i Zotit. Flitet për zellin reformues të Mesisë (69a), flijimin e vetvetes (40,6-8), përjetimin e izolimit (69,8), tradhtinë, urrejtjen dhe mospranimin e tij (41,9; 69,4; 35,19; 118,22), pësimin e përbuzjes (69,9), talljen (22,7; 69,21), zveshjen e tij (22,18), dhe gozhdimin në kryq (22,16). Fjalët e tij të fundit ishin një citim nga Ps 22,1 dhe 31,5. Jezusi shihet gjithashtu te Psalmet, si njeriu që zëvendëson njerëzimin (8,4), mbreti që është njëkohësisht edhe kryepriфт (110,4), guri që hodhën tej ndërtuesit (118,22), mbi të cilin thyhet njeriu (shih edhe Isaia 8,13-15) dhe guri që dërrmon perandoritë e botës (Dn 2,34). Shih Lk 20,18.

Psalmet janë shkruar në formë poezie hebraike, sipas rregullave të poezisë orientale të lashtësisë. Kjo gjini letrare karakterizohet jo nga rima, por nga ritmi, d.m.th. nga numri i rrokjeve të theksuara në çdo varg. Megjithëse s'është e mundur të riprodhohet në përkthim një strukturë e tillë, mund të vihet re një tipar tjetër i poezisë hebraike, d.m.th. paralelizmi që shihet në përsëritjen e rreshtit si jehonë, si kontrast, sintezë, ose gradues.

Mbishkrimet e shtypura në krye të psalmeve do të jenë meloditë, sipas të cilave duheshin kënduar psalmet. Shënimet e shkruara në tekstin e psalmeve (p.sh. Sela) do të jenë udhëzimet për këndimin e psalmeve (si *allegretto*, *fortissimo*) ose ndoshta ndryshimet e çelësit.

Psalmet janë ndarë në pesë libra që u përgjigjen të pesë librave të Ligjit (Torës):

Libri i parë Ps 1-41 — Psalmet e Davidit. Tema: Pashkët

Libri i dytë Ps 42-72 — Psalmet e Davidit. Tema: Rreshajet

Libri i tretë Ps 73-89 — Tema: Shkatërrimi i Izraelit

Libri i katërt Ps 90-106 — Tema: Rigrumbullim i Izraelit (mijëvjeçari)

Libri i pestë Ps 107-150 — Tema: Çlirimi i Izraelit.

Sipas traditës së çifutëve, këto pesë ndarje janë përgjigjja e Izraelit, në formë lutjesh, të pesë librave të Torës. Një shpjegim tjetër i mundshëm është se librat e Psalmeve pasqyrojnë disa mbledhje që qarkullonin para se të mblihdeshin në një libër të vetëm. Kjo do të shpjegonte, p.sh. pse ka dublikata psalmesh.

Disa psalme janë shkruar në formë akrostike: çdo pjesë e këtyre psalmeve fillon me një shkronjë të alfabetit hebraik. Këto janë: 9-10, 25, 34, 37, 111, 112, 119, 145. Kjo formë duhet të ketë ndihmuar adhuruesin t'i mësojë përmendësh.

Mbishkrimi i titulluar "Për mjeshtrin e korit" (*la-mēnaceax*) do t'i referohet përmbledhjes që përdorej me raste të veçanta.

Psalmet ishin kryesisht libra himnesh fetare të Tempullit dhe ishin të paracaktuara për këndim gjatë shërbesave fetare. Shumë prej tyre janë të stilizuara. Ka vajtime, psalmet e

mirënjohjes, këngët e lavdërimit, psalmet e historisë së shpëtimit, psalmet e festimit dhe psalmet e kredis kombëtare, psalmet e urtësisë (ku lavdërohen përparësitë e urtësisë dhe të jetës së devotshme) dhe këngët e besimit.

Ka më shumë se 60 psalme të vajtimit, për shembull: shembujt për vajtimin individual janë: 3, 22, 31, 39, 42, 57, 71, 120, 139, 142): kurse shembujt e vajtimeve të përbashkëta janë: 12, 44, 80, 94, 137).

Shembujt për psalmet e mirënjohjes janë: 65, 67, 75, 107, 124, 136 (falënderime të përbashkëta) dhe 18, 30, 32, 34, 40, 66, 116, 118, 138 (falënderime individuale).

Shembujt për psalmet e lavdërimit janë: Perëndia lavdërohet si Zot i gjithësisë (8, 19, 104 and 148), si mbrojtës dhe mirëbërës i Izraelit (66, 100, 111, 114 dhe 149) si Zot i historisë (33, 103, 113, 117, 145-7).

Shembujt e psalmeve të historisë së shpëtimit janë 78, 105, 106, 135, 136). Shembujt e psalmeve të festimit dhe të kredis kombëtare ndahen në disa kategori:

- 1) liturgjitë për ripërtëritjen e besëlidhjes (50, 81),
- 2) Psalmet e besëlidhjes davidike (89, 132),
- 3) Psalmet mbretërore (2, 18, 20, 21, 45, 72, 101, 110, 144).

Mbretërit mbaheshin si ndërmjetësit e Perëndisë që furnizonin mbrojtje dhe stabilitet..

Pastaj kishte psalme të fronizimit (24, 29, 47, 93, 95-99): ato do të jenë përdorur gjatë ceremonisë vjetore për të festuar fronizimin e mbretit.

Pastaj janë psalmet e Cionit ose Këngët e Jerusalemit (46, 48, 76, 84, 87, 122). Jerusalemi si vendndodhje e Tempullit dhe selia e mbretërisë davidike, do të merrej parasysh roli që ai do të luante në kohën e mijëvjeçarit.

Pastaj janë psalmet e besimit (1, 36, 37, 49, 73, 112, 127, 128, 133), dhe psalmet e shpresës për të ardhmen (11, 16, 23, 27, 62, 63, 9 dhe 1, 121, 125, 131) të cilat na shpjegojnë se si mund të kemi besim te Zoti në kohën e vështirë.

Në mbishkrimet hebrailke përdoren fjalë të ndryshme:

1. *mizmor* – himn i kënduar me shoqërim muzikor.
2. *shir* – këngë
3. *maskil* – himn
4. *miktam* – vajtim
5. *shiggaion*: – melodi prekëse
6. *higgaion*: – psalm i shoqëruar me muzike te qetë

Autorësia: Shumë psalme mbajnë mbishkrimin, *Ië-David* i cili do të thotë fjalëpërfjalë: “për Davidin”. Mund të kuptohet se Davidi e shkroi, ose se ishte bëntë pjesë me mbledhjen e tij, ose kushtuar Davidit, ose komponuar sipas stilit të Davidit. Disa madje kanë sugjeruar se kjo do të thotë “për përdorimin e dinastisë davidike.

Është kuptimplotë se në kohën kur u përkthye Septuaginta, askush nuk e dinte më kuptimin e këtyre titujve. Megjithatë është e qartë se ata u shtuan pas kompozimit të atyre psalmeve, sepse janë shkruar në vetën e tretë

Ka aludime për autorë të tjerë: pasardhësit levitikë të rebelit që vdiq) i referohen një kor të Tempullit të cilin e themeloi Hemani, nën mbretërimin e Davidit të cilit bashkëlevitët, Asafi dhe Jedutuni (ndryshme Ethani, ezrait) drejtonin koret e nxjerra nga dy klanët levitikë e tjerë (1 Kronikat 6,31.33.39.44). Natyrisht këto kore vazhduan shumë kohë pas vdekjeve të themeluesve të tyre. Madje edhe ka një psalm që i atribuohet Moisiut (Psalm 90). Meqenëse gjuha është e ngjashme me këngën dhe bekimin e Moisiut (Lp 32 and 33) dhe melankolia e humorit i përket atij të një gjenerate të humbur, s’ka pak të ngjarë në këtë mbishkrim

Psalmet mund të ndahen gjithashtu në mbledhje që nuk u përgjigjen librave të njohur. Kështu:

1. Psalmet 3-41, mbledhje davidike me doksologji dhe prirje për përdorimin e fjalës *Jahve* (272 raste në krahasim me 15 përdorimet e fjalës *Elohim*)

2. Psalmet 51-72, mbledhje davidike doksologji dhe prirje me perdorimin e fjalës *Elohim* (208 reste në krahasim me 48 perdorimin e fjalës Zot.).

3. Psalmet 50, 73-83, mbledhje esnafike e atribuar Asafit..

4. Psalmet 90-99, psalmet e sabbatit të lidhura me adhurimin e rregullt të sabbatit.

5. Psalmet 113-118, Lavdërim (*Hallel*) për çlirimin nga Egjipti, psalme të lidhura me adhurimin me rastin e festës së Pashkës. (krhs. 136).

6. Psalmet 120-134, Këngët e pelegrinazhit, që do t'i kenë kënduar pelegrinët udhës për në Tempull.

7. Psalmet 146-150, Halleluja Psalmet e kënduara me rastin e festave.

Disa psalme janë të shkruara në formë akrostike: çdo rresht fillon me një letër të ndryshme të alfabetit hebraik. Këto janë: 9-10, 25, 34, 37, 111, 112, 119, 145. Te Ps 119 çdo seksion përmban një sinonim për Ligjin. Të gjitha këto mjete do të ndihmojnë me memorizim..

Mjedisi i psalmeve: Ka të ngjarë se disa psalme ishin të lidhura me festën e tendave si ripohim i mbretërisë hyjnore ose si ceremoni për ripërtëritjen e besëlidhjes. Kjo do të shpjegonte përse në kohën e mijëvjeçarit, kombet duhen të dërgojnë delegacione për të marrë pjesë në festën e tendave, për të ripërtërirë besnikërinë ndaj Mbretit të madh (Mesisë). Në qoftë se ky interpretim është i saktë, atëherë frazeologjitë te Psalmet 93,97,99, si «Zoti mbretëron», duhen përkthyer si «Zoti është bërë (përsëri) mbret».

Datimi i kompozimit: Formimi i psalterit duhet të ketë qenë proces gradual. Periudha kryesore e kompozimit do të ketë qenë katërt shekujt e dinastisë davidike (rreth 1000 p.e.s.- rreth 600 p.e.s), sepse si atëherë, gjatë dhe pas mërgimit, puna e kompilimit dhe editimit vazhdoi nën mbikëqyren e Shpirtit të

Perëndisë deri në përfundimin e kësaj kryevepre për nder të Zotit..

Përmbajtje profetike: Në fund, Psalmet kanë një përmbajtje profetike të theksuar. Psalmist do të ketë filluar me një temë të njohur, por pastaj Shpirti i Zotit e çoi jashtë kohës (ose më përpara) dhe ai foli për gjëra të ardhshme.

Mesia në Psalme: duket qartë nga shumë citate nga Psalmet që gjenden në DhR se ato ishin një burim i pasur i civateve mesianike. Ato vijjnë nën titujt që vijojnë:

1) Mbreti i shuguruar (d.m.th. Mesia) i cili është njëkohësisht Mesi dhe Perëndi Biri. Këtë e thekson Letra drejtuar hebrenjve (Ps 110 dhe 45), si dhe

2) Shërbëtori i Zotit: Shumica e aludimeve për Jezusin janë të këtij lloji: bëhet fjalë për zilinë e tij reformuese (69,9a), vetëflijimi i tij (40,6-8), përvoja e tij e izolimit (69,8), tradhtia e tij, urrejtje dhe mospranim (41,9; 69,4; 35,19; 118, 22), pësimi i përbuzjes (69,9), tallje (22,7; 69,21), zhveshje (22,18) gozhdimi në kryq (22,16). Fjalët e tij të fundit ishin citate nga Ps 22,1, dhe 31,5).

3) Jezusi shihet si njeriu përfaqësues (8,4), mbreti që është njëkohësisht kryeprieti (110,4), guri që nuk e pranuan ndërtuesit (118,22), guri në të cilin bien njerëzit dhe copëtohen (krhs. dhe Isaia 8,13-15) si dhe guri që dërrmon mbretëritë e botës (Dan 2,34).

Portreti i mbretit si vijon: Mbreti haset me kundërshtimin botëror (Ps 2,1-3; 110,1) por, si Fitimtar (45,3-5; 89,22f) dhe me përkrahjen e Perëndi Atit (Ps 2,6.8; 18,46-50, 21,1-13; 110,10) vendos sundimin e tij botëror (2,8-12; 18, 43-45; 45,17; 72,8-11; 89,25; 110,5ff), bazuar në Cion (2,6) dhe tipizuar nga drejtësi, paanësi dhe moralitet (45,4.6; 72,2-4.7; 101). Sundimi i tij është pa fund (21,4; 45,6; 72,5); lulëzon (72,7.16) dhe me devotshmëri të qëndrueshme ndaj Zotit (72,18-19). Ai është plotë hir, dhurata dhe dinjitet (45,2-7) gjithashtu mik i të varfërve dhe armik i

shtypjes (72,2.4.12-14); nën sundimin e tij të drejtët (d.m.th. besimtarët) lulëzojnë (72,7). Kujtohet përgjithmonë (45,17); ka nam të përjetshëm (72,17) dhe është objekt i mirënjohjes pa fund (72, 15). Në lidhje me Zotin, ai pranon bekimin e përjetshëm (45,2). Ai është trashëgimtar i besëlidhjes davidike (89,28-37; 132,11f), dhe i priftërisë së Melkizedekut (110,4). Ai i përket Zotit (89,18) dhe i është nënshtruar (21,7; 63,1-8.11) Ai është regjenti (nënmbreti) i tij (2,7; 89,27), i ulur në të djathtën e tij (110,1) dhe është vetë hyjnor (45,6).

KOMENTARI

Parathënie

Në këtë komentar jepen së pari teksti i Biblës Drita. Për të plotësuar shpjegimin e psalmeve, kemi shtuar në fund të librit një përkthim tjetër dinamik më të lirë.

LIBRI I (Ps 1-41)

PSALMI 1

Dy udhët

1 Lum njeriu që nuk i ndjek këshillat e keqbërësve,
që nuk qëndron në udhën e mëkatarëve
e nuk rri së bashku me përqeshës,
2 por kënaqet në Ligjin e Zotit
dhe e kujton atë ditë e natë.

3 Ai është pors i pema e mbjellë në bregun e ujit që rrjedh,
e cila frytin e vet e jep në stinë dhe gjethet kurrë s'i
vshken:

i ecën mbarë gjithçka të ndërmarrë.

4 Jo, kështu jo, s'do t'u ndodhë të paudhëve,
por ata janë pors i byku që shpërndan era.

5 Prandaj të paudhët s'do t'i bëjnë ballë gjyqit
as mëkatarët bashkimit të të drejtëve!

6 Sepse Zoti e di udhën e të drejtëve,
kurse udha e keqbërësve do të mbarojë.

(BIBLA DRITA)

KOMENTARI

Psalmi i parë quhet psalmi i besimit, por është gjithashtu psalm tipik për letërsinë e urtësisë, posaçërisht ajo e Fjalëve të urta: dy udhët, d.m.th. dy mënyrat e jetesës dhe dy fate (krhs Lp 30,11-20).

Tiparet e tjera gjenden te ky psalm që e identifikon me letërsinë e urtësisë janë si vijon:

1. Interes për shoqërinë që mban njeriu dhe për tipe morale
2. Shëmbylltyrat e nxjerra nga natura
3. Interes për përfundimin logjik të procesit
4. Përdorimi i fjalës «i bekuar». (*ashré*).

Fjalori i përdorur në lidhje me letërsinë e urtësisë:

1) shprehjet që shënojnë «të urtët»:

i varfër, i nevojshëm (*ani, eljon, dal, dak*)

i urtë (*hakam*)

kuptim (*bina; tëbuna. gjithashtu: sekel*)

besnik (*hasid*)

i ndershëm (*jasar*)

i drejtë (*sadiq*)

i patëmetë (*tamim* – që shënon një mënyrë jetesë të ndershmerisë)

frikë (*jira*) qëndrim i nënshtrimit dhe hapësi ndaj mësimit hyjnor.

2) shprehjet që shënojnë rebelin:

mëkatar (*hata*)

i keq (*rasa*)

tallës (*lesim*)

arrogant (*zedim*)

budalla (*naval*)

armik (*ojev, mëreim, rodef, soné, sorer*)

Thuhet se Psalmi i parë shërben si hyrje në mbarë librin e psalmeve. Psalm 150, në anën tjetër, është doksologji e përgjithshme për mbarë psaltrin.

Si shumica e letërsisë të këtij lloji, libri i psalmeve e quan si të vërtetë dy gjëra:

1) Kjo botë i takon Perëndisë dhe ata që marrin anën e tij do të gëzojnë në fund të fundit bekim. Ose, siç shprehet në gjuhën e Letrës drejtuar hebrenjve «Askush nuk mund t'i pëlqejë Perëndisë, në qoftë se nuk i beson atij. Kush do t'i afrohet Perëndisë, duhet të jetë i bindur se Ai ekziston dhe i shpërblen ata që e kërkojnë». (Hebr. 11,6).

2) Psalmi i parë është psalm i angazhim për një mënyrë jetese të veçantë për t'i bindur fjalës së Perëndisë (ecje...rritje në këmbë) siç shprehjet te Ligji i Tij (mësim siç jep një atë dashamirës fëmijës së tij).

v. 1, **tora**: thuhet se Ligji (Tora) është zbulim që vjen nga Perëndia për ta ndihmuar njeriun për të jetuar në harmoni me vullnetin e Zotit, kurse feja njerëzore është përpjekja e njeriut për të rregulluar udhën e tij dhe për të shpjeguar botën përreth.

medito: Theksi bie në mendje: ajo që formon mendjen e njeriut formon edhe jetën e tij. Për këtë arsye Joshuas i thuhet që të kujtojë në mendje Ligjin e Zotit ditën e natën.

ulu...ec...rri në këmbë përfaqëson tre hapat e largimit nga Perëndia (përshtatje me botën në tri nivele: pranimit i këshillit të saj, marrja e anës së saj dhe adoptimi i qëndrimit të tij (talljes),

Rr. 3 fjala “mbjellë” mund të thotë “artitur” dhe kjo shënon një pozitë të re në të cilën është artitur besimtari. Ai ka kaluar nga vdekja në jetë, nga bota në mbretërinë e Perëndisë (d.m.th. në sferën ku Ai sundon drejtpërdrejt).

Rr. 3 vija e ujit është kanali i ujitjes që furnizon ujin e nevojshëm në çdo kohë.

Rr. 5-6, Dy fatet kontrastohen dramatikisht në dy rreshtat e fundit (në formën e paraleleve). Ka kontrast të plotë ndërmjet atyre që shkojnë udhës së vet dhe atyre që janë në rregull me Perëndinë dhe rreshtohen në Fjalën e Tij.

Rr. 6 Zoti e di udhën e të drejtit, d.m.th. ai kujdeset për besimtarin, ose e drejton.. Zoti merret me rrugën e të drejtit (besimtarit), kurse të këqijtë i merr rryma e botës, drejt humbjes.

PSALMI 2

Drama mesianike

1 Përse paganët çohen peshë
e përse popujt bluajnë punë të kota?
2 Mbretërit e tokës po ngrihen,
princat me përбетim çohen kundër Zotit e Mesisë së tij.
3 »Le t’i këputim vargjet e tyre,
le ta flakim prej nesh zgjedhën e tyre!«
4 Qeshet Ai që selinë e ka në qiell, i Larti Zot i përqesh
ata!
5 Pastaj u thotë në hidhërimin e vet,
me felgrimin e hidhërimit të vet i huton:
6 »Unë e kam shuguruar mbretin tim mbi Cion,
malin tim të shenjtë!«
7 Unë do ta shpall vendimin e Zotit.
Ai më tha: »Ti je im Bir, unë sot të linda!
8 M’i kërko e unë, për pronë do të t’i jap popujt,
nën sundimin tënd gjithçka përfshin toka.
9 Sundo mbi ta me skeptër hekuri
dhe do t’i thyesh porsi vegsha vorbëtari!«
10 E tash pra, merrni vesh, o mbretër,
mësoni ju që gjykoni tokën!
Shërbeni Zotit me frikë të madhe,
nënshtrojuni Atij me nderim e dridhje,
12 bëni siç kërkon Ai

që të mos hidhërohet e të sharroni nga udha.
 Papritmas flakë i ndizet zemërimi.
 Lum zemra e atyre që shpresojnë në Të!

KOMENTARI

Ky është një psalm mesianik (mbretëror) (si 18, 20, 21, 45, 72, 101, 110, 144). Mund të ketë formuar një hyrje të përgjithshme për psaltrin (bashkë me psalmin e parë) dhe parashtron dy rrugë për kombet. Porsi individët e këqij do të shfarosen (te psalmi i parë), ashtu edhe do t'u ndodhë kombeve që nuk pranojnë t'i nënshtrohen Mesisë. Në të vërtetë psalmi bën aludim për situatën pas fillimit të mijëvjeçarit kur Zoti do të ketë vendosur mbretin e vet.

Mbretërit mbaheshin për ndërmjetësit (dhe zëvendësit) që jepnin stabilitet dhe mbrojtje. Për këtë qëllim, ata «u adoptuan» ose u emëruan nga Perëndia (këtej gjuha e birësimit) kështu që mbreti u bë «Bir», kurse Perëndia «Atë».

Kështu Hebr. 1,6 do të thotë në të vërtetë: «Perëndia kurrë nuk i tha ndonjë engjëlli: *Ti je Biri im, sot të emërova (Mesi ose zëvendësi im)*. As nuk tha për ndonjë engjëll: *Unë do të jem për të Atë, dhe ai do të jetë për mua Bir.* »

Ky psalm do të jetë përdorur me rastin e ardhjes në fuqi të mbretit të ri të Judës, posaçërisht me atë të Salomonit (2 Sam 7,5-16), si trashëgimtar i fronit. Megjithatë vetëm me rastin e Mesisë, mbretit hyjnor, mund të realizohet plotësisht kjo profeci.

Kryengritje: rebelimi i kombeve llogaritet si rebelim kundër popullit të Perëndisë, kundër mbretit e tij dhe kundër vetë Zotit.

Është tipik për taktikën e Satanit të kërkojë t'i bindë kombet se kushtet e Zotit kufizojnë aftësinë e tyre për të realizuar «lirinë» që meritojnë.

Nënshtrimi: puthja e këmbëve dhe duarve të mbretit mbahej si simbol besnikërie. Zoti as nuk diskuton me rebelët as nuk

adaptohet në kërkesat e tyre, por thjesht ripohon planin e tij mbretëror – tashmë ka vendosur mbretin e tij dhe pikë.

E dimë nga Zak 14 se në fund kombet do të dërgojnë delegacione në Jerusalem për të ripërtërirë besnikërinë e tyre ndaj mbretit, por madje në këtë kontekst ka mundësi për rebelim, dhe kjo do të përfundojë me ndëshkim. «Atëherë Zoti do të sundojë si mbret mbi të gjitha kombet. Përveç tij nuk do të ketë zot tjetër, dhe në tokë nuk do të nderohet asnjë perëndi tjetër.... Ata që do të mbeten gjallë prej kombeve që i ishin afruar Jerusalemit për ta sulmuar, do të udhëtojnë çdo vit në Jerusalem, për të kremtuar festën e tëbanave dhe për ta nderuar Zotin e gjithëfuqishëm si mbretin e tyre. Në qoftë se një komb nuk pranon të vijë për të nderuar Zotin, në vendin e tij nuk do të bjerë shi.

Por kur është fjala për egjiptianët, në vend të kësaj Zoti do t'i godasë me të njëjtën sëmundje, me të cilën shkatërroi ushtritë e kombeve. Ai do t'i ndëshkojë të gjithë ata që nuk pranojnë të vijnë në Jerusalem për të kremtuar festën e tëbanave. » (Zak 14,9. 16-19).

Por mjerisht edhe në fund të mijëvjeçarit do të ketë rishtas kryengritje

«Kur të mbushen një mijë vjet, Satani do të lirohet nga burgu i tij. Do të dalë për t'u mbushur mendjen popujve nga të katër anët e botës – Gogut dhe Magogut. Ata janë të shumtë si kokrrizat e rërës në breg të detit, dhe Satani do t'i bashkojë të gjithë në luftë. Këta u derdhën në mbarë tokën (e premtuar) dhe e rrethuan qytetin (e Jerusalemit), fushimin e popullit të Perëndisë, qytetin që Perëndia e do. Por nga qielli zbriti zjarri dhe i përpiu. Pastaj Djalli, i cili i kishte mashtruar, u plandos në liqenin e zjarrtë dhe të sqfurfur, aty ku gjendeshin Egërsira dhe Profeti i rremë. Aty do të vuajnë ditë e natë, përgjithmonë». (Apok 20,7-11)

Ky psalm citohet shumë herë në Dhiatën e Re.

Rr. 2, Te Veprat 4,25-28 shihet plotësimi i parimit të kryengritjes së kombeve kundër Perëndisë dhe Mesisë së tij, në kundërshtimin e Herodit dhe Pilatit ndaj Jezusit dhe kishës së tij.

Rr. 7 lidhet me Jezusin me rastin e pagëzimit, shndërrimit dhe ringjalljes për të përkrahur emërimin e tij paraprak si Mesia. Ashtu si nënkuptohet te Hebr 1,5, ky emërim u bë para krijimit të gjithësisë. Sigurisht, kështu shihet te kredoja e Nikesë: i lindur (d.m.th) i emëruar para të gjithë botave. Mjerisht kredoja vazhdon të japë të kuptohet se Biri ishte pasoja e një emanacioni (i lindur e jo i krijuar). Kjo keqkupton shprehjen i lindur i cili nuk aludon për fillimin e ekzistencës, por për emërimin e tij si Mesia.

Rr. Tek Apokalipsi 12,5 and 19,15 rreshti 9 ka të bëjë me natyrën e sundimit të Mesisë, i simbolizuar nga shkopi dhe skeptri i (krhs. Zan 49,10 dhe Ezek 20,37). Shpartallimi i kombeve mund t'i referohet disfatës së tyre në fund të mjerimit të madh, pas së cilës ata që mbijetuan do të gëzojnë sundimin e tij mirëdashës, por të rreptë.

PSALMI 3

Lutja në mëngjes e të drejtit të përndjekur

Psalm. I Davidit. Kur u arratis para birit të vet Abshalomit.

2 Sa shumë janë, o Zot, ata që më salvojnë! Sa shumë asi që po më çohen kundër!

3 Shumë janë ata që thonë për mua: »As Perëndia më nuk do ta shpëtojë!«

4 Por ti, o Zot, je mbrojtësi im, nderi im që lart ma mban kryet!

5 Zërin tim e lartësoj te Zoti dhe më vështron prej malit të vet të shenjtë.

6 Unë bie në shtrojë e fle e prapë zgjohem: sepse Zoti më ruan.

7 Jo, nuk i druaj njerëzit edhe me mijëra në qofshin që përçark më rrethojnë porsì armiq.

Ngrihu, o Zot, më shpëto, O Perëndi im!

8 Shputë ua pëlçet turinjve armiqve të mi, dhëmbët ua thyen mëkatarëve!

9 Shpëtimi vjen prej Zotit: bekimi yt mbi popullin tënd!

KOMENTARI

Ky psalm klasifikohet si psalm vajtimi. David gjendet në rrezik vdekjeje, prandaj i kthehet Zotit për çlirim sepse është zëvendësi i Tij i zgjedhur – me të drejtë mbret i Izraelit. Davidi i flet Zotit për problemin e tij dhe pastaj e pyet për zgjidhjen. Si vazhdon të flasë me Perëndinë, e sheh situatën e tij nga një perspektivë e re.

Ky është psalmi i parë ku jepet në mbishkrim një e dhënë për sfondin e psalmit. (2 Sam 15,13-17,24). Ky është një prej 14 psalmet që lidhen me një ngjarje historike në jetën e Davidit. Ndërsa titulli na sjell ndër mend pikëllimin e tij: ai zbulon çëshje të mëdha që e shqetësonin: shtimi i pabesës ndër popull (1, 6): thuhet se Perëndia e ka braktisur, si dhe gjendja e pasigurte e popullit të tij. Siç duket, Davidit i ka ardhur fundi.

Gjithashtu duhet vërejtur se problemi i Davidit ishte pjesërisht i tiji. Ndërshkimi i tij për kurorëshkeljen e tij me Batshevën kishte për pasojë probleme familjare. Ka llastuar fëmijët e tij dhe Avshalomi ka reaguar logjikisht: në qoftë se fëmija llastohet, ai nuk do të respektojë atin e tij. E megjithatë Davidi mund t'i drejtohet Perëndisë për çlirim.

rr. 1 na flet për shtimin e kundërshtimit. Davidi gjendet në një situatë të ngjashme me atë të Jobit (2, 11-13) miqtë e të cilit ishin të bindur se Perëndia e kishte braktisur.

rr. 3-4 përmban disa hebraizme tipike që duhen shpjeguar si vijon

1). Zoti është mburojë do të thotë se Zoti do ta mbrojë

2). Zoti është lavdia e tij do të thotë se Zoti është ai që do të rimëkëmbë dinjitetin e tij..

3). Zoti është ai që do të ngrrejë kokën e tij do të thotë se Zoti është ai që do t'i japë kuraj të ri.

rr. 7 përmban hebraizme të mëtejshme

1. Shuplakë në faqe është qortim

2. Thyerja e dhëmbëve do të thotë të shfuqizosh armikun.

Ky psalm na flet për masat që mori Davidi për të zgjidhur situatën

1. Davidi kishte kaluar dy natë në ikje nga Avshalomi. Nata e parë e gjeti Davidin shumë skurajuar (rr. 1-2).

2. Kundërhelmi i skurajimit është pohimi i së vërtetës hyjnore. (rr. 3)

3. dhe kërkimi i ndihmës nga Zoti (rr. 4).

4. Pasoja është bekimi i gjumës (rr. 5)

5. dhe besim i ri për një ditë të re (rr. 6)

6. Sikurse dita e parë ka përfunduar me lutje të dëshpëruar, ashtu edhe dita e re fillon me kërkesën e mbrojtjes nga Perëndia, duke bazuar në marrëdhënien e tij të veçantë me Zotin

(kështu armiqtë e tij janë armiqtë e Zotit) si dhe në përjetimin e tij të hirit të Zotit. .

7. Kështu Davidi merr siguri që e mundëson të japë një profeci* të re. Zbatimi për ne është se edhe ne gëzojnë një marrëdhënie të veçantë me Zotin, prandaj mund t'i kërkojë ndihmë, megjithëse kemi dështuar në të kaluarën.

*Fjala profeci është mesazhi i frymëzuar (ose orakull) nga Zoti, e jo medoemos shikim në të ardhmen.

Prandaj t'i afrohemi fronit, mbi të cilin është ulur i Mëshirshmi (Perëndi). Kur të kemi nevojë për ndihmë, atje do të gjejmë gjithnjë dashurinë dhe mëshirën e tij (Hebr 4,16).

PSALMI 4

Urata e mbrëmjes

Mjeshtrit të korit. Për instrumente me korda. Psalm. I Davidit.

2 Kur të të thërras në ndihmë, më dëgjo, O Perëndi, drejtësia ime! Ti që më shpëtove në vështirësi: ki mëshirë për mua e ma dëgjo uratën!

3 Deri kur, o njerëz, do të jeni zemërgurë? Përse e doni kotësinë e ndiqni rrenën?

4 Dijeni: Zoti bën mrekulli për shenjtin e vet, Zoti më dëgjon kur unë e thërras në ndihmë.

5 Zemërohuni e mos mëkatoni, përsiatni në zemrat tuaja, në shtrojat tuaja e qetësohuni.

6 Flijoni fli drejtësie e shpresën kijeni në Zotin!

7 Shumë thonë: »Kush do të na bëjë ta shohim fatbardhësinë? Le të ndritë mbi ne, o Zot, drita e fytyrës sate!

8 Ti ndikove në zemrën time më shumë gëzim sesa kur të tjerëve u bëhet grurë e verë me shumicë!

9 Posa bie në shtrojë gjumi menjëherë më merr në qetësi, sepse vetëm ti, o Zot, ma jep pushimin e qetë.

KOMENTARI

Ky psalm i përket kohës së ikjes së Davidit nga Avshalomi kur ballafaqohet edhe një natë duke fletur përjashta dhe me rrezik. Davidi kundërshton ata që denigrojnë dinjitetin e tij si mbret, duke u bërë thirrje për t'i dhënë fund mashtrimin të tyre për fuqi. (rr.1-2)

Davidi nuk mohon se ka frikë, por përdor orët e natës për lutje të qetë, duke iu afruar Zotit me shpirtin e përkushtimit, shoqërisë, rrëfimit të mëkateve, dhe në pritje të plotësisimit të lutjeve të tij. Dëshmia e Davidit është se lutja sjell gëzim më të madh se sa ajo që ofron bota.

Thirrja e psalmistit për ndihmë (rr. 1) themelohet në përvojën e mëparshme për çlirimin nga Zoti kur gjendej ngushtë.

rr. 1 Perëndia ime e drejtë: fjj. 'Perëndia e drejtësisë sime'. Zoti është përkrahës i drejtësisë, nga i cili kërkon të shfajësohet.

rr. 2. O njerëz: fjj. 'bijtë e njeriut'; ka të ngjarë aludim për anëtarët e pasur dhe me ndikim të komunitetit. (krhs. 49: 2).

Në rr. 2, 3 Davidi u bën thirrje armiqve të tij: si mund të vazhdojnë ta paditin, kurse shihet qartë se Zoti ka qenë i mëshirshëm me të, prandaj ka të drejtë. Në dritën e këtyre paditjeve, ai u bën thirrje armiqve që të mendohen mirë edhe një herë, të ndërpresin qëllimet e tyre të mëkatshme dhe të tërheqin paditjet e tyre. (rr. 4); atëherë ata duhet të kërkojnë të vihen në rregull me Zotin (rr. 5).

rr. 3. i devotshëm: Heb. *hasid*, është ai që vë në jetë *hesed* (krhs 5: 7), d.m.th ai që është besnik ndaj kushteve të besëlidhjes në marrëdhëniet e tij me njerëzit dhe me Zotin (krhs. 18: 25; 86: 2; 109: 16), por posaçërisht ai që i kushtohet plotësisht shërbimit të Zotit.

rr. 5. flijime të drejta: janë ato që kushtohen me ritual të saktë ose të sjella me shpirtin e drejtë dhe të shoqëruar me jetën e drejtë (krhs. Lp. 33: 19; Ps. 51: 19; 1 Sam. 15: 22; 2 Sam. 15: 12).

rr. 6. Faqja e Zotit shënon praninë e tij si dhe shprehjen e ndjenjave të Tij (krhs. Nr. 6: 24-26). Të lejosh që të ndritë drita e faqes së tij (fj. 'të ngresh dritën') do të thotë të buzëqeshësh ose të tregosh miratimin dhe favorin (krhs. GNB 'na sheh me dashamirësi; (krhs Fu. 16, 15).

PSALMI 5

Urata e mëngjesit

Mjeshtrit të korit. Me fyej. Psalm. I Davidit.

2 Dëgjoji, o Zot, fjalët e mia, kuptoje dënesën time!

3 Dëgjoje zërin e britmës sime, Mbreti im e Perëndia im!

4 Sepse ty ta drejtoj uratën time, o Zot, qysh në mëngjes e dëgjon zerin tim: që në mëngjes dal para teje e pres.

5 Sepse ti nuk je Perëndi që i pëlqen padrejtësia, pranë teje nuk ka vend keqbërës,

6 keqbërësit nuk mund të qëndrojnë përpara syve të tu.

7 Ti i urren të gjithë ata që bëjnë keq, i zhbin të gjithë ata që flasin rrena,

Të neverit gjakësori e tradhtari.

8 E unë në saje të dashurisë sate të madhe do të hyj në Shtëpinë tënde, do të bie përmbys me nderim në Tempullin tënd të shenjtë.

9 O Zot, më prij udhës së drejtësisë sate për shkak të armiqve të mi, rrafsho para meje udhën tënde.

10 Jo, s'ka çiltëri në gojën e tyre, humnerë është zemra e tyre, gurmazi i tyre varr i hapur e me gjuhë përkëdhelin.

¹¹Ndëshkoji ata, o Perëndi, poshtë le t'u bien synimet, dëboji për shkak të pabesive të shumta të tyre, sepse ngritën krye kundër teje, o Zot.

12 Le të, gëzohen ata që mbështeten në ty, le të galdojnë përherë e në amshim!

Mbroji dhe le të gëzohen në ty të gjithë ata që e duan emrin tënd!

13 Sepse ti, o Zot, e lavdëron të drejtin, si shqyt e mbron dashamirësia jote.

KOMENTARI

Ky është psalmi i parë që përmban mallkime kundër armiqve të Davidit. Si me fragmente të ngjashme të psalmet, Davidi i kërkon Zotit të bëjë atë që ka pohuar se do të bënte, me këtë rast, të sjellë në dritë mëkatet dhe të ndëshkojë mekatarët; t'u bëjë akuzuesve atë që do t'i kishin bërë objektit të inatit të tyre. Ai e lëshon veprimin në duart e Zotit duke refuzuar të merret hak personalisht. Në këtë Davidi është motivuar nga dëmi i shkaktuar Zotit e jo nga armiqësi personale. (rr. 10).

Ky psalm është vajtim i individit, lutja e njeriut të paditur padrejtësisht, ose të sulmuar nga bashkisraelitët e pamëshirshëm; (joçifutët nuk i plotësojnë kërkesat për të hyrë në Tempull). Në qoftë se këtë psalm e kompozoi Davidi, ka të

ngjarë që të ketë prejardhjen në oborrin e Shaulit (1 Sam. 19; 20) ose, ka më të ngjarë, nga koha e kryengritjes së Avshalomit (2 Sam. 15-18; me rr. 7 krhs. 2 Sam. 15, 25; me rr. 10 krhs. 2 Sam. 15, 31). Përdorimi kultik i mëpasshëm i psalmit mund të ketë qenë nga mbreti davidik ose nga individë që priste zgjidhjen e procesit të tij, ose nga një këngëtar levitik në interes të mbarë kongregacionit.

rr. 3 Ishte në mëngjes që jepeshin vendime gjyqësore. Davidi i besoi procesin e tij Zotit dhe priste zgjidhjen.

rr. 7. *mëshirë*: Heb. *hesed*. Ideja themelore është qëndrueshmëria, përdorimi i fjalës të bën të kuptosh ekzistencën e një besëlidhjeje (krhs. Ps. 89: 1 etj., 28). Fjala do të thotë 'besnikëri', 'devotshmëri', 'besë' cilësi që pritet nga partneri i besëlidhjes (krhs. 1 Sam. 20: 8). Fjala haset te Psalmet më shumë se gjithkund tjetër.

rr. 8. *sipas drejtësisë sate*: do të thotë ose sepse jeni besnik ndaj premtimeve të besëlidhjes, ose me anë të veprave të tua lidhur me besëlidhjen.

PSALMI 6

Thirrje në ndihmë në vështirësi

Mjeshtrit të korit. Për instrumenta me korda. Në oktavë. Psalm. I Davidit.

2 O Zot, Mos më qorto në zemërimin tënd as mos më ndëshko në hidhërimin tënd!

3 Ki mëshirë për mua, o Zot, se më shkatërroi sëmundja, më shëro, o Zot, se u thërmuan eshtrat e mi.

4 Shpirti im është tejet i shqetësuar, e ti, o Zot – e dëri kur ... ?

5 Kthehu, o Zot, deh më shëro,
 më shtpëto në saje të mirësisë sate!
 6 Sepse ndër të vdekur kush të, kujton, në Nëntokë kush
 të këndon lavde?
 7 Plasa duke gjëmuar, natë për natë e laj shtratin tim, me
 lotët e mi e laj shtrojën time.
 8 Sytë e mi po shqimen nga vajtimi, u plaka midis
 armiqve të mi.
 9 Largohuni prej meje të gjithë ju që bëni keq, sepse Zoti
 e dëgjon zërin e dënesës sime!
 10 Zoti e dëgjon lutjen time, Zoti e pranon uratën time!
 11 U turpërofshin dhe tmerrësisht u hutofshin armiqtë e
 mi e, të çnderuar, vrik u kthefshin prapa!

KOMENTARI

Aludimi për armiq njerëzorë (rr. 7, 8, 10) të bën të kuptosh se sfondi i psalmit mund të jetë identik me atë të Ps. 3, duke marrë parasysht mundimin e udhëtimit, rrezik për sulm si dhe përgjegjësi për shoqëri të përzier që iku bashkë me Davidin (2 Sam. 15,16, 18, 22), s'është çudi që Davidi ka përjetuar kohët e rraskapitjes. (2 Sam. 16,14; 17,29). (Nga ana tjetër, rr. 3 shënon më mirë një sëmundje. Në nivelin e ulët të energjive fizike, mendore dhe emocionale, Davidi përjetoj thellësitë të përshkruara në këtë psalm.

Sepse, në depresionin e tij Davidi do të ketë sjellë ndërmend se po të mos bënte mëkat me Batshevën (2 Sam. 11, 12) s'do të kishte qenë pa fuqi kur biri i tij më i madh e përdhanoi motrën e Avshalomit (2 Sam. 13). Po të mos prishte rastin e Avshalomit, duke lënë të acarohet shpirti i tij i stuhishëm (2 Sam. 14, 15), ka mundësi që kryengritja të mos ndodhë. Davidi fare mirë mund të ndihet se Zoti e kishte braktisur me inat (rr. (5)! Por rreziku më i

madh duhet të lëshojë pe para zgjidhjes më të thjeshte: (rr. 2) thirrje për të pasur mëshirë sjell siguri se Zoti e ka dëgjuar thirrjen e tij për mëshirë (rr. 9). Në qoftë se nevoja më e madhe zhduket me anë të lutjes, atëherë mos të plotësohen nevojat më të vogla në të njëjtën mënyrë (rr. 10)? Me anë të lutjes terrori i Davidit bëhet terrori i armiqve të tij, kthimi i Zotit në përgjigje të lutjes (rr. 5, 6) është sinjal për armiqtë e tij që të largohen (rr. 9, 10); atëherë kur ishte i dobët (rr. 7, 8) Davidi zbuloi se ishte i fortë..

rr. 6. *kujtimi*: paralelisht me lavdërimin, është më shumë se përkujtim mendor: është tregimi i hapur i veprave të mëdha të Zotit në kuadër të kultit në Tempull.: krhs. 71,15f; Isaia 63,7.

Në sheol: bota e të vdekurve mund të përfitohet si shpellë shumë e madhe nëntokësore. (krhs. Ezk. 32,18-32) ose kështjellë me porta (Pss. 9,13; 107,18; Mt. 16,18); por edhe si shkretëtirë shumë e madhe dhe e errët (Jb. 10,22) ose si kafshë grabitqare (e.g. Is. 5,14; Jon. 2,2; Hab. 2,5). Vdekja bën të pushojë adhurimi i Zotit, shkatërron planet e tij dhe e ndan nga Zoti dhe i jep fund. Në qoftë se ai harron të vëkurit, kjo do të thotë se Ai nuk ndërhyr më në favor të tyre. Theksi i DhV bie kryesisht në vdekjen si nivelues i madh (krhs. Jb. 3,13-19), por ka edhe thellësitë ku përfundojnë tiranët (krhs Isaia 14,13; Ezekiel 32, 18. Por nganjëherë në Bibël flitet edhe për çlirim nga bota e të vdekurve, me anë të ringjallës (Is. 26,19; Dn. 12,1-3). «Ata që vdiqën nga populli ynë, do të jetojnë përsëri. Trupat e tyre do të kthehen në jetë. Të gjithë ata që fleXnë në varret e tyre, do të zgjohen dhe do të këndojnë nga gëzimi. Sikurse vesa e freskon tokën, ashtu do t'i ringjallë Zoti ata që kanë vdekur prej kohësh (Is 26,19) dhe... «Atë kohë, – tha engjëlli, – do të ndërhyjë kryetari i madh engjëllor, Mihaeli, dhe do të luftojë për popullin tënd. Do të ketë një periudhë vështirësish dhe shtypjeje, e cila nuk ka ekzistuar qysh sa mbahet njerëzimi mend. Por populli yt do të shpëtojë, secili, që e ka emrin të shkruar në librin e Zotit. Shumë veta që flejnë nën dhe, do të zgjohen, disa për jetë të përjetshme dhe disa për humbje të përjetshme. Por ata që e

kanë ruajtur urtësinë e Zotit dhe që u kanë treguar shumë njerëzve rrugën për në jetë (të përjetshme), do të ndriçojnë përgjithmonë si yjet në qiell.» (Daniel 12,1-3).

PSALMI 7

Urata e të drejtit të përndjekur

Ankim. I Davidit. E këndoi për nder të Zotit për shkak të fjalëve të Kush, Benjaminasit.

2 Ndore tënde, o Zot, Perëndia im! Më shpëto prej të gjithë salvuesve të mi e më liro

3 që të mos ma rrëmbejnë shpirtin porsì luani që shqyen kur s'ka kush të shpëtojë!

4 Por, o Zot, Perëndia im, nëse veprova kështu: nëse gjendet padrejtësi në duart e mia,

5 nëse ia ktheva me të keqe bamirësit tim, nëse e kurseva salvuesin e padrejtë, 6 më ndjektë armiku e më pushtoftë: jetën time përdhe e shqelmoftë, nderin tim pluhur e bëftë!

7 Ngrihu, o Zot, në felgtimin tënd, ngrihu kundër tërbimit të armiqve të mi, ngrihu, Perëndia im, në gjyqin që caktove!

8 Le të të rrethojë kuvendi i popujve, por ti prej së larti sillu kundër tij!

9 Zoti vendos mbi çështjet e popujve! Më gjyko, o Zot, sipas drejtësisë sime, dhe sipas pafajësisë sime.

10 Le të zhbihet fajësia e mëkatarëve, lart ngrihe të drejtin, Perëndia i drejtë, që shqyrton zemrat e veshkat!

11 Mburoja ime është në Perëndinë që i shpëton zemërdrejtët.

12 Perëndia është gjykatës i drejtë, i forte e që zemërohet çdo ditë,.

13 Vallë, a s' do ta mprehë përsëri shpatën e vet, s' do ta ngrehë harkun e s' do ta mbajë gati?

14 Gati i bëri armët vdekjeprurëse, shigjetat e veta flakë i skuqi!

15 Ja, keqbërësi lindi padrejtësinë: ngjizi shpirtligësinë e lindi tradhtinë.

16 Hapi gropën e e thelloi: ai vetë bie në gropën që çel.

17 Shpirtligësia e tij do të bjerë mbi krye të tij, dhuna e tij do t'i bjerë në majë të kokës së tij!

18 E unë do ta lavdëroj Zotin, sepse është i drejtë, lavde do t'i këndoj emrit të të Lartit Zot.

KOMENTARI

Ky mbishkrim e lidh këtë psalm me një përvojë të panjohur të Davidit, ka të ngjarë kur ishte bandit (I Sam. 21-26) ose pak para (I Sam. 18-20). Kushi, bashkanëtar i fisit të Shaulit, siç duket, e hodhi fjalën se Davidi kishte thurrur komplot kundër mbretit (krhs. I Sam. 22, 8; 24, 9; 26, 19). Ky psalm atëherë do të jetë protestim kundër këtij paditjeje si dhe thirrje për çlirim (krhs. I Sam. 24, 11-15). Përdorimi i mëvonshëm do të ishte kur një individ i paditur shkonte në Tempull për të kërkuar mbrojtje dhe të marrë zgjidhjen e procesit të tij nga vetë Zoti, të transmetuar nëpërmjet priftit ose gjyqtarit të nesërmen në mëngjes (krhs. Dal. 22, 10-11; Nr. 5, 11-31; Lp. 17, 8-12; I Mb. 8, 31 +). Ky psalm, me benë e pastrimit (rr. 4-6), do të recitohej nga i akuzuari ose për hir të akuzuarit, atëherë ai do të priste vendimin e shfajësimit. Ka edhe mundësi që mbreti ta ketë recituar këtë psalm me rastin e fatkeqësisë kombëtare.

Pas lutjes hyrjese për çlirim (rr. 2, 3), psalmisti e deklaroi pafajësinë e tij në trajtë të besës solemne (rr. 35, krhs. Job 31). Pastaj në rr. 7-12 ai i bën thirrje Perëndisë, gjyqtarit të drejtë të mbarë botës, të japë vendimin e tij gjyqësor dhe ta shfajësojë,

sepse e di se është në rregull me Ligjin. Vg 13-17 përshkruajnë fatin e njeriut të keq dhe pasojat e tmerrshme të së keqes së tij. Në fund (rr. 18) psalmisti bën be për të lavdëruar Zotin për çlirimin që sigurisht do të pasojë.

4 *në duart e mia* :a mundësi që një be e tillë e pastrimit të jetë bërë me larjen simbolike të duarve (krhs. 26, 6; Is. 1, 15+).

8. *ngrihu në gjyqin që caktove*: Gjykim përfshin edhe shfaqësimin e të pafajshmeve si dhe ndëshkimin e fajtorëve..

9, *sipas drejtësisë sime*: ky s'është pretendim për përsosurinë morale, por për pafajësinë para gjyqit.

10. *zemrat dhe veshkat*: d.m.th. mendjet dhe zemrat: selia e mendimeve dhe emocioneve.

15. Përfytyrim i gjallë i zhvillimit të së keqes te njeriu (krhs. Job 15, 35; Is. 33, 11; 59, 4; Jak 1, 15).

18. *Zoti është i drejtë*: Zoti qëndron besnik ndaj standardit të karakterit të tij të zbuluar (shih edhe 33, 5).

emrit: emri shënon personin (krhs. 68, 4; 145, 1,-2), karakterin e tij të zbuluar (krhs. Dal. 34, 5+) si dhe praninë e tij vepruese (krhs. Dal. 23, 20 fl; Nr. 6, 27).

të të lartit Zot: 'Eljon ishte emri i lashtë për El, perëndinë më të lartë të panteonit kananas, si dhe emri i hyjnisë më të lartë të kultit jevusas në Jerusalem para kohës së Davidit (krhs. Zan. 4, 18-24). Kur përdorej për Zotin, ky emër thekson epërsinë e tij mbi perënditë e tjera (krhs. Ps. 95, 3).

PSALMI 8

Bujaria e Krijuesit e fuqia e emrit të tij

*Mjeshtrit të korit. Në mënyrë këndimi me »Shtrydhës ...
« Psalm. 1 Davidit.*

2 O Zot, Zoti ynë, sa i mrekullueshëm është emri yt mbi mbarë tokën! Me madhëri e tejkalon edhe qiellin!

3 Prej gojës së ferishteve e të foshnjave lavdinë e bëre gati kundër armiqve që t'i bësh të heshtin armiq e kryengritës.

4 Kur e sodis qiellin – veprën e gishtave të tu, hënën e yjet që ti i vendose,

5 Çka është atëherë njeriu që ta kujtosh, biri i Adamit që të përkujdesesh për të?

6 E pra, e bëre pak më të vogël se engjëjt, e kurorëzove me lavdi e shkëlqim,

7 i dhe pushtet mbi veprat e duarve të tua. Gjithçka vure nën këmbët e tij:

8 delet e kafshët të gjitha, për më tepër edhe egërsirat e fushës,

9 shpëndët e ajrit dhe peshqit e detit, të gjitha që përshkojnë udhët e detit.

10 O Zot, Zoti ynë, sa i mrekullueshëm është emri yt mbi mbarë tokën!

KOMENTARI

Psalmi 8 u klasifikua si himn lavdërimi për nder të Zotit si krijuesi i njerëzimit.

Dinjiteti i njeriut dhe madhështia e Zotit: Ky psalm është himn që arrin lartësinë e madhështisë rrallë e realizuar nga njeriu i kufizuar. Ka zhvillim mendjeje nga madhështia e fronit të Zotit në qiell deri në kafshët më të ulta në botë. Njeriu përfytyrohet si qendra e krijimit të Perëndisë. Psalmi fillon dhe përfundon me një refren. Pyetjet e psalmit 6 citohen të Hebr 2,6 + kur përshkruhen poshtërimi dhe lartësimi i Krishtit si njeri dhe Adami i dytë..

rr. 1,2. *Sa i madh është emri yt!* Kjo hyrje identifikon emrin me Jahveun, Zotin tonë (Adoni).

Ai është Zoti ynë = ne jemi anëtarë të besëlidhjes. Njeriu mund t'i flasë Perëndisë me «Ti», dhe kjo shënon se ai ka nder të flasë me Të.

Shprehja «fëmijët dhe foshnjat» mund të jetë figurë e njeriut në dobësinë e tij. Lavdërimi i foshnjave kontrastohet me intrigat e armiqve të Perëndisë.

rr. 2, përkthim tjetër: «Lavdërimi yt arrin gjer në qiell; këndohet nga fëmijët dhe foshnjat. Ti je i sigurt nga të gjithë armiqtë e tu; ti ndalon ndokënd që të kundërshton. »

rr. 3,4. Njeriu në kontrast. *Kur mendoj për qiellin tënd, ...Ç'është njeriu?* Qielli i natës shkakton lavdërimin e madhështisë të Perëndisë siç shihet në qiell. Kur njeriu (*enosh*, njeriu i dobët) krahasohet me shtrirjen e qiellit, njeriu duket pa shumë vlerë. Ai është me të vërtetë biri i njerëzimit ('*adam*, njeriu i përgjithshëm). Megjithatë vetëm njeriu mund ta bëjë një pyetje të tillë për vlerësi. Zoti nuk planifikoi një gjithësi të shkretë dhe pa kuptim, por si vendbanim për familjen e tij.

rr. 5,6. *Vendi i njeriut*. «më pak i ulët sa engjëjt. Kjo shprehje përkthehet më mirë si «më pak sa hyjni». «Më pak» mund të përkthehet edhe si «për pak kohë».. Fjala «*elohim*» mund të shënojë ose Perëndi ose perënditë (d.m.th. engjëjt). Gjendja e njeriut karakterizohet nga tri gjëra. lidhja e tij me hyjninë, dinjiteti i tij (lavdi dhe nder) si dhe sundimi i tij. Zoti e kujton me kuptimin se kujdeset aktivisht për mirëqenien e tij.

rr. 7,8. *Ilustrime për sundimin e njeriut...delet dhe kafshët të gjitha..egërsirat e fushës, shpendët e ajrit dhe peshqit e detit...* Bëhet aludim për krijimin e jetës në planetin tonë siç përshkruhet te Zanafilla 1.

Këto ide zhvillohen në tri menyra nga autorët e DhR:

1. Megjithëse njeriu ende nuk ka arritur fatin e tij të dhënë nga Zoti, zëvendësi dhe pararendësi i tij (Jezusi) e ka arritur, dhe kjo është garanci që edhe ne (besimtarët) do ta arrijmë.

2. Pali pret me padurim që vdekja të mos ekzistojë më, dhe kur i gjithë pushteti i deleguar t'i kthehet Atit. (1 Cor 15,27)

9. *Doksologji*. *Sa i madh është emri yt.* = sa madhështor je dhe sa i madh është reputacioni yt. Refreni e thirr njeriun prapë që të mendohet për madhësinë e Zotit që të mos mendojë për

arritjet e tij. Njeriu ka dinjitet, por madhështia i përket vetëm Perëndisë.

Megjithatë sundimi i njeriut mbi natyrën, sa i madh që të jetë, nuk mund të krahasohet me madhësinë e Perëndisë. Njeriu është para së gjithash shërbëtori dhe adhuruesi i Perëndisë.

Psalmet 9-10.

PSALMI 9

Perëndia i përul keqbërësit e shpëton të përvuajturit.

*Mjeshtrit të korit. Sipas këndimit: »Vdis për djalë ... «
Psalm. I Davidit.*

Alef 2 Të lavdëroj, O Zot, me gjithë zemrën time, i shpall të gjitha mrekullitë e tua.

3 Gëzohem dhe galloj në ty, i këndoj emrit tënd, O i Larti Zot!

Bet 4 Armiqtë e mi u kthyen prapazi, ranë përdhe e sharruan ndër syte e tu,

5 Sepse ti u kujdesove për të drejtën e çështjen time, ti nderje mbi fron, Gjykatës i drejtë!

Gimel 6 Ti i qortove paganët, e shove të pabesin, emrin e tyre e zhduke për jetë të jetës!

7 Armiqtë sharruan – rrënojë e përhershme, gërmadha ua bërë qytetet, mbaroi kujtimi i tyre me ta.

He 8 Zoti sundon në jetë të jetës, e vendosi fronin e vet të gjykojë;

9 Ai vetë me drejtësi gjykon mbarë botën, ua jep popujve dënimin e drejtë.

Vav 10 Zoti është strehimi i të saluarit, vend i sigurt për ditë të vështira. Le të shpresojnë ne ty ata që e njohin emrin tënd, sepse ti s'i lëshon dore ata që të kërkojnë ty, o Zot.

Zain 12 Këndoni Zotit që banon në Cion, kumtoni ndër popuj mrekullitë e tij!

13 Sepse si ndëshkues gjakësorësh në mend i bie për ta, e britmën e skamnorit nuk e qet në harresë.

Het 14 Ki mëshirë për mua, o Zot, shihe mjerimin tim ku më hodhën armiqtë e mi, më shpëto prej derës së vdekjes

15 për t'i shpallur të gjitha lavditë e tua para dyerve të qytetit Cion gëzuar për shpëtimin tënd.

Tet 16 U plandosën paganët në atë gropë që vetë hapën, këmba e tyre u zu në atë lak që vetë vunë,

17 Zoti e dëftoi veten e çoi në vend të drejtën, mëkatari u ngatërrua në veprat e duarve të veta!

Jod 18 Le të kthehen mëkatarët në Nëntokë, të gjithë paganët që e harrojnë emrin e Perëndisë!

Kaf 19 Sepse skamnori nuk do të harrohet për amshim, shpresa e varfanjakut nuk do të mbarojë askurrë.
20 Zgjohu, o Zot, të mos mbizotërojë njeni, para teje le të gjykohen paganët!

21 Mbushi me frikë e tmerr, o Zot, le ta dinë paganët se janë vetëm njerëz.

PSALMI 10 (Vg 9,22-39)

Lamed 1 Përse, o Zot, qëndron larg, përse fshihesh në ditë të vështirë?

2 Me madhështi i patenzoni po e përndjek skamnorin: le të zihet krenari në dhelpërinë që sheston!

Mem 3 I pabesi mburret me dëshirat e shpirtit të vet, lakmuesi shan Perëndinë me përbuzje.

Nun 4 Me kreninë e vet mëkatari e përbuz Zotin:
»S'kërkon përgjegjësi! Perëndi nuk ka!«

5 Ja, gjithçka ai mendon! Dhe prapë, udhët e tij janë plot suksese, gjyqet e tua janë tepër lart për të, të gjithë kundërshtarët e vet i bën asgjë.

6 Në mendjen e vet thotë: »Nuk do të bie poshtë, brez pas brezi e keqe s'do të më gjejë!«

Pe 7 Goja e tij është plot shpifje, dredhi e gënjeshtër, nën gjuhën e tij vuajtje e poshtërsi!

8 Rri në pritë ndër fshatra, në moh e vret të pafajshmin.

Tsade 9 Me sy e vrojton të vobektin, në pritë porsi lùani, i fshehur mirë në strofull, përgjon për ta rrëmbyer të varfrin: e rrëmben të varfrin duke e qitur në lak.

10 Sulet, struket në, pritë e dhunës së tij të mjerët i bëhen pre.

11 Tha në zemër të vet: »Perëndia harron, ai nuk këqyr, askënd nuk sheh!«

Kof 12 Ngrihu, o Zot, lartësoje dorën tënde, O Perëndi, mos i qit në harresë, të mjerët!

13 Përse i patenzoni ta përbuzë Perëndinë? Sepse ai tha në zemrën e vet: »Nuk do të ndëshkosh.«

Resh 14 E pra, ti sheh, ti shikon mjerimin e vështirësinë, me dorën tënde i peshon: në ty mbështetet i mjeri, ti ia jep bonjakut sigurinë.

Shin 15 Copëtoje krahun e dhunuesit e të keqbërësit: kërkoje fajin e tij derisa ta zhbish prej faqes së dheut.

16 Zoti është mbret në shekuj të shekujve: do të zhduken paganët prej tokës së tij.

*Tau*17 Vështroji, o Zot, dëshirat e të mjerit, forcoja zemrën, ti prirja veshin,

18 për t' i dhënë të drejtën bonjakut e të salvuarit, që njeriu – pluhur e dhe – tmerr kujt më të mos i shtjerë!

KOMENTARI

Siç duket, këto dy psalme ishin njëherë të bashkuara, sepse ashtu janë te disa pergamena hebraike, te Septuaginta dhe te Vulgata, dhe kjo shpjegon pse numërimi i rreshtave është ndryshe. Këtë pohim e vërtetojnë faktet si vijon:

(i) Ps 10 s'ka mbishkrim (dhe kjo është e rrallë te libri i parë i psalmeve).;

(ii) një skemë akrostike është në veprim në të dy psalmet. (rreth përdorimit të akrostikës shih Ps 25): te Ps. 9 strofë prej dy rreshtave fillon me njerin prej 11 letrat e para të alfabetit hebraik; Ps 10 fillon me letrën e 12 dhe përfundon me letrën e katërt të fundit (ka të ngjarë që mesi të ketë pësuar korrupsionin tekstual);

(iii) Shprehja 'Selah' nuk haset zakonisht në fund të psalmit (9, 20);

(iv) Ka ngjashmëritë e gjuhës dhe përmbajtjes në të dy psalmet (krhs. 9, 9 dhe 10, 1; 9, 19 dhe 10, 12; 9, 5 dhe 10, 16). Ata që mohojnë se ka unitet letrar, vënë re se ka ndryshim të gjendjes shpirtërore ndërmjet Ps. 9 dhe Ps. 10, Ps. 9 është falënderim individual : Ps 10 është vajtim. Ata supozojnë se Ps 10 ishte shkruar për t'ë qënë shtesë e Ps. 9. Megjithatë një përzierje e tillë stilesh nuk haset gjëkund (krhs. Ps. 22; 36) prandaj duhet t' i trajtojmë këto dy psalmet si unitet.

Ata që ia atribuojnë këto psalme Davidit shohin aludime për fitoret e tij (2 Sam. 8), posaçërisht mbi filistinët dhe jevusasit (krhs. Ps. 10, 16), kurse të këqijtë te Ps. 9 kuptohet janë vetvetiu kombet pagane (rr. 4, 17); te Ps 10 siç duhet, fjala u referohet njerëzve të veçantë brenda Izraelit (por krhs. 10, 16). Po ashtu, shprehjet «viktima të shtypura, të pikëlluar, të gjorë»,

mund t'u referohen individëve të veçantë brenda Izraelit ose mbarë komunitetit të besëlidhjes, duke përshkruar jo vetëm gjendjen e tij, por edhe (të paktën simbolikisht) qëndimin e tij ndaj Zotit (d.m.th. përulje).

Psalmisti fillon duke premtuar të lavdërojë Zotin (9, 1, 2), sepse është i bindur se Ai do t'ia plotësojë lutjen. (rr. 3, 4). Kjo bindje është themeluar në veprimin e mëparshëm të Perëndisë në historinë e Izraelit, p.sh. fitoret e Davidit. (rr. 5, 6). Burimi i kësaj bindjeje vjen nga natyra dhe statusi i Zotit. (rr. 7-12): Mbret përgjithmonë; Gjyqtar i botës; Mbrojtës i të shtypurve; Shpagimtar i gjakut. Rreshtat 13-20 parashtrajnë lutjen e individit në nevojë, me dëshmi të mëtëjshme për besim te drejtësia e Zotit. Në rr. 15, 16 do të ketë aludim për ngjarjet e kaluara, por folja mund të jetë në kohën e kryer profetike.

9, 2. *të gjitha mrekullitë e tua*: ato vepra të Zotit që ngjallin habi, qoftë konsideruar si të mrekullueshme qoftë jo (krhs. 119, 18): vepra krijuese (136, 4); gjykimi (116, 7, 22; 78,4); çlirimi individësh ose kombëtar (71, 17).

9, 4. *u kthyen prapazi*: disfatë (krhs. 44, 10) ose tërheqje. Foljet te rr. 4, 5 mund të kuptohen si koha e tashme ose koha e kryer.

9, 6. *Ti i qortove paganët*: me vepra e jo vetëm me fjalë (krhs. 104, 7). Foljet te rr. 6, 7 mund të kuptohen si koha e kryer profetike ose si urdhërore. Koha e kryer profetike është një ndërtim ku e ardhmja konsiderohet aq e sigurt sa përshkruhet se tashmë ka ndodhur.

9, 8. *e vendose fronin e vet*: d.m.th. në qiell (banesa qiellore e Zotit, krhs. Ps. 18, 6; 47, 8; 103, 19, Hab. 2, 20), por gjithashtu në tempullin tokësor (rr. 11; krhs. 76, 2; 80, 1).

9, 11. *që e njohin emrin tënd*: ata që pranojnë natyrën e Zotit dhe kërkesat e tij, të cilët jetojnë sipas vullnetit të tij. (krhs. 91, 14; shih edhe komentarin për 20, 1).

që të duan, (fj.fj. që kërkojnë faqen tënde): janë ata që dëshirojnë praninë dhe bekimin e Zotit (krhs. Nr. 6, 23 +; Ps. 4, 6; 11, 7; 17 15; 42, 2).

9,13. *britmen e skamnorit*: Heb. 'nawim, fjj. 'ata që bien përmbys', d.m.th.. 'të përulurit', 'ata që kanë besim te Zoti'. Fjala nënkupton se individ, për të cilin bëhet fjalë, është besimtar

9,14. *dyert e vdekjes*: çdo përvojë e sëmundjes ose fatkeqësisë mund të konsiderohet si të jesh në prag të vdekjes (krhs. Ps. 107, 18; Is. 38, 10), të jesh tashmë në kthetrat e botës së vdekurve (krhs. 18, 5; 30, 3).

9,15. *para dyerve të Cionit*: qendra e jetës shoqërore dhe tregtare (krhs. 69, 12), dyert përfaqësojnë mbarë qytetin (krhs. 87, 2).

bijat e Cionit: qyteti mund të quhet nëna, kurse banorët e qytetit fëmijët e saj (krhs. 149, 2); këtu përfaqësohet vetë qyteti (krhs. Is. 1, 8).

9,19. *skamnorit*: Heb. 'evjon, 'varfër' (krhs. 112, 9; 132, 15) dhe kështu ka nevojë për ndihmën e Zotit (krhs. 12, 5). Fjala përdoret më vonë si vetëpërshkrim i komunitetit të Kumranit si dhe i sektit të judeo-krishterë. (ebionitët).

varfanjak: Heb. 'anijim, fjj. 'të përkulurit', i.e. 'të pikëlluarit'.

KOMENTARI

Psalm 10, Ps. 10, 1-11 vazhdon lutjen e individit të pikëlluar, duke shprehur shqetësim për qëndrimin e vetësigurt dhe blasfemues të të këqijve si dhe suksesin e intrigat e tyre. Përsëri (rr. 12-15) ai i bën thirrje Zotit për të vepruar vendimtarisht për hir të të dobtëve dhe të të varfërve duke shprehur bindjen e tij se në fund Zoti, Mbreti i përjetshëm, do të dëgjojë dhe t'ia plotësojë lutjen.

1. Ps. 10, 1-11 aludime të mundshme për trazirat civile gjatë mbretërimit të Davidit (krhs. 2 Sam. 3, 39; 15, 2 +). Disa të tjerë japin të kuptojnë që ky psalm është lutja e mbretit ose udhëheqësit të komunitetit, gjatë periudhës së hegjemonisë së huaj (e.g. asiriane ose babilonase). Mundësia tjetër është se

këtë psalm ta ketë përdorur ndonjë individ i nevojshëm i cili erdhi në Tempull për të kërkuar ndihmën e Zotit.

10,1 *Pse, o Zot, qëndron larg?*: tërheqja e pranisë dhe ndihmës së Zotit kuptohet zakonisht si disiplina për shkak të mëkatit. (krhs. Mik. 3, 4; Is. 54, 8; 57, 17; 59, 2).

skamnorin: Hebr. 'ani, njëjës i 'aniyyim (shih 9, 18).

10, 3. lakmuesi: fjfj, Heb. *nefesh* – shpirt

10, 3. *mburret*: d.m.th. ai arrin atë që dëshiron..

10, 4. *i pafe*: jo mospranim filozofik i ekzistencës së Perëndisë (d.m.th ateizëm) por të jetosh sikurse Ai nuk çan kokën për gjërat njerëzore (krhs. rr. 6, 11, 13; 14, 1).

10,7. *nën gjuhën e tij*: d.m.th. në majë të gjuhës .

10,12. *Ngrihu*: gjest për autoritet mbretëror.

mos i qit në harresë: shih 9, 17.

të mjerët: përfaqësojnë të gjithë të varfrit dhe të shtypurit (krhs. 82, 3).

thyer dorën: i heq fuqi.

10,17. *të shtypurit*: Heb. 'anjim (shih 9, 12).

PSALM 11.

Shpresa e të drejtit

Për mjeshtrin e korit. I Davidit.

Jam ndore të Zotit! Përse atëherë i thoni shpirtit tim:

»Fluturo si shpend në mal!

2 Ja, keqbërësit harkun e shtrënguan, mbi kordë shigjetën vendosën për t'i shigjetuar fshehtas të drejtët.

3 Kur themelet janë të luhatura, çfarë mund të bëjë i drejti?«

4 Zoti është në Tempullin e vet të shenjtë, Zoti fronin e ka në qiell.

Sytë e tij vëzhgojnë të vobektin, qerpikët e tij shqyrtojnë bijtë e njerëzve.

5 Zoti shqyrton të drejtin e të paudhin, ai e urren atë që e do paudhësinë.

6 Mbi mëkatarë do të bëjë të bjerë prush: zjarr, sulfur e stuhi është pjesa e trashëgimit të tyre.

7 Zoti është i drejtë e drejtësinë e ka për zemër: të drejtët do ta shikojnë fytyrën e tij.

KOMENTARI

Ky psalm i besimit i drejtohet jo Zotit, por atyre miqve të druajtur me qëllime të mira që e këshilluan psalmistin të ikë prej armiqve të tij. Gjendja e vështirë e autorit s'është e qarte.: Rr. 2 mund të përshkruajë përpjekje për ta vrarë, ose zhvillimin e një fushate për ta marrë nëpër gojë; rr. 3 jep të kuptojë një kohë kur rendi shoqëror nuk punon. Ata që e lidhin këtë psalm me një përjetim të Davidit i referohen 1 Sam. 18, 12-29; 19, 11; or 2 7, 1 + Si rr. 1,4 jep të kuptojë se psalmisti ka hyrë në shenjtërore duke kërkuar mbrojtje nga armiqtë e tij (krhs. Exod. 21, 12 +; 1 Ki 1,50), si jo, poezia do t'i përshtatet përdorimit nga një individ i tillë kur priste në tempull që Zoti të veprojë për hir të tij,. Psalmi ndahet në dy pjesë: rr. 1-3 skicojnë situatën nga pikëpamja e miqve të psalmistit: është koha që të kapë paniku dhe të ikësh; rr. 4-7 përshkruan situatën nga pikëpamja e psalmistit: është koha të besosh te Zoti, mbreti i drejtë dhe i gjithëdijsëm.

3. *themelet* zakonisht aludim për rendin shoqëror (krhs. Ps. 82, 5; Is. 19, 10, 13; Ezek. 30, 4).

4. *tempull*: ose 'pallat'; mund të jetë aludim për shenjtëroren tokësore (krhs. Ps. 9, 11; Jer. 3, 16 +), por këtu, siç duket, mund të shënojë vendbanimin e Perëndisë në qiell (krhs. Ps. 18, 6; 47, 8; 103, 19, Hab. 2, 20).

6. *shpirt*: ai vetë. Hebr. *nefesh* përdoret në tri menyra të mundshme të Psalmet:

(i) fjala shënon parimin e jetës të njeriut, forca e tij jetësore (Ps. 6, 4; 107, 5);

(ii) i referohet aspektit mendor ose psikik të njeriut, personalitetit të tij, selisë së ndjenjave, dëshirave dhe vullnetit të tij (Ps. 6, 3; 11, 5; 24, 4; 25, 1; 35, 13);

(iii) me prapashtesën përemërore, shërben si perifrazë ose zëvendës emocional për përemrin vetor: «shpirti im» = «unë vetë» (kështu këtu dhe te 6, 3, 4; 120, 2; etj.). Te Zan. 2, 7 fjala i përgjigjet fjalës «qënie», kurse në referime si Lev. 7, 20 and Ezek. 18, 4 «person». Kuptime më të rralla janë «grykë», ose «qafë» (Ps. 69, 1), «lakmi» (Ps. 17, 9) «oreks» (Ps. 78, 18), «dëshirë» (Ps. 35, 25) dhe «kuraj» (Ps. 107, 26).

4-5 *pastruar*: shqyrtoj: metaforë për pastrimin e metalit (krhs. Jer. 6, 27-30), kuptohet «ndarje».

6. *prush, zjarr, squfur e stuhi* d.m.th. gjykim i papritur dhe përfundimtar si ai i Sodomit dhe Amorrës (Zan. 19, 24).

fati (fj. kupë): ajo që është përcaktuar nga Zoti, qoftë besim (16, 5; 116, 13) qoftë gjykim (krhs. Is. 51, 1'7; Lam. 4, 21).

7. *do ta shikojnë fytyrën e tij*: d.m.th. do të përjetojnë praninë dhe favorin e tij, posaçërisht në shenjtëroren e tij (shih 4, 6; krhs. 17, 15; 24, 2; 2'7, 4; 63, 2).

PSALM 12

Kundër botës gënjeshtare

Mjeshtrit të korit. Në oktavë. Psalm. I Davidit.

2 Më shpëto, o Zot, se e kishte shenjtë, sepse ndër bijtë e njerëzve u pakësuan bësniqët!

3 Të gjithë po e gënjejnë të afërmin e vet: flasin me buzë shtiracake, me zemër të paçiltër.

4Thaji o Zot, të gjitha buzët shtiracake, edhe gjuhën që flet fjalë të mëdha!

5Ata thonë: »Fuqia jonë është gjuha, buzët tona janë tonat! Kush është zotëria ynë?«

6 »Për shkak të mjerimit të të varfërve, për shkak të klithmës së të ndrydhurve tani do të ngrihem – thotë Zoti – e do ta shpëtoj atë që e përbuzin.«

7 Fjalët e Zotit janë të pastra: argjend i pastruar n zjarr, i ndarë nga balta, i pastruar shtatë herë!

8 Por ti, o Zot na ruaj, na mbro përherë prej kësaj breznie të mbrapshtë

9 e atëherë le të sillen rreth nesh keqbërësit, le të rritet, në dashtë, fundërria e njerëzve!

KOMENTARI

Sfondi fillestar i këtij psalmi është i panjohur. Mund të ketë pasqyruar kushtet në kohën e mbretërimit të Shaulit (krhs. 1 Sam. 23, 11, 19 +; 26, 19) por gjithashtu mund t'i përgjigjet çdo kohe para mërgimit, posaçërisht në shek. VIII dhe VI. p.e.s. (krhs. Hos. 4, 1 +; Mik. 7, 2 +; Is. 33, 7-12; Jer. 5, 15). Do të jetë përdorur në kult si vajtim i komunitetit me udhëheqës (mbret) në krye i cili e recitoi psalmin.

rr. 1-4, Thirrje në "betejën e fjalëve". Prift ose profeti do të përgjigjej me orakullin hyjnor te rr. 5, me premtim për shpëtim; kurse komuniteti do të përgjigjej me 'Amen' te rr. 6-8, siguria që në çdo situatë fjala e Perëndisë është e besueshme.

2. *besnikët*. Heb. *hasid*, njeriu që ushtron *hesed* (see on 5, 7), i.e. njeriu që është besnik ndaj kërkesave të besëlidhjes në marrëdhëniet e tij me Zotin dhe me njerëzit. (krhs. 18, 25; 86, 2; 109, 16), por posaçërisht njeriu që i është kushtuar shërbimit të Zotit.

5. *usne*: figurë letrare (sinekdoke) ku një pjesë përfaqëson tërësinë: të këqijtë do të shkatërrohen (krhs. Am. 2, 3). Fuqia e fjalëve për të shfrytëzuar, të mbizotëruar dhe të shkatërruar është e njohur gjithkund në Bibël (krhs. Dan. 7, 20, 25; Jak 3, 5 etj.; 2 Pjet. 2, 1 +; Apok. 13, 5 etj.).

7. *Fjalët*: Fillimisht orakull i dhënë psalmistit ose drejtpërsëdrejt (sepse ishte vetë profet krhs. 2 Sam. 23, 1 etj.) ose nëpërmjet priftit ose profetit të shenjtërores (krhs. 1 Sam 15,17; 1 Mbr. 37, 15 etj., 21 etj.).

8. *çiltër*: d.m.th. i vërtetë, i besueshëm

argjend: në lashtësi argjendi ishte më i vlefshëm se sa ari dhe përdorej në tregti. Prandaj pastërtia e tij ishte e rëndësishme.

PSALM 13

Klithma me shpresë

Për mjeshtrin e korit. Psalm. I Davidit.

2 E deri kur, o Zot, do të më harrosh krejtësisht? Deri kur do ta fshehësh fytyrën tënde prej meje?

3 Deri kur do t'e' shqetësohem në shpirt, në zemrën time do të kem trishtim për çdo ditë? Deri kur armiku do të më rrijë shqipe mbi krye?

4 Shih e më ndihmo, o Zot, Perëndia im! Ndriti sytë e mi që të mos më kapë gjumi i vdekjes,

5 të mos thotë armiku: »Ngadhënjeva mbi të!«, që të mos gëzohen salvuesit nëse rrëzohem ndonjëherë.

6 Por unë jam i sigurt në dashurinë tënde, le të galdojë shpirti im në shpëtimin tënd! Do t'i këndoj Zotit, Bamirësit tim!

KOMENTARI

Skenari këtu është i njëjtë si te Psalmet 9 – 12, Davidi është i rrethuar nga armiqtë, por ai ka ndër mend një armik të veçantë (2, 3). Fakti se Davidi nuk lutet për shkatërrimin e tij, do të thotë se bëhet fjalë ose për Shaulin (1 Sam. 26,9 etj) ose për Avshalomin (2 Sam. 18,5).

Në këtë psalm shprehen dëshirat e mëdha më të thella të shpirtit të shqetësuar. Megjithëse në prapëskenë është armik personal, psalmisti lufton me dyshimet e tij rreth veprimtarisë së Zotit për hir të tij. Meqë nuk ka aludim për sëmundje problemi do të jetë frika e tij.

Pa dyshim harresa dhe fshehja e fytyrës së Zotit shënon tërheqjen e ndihmës praktike, sepse te DhV kujtimi dhe shikimi i Zotit shënojnë përgatitje për veprim. Shoqëria e tij me Zotin u errësua – Zoti kishte fshehur fytyrën e tij (11,8; 17,16; krhs. 27,5, 9; 34,6). shih edhe Job 29, 1 +; 30,20 sl., dhe Psalm 22,2 etj.

PSALM 14

Njeriu që s'beson në Perëndinë

Mjeshtrit të korit. I Davidit.

Tha i marri në zemrën e vet: »Nuk ka Perëndi! « U prishën të gjithë, veprat e tyre të urreyeshme, s'ka më njerëz të ndershëm!

2 Prej qiellit Zoti vëren drejt bijve të njerëzve që të shohë në ka ndonjë njeri të mençëm, ndonjë që e kërkon Perëndinë.

3 Të gjithë e lanë rrugën, të gjithë së bashku u prishën, s'kanë mbetur asi që bëjnë mirë, – s'mbeti asnjë!

4 A thua s' do të zënë mend ata që bëjnë keq, ata që përpjnë popullin tim siç e hanë bukën? Nuk e thërrasin në ndihmë emrin e Zotit,

5 pra, një ditë do të dridhen prej tmerrit, sepse Perëndia është me brezninë e të drejtëve.

6 Dëshironi ndoshta ta çoni huq synimin e të mjerit?
Dijeni veç se Zoti është strehimi i tij.

7 Izraelit i ardhhtë shpëtimi prej Cionit!

Kur ta kthejë Zoti popullin e vet nga robëria,
se ç' do të gëzojë Jakobi, se ç' do të galdojë Izrael!

KOMENTARI

Këtu ka një shembull të mirë për të treguar si u zhvillua psaltiri. Përveç disa ndryshimeve të vogla (posaçërisht. v. 6) ky psalm është identik me psalmin 53 Meqë psalmi 53 rrjedh nga një mbledhje të mëvonshme dhe zëvendëson Zotin me Elohim, psalmi 14 përfaqëson trajtën e tij më të herët. Në të dy psalmet autori sheh gjendjen e prishur të njeriut nga pikëpamja e shpirtit të tij profetik.

1-3. **Prishja e budallait.** Heb. *nabal* nuk do të thotë leshko, por njeri me mendime morale të prishura i cili me paramendim e ka mbyllur mendjen e tij ndaj realitetit të Perëndisë dhe ndaj rrjedhimeve të sundimit të tij moral. (krhs. Lp. 32, 5 +; 2 Sam. 13, 12 +; Is. 32,6; Rom 15,19, 22, 28). Ateizmi për të cilin bëhet fjalë nuk është teorik, por praktik. Fjalët «prishur, neveritshëm, shthurur» të gjithë shënojnë çoroditjen e një individi të tillë, i cili përfytyrohet si tipik për Izraelin.

4-6. **Prishja e priftërisë.** Ata që s'kanë dijeni do të jenë priftërinjtë, që hanë bukët e kushtuara dhe duhet t'i bëjnë thirrje Zotit. Në vend të kësaj, ata janë bërë keqbërësit. (krhs. Hos 1,4-6). Në vend të udhëheqin popullin e Perëndisë, ata e

shfrytëzojnë. Brezi i të drejtëve i referohet popullit tim, kurse skamnorët kanë strehë te Perëndia.

7. **Shpresa për çlirim.** Kjo lutje do të jetë shtuar për qëllimet liturgjike, ose mund të ketë shprehur një fije shprese në një kohë të errët.. Të kthejë robërit mund të ketë kuptim «të rimëkëmbjes të fatit të mirë». Pavarësisht nga datimi i kompozimit të këtij rreshti, shërben si konkluzion i përshtatshëm.

PSALM 15

Miku i Zotit

Psalm. I Davidit.

O Zot, e kush do të guxojë te hyjë në tendën tënde? Kush do të guxojë të banojë në malin tënd të shenjtë?

2 Vetëm ai që jeton me nder, që vepron me drejtësi e prej zemrës flet të vërtetën,

3 që s'i shpifet kujt me fjalë, që të afërmin s'e dëmton, që shokun nuk e çnderon:

4 ai që keqbërësin e mban për asgjë e i çmon ata që e druajnë Zotin, ai që i përbehet dashamirit të vet dhe ia mban fjalën,

5 nuk jep të holla me kamatë e nuk merr ryshfet kundër të pafajshmit.

Kush vepron kështu kurrë e për këtë jetë nuk do të luhatet.

KOMENTARI

Ky psalm i urtësisë është komentari për detyrat e njeriut ndaj Perëndisë dhe ndaj njeriut siç shpjegohet te Lp 6,5 dhe Lev 19,18. Ka të bëjë me kushtet morale dhe etike për të lejojë që

adhuruesi të hyjë në praninë e Zotit. Sipas dëshmisë arkeologjike e kishte zakon në Lindjen e mesme t'u njoftohet adhuruesve për kushtet e hyrjes në tempull. Ka mundësi që ky psalm të jetë përdorur për këtë qëllim dhe më vonë në tendën e shenjtë në kohën e Davidit dhe pastaj në tempullin e Jerusalemit.

(rr. 1). Atëherë prifti ose leviti do të japë përgjigjen (rr. 2-5b (krhs Mal. 2,7). Megjithëse ka mundësi të gjejmë dhjetë kushte këtu (krhs. dekalogu nga Dal. 20), më mirë të mbajmë rr. 2 si përgjigje të vërtetë kurse rr. 3-5b si furnizim i disa shembujve. Rreshti 5c mund të jetë shtesë e mëvonshme kur psalmi përdorej për qëllime didaktike. Liturgji hyrjeje të ngjashme gjenden te Ps. 24, 3-6 dhe Is. 33, 14-17; dhe mësim profetik i këtij lloji gjendet te Mik 6, 6 +; Jer. 7, 1-11; Ezek. 18, 5-9; 44, 5 f

Krishti shihet si plotësimi i idealit të parashtruar te ky psalm kur hyri në praninë e Perëndisë pasi kishte bërë një jetë të përsosur (krhs. Heb. 4, 14 +; 7, 26).

në tendë: do të jetë aludim për tempullin (krhs. Ps. 27, 4-5; Is. 33, 20).

në malin e shenjtë: Mali i Cionit, i veçuar nga prania e Zotit. Cioni ishte emri i parë ose i kështjellës jevusase ose i malit në të cilin gjendej (krhs. 2 Sam. 5, 7); por pastaj u transferua si sinonim për tempullin (Ps. 132, 13; Mic. 4, 2) dhe më në fund si sinonim për mbarë qytetin (krhs. Is. 10, 24; Am. 6, 1) të cilin Zoi adoptoi si qyteti i tij. (48, 1 +).

2. *jeton me nder*. Heb. *tamim* do të thotë 'i plotë', 'patëmetë',; e jo 'i përsosur', por 'pa të metë të dukshme' (krhs. 19, 13), 'jetë të drejtë', me 'zotim të plotë' (krhs. Lp. 18, 13). Këtu nënkuptohet integritet, çiltërsi, devotshmëri ndaj Zotit dhe Ligjit të tij me gjithë zemër (krhs. Zan. 17, 1; Ps. 119, 1).\

vërtetë: i besueshëm.

3. *fqinj*: njeriu.

4. *ai që bakëqin*: keqbërës i shqyer i braktisur nga Zoti.

5. *nuk jep të holla me kamatë*: Dhënia e të hollave me kamatë ishte i ndaluar nën ligjin izraelit. (krhs. Dal. 22, 25; Lev. 25, 36 +), por i lejuar në rastin e marrëveshjeve tregtare me të

huajt (krhs. Lp. 23, 20). Kamata në Mesopotaminë e lashtë mund të ishte me 50% në vit.

merr rryshfet. Korruprim ishte tundim për gjyqtarët si edhe për dëshmitarët.

nuk do të luhatet. një njeriu të tillë jo vetëm i lejohet të hyjë në shenjtërore, por porsì çdo mysafir në Lindjen e mesme, do të jetë vazhdimisht nën mbrojtjen e mikpritësit.

PSALM 16

Zoti – pjesa e trashëgimit tim

Miktam. I Davidit.

Më ruaj, O Perëndi, sepse të kam rënë ndore!

2 I thashë Zotit: »Ti je Zoti im, tjetër të mirë nuk kam veç teje!«

3 Për shenjtërit që janë përmbi tokë, njerëz bujarë, po përvëlohem krejtësisht prej dëshirës!

4 I shumojnë të zezat e veta ata që shkojnë pas zotave të huaj. Unë nuk do t' u flijoj fli njomjeje gjakrash, buzët e mia nuk do t' ua përmendin emrat.

5 Zoti është pjesa e trashëgimit tim dhe gota, në dorën tënde është fati im!

6 Shorti më ra në më të mirën tokë: pjesa e trashëgimit tim më pëlqen!

7 E lavdëroj Zotin që më dha kuptim, edhe natën veshkat e mia më mësojnë.

8 Zotin e kam gjithmonë para sysh, më rri në të djathtë, nuk kam sesi të rrëzohem!

9 Prandaj galdon zemra ime, gëzon shpirti im, mbarë trupi im pushon në qetësi.

10 S'do të ma lësh shpirtin në Nëntokë, as s'do të lejosh që Shenjti yt të kalbet në dhe.

11 Ti do të ma tregosh udhën e jetës, gëzimin e plotë para fytyrës sate, kënaqjen e amshueshme në të djathtën tënde.

KOMENTARI

Ky psalm i besimit, siç duket, e ka prejardhjen në përvojën e ruajtjes nga vdekja e parakohshme; është pothuajse falënderimi për të kaluarën si dhe shprehje besimi për të ardhmen. Kjo do të jetë përvoja e Davidit si bandit jashtë ligjit. (rr. 4-6, krhs. 1 Sam. 26, 19+).

Hyrja e parë dhe dëshmimi i fesë (rr. 1, 2) nënkupton se megjithëse kriza mund të ketë kaluar, psalmisti ende ka nevojë për mbrojtjen e Zotit.

Vargjet 3, 4 janë të vështirë për të shpjeguar, por siç duket japin kontrast ndërmjet besimtarëve dhe apostatëve (atyre që janë të joshur nga paganizmi) të shoqërisë izraelite; autori identifikohet me grupin e parë dhe veçohet nga grupi i dytë (Vargjet 1-4 mund të kuptohen si një strofë e vetme.)

Vargjet 5-8 shprehin vetëdijen e autorit se te Perëndia ka gjithçka që i duhet për një jetë të lumtur dhe të sigurt. Në fund vgr. 9-11) ai gëzohet me besimin se Perëndia do ta ruajë nga vdekja, kështu që mund të gëzojë një jetë edhe më plotësuese të atij që gëzon praninë dhe bekimin e Perëndisë së tij në çdo kohë..

Shumë komentues shohin rr. 9-11 si besim (ose shpresë) në jetën pas vdekjes, ose me anë të ringjalljes (krhs. Dan. 12, 2) ose nga transferim në qiell (shih edhe komentin për Ps. 49, 15; 73, 24). Ky konkluzion sigurisht shkon tepër larg; shqetësimet e tij merren me këtë jetë e jo me jetën jashtë varrit. Ka kontrast ndërmjet jetës me Perëndinë dhe jetës pa Të. Sidoqoftë rrjedhimet e besimit të tij te Perëndia parashikojnë mundësinë e jetës së përjetshme në praninë e Perëndisë. 'Besimtari *hasid* (i devotshmi) që jeton për nder të Perëndisë nuk e quan vdekjen

realitet kërcënues. në praninë e Perëndisë vepruese vdekja humb rendësinë e saj'. Predikuesit e kishës së hershme, duke u themeluar në përkthimin e Septuagintës të rreshtat. 8-11, i quanin këto fjalë profeci për ringjalljen e Jezusit (Veprat 2, 24-31; 13, 34-37; krhs. Lk. 24, 44 +). Atë për të cilën psalmisti bënte aludim, u realizua për besimtarët nëpërmjet veprës së Krishtit (krhs. Jn 5, 28 +; 6, 47, 54; 10, 10; 2 Tim. 1, 10).

6. *shorti*: parcelat e tokës të matura sipas linjes. (krhs. Jos. 17, 5). Te rr. 5, 6 psalmisti interpreton shpirtërisht një traditë të lashtë: kur tokën e Kananit e ndanin me short në dobi të fiseve izraelite, fisi i Levit nuk mori pjesën e tij, sepse vetë Zoti do t'i jepte prodhimin e tokës nëpërmjet sistemit të të dhjetave.

7. *kuptim*: krhs. v. 11a; i dhënë me profeci, në ligjin e shkruar (krhs. 73, 24) ose me ndërgjegje (krhs. zemra).

zemra: fjj. 'veshkat', qendra e emocioneve dhe dëshirave të thella; këtu ekuivalenti i 'ndërgjegjes'.

mëson: disiplinon, ndreq.

8. *e kam parasysht*: duke iu përmbajtur ligjit.

trup: Hebr. *basar* mund të shënojë pjesën fizike të kafshëve dhe njerëzve (fjj. Zan. 40, 19) prandaj përfytyron trupin përgjithësisht (krhs. 79, 2; 109, 24). Fjala mund të shënojë ose 'njeriun' ose 'njerëzimin'. Megjithatë në këtë rresht, 'trup' përfytyron 'mbarë personin' (krhs. 38, 3; 63, 1; 84, 2) dhe s'ka asnjë kontrast ndërmjet 'zembrës' dhe 'shpirtit'. Ndërsa ka shpeshherë theks në dobësinë e trupit, në DhV kurrë nuk mbahet si thelbësisht i keq. (krhs. Rom. 8, 3 +).

nëntoka: Hebr. *sahat*, tj. varri; sinonim për *Sheolin*, *botën e të vdekurve* (krhs. 49, 9). Te Septuaginta prejardhja e ka nga folja 'shkatërroj', 'prishet', dhe përkthehet si 'prishje'.

ii. *udhën e jetës*: 'jeta në të cilën besimtarët mund të realizojnë fatin e tyre; krhs. Prov. 4, 18; 5, 6; 9, 23; 10, 17; 15, 24.

para fytyrës sate: d.m.th. në praninë tënde.

kënaqjen e amshueshme: ka të ngjarë 'sa të zgjasë jeta' (krhs. Exod. 21, 6; shih edhe Ps. 23, 6).

PSALM 17**Lutja e të pafajshmit**

Lutja. E Davidit

Dëgjoje, o Zot, çështjen me të drejtë, vështroje lutjen time,
Vëji vesh lutjes sime që del nga buzët jostiracake.

2 Prej teje le të më vijë vendimi gjykues, sepse vetëm sytë
e tu shikojnë të drejtën.

3 Sprovoje zemrën time, vëreje atë natën, më sprovo me
zjarr: në mua nuk do të gjesh padrejtësi.

4 Goja ime s'gabon siç veprojnë njerëzit, në saje të fjalëve
të buzëve të tua iu shmanga udhës së mujsharit.

5 Mbaj hapat e mi brenda shtigjeve të tua, që këmbët të
mos më marrakoten.

6 Në ndihmë të thërras ty, O Perëndi, e më vështro, ma
prir veshin tënd e dëgjo fjalët e mia,

7 madhëroje mbi mua dashurinë tënde, ti që i shpëton nga
armiku ata që shpresojnë në të djathtë tënde.

8 Më ruaj porsia beben e syrit, më fsheh nën hijen e
krahëve të tu,

9 prej syve të të pabesëve që po më përndjekin. Armiqtë e
mi të tërbuar po më rrethojnë gjithkah,

10 nga zemra e padhimshme goja u flet kreni.

11 Ja, po më afrohen tani po më rrethojnë m'i ngulën sytë
për të rënë përplasur për tokë.

12 Të ngjashëm me luanin i gatshëm pret pre, me zogun e
luanit që rri gati në pritë.

13 Ngrihu, o Zot, dili para, përplase përdhe, me shpatën
tënde ma shpëto jetën prej të paudhit!

14 Prej vdekatarëve nga dora jote, o Zot, prej vdekatarëve që s'kanë pjesë në jetë. Mbushua, ani, me të mirat e tua barkun, le të ngopen edhe fëmijët e tyre e le të teprojë edhe për foshnjat e tyre!

15 E unë në pafajësi do ta shikoj fytyrën tënde, e një ditë, kur të zgjohem, do të kënaqem me praninë tënde.

KOMENTARI

Ky vajtim i individit (ose psalm i pafajësisë) dë të ketë qenë i përshtatshëm për përdorimin në tempull nga ana e njeriut të paditur padrejtësisht (shih Ps. 5 dhe 7), ose nga mbreti posaçërisht si zëvendës i popullit. Vargjet 3 dhe 15 mund të bëjnë të kuptosh se kërkuesi do të kalojë natën në shenjtërore (krhs. 2 Sam. 12, 6) duke shpresuar të marrë përgjigjen hyjnore ose me ëndërr (krhs. 1 Mbr. 3, 5) ose nëpërmjet priftit ose gjyqtarit (krhs. Lp. 17, 8-12) të nesërmen në mëngjes. Ky psalm mund të ketë për prejardhje periudha kur Davidi ishte bandit. (krhs. 1 Sam. 24, 12-15).

Rendi i mendjes është i qartë, me gjithë disa vështirësi rreth përkthimit. Te rr. 3 +, 14. Në rr. 1, 2 psalmisti i bën thirrje Perëndisë për të dëgjuar kërkesën e tij për drejtësi, dhe te rr. 3-5 shpall edhe pafajësinë nga krimet për të cilat paditet (krhs. 7, 3-5) si dhe integriteti i përgjithshëm i jetës së tij (por s'ka pretendim për përsosuri). Te rr. 6-9 ai përtërit lutjen e tij për mbrojtje duke besuar se i drejtohet Perëndisë së fuqishme dhe dashurisë (rr. 7a); ndërsa rr. 10-12 përshkruajnë pazemërsinë e armiqve të tij ndërsa i afrohen atij. (krhs. 1 Sam. 23, 25 +). Vargjet 13, 14 janë thirrje për hakmarrje dhe shpagim, e cila do të zgjasë madje edhe në gjeneratën vijuese. (krhs. Dal. 34, 7). Rreshti i fundit (rr. 15) është ripohim (ose lutje) që psalmisti do ta shohë Perëndinë jashtë varrit (krhs. Job 19, 27), shpallur në favor të tij, dhe kështu do sigurohet për praninë dhe bekimin e tij të vazhdueshëm (rr. 16, 11).

lutje – f.fj. drejtësi, d.m.th. lutja e drejtë.

drejtësi: Hebr. *cedaqah** do të thotë pajtim me një standard, qoftë shoqëror, qoftë hyjnor. Kur kjo shprehje lidhet me Perëndinë, do të thotë ose drejtësia e tij morale dhe konsekuencë (drejtësi), ose veprimtaria e tij për të shkaktuar marrëdhënie të drejta (shpallja e pafajësisë). Prandaj mund të përshijë çlirim, justifikim dhe fitore për popullin e tij, hakmarrje dhe ndëshkim për të këqijtë (krhs. 22, 31; 40, 9 +; 51, 14; 65, 5; 69, 27; 71, 24; 103, 6; 119, 75).

7. *në të djathtën tënde*: mund të shënojë ose me anë të fuqisë sate ‘ (krhs. 20, 6; 60, 5) ose ‘ata që ngrejne krye kundër fuqisë sate, ose në të djathtën tënde, pranë teje janë në siguri.

8. *nën hijën e krahëve të tu* : krhs. Ru. 2, 12; aludim ose për kerubimët që rrinë mbi arkën (krhs. 1 Mbr. 8, 6 +; Ps. 61, 4; 80; 1) ose për zogjtë mëmë (krhs. Dr. 32, 11; Ps. 91, 4; Mt. 23, 37).

8. *porsi beben e syrit*. Sikurse ne instinktivisht lëvizim për të mbrojtur sytë e vet, ashtu Davidi pret një reagim instinktiv hyjnor nga ana e Zotit, për ta mbrojtur.

15. *në pafajësi*: ‘për justifikimin tim’ ose ‘si përkrahës i drejtësisë’ (see on 33, 5), e jo ‘sepse unë jam i drejtë’.

kur të zgjohem: këtu mund të ketë aludim për ringjallje (krhs. Is. 26, 19; 2 Mbr. 4, 31; Dan. 12, 2), ose këtu për zgjimi nga gjumi i zakonshëm. Te psalmet agimi është koha kur Zoti i përgjigjet lutjes (krhs. 5, 3; 30, 5; 57, 8) dhe jep një dijeni për praninë e tij (krhs. 139, 18), posaçërisht në tempull.

PSALM 18

Këngë falënderimi e mbretit

1 Mjeshtrit të korit. E shërbëtorit të Zotit, Davidit, që ia drejtoi Zotit fjalët e kësaj kënge, kur Zoti e kishte shpëtuar nga pushteti i të gjithë armiqve të tij

2 dhe nga dora e Shaulit. Ai tha: Të dua, o Zot, fuqia ime!

3 Ti, o Zot, je Qeta ime, Kështjella ime, Streha ime,
Shpëtimtari im! Perëndia im, Ndhimëtari im, në Të shpresoj!
Ai është Mbrojtësi im, fuqia e shpëtimit tim, ndorja ime!

4 Në ndihmë do ta thërràs Zotin tejet të lavdishëm, dhe do të shpëtoj nga armiqtë e mi.

5 Më rrethuan valët e vdekjes, më tmerruan përrenjtë e Belialit,

6 më lidhën leqet e Nëntokës. Po më shtrëngonin prangat e vdekjes:

7 atëherë në ngushtimin tim, ndore i rashë Zotit, kushtrim i lëshova Perëndisë tim:

nga Tempulli i tij dëgjoji zërin tim, britma ime i mbërriti përpara në veshët e tij!

8 Toka u tund edhe u tund, u lëkundën themelet e maleve, vendit u shkundën, sepse Ai u zemërua!

9 Njëpër vrima të hundës' tym ngufoi, prej gojës zjarr e flakë buçiti, prush i gjallë prej tii flakëroi!

10 I uli qiejt, poshtë zbriti, nën këmbë re të murrme!

11 Kaluar mbi kerubin fluturoi, lundroi mbi krahët e erërave!

12 Si me vel me errësirë u mbështoll, tenda e tij – errësirë uji, re përmbi re,

13 para fytyrës së tij zhdukeshin retë me breshër e prush të gjallë!

14 Gjëmat e motit qiellit gjëmuan: i Tejetlarti bëri t'i dëgjohei zëri: breshër e prush zjarri!

15 I lëshoi shigjetat dhe, i shpëmdau ata, i lëshoi rrufetë dhe i tmerroi ata.

16 Atëherë u dukën burimet e ujërave, u zbuluan themelet e rruzullit prej qortimit tënd, o Zot, prej erës së frymës së hidhërimit tënd.

17 Shtriu dorën prej majës e më mori, më nxori nga ujërat e shumta,

18 më shpëtoi nga armiku i forte, prej atyre që më urrenin, që ishin më të fortë se unë.

19 Më sulmuan në ditën më të keqen, por Zotin e pata krah,

20 Ai më qiti në vend të shpëtimit, më shpëtoi sepse më kishte, për zemër.

21 Zoti më shpagoi sipas drejtësisë sime, më shpërbleu sipas pastrisë së duarve të mia, 22 sepse unë i mbajta udhët e Zotit, nuk u largova prej Perëndisë tim.

23 Të gjitha gjyqet e tij i kam para sysh, dhe urdhërimet e tij nuk i largova prej meje.

24 Jam i pastër para syve të tij, sepse ruhem vazhdimisht prej mëkatit.

25 Zoti më shpërbleu sipas drejtësisë sime, sepse e pa pastrinë e duarve të mia.

26 Ti je i mirë me njerin e mirë, me të pafajshmin je i pafajshëm,

27 me të mbrapshtin ti je i squet.

28 Ti e shpëton popullin e pëmjtë, e krenarët i bën t' i ulin sytë.

29 O Zot, ti e ndez dritëzën time, ti, O Perëndi, e ndriçon terrin tim.

30 Me ty do t' i sulmoj turmat e armiqve, me ndihmën e Perëndisë tim do t' i kapërcej muret.

31 Udha e Perëndisë është krejtësisht e pastër, fjala e Zotit është e sprovuar me zjarr: Ai është Mbrojtësi i të gjithë atyre që shpresojnë në të.

32 Sepse kush tjetër është Perëndi përveç Zotit? Kush tjetër Qetë shpëtimi përveç Perëndisë sonë? 33 Perëndia që më ngjesh me fuqi, që e bën udhën time te pastër.

34 Ai m'i dha këmbët e shpejta si të drerëve, ai më vendosi mbi bjeshkët e larta.

35 Ai m'i ushtron duart për luftim, krahët e mi për t'c' përdorur harkun e bronzit.

36 Ti ma dhe mburojën e shpëtimit tënd, e djathta jote më ndihmoi, mirësia jote më rriti.

37 Ti i zgjeron hapat e mi nën mua e këmbët e mia më nuk më merren.

38 I ndiqja armiqtë e mi e i zija, prapazi nuk u ktheja derisa i shfarosja.

39 1 dërrmoj a e në këmbë s'mund të qëndronin, rrezoheshin përnën këmbët e mia.

40 Ti më ngjeshe më fuqi për luftë, kurse armiqtë e mi i vure nën mua.

41 Armiqtë e mi i bëre të më kthejnë shpinën, kurse ata që më urrejnë i shpërndave.

42 Dhanë kushtrimin, por askush s'i shpëtoi, thirrën edhe Zotin – por ai s'u përgjigj.

43 1 grimcova porsi pluhurin para erës, i shkela porsi baltën e rruges.

44 Ti më shpëtove nga kundërshtimi i popullit tim, kryeparë më bëre ndër popuj paganë: më shërbeu populli që as nuk e njihja!

45 Fjalën time e dëgjojnë me poni, bijve të huaj u duhet të më përkëdhelin,

46 para meje të huajve ora u liget, u dridhën në strehimet e veta.

47 Është Zoti! Lavdëroftë Qeta e strehimit tim! Qoftë madhëruar Perëndia, Shpëtimtari im!

48 Perëndia që ma bën të mundshme të shpaguehem! Ti i shtron popujt nën mua, ti që më liron prej armiqve të mi të hidhur,

49 ti më lartëson përmbi kundërshtarët e mi, ti më shpëton prej njeriut mujshar.

50 Prandaj, o Zot, do të të lavdëroj ndër paganë, himne gëzimi do t' i këndoj emrit tënd!

51 Zoti ia shumon fitoret mbretit të vet, e përkrah të shuguruarin e vet,

Davidin e pasardhësit e tij deri në amshim!

KOMENTARI

Si Davidi, i prerë për të dhënë mend pas kuvendit, ai e di se vetëm Perëndia e Sinait do ta ketë realizuar këtë çlirim. (rr. 7-8; Dal 19,18), fatkeqësitë që ranë në Egjipt (9-12; Dal 9,13sl; 10,21sl), mrekullinë e Detit të Kuq (15), Zoti që ka vepruar me shenjtëri, gjykim dhe çlirim. Ky është kuptimi i gjuhës së figurshme: prapa të gjitha rrethanave gjendet veprimtaria mbinatyrshe e Perëndisë. Për çudi, edhe ne jemi aq të rëndësishëm sa edhe ishte Davidi në DhV.

Ky psalm përmban gjuhën e figurshme që na vret mendjen. Te rr. 10 flitet për Zotin që zbret për ta ndihmuar, duke ngasur kerubin (një engjell i fuqishëm). Stuhitë dërgohen për ta çliruar (Josh 10,11) por jo në historinë e Davidit; megjithatë era e Zotit ka hapur rrugën nëpër Detin e Kuq, (Dal 14,21; 15,10), por asnjë

ngjarje e tillë nuk regjistrohet te Davidi. Davidi u çlirua me mjete të ndryshme: një sulm filistin, (1 Sa 23,26f), egërsia e terrenit (1 Sa 24,1-3), ndërgjegjja e ndikueshme e Shaulit (1 Sam 24,26), ose madje edhe ikja (1 Sa 27,1). Një jobesimtar mund t'ua atribuojë këto çlirimet rrethanave, por Davidi e di mirë: Perëndia i drejton këto rrethana.

E megjithatë lutja e vazhdueshme luan një rol të rëndësishëm në të gjitha këto. Te rr. 2 njoftohet se Davidi vazhdonte të thërriste ...dhe Zoti ia plotësoi lutjen. Bëhet fjalë për fuqi sovrane që pret për t'u vënë në veprim me anë të lutjes. Perëndia është që shtyn njerëzit për t'iu lutur Atij, kështu që në fund nderohet Ai. Lutja e shërbëtorit të Perëndisë është vepruese sepse bëhet nga fëmija e tij, ose në terminologjinë e DhV, bëhet në favor të Perëndisë, Zotit të besëlidhjes i cili quhet Zoti im, i cili bëhet i afrueshëm (në tempull) dhe dëgjon personalisht (veshët).

Por efikasiteti i kësaj marrëdhënie varet nga ndjekja aktive e drejtësisë (sjellja e drejtë) nga ana e Davidit dhe angazhimi i vendosur për shenjtëri.

PSALMI 19

Zoti Dielli i drejtësisë

Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.

2 Qiejt e shpallin lavdinë e Perëndisë, kupa qiellore kumton veprat e duarve të tij!

3 Dita ditës ia përsërit këtë gjë e nata natës ia sjell këtë të vërtetë.

4 E, pra, nuk është fjalë as zhumhur të të foluri, po as zë që do të mund të dëgjohet,

5 megjithëse nëpër tokë i shpërndahet jehona, diçka si fjalë arrin deri në skaj të botës!

6 Diellit në to ia ngrehu tendën: del dielli si dhëndër nga dhoma martesore, thua vigani pash më pash i bie sheshit!

7 Në njërin skaj të qiellit lindjen e ka, udha e tij kapet në skajin tjetër, asgjë s'mund t'u fshihet rrezeve djegëse të tij.

8 I përsosur është Ligji i Zotit, shpirtin përtërin; për t'u besuar është Dëshmia e Zotit, të miturve u jep dijen,

9 Urdhërimet e Zotit janë të drejta, kënaqin zemrën; urdhri i Zotit është i qartë, dritë u jep syve.

10 E panjollë është frika e Zotit, nuk ndërron në shekuj të shekujve; gjyqet e Zotit janë të vërteta, të gjitha njënjë të drejta.

11 Më të çmueshme se ami, se më i pastri ar, më të ëmbla se mjalti, se hoja që rrjedh mjaltë.

12 Shërbëtori yt me kujdes i mëson: t'i pashë ato është fitesë e madhe.

13 Porse kush i heton gabimet? Më pastro, o Zot, prej mëkateve të fshehta,

14 ruaje shërbëtorin tënd, o Zot, prej krenisë që të mos më zotërojë ajo, atëherë do të jem i patëmetë, i pastër krejtësisht prej mëkatit të madh.

15 Të pëlqefshin, o Zot, fjalët e gojës sime, edhe mendimi i zemrës sime para teje, o Zot, Ndihmësi im e Shpëtimtari im!

KOMENTARI

Ky psalm u klasifikua si psalm i lavdërimit.

Pjesa e parë merret me krijimin e Perëndisë dhe me mënyrën si është nën kontrollin e Tij dhe shërben për ta adhuruar (si në rrëfimin e krijimit të Zanafilla). Në pjesën e parë del në pah dielli – krahasohet me dhëndrin njerëzor, me veshje madhështore, i cili

niset për të shkuar në shtëpinë e nusës për ta kërkuar. Por dielli është nën komandën e Zotit dhe duhet të vrapojë në një garë dhe ka një trajektore për të ndjekur. Përveç kësaj trupat qiellorë shërbejnë për të zbuluar përsosmërinë e krijesës së Perëndisë. Megjithatë ata nuk mund të shqiptojnë ose të transmetojnë një mesazh të saktë (rreth shpëtimit – ata janë pjesë e zbulimit të përgjithshëm të Perëndisë – vetëm fjala e shkruar mund ta bëjë, ka mundësi që çdo shënje e zodiakut të ketë shënuar rrugën e shpëtimit.

Pjesa e dytë e psalmit merret me zbulimin e Zotit nëpërmjet fjalës së shkruar, posaçërisht te Tora. Kjo pjesë hyn në hollësi në lidhje me kategoritë e ndryshme të Ligjit.

Emrat që përdoren janë si vijon:

Ligji (*Tora*): është term gjithëpërmbledhës që do të thotë “vullneti i zbuluar i Perëndisë për besimtarin.”

Dëshmitë (*edut*) u referohen kushteve të besëlidhjes – teksti i kontratës me shkronja të mëdha.

Rregulla (*piqudim*) u referohen hollësive të vogla të jetës. Ato janë teksti i kontratës me shkronja të vogla.

Urdhërat (*mitsvot*) janë ato ligje që u duhen bindur sepse Perëndia është Zot.

Gjykimet (*mishpatim*) janë vendime gjyqësore që bëjnë ligjet. Këto janë të drejtat e mbështetura në praktikën e mëparshme

Dekretat (*huqim*): dekrete mbretërore

Së bashku këto terma vëjnë në pah qëllimin praktik të zbulimit – që besimtari të ndikohet nga vullneti i Zotit që të ngjallë një përgjigje inteligjente të frikës dhe besimit të mirëmbështetur dhe bindjes në hollësi. Ka mbiemra të ndryshëm për të përshkruar ligjin.

i përsour: gjithëpërmbledhës

i sigurt: i vërtetuar nga përvoja

i vërtetë: i besueshëm

i drejtë: i thjeshtë, përsa i përket drejtësisë morale

i shkëlqyeshëm: i çiltër, i liruar nga ndotja

i pastër: i patëmetë

i drejtë: në rregull, ajo që i përgjigjet normës.
 i embël: për t'u gëzuar
 i çmuar: me të drejtë i dëshirueshëm.

Pjesa e fundit merret me zbatimin personal. Mësimi moral i Perëndisë, që shërben si paralajmërim, mund ta çojë individin në shpërblesën e dëshiruar. Meditimi për mësimet e Perëndisë shërben si pasqyrë për të nxjerrë në dukje njeriun e brendshëm (krhs. Jakobi 2). Prandaj psalmisti përfundon duke kërkuar forcën për të dalë fitimtar mbi të gjitha llojet e mëkatit dhe të gjendet i pranueshëm. Këto përfshijnë:

gabim: shkarje
 faj: deri këtu i panjohur
 vepër i paramenduar: shkelja e ligjit të Zotit
 mëkat: rebelim i hapur kundër mbikëqyrësit.

Si ka mundësi të vazhdoj në një jetë të tillë? Vetëm duke iu afruar vetë Zotit me forcat e tij, me besueshmërinë e tij, në dashamirësinë e tij si shpagimtar.

Shërbëtori është personi që ndërmerr të kryejë vullnetin e tjetrit, në këtë rast atë të Zotit të besëlidhjes.

Ai kërkon të jetë i pranueshëm nga Perëndia. Fjala “i pranueshëm” e ka prejardhjen në terminologjinë e kushtimit të flijimeve dhe do të thotë rikushtim i përgjigjes së përshtatshme të mendjes ndaj fjalëve të veta, si flijim i pastër. Përveç kësaj Perëndisë nuk drejtohet si paditës i mëkatarit ose gjyqtar, por si streha (shkëmb) dhe përkrahës i tij (shpagimtar).

PSALMI 20

Lutje për mbretin

Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.

2 Të dëgjoftë Zoti në ditë të vështirë, zot të daltë emri i Perëndisë së Jakobit!

3 Ta çoftë ndihmën prej Shenjtërores e të mbroftë nga Cioni!

4 i rëntë në mend për të gjitha flitë e tua, u kënaqtë në flinë tënde të shkumbimit!

5 I plotësoftë të gjitha dëshirat e tua, i çoftë në vend të gjitha synimet e tua!

6 U gëzofshim për ngadhënjimin tënd, lart i ngritshim flamujt për nder të emrit të Perëndisë! I plotësoftë Zoti të gjitha kërkesat e tua!

7 Tani po e di se Zoti e shpëton të shuguruarin e vet, e dëgjon nga qielli i vet i shenjtë me fuqi ngadhënjyese të së djathtës së vet.

8 Disa mburren me qerre e disa me kuaj: ne ne Emër të Zotit, Perëndisë sonë, jemi të fortë.

9 Ata rrëshqitën dhe u rrëzuan, ne qëndrojmë drejt, të pathyeshëm.

10 O Zot, shpëtoje mbretin tonë, na dëgjo kur të të thërrasim në ndihmë.

KOMENTARI

Ky është edhe një shembull për një psalm mbretëror, i cili përshkruan mbretin që është në prag të niset me trupat e tij për ta ballëfaqur armikun në betejë (në ditë të vështirë = krizë

kombëtare). Mbreti ka kushtuar lutjet dhe flijimet e tij, ka bërë planet e tij dhe ka grupuar burrat e tij nën flamurët e tyre.

Te rr. 1-5 kongregacioni i uron udhë të mbarë dhe i lutet Perëndisë për bekim.

Te rr. 6-8 mbreti përgjigjet dhe te rr. 9 bëhet lutja e fundit para se të shkojë në luftë.

Nga ana profetike ky skenar parashikon betejën e fundit në të cilën do të hyjë Mesia kundër të gjithë ata që kundërshtojnë popullin e tij (Psalm 110 dhe Apok 19).

PSALMI 21

Falënderim për kurorëzimin e mbretit

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.*

2 O Zot, mbreti gëzohet në saje të fuqisë sate, plot hare e mbush shpëtimi yt.

3 Ti ia plotësove dëshirën e zemrës së tij, nuk i përbuze lutjet e buzëve të tij.

4 Që më parë i dhe bekime të mëdha: mbi krye i vure kurorë ari të kulluar.

5 T'u lut për jetë e ti i dhe ditë të shumta – në jetë të jetës.

6 E madhe është lavdia e tij në shpëtimin tënd: e stolise me madhëri e me shkëlqim.

7 Ti e bërë bekim përgjithmonë, e kënaqe me gezim ne praninë tende.

8 Sepse mbreti shpresën e ka në Zotin, në saje të besnikërisë së të Lartit Zot s'do të tundet.

9 Dora jote do t'i mbërrijë të gjithë armiqtë e tu, e djathta jote do t'i gjejë ata që të urrejnë.

10 Ditën që të deftohesh furrë zjarri do t'i bësh, Zoti do t'i përpijë në zemërimin e vet, zjarri do t'i përlejë.

11 Farën e tyre do ta zhbish nga dheu, farën e tyre do ta zhdukësh prej mesit të njerëzve.

12 Kanë menduar të ta bëjnë të keqen, bënë sendërgjime: por s'do t'ia dalin.

13 Ti ke për t'i vënë në të ikur, harkun tënd do ta drejtosh në ta.

14 Ngrihu, o Zot, me fuqinë tënde, e ne do të këndojmë e do të vallëzojmë për ngadhënjimin tënd.

KOMENTARI

Ky psalm mbretëror vepron si vazhdim i psalmit 20, sepse lutja bëhet falënderimi për shkak të fitores së kohës së fundit. E njëjta strukturë antifonike do të jetë përdorur në adaptimin e psalmit për adhurimin në tempull. Disa komentues kanë sugjeruar se rasti duhet të jetë ditëlindje (krhs. rr. 4) ose kurorëzim i mbretit (krhs. v. 3).

1-7. **Falënderimi për plotësimin e lutjes.** Kongregacioni ose kori i tempullit ia drejton lutjen e mirënjohjes Zotit për një fitore të madhe. Çdo varg kontribuon për listën e gjërave që Zoti ka bërë për mbretin ose për hir të tij. Të gjitha këto bekime janë të lidhura me besimin e mbretit të Zoti.

8-12. **Shpresa për të ardhmen.** Fjalët tani i drejtohen drejpërdrejt mbretit, por në kuadër të adhurimit. Falënderimi vazhdon duke parashikuar fitoret e ardhshme derisa në fund të gjithë armiqtë të shkatërrohen.

13. **Doksologji mbyllëse.** Mbretëroftë supremi! Përsëri kori bashkohet në shprehjen përfundimtare të mirënjohjes dhe të lavdërimit, dhe kjo na kthen në figurën e forcës tek rreshti i parë.

PSALMI 22

Vuajtet dhe shpresat e të drejtit

1 *Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Shuta në agim«.*
Psalm. I Davidit.

2 O Perëndi, Zoti im, pse hoqe dorë prej meje?

Larg nga Shpëtimi im fjalët e dënësës sime!

3 Perëndia im, kërkoj ndihmë ditën e ti nuk më
 përgjigjesh, qes kushtrimin natën e nuk gjej pushim.

4 E, pra, ti je Shenjti që banon në lavditë e Izraelit.

5 Në ty shpresuan etërit tanë, shpresuan e ti i shpëtove!

6 Ty të thirrën në ndihmë e gjetën shpëtim, në ty e vunë
 shpresën e nuk u turpëruan!

7 Vërtet unë jam krimb e jo njeri, turpësi e njerëzve,
 përbuzje e popullit.

8 Gjithkush më shikon, më përqesh, shtrembërojnë buzët,
 luajnë me kokë:

9 »Shpresoi në Zotin: le ta lirojë, le ta shpëtojë sepse i
 pëlqen Atij!«

10 E, pra, ti më nxore nga kraharori i nënës, ti më bëje të
 sigurt në prehrin e nënës sime.

11 Në ndoren tënde jam që nga kraharori i nënës, qysh se
 më mbante nëna, ti je Perëndia im.

12 Mos qëndro larg meje sepse rreziku është afër e s'kam
 tjetërkënd që të më ndihmojë.

13 Më rrethuan dema të shumtë, mëzetërit e Bashanit më
 qarkuan,

14 përmnershëm e hapin gojën e vet në mua si luani që shqyen e ulërin.

15 Si uji u derdha, m'u zbërthyen eshtrat, m'u bë zemra porsi dylli, shkrihet brenda kraharorit tim;

16 porsi tjegull m'u tha qiellza, gjuha më ngetet për gurmaz: e ti më hodhe në pluhurin e vdekjes.

17 Më rrethuan qen me shumicë, turmë bakëqijsh më rrethuan gjithkah.

M'i shporuan duart e këmbët

18 mund t'i numëroj të gjithë eshtrat e mi, e këta më këqyrin e nuk m'i ndajnë sytë.

19 Petkat e mia ndër v ete i ndajnë, e mbi petkun tim qesin short.

20 Por ti, o Zot, mos rri larg meje, fuqia ime shpejto të më ndihmosh!

21 Ma shpëto jetën prej shpatës, prej dorës së qenit të vetmen të mirë që kam!

22 Më shpëto prej gojës së luanit, prej brirëve të buajve të egër mua të gjorin.

23 E unë do t'ua shpall vëllezërve emrin tënd, do të të lavdëroj në kuvendin e dheut:

24 »Ju që e droni Zotin, lëvdoheni atë, mbarë fara e Jakobit, lëvdoheni atë!

Të gjithë pasardhësit e Izraelit, nderojeni atë,

25 sepse nuk e përbuzi as s'e qiti në harresë mjerirnin e skamnorit, nuk e fshehu fytyrën e vet prej tij, por, kur i kërkoi ndihmë, e dëgjoi.«

26 Prandaj do të të lëvdosh në kuvendin e dheut, ndër sy të besimtarëve të tu do t'i kryej kushtet.

27 Do të hanë skamnorët e do të ngihen, do ta lavdërojnë Zotin ata që e kërkojnë: ‘Rroftë zemra e tyre për amshim!’

28 Do të kujtohen e do të kthehen te Zoti mbarë skajet e tokës, do të adhurojnë para tij mbarë familjet e kombeve.

29 Sepse Zoti është mbret! Ai i sundon kombet!

30 Atë, vetëm atë do ta adhurojnë të gjithë ata që pushojnë nën dhe

para tij do të përmbysen të gjithë ata që kthehen në pluhur.

Kurse shpirti im për të do të jetojë,

31 në shërbim të tij do të jetë fara ime, breznisë së ardhshme do t’i tregohet për Zotin,

32 për drejtësinë e tij do t’i tregohet popullit që vjen:

»Kështu bëri Zoti!«

KOMENTARI

Davidi fillon të meditojë në një temë të vajtimit personal, por ky shpejt (nën frymëzimin e Shpirtit të shenjtë) zhvillohet në profeci që nuk lidhet më me Davidin, por me pasardhësit e tij, Mesinë, dhe çka është mjaft domethënëse, nuk përmendet asnjë mëkat si shkak i telashit të penduesit, s’ka asnjë deklaratë pafajësie dhe as hakmarrje.

rr. 1-18 Nga ana tjetër, pësimtari ndihet i braktisur nga Perëndia, por edhe di se Ai është afër. Pas përkujtesës së besimit të paraardhësve të tij si dhe çlirimin e tyre, ai përshkruan veprimin përçmues të armiqve të tij.

rr. 4 përmban një ide të ngjeshur (siç ndodh shpesh në hebraishten). Thuhet për Perëndinë se “banon në lavdërimet e Izraelit” Kjo do të thotë se dinjiteti i tij i fronizuar njihet ndërsa populli i tij e lavdëron për gjërat e mëdha që ka bërë. Megjithatë

REB ka një përkthim tjetër: “Ti, objekti i lavdërimit të Izraelit, rri në fron në shenjtërore”. ose (GNB) “Ti rri në fron si i Shenjti, objekti i lavdërimeve të Izraelit”.

rr. 14-15 Psalmisti i ndjen thellësisht pasojat e largimit nga Perëndia. Uji dhe dylli shprehin gjendjen e njeriut të dërrmuar. Ai është i traumatizuar për shkak të izolimit

rr. 19-21 përfytyron lutjen e tij për çlirim.

rr. 22-26 përfytyron falënderimin e tij të hapur – dëshiron ta pranojë publikisht varësinë e tij nga Perëndia dhe të shpallë çlirimin e vet personal.

rr. 27-31 Si pasojë e pësimit të Shërbëtorit, shohim kthimin e njerëzimit drejt Perëndisë me adhurim. (Is 40,7; Fil 2,10), dhe kjo përfytyron dëshirat më të larta të Izraelit. (rr. 24), skamnorët ftohen në gosti (rr. 25), të gjithë janë të ftuar (rr. 29) dhe fjala do të përhapet për hir të brezave të ardhshëm (rr. 30-31). Kjo shpjegon shëmbëlltyrën e pasanikut që parashtrroi gosti. (Lk 14,15-24)

rr. 30-31 *drejtësia*: do të thotë fjalë për fjalë “vepra e vënies në rregull”, në këtë rast “vepra e tij e çlirimit falë të cilit Perëndia tregon sundimin e tij të gjithëfuqishëm.”

PSALMI 23

Bariu i mirë

1 *Psalm. 1 Davidit.*

Zoti është bariu im,

asgjë nuk më mungon.

2 Më mballon kullotave të gjelbra, më prin në ujëra të qeta,

3 shpirtin ma përtërin.

Ai më prin shtigjeve të drejta

në saje të dashurisë së emrit të vet.

4 Po edhe në kalofsha nëpër luginën e hijes së vdekjes,
s'trembem nga e keqja
sepse ti je me mua:
thupra jote dhe kërraba
për mua janë ngushëllim.

5 Ti ma shtron tryezën përpara ndër sy të armiqve të mi,
me vaj erëmirë kryet ma lyen, gotën ma mbush plot e
përplot.

6 Hiri dhe mirësia do të më përcjellin në të gjitha ditët e
jetës sime, do të banoj në shtëpinë e Zotit sa të jem gjallë.

KOMENTARI

Sfondi i këtij psalmi do të jetë rimëkëmbja e Davidit pas kryengritjes së Avshalomit. Armiqtë e Davidit, që janë të detyruar të jenë të pranishëm në gostinë që feston këtë ngjarje, do të jenë ata që kishin përkrahur Avshalomin në kryengritjen e tij. Perëndia e pret përsëri Davidin si mysafir të veçantë, sepse është Perëndia që i dha fitoren, dhe kështu ripohoi zgjedhjen e tij paraprake të Davidit si mbret.

Ky psalm i Davidit mund të ndahet në tri pjesë:

1. qentë dhe bariu (rr. 1-3)
2. udhëtari dhe shoku (rr. 4)
3. mysafiri dhe mikpritësi (rr.5-6).

Rr. 1-3 Në këto rreshta theksi bie në përvojën e bollëkut (lëvadhata), paqes (ujët) dhe rimëkëmbjes (Zoti më rimëkëmb).

“*Lëvadhata*” (vendet për kullotjen), që janë në dispozicion në pranverë dhe në dimër, duhen kërkuar nga bariu me stinët e tjera, kur bariu thahet nga vapa e verës.

“*Ujë e qetë*” janë aludim për burimet dhe pusët në të cilat drejton bariu qengjat e tij, posaçërisht kur ata kanë nevojë për pushim dhe freskim.

Parimi prapa këtyre përjetimeve është kjo – ai na zgjedh shtigje të drejta, e kjo do të thotë udhët të cilat, sipas mendimit të Tij, janë më të mira për ne. Ai vepron në sajë të dashurisë së tij, d.m.th. sipas karakterit të tij të zbuluar si bariu i Izraelit

Rr. 4. Por është gjithashtu udha e shtegtarit që bën pjesë me jetën e krishterë, e cila kalon nëpër terën më të vështirë që përfshin edhe luginën e hijës së vdekjes. Kjo është errësira më e dendur që përjetohet kur njeriu kalon nëpër lavdinë e thellë. Në mënyrë figurative kjo përfshin edhe vdekjen. Vetëm Zoti mund ta çojë njeriun nëpër vdekjen: të gjithë udhërrëfyesit e tjerë duhen të kthehen prapa, dhe udhëtari duhet të shkojë vetëm. Në këtë përjetim thupra shënon mbrojtje kurse kërraba përkrahje. Thupra është mjet që përdor bariu për të larguar kafshët grabitqare, kurse kërraba përdoret për ti bashkuar dhe t'i ruajë qengjat në udhën e drejtë.

Rr. 5-6. Kjo mund të ketë pasqyruar një përjetim të Davidit ose kur ishte i kërkuar nga Shauli ose kur po ikte nga Avshalomi. Nganjëherë Perëndia përdor agjentë njerëzorë për të plotësuar premtimet e tij (p.sh.. kujdesi i Barzillait gjatë kryengritjes së Avshalomit). Psalmi aludon për rrethanat armiqësore (rr. 4) dhe njerëzit armiq (rr. 5). Ne mund t'i adaptojmë logjikisht këto përjetime të Davidit nësiguritë që përjetojmë kohë pas kohe në jetën tonë.

Ky imazh i fundit është ai i gostisë në të cilën Davidi është mysafir i Perëndisë. Gostia ishte simbol për shoqëri të ngushtë, me besnikëri të dyanshme. Ajo na përkujton për indivin që “përjetë do të hajë bukë në tryezën time.” (2 Sam 9,7.13)

Koka e Iyer na flet për mikpritjen e Zotit, kurse gota e mbushur plotë e përplotë për furnizimin e bollshëm të Tij. Hiri dhe mirësia do ta përcjellin, jo vetëm derisa të jetojë, por më tej, sepse në perspektivën e DhV, marrëdhënia e angazhimit të besëlidhjes nuk mund të thyhet kurrë, e kjo do të garantojë ringjalljen e ardhshme. (Mt 22,32). Pasazhi paralel do të jetë te DhR në Rom 8,31-39.

Mëshira është përkthim i fjalës hebraike *hesed* – megjithëse ne jemi nganjëherë të pabesë, ai rri besnik ndaj angazhimit të Tij. (2 Tim 2,13).

Mirësia (hebr. *tuv*) jep të kuptojë dashamirësinë e vazhdueshme dhe përkrahjen tek e cila mund të mbështetim në rrethin e familjes ose ndër miq.

PSALMI 24

Liturgjia e hyrjes në shenjtërore

1 *Psalm. I Davidit.*

E Zotit është toka dhe gjithçka ajo ka, rruzulli mbarë e të gjithë banorët e tij.

2 Ai vetë e themeloi mbi dete, dhe e bëri të qëndrueshme mbi lumenj.

3 Kush do të ngjitet mbi malin e Zotit e kush do të qëndrojë në vendin e tij të shenjtë?

4 Ai që duart i ka të pafajshme e zemrën të pastër, ai që nuk e drejtoi shpirtin e vet në kotësi, ai që nuk përbehet në rrenë.

5 Ky do ta marrë bekimin prej Zotit, shfajësimin e Perëndisë, Shpëtimtarit të vet.

6 E fillë është breznia e atyre që kërkojnë Zotin, e atyre që kërkojnë fytyrën e Perëndisë së Jakobit.

7 »Lartësoni, o dyer, ballnikët tuaj! Lartësohuni, o dyer të amshueshme, që të hyjë Mbreti i lavdisë!«

8 Kush është ky Mbreti i lavdisë? Zoti, i Forti, Ngadhënjyesi! Zoti, Ngadhënjyes në luftë!

9 Lartësoni, o dyer, ballnikët tuaj, lartësohuni, o dyer të amshueshme, që të hyjë Mbreti i lavdisë!

10 »E kush është ky Mbreti i lavdisë? Ai, Zoti i Ushtrive, ai vetë është Mbreti i lavdisë!«

KOMENTARI

Ky psalm mund të klasifikohet si psalm fronizimi.

Rasti i psalmit do të jetë lidhur me festën e tëbanave, përkushtimin e tempullit dhe sjelljen e arkës së besëlidhjes në Tendën e shenjtë në kohën e Davidit. Alternativa e fundit përshtatet më mirë (1 Chr. 13,8) por ishte përdorur me rrethanat të mëvonshme. Ka të ngjarë të jetë kënduar antifonikisht ose nga dy kore ose nga individi dhe kori..

Refreni i kënduar gjatë kortezhit. Theksi bie mbi gjithëpushtetin e Zotit mbi mbarë botën, e jo vetëm mbi Izrael dhe Jerusalem,

Kushtet për adhurim: Perëndisë duhet t'i afroresh me kushtet e veta. Kërkohen standarde të larta të sjelljes morale me theks mbi cilësinë e adhurimit. Adhuresi duhet të bëjë jetë të drejtë (plot integritet) dhe në rregull me Perëndinë.

Hyrja e Zotit: majet ose arkitrat e portave përfytyrohen si tepër të ulta që të hyjë mbreti hyjnor. Në fund mbreti identifikohet me Zotin e ushtrive ëngjëllore qiellore.

PSALMI 25

Urata në rast rreziku

1 *Davidit.*

Alef Te ti, o Zot, e lartësoj shpirtin tim!

Bet 2 Perëndia im, në ty shpresoj: mos lejo të turpërohem!

Të mos ngrihen në mua armiqtë e mi,

- Gimel* 3 dhe askush që shpreson në ty mos u turpëroftë!
Turpi i mbuloftë; ata që për asgjë tradhtojnë.
- Dalet* 4 Bëj t'i njoh, o Zot, udhët e tua, e m'i mëso shtigjet e tua.
- He* 5 Më drejto me të vërtetën tënde dhe më mëso, sepse ti je Perëndia im, Shpëtimtari im,
- Vavv* në ty shpresoj gjithmonë.
- Zain* 6 Të të bien në mend mëshirat e tua, o Zot, dhe dashuria jote që është e amshueshme.
- Het* 7 Mos i kujto fajet e rinisë sime e paudhësitë: të të bie në mend për mua sipas dashurisë sate – për hir të mirësisë sate, o Zot.
- Tet* 8 I ëmbël e i drejtë është Zoti, mëkatarët i kthen në udhë të drejtë,
- Jod* 9 të pervujtëve u prin në drejtësi, të butëve ua mëson udhën e vet.
- Kaf* 10 Të gjitha udhët e Zotit janë mëshirë dhe e vërtetë për ata që mbajnë Besëlidhjen e tij e urdhërimet.
- Lamed* 11 Pashë emrin tënd, o Zot, ma fal mëkatin: sepse është i madh.
- Mem* 12 A ka njeri që e druan Zotin?
Vetë Zoti ia mëson udhën që duhet të marrë.

- Nun* 13 Ai do ta kalojë jetën në mirëqenie,
pasardhësit e tij do ta trashëgojnë tokën.
- Sameh* 14 Miqësisht sillet Zoti me ata që e druajnë,
për t'ua njoftuar Besëlidhjen e vet.
- Ain* 15 Sytë e mi përherë i drejtoj te Perëndia,
sepse ai i nxjerr këmbët e mia prej lakut.
- Pe* 16 Më shiko, o Zot, e ki dhembje për mua,
sepse jam i vetmuar e i mjerë.
- Tsade* 17 Lehtësoji dhembjet e zemrës sime
e më nxirr nga vështirësitë e mia.
- Kof* 18 Shihe përvujtërimin tim dhe mundimin
dhe m'i fal të gjitha fajet e mia.
- Resh* 19 Shikoj armiqtë e mi; se ç'u shumuan
dhe më urrejnë me urrejtje të tërbuar!
- Shin* 20 Ruaje shpirtin tim dhe më shpëto;
mos lejo të turpërohem pasi jam nën dorën tënde.
- Tau* 21 Le te më mbrojë pafajësia dhe drejtësia,
sepse në ty e kam vënë shpresën.
22 Shpëtoje, O Perëndi, Izraelin;
prej të gjitha vështirësive të tij.

KOMENTARI

Ky psalm ka të bëjë me lutjen, por versioni përfundimtar adapton për Izraelin atë që vlente për Davidin që iu lut Zotit. Kështu një lutje personale bëhet lutja e mbarë kongregacionit..

Armiqtë: armiqtë mungojnë rallë në psalmet e Davidit, ata personalë ose ideologjikë. Duhet vërejtur se fitorja e tyre do të diskreditonte jo vetëm Davidin (mbretin e Izraelit) por edhe atë që e përfaqëson, d.m.th. bindjen që njeriu duhet të jetojë me ndihmën e Perëndisë e jo me forcat e veta.

Mbrojtja e Davidit është integriteti dhe drejtësia. Ai mbështetet te Perëndia për t'i dhënë të drejtë në mënyrën e vet dhe në kohën e vet.

Drejtimi: Drejtimi është tema kryesore e këtij psalmi. Më parë Davidi i lutet Zotit për mësim në vullnetin e përgjithshëm të Tij (udhët, rrugët) por kur bëhet fjalë për drejtim të veçantë, Davidi e themelon në zbatimin e parimeve të përgjithshme, e jo në shënja irracionale dhe ogurë që janë tipike për paganizmin. Këto parime themelohen:

1. Formimi i mendjes për të dalluar të mirën nga e keqja.
2. Vigjilencë për të dalluar shenjën e parë të miratimit ose mosmiratimit të Zotit.
3. Konstatim se duhen shlyer menjëherë llogaritë me Zotin, d.m.th. se duhet t'i pranojmë menjëherë mëkaret përpara Zotit .
4. Mbajtja e marrëdhënieve të ngushta (hebr. *sod*) me Zotin.
5. Duhet të presim me padurim përgjigjen e Zotit. Kjo do të thotë se duhet të pranojmë momentin e tij të përshtatshëm për të na e plotësuar lutjen, dhe kështu urtësinë e tij. Ka dallim të qartë ndërmjet sjelljes së vrullshme të Shaulit dhe sjelljes së Davidit i cili ishte i durueshëm dhe në rast dyshimi i jepte Zotit përparësi. Megjithatë Davidi pret me padurim përgjigjet e Zotit, dhe nuk i bindet fatit.

PSALM 26**Urata e njeriut të pafajshëm***1 I Davidit*

Ma jep të drejtën, o Zot, sepse jetoj në pafajësi, i mbështetur në ty nuk kam se si të ligështohem.

2 Më shqyrto, o Zot, e më vër në provë, m'i pastro me zjarr veshka e zemër!

3 Para sysh e kam dashurinë tënde, jetoj e veproj sipas drejtësisë sate.

4 Nuk rri me njerëz të këqij as s'bëj shoqëri me njerëz shtiracakë.

5 I urrej mbledhjet e të paudhëve, me njerëz të pabesë nuk do të rri.

6 Në pafajësi i laj duart e mia

7 e rreth i sillem altarit tënd, o Zot, për ta shpallur botërisht lavdinë tënde, për t'i kumtuar të gjitha mrekullitë e tua.

8 O Zot, e dua shtëpinë ku ti banon, dhe vendin ku qëndron Lavdia jote.

9 Mos e shoqëro shpirtin tim me atë të mëkatarëve, as jetën time me atë të gjakësorëve.

10 Në duart e tyre është paudhësia, e djathta e tyre është plot dhurata.

11 E unë jetoj në pafajësinë time, më shpërble, o Zot, e ki dhembje për mua.

12 Tashmë këmba ime shklet në udhë të drejtë: në bashkime do ta lavdëroj Zotin.

KOMENTARI

Duket qartë se nga ky vajtim kishte mosmarrëveshje ndërmjet grupeve fetare në Izrael. Disa komentues sugjerojnë se është fjalë për një murtajë për të cilën Davidi do të jetë fajtor. Sidoqoftë protestat rreth integritetit të tij tregojnë se mosbesimtarët janë duke u rritur.. Këtë psalm, megjithëse më tepër individual se sa i përbashkët, mund ta ketë përdorur një grup besimtarësh në kohën e pikëllimit.

1-7. **Protesta e pafajësisë** Psalmisti është aq i sigurt për integritetin e tij saqë kërkon gjykimin hyjnor. Kërkon që Zoti ta shqyrtojë dhe ta provojë. Pretendon të jetë sjellë me integritet, të ketë shmangur ndonjë kontakt me çifutët renegatë që kanë marrë pjesë të rregullt në adhurim. Të gjitha këto dallohet me sjelljen e armiqve të tij..

8-12. **Lutje për justifikim.** Lutja e tij s'është që të shmangë vdekjen, por që të evitohet të grupohet me jobesimtarët, të cilët i ka shmangur me aq kujdes. Në këtë lutje ai i drejtohet Zotit që ta çlirojë dhe të ketë mëshirë për të sepse do të vazhdojë të sillet me integritet, të rri i patundur dhe ta falënderojë hapur Zotin

të bekoj: f.fj. 'lavdëroj'. Kuptimi i parë i foljes hebraike *barak* ishte të biesh në gjunjë para eprorit. Sikurse eprori bie në gjunjë para eprorit për të marrë bekimin e tij, (Heb. *berakah*) ky me radhë e lavdëron edhe dhënësin duke i kushtuar lavdërim dhe falënderim dhe e quan i bekuar. (Heb. *baruk*).

PSALMI 27

Përballë Perëndisë nuk kam frikë

1 I Davidit.

Zoti është drita ime dhe shpëtimi im, kë do të kem frikë?
Zoti është mbrojtësi i jetës sime, para kujt do të dridhem?

2 Kur më sulen keqbërësit për të më ngrënë gjallë,
kundërshtarëve të mi e armiqve të mi, ora u liget dhe
rrëzohen.

3 Le të çohet, në dashtë, edhe një ushtri e tërë kundër
meje: zemra nuk më trembet, le të shpërthejë, në dashtë,
edhe lufta kundër meje; edhe atëherë j am plot shpresë.

4 Për një gjë të vetme i lutem Zotit, vetëm atë ia kërkoj, që
të jetoj në Shtëpinë e Zotit të gjitha ditët e jetës sime, që ta
shijoj kënaqësinë e Zotit e ta vërej Shtëpinë e Zotit.

5 Zoti më fsheh në tendën e vet në ditë të vështirë,
më strehon në vend të fshehtë të tendës së vet, më ngre l
art mbi qetë.

6 E tani e lartësoj kryet mbi armiqtë e mi që më rrethojnë,
në tendën e tij do të kushtoj fli gëzimi, do t'i këndoj Zotit
këngë hareje.

7 Dëgjoje, o Zot, zërin e britmës sime, ki mëshirë për mua
dhe më dëgjo!

8 Për ty tha zemra ime: »Kërkojeni fytyrën time!«
»Fytyrën tënde, o Zot, do ta kërkoj.«

9 Mos e fsheh fytyrën tënde prej meje, mos e dëbo me
felgrim shërbëtorin tënd!

Ti je ndihmëtari im, mos më përbuz, mos hiq dorë prej
meje, Perëndia i shpëtimit tim!

10 Im atë e nëna ime hoqën dorë prej meje, por Zoti më mori ndore.

11 Ma trego, o Zot, udhën tënde dhe më drejto shtegut të drejtë për shkak të armiqve të mi!

12 Mos më lësho në pamëshirën e kundërshtarëve të mi, sepse u ngritën kundër meje dëshmitarë të rrejshëm, të cilët shfryjnë dhunë.

13 Besoj se do t'i shijoj te mirat e Zotit në tokën e të gjallëve.

14 Shpeso në Zotin: bëhu burrë! Ji zemërfortë e prite Zotin!

KOMENTARI

Dallimi i qartë midis vargjeve 1-6 dhe 7-14 ka ndikuar në shumicën e komentuesve ta shënojnë këtë psalm si përzierje. Edhe në përmbajtjen edhe në shpirtin e atyre seksioneve ka ndryshim të madh. Gjendja shpirtërore ndryshon nga besimi i gëzuar në frikë dhe ankth. Megjithatë dy elemente i bashkojnë të dy pjesët e ndryshme – armiq të ngjashëm dhe besimi te Perëndia.

1-3. **Besimi pa kusht.** *Zoti është mbrojtësi i jetës sime.* Këto fjalë të gëzuara janë hyrje për në një skenar të bukur. Asgjëkundi te DhV Zotit nuk i referohet si drita ime. Meqë psalmisti e ka gjetur Zotin si burim drite, shpëtimi dhe forcash, s'ka arsye për frikë ose tmerr. Qetësia e tij nuk kushtëzohet nga rrethana të jashtme, por është pa kusht.

4-6. **Dëshira më e madhe e jetës.** *Për një gjë të vetme i lutem Zotit.* Duhet të aludohet për themelin e dëshirës së trefishtë. Ky themel ose emëruesi i përbashkët është prania e Zotit, të cilën psalmisti e kërkon dhe dëshiron. Konstatimi i kësaj pranie vjen nga banimi në shtëpinë e Zotit duke parë bukurinë e tij dhe duke i kërkuar këshillë në Tempull. E njëjta prani ka për pasojë siguri në kohën e vështirë.

7-14. **Thirrje e frikësuar.** *Dëgjo, o Zot.* Këto fjalë e zhvendos gjendjen shpirtërore nga triumfi në pikëllim të thellë, sepse përhapin një situatë dhe një rrethanë të re. Megjithëse psalmisti ndihet i braktisur, besimi i tij vazhdon. Nga thellësitë e dëshpërimit ky kthen te durimi i kërkuar kur njeriu i kërkon Zotit ta realizojë vullnetin e tij.

PSALMI 28

Lutje dhe falënderim

1 *I Davidit.*

Të thërras në ndihmë, o Zot, Perëndia im, mos rri shurdh ndaj meje, sepse po ndenje shurdh ndaj meje do të bëhem si ata që zbresin në varr.

2 Dëgjoje zërin e lutjes sime kur me afsh të thërras në ndihmë,
kur i ngre duart e mi në drejtim të Tempullit tënd të shenjtë.

3 Mos më merr me mëkatarë e me ata që bëjnë të keqen:
flasin për paqe me të afërmit e vet, kurse në zemër përbluajnë të keqen.

4 Shpaguaji sipas veprave të tyre, sipas paudhësisë së veprimeve të tyre. Shpaguaji sipas veprave të duarve të tyre, jepu shpagimin si e meritojnë.

5 Ata e përbuzin veprimin e Zotit, i bëjnë asgjë veprat e duarve të tij:
përdhe i përplastë e më mos i ngrittë!

6 Lavdëroftë Zoti, që e dëgjoji zërin e lutjes sime.

7 Zoti është ndihma ime, mbrojtësi im, në të shpreson shpirti im dhe gjeta ndihmë: zemra më, gëzohet e me këngën time e falënderoi.

8 Zoti është fuqia e popullit të vet, kështjellë shpëtimi për të shuguruarin e vet.

9 Shpëtoje popullin tënd e lavdëroje trashëgimin tënd:
priju e ngriji deri në amshim!

KOMENTARI

Ky psalm, si shumë vajtime të tjera merret me mosmarrëveshjen ndërmjet besimtarëve tradicionalë dhe atyre të ndikuar nga paganizmi. Psalmisti ka shumë frikë se mos të njëjtin fat që do të pësojnë edhe kundërshtarët e tij. Fakti se ai e quan lutjen e tij të plotësuar dallohet qartë nga ndryshimi që paraqitet te rr. 6

1,2. **Lutje për t'u dëgjuar.** *mos rri shurdh ndaj meje. . .*
Dëgjo. Psalmisti i bën thirrje Zotit për ta dëgjuar dhe t'ia plotësojë lutjen. Përsa i përket hebreat, mungesa e përgjigjes i dukej sikur Perëndia s'do t'ia plotësojë lutjen. Natyra urgjente e

thirrjes së psalmistit theksohet nga mundësia që ai të vdesë po të mos ia dëgjojë lutjen.

3-5. **Lutje për ndërhyrje.** *Mos më merr me mëkatarë... Shpaguaji sipas veprave të tyre.* Lutja e tij e parë është për të kërkuar mbrojtje kundër armiqve të pabesë. Megjithatë theksi i tij menjëherë kthehet në lutje për shpëtim.

6,7. **Falënderimi për lutjen e plotësuar.** *Lavdëruar qoftë Zoti.* Shkaku i këtij shpërthimi lavdërimi duhet të kuptohet si plotësimi i lutjes së re.

rr. 1-2.. Këtë falënderim mund ta ketë shtuar më vonë psalmisti, ose mund të jetë shprehja e besimit të brendshëm që Zoti e ka dëgjuar me të vërtetë dhe nuk hesht më.

8,9. **Zbatimi për kombin.** *Zoti është themeli forcës së popullit të vet.* Fakti se Perëndia është burimi i forcave të psalmistit zbatohet për kombin dhe mbretin. Kjo mund të jetë shtesë e mëvonshme për t'ia adaptuar shprehjen e besimit të individit adhurimit të përbashkët.

PSALMI 29

Himn për nder të Zotëruesit të stuhisë

1 Psalm. *I Davidit.*

Jepni Zotit, o bijtë e Perëndisë, jepni Zotit lavdinë e fuqinë!

2 Jepni Zotit nderin e emrit të tij, adhurojeni Zotin në shkëlqimin e shenjtë!

3 Dëgjo! Zoti gjëmon mbi ujëra, Perëndia i madhërisëm gjëmon,

Zoti bubullin mbi ujëra të mëdha!

4 Dëgjo! Zoti gjëmon fuqishëm, Zoti gjëmon me madhëri!

5 Ja, zëri i Zotit i copëton cedrat, Zoti i thërrmon cedrat e Libanit!

6 E bën të këcejë si viç Libanin, Sirionin si kotorr bizoni!

7 Ja, zëri i Zotit – përhap flakë zjarri,

8 ja, zëri i Zotit e godat shkretëtirën, e godet Zoti shkretëtirën Kadesh!

9 A ke ç' ndien? Prej tmerrit pjellin shutat, zëri i Zotit i shkurton pyjet!

Ndërkaq në Tempulli n e tij të gjithë thonë: »Lavdi! «

10 Zoti e ka fronin përmbi përmytje, Zoti mbretëron përgjithmonë e jetë!

11 Zoti i jep fuqi popullit të vet, Zoti e lavdëron popullin e vet me paqe.

KOMENTARI

Ky psalm është interesant sepse ka ngjashmëri të shumta përsa i përket terminologjisë me poema kananas nga periudha 1400-1300 të zbuluara në Ugarit të Sirisë. Megjithëse psalmisti do ta ketë huazuar idenë nga poezia kananase, ai me kujdes pohon se Zoti është e vetmja perëndi e vërtetë,.

Shembujt e tjerë të mitologjisë kananase gjenden tek Isaia 27,1 dhe te psalmi 74,13-15 ku dragoja simbolizon Egjiptin. Në poemën kananase, flitet për Baalin se ka dalë ngadhënjimtar mbi detin dhe lumin e personifikuar, mbi dragojën (*tanninim*) dhe mbi gjarprin me 7 koka me emër Lotan (ose: *leviathan*). Mësimi që nxirret nga psalmi 74 është se ajo që vlente për Baalin në sferën e mitit, është bërë realitet në sferën e historisë ku Perëndia ka mundur Egjiptin dhe ka çliruar popullin e tij. .

Psalmi gjurmon udhën e shtrëngatës që arrin papritur nga deti, del në breg pranë Libanit, kalon pranë malit Hermon

(ndryshe Sirion) dhe poshtë nëpër mbarë tokën e Izraelit dhe përfundon në Kadesh larg në jug.

Për disa stuhi është stuhi, por për psalmistin stuhia është ilustrim për fuqinë e pakufizuar të Zotit, sepse bie në pemë, male dhe shkretëtirë, dhe kjo shërben si shkak lavdërimi..

Më së pari, qëniet mbinatyrore e nderojnë Zotin në qiell. Pastaj shtrëngata e madhe kalon nëpër Izraelin. Kur të kthjellojë, Zoti duket me gjykim mbi botën e tij, por me bekim për popullin e tij. Stuhia e vrullshme kalon nëpër Izraelin. Kështu duket fuqia e Perëndisë, jo me fuqi pa qëllim, por si mjet gjykimi (përmbytja) dhe mjet shpëtimi për popullin e tij.

PSALMI 30

Falënderim për shpëtim nga vdekja

1 Psalm, Këngë në festën e Kushtimit të Tempullit. E Davidit,

2 Të madhëroj, o Zot, pse më shpëtove
e nuk lejove të ngihen armiqtë e mi mbi mua.

3 O Zot, Perëndia im,

4 unë të thirra e ti më shërove, ti, o Zot, ma nxore shpirtin
nga Nëntoka, më ktheve në jetë që të mos zbres në varr.

5 Këndoni Zotit ju, o besimtarët e tij, falënderojeni emrin e
shenjtë të tij!

6 Sepse një çast zgjat hidhërimi i tij e tërë jetën
dashamirësia e tij! Mbrëmja vjen me lot, e mëngjesi plot
hare!

7 Kur nuk më mungonte gjë, thosha: »Askurrë s'do të
tundem!«

8 Më ke vënë, o Zot, në majën e malit të sigurt, porse,
posa ma fsheh fytyrën tënde, frikësohem.

9 Atëherë ty, o Zot, të lëshoja kushtrimin, i lutesha
Perëndisë tim.

10 Ç' dobi nga gjaku im, në qoftë se zbres në shkatërrim?
A thua do të të lavdërojë pluhuri, e do ta kumtojë
besnikërinë tënde?

11 Më dëgjoi Zoti e kishte mëshirë për mua, Zoti u bë
ndihmëtari im.

12 Ti vajën ma ktheve në valle, ma zhgjeshe grathoren time
e më ngjeshe me hare,

13 që shpirti im të të këndojë e të mos pushojë:
»O Zot, Perëndia im, do të të lavdëroj për amshim'«

KOMENTARI

Në këtë psalm tregohet për përjetimin e njeriut që i kishte ikur vdekjes duke qenë i çliruar nga një sëmundje të rëndë. Rimëkëmbja e tij e pazakonshme ngjall falënderime të gëzuara dhe e çon të mendohet mirë për mësimet e nxjerra nga përvoja e tij.

Mbishkrimi i psalmit. *Një këngë për përkushtimin e shtëpisë*, nuk i referohet moedemos tempullit, por shtëpisë së vet. Megjithatë ka mundësi që të përdorej më vonë për kushtimin e Tempullit.

rr. 1. *Të madhëroj, o Zot* do të thotë "Do ta shpall madhësinë tënde".

Po ashtu, shprehja *pse më ka ngritur* do të thotë "ti e ke rimëkëmbur nderin tim".

rr. 1-5 te këta rreshta aludon për takimin e ngushtë me vdekjen e cila e ka detyruar të kthehej në dëshpërim te Zoti, i cili e ka shëruar dhe kështu e ka justifikuar.

*Sigurisht do të ketë qenë përkrahës të Shaulit që e quanin Davidin usurpator dhe me qejf do të gëzoheshin për vdekjen e tij. Ka mundësi që ata ta quanin këtë sëmundje ndëshkim nga Zoti.

Si pasojë e këtij plotësimi të lutjes Davidi thërret shërbëtorët besnikë të Zotit të bashkohen me të për të lavdëruar Perëndinë, sigurisht në Tempull. Ai e ndan përjetimin e tij me të tjerët të mendimit të tij, kështu që së bashku ata mund ta lavdërojnë hapur Perëndinë.

rr. 6-7, Megjithatë Davidi pranon se kishte qenë fajtor për besim të tëpruar tek aftësitë e tij. Kjo do t'i përgjigjet kohës kur ishte përforcuar. Jerusalemi ishte zënë, prej të cilin ai kishte bërë kryeqytetin e mbretërisë së tij të bashkuar. Fuqia e tij po shtohet. Ushtria e tij ishte e fortë dhe familja e tij po rritej. Filistenjtë ishin të mundur. Tani po ndërtonte pallatin e vet. Shkurt, gjithçka i shkonte mbarë.

Pikërisht në atë kohë Davidi u sëmur rëndë, kështu që mendonte se do të vdiste. Megjithatë, në lutjet e tij, ai argumenton me Perëndinë që Ai nuk do të arrinte asgjë duke shkaktuar vdekjen e tij. – do të humbiste adhurues. Kështu jep të kuptojë se nëntoka ishte vend mosveprimi – vend i hijeve ku Perëndia nuk adhurohej më.

rr. 7 thotë për Zotin se *më ke zënë në malin e sigurt*, do të thotë «ti më ke mbrojtur si kështjellë malësore.»

rr. 8-12 flet për thirrjen e Davidit drejtuar Perëndisë. Koha e foljes hebraike jep të kuptojë se vazhdonte t'i lutej Perëndisë. Me fjalë të tjera Zoti nuk ia plotësoi menjëherë lutjen. Po ashtu edhe ne kemi prirje të mendojmë se në qoftë se Zoti nuk na e plotëson lutjen menjëherë, aspak do ta plotësojë. Kjo është gabim.

PSALMI 31 (30)**Lutja në ditë të vështira**

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.*

2 Në ty, o Zot, shpresoj: mos lejo të turpërohem për amshim,

më liro me drejtësinë tënde.

3 Prire drejt meje veshin tënd, nxito të më shpëtosh!

Ji për mua qetë shpëtimi, kështjellë mbrojtjeje!

4 Sepse forca ime e strehimi im ti je: pashë emrin tënd më pri e më sundo.

5 Më nxirr nga rrjeta që fshehtazi ma vunë, sepse ti je fuqia ime.

6 Në duar të tua po e porosis shpirtin tim, më shpërble, o Zot, Perëndia besnik.

7 Ti i urren shërbëtorët e idhujve të rrejshëm, ndërsa unë shpresën e kam në Zotin.

8 Me gëzim do t'i brohoris mirësisë sate se ti këqyre me dhimbje mbi mjerimin tim, ti e ndihmove shpirtin tim në ditë të ngushtë;

9 nuk më dorëzove në thonj të armiqve të mi, hapave të mi u prive rrugës së shpëtimit.

10 Ki mëshirë për mua, o Zot, se ndodhem në ngushtim të madh! Vuajtjet m'i ligështuan sytë e mi, shpirtin edhe trupin.

11 Jeta më sharroi në dhembje e vjetët më kaluan në dënësë, fuqia më mbaroi nga munda e eshtrat m'u thanë.

12 Në sy të armiqve të mi u bëra tallje, për fqinjë i mërzitshëm e për të njohur tmerr. Ata që më shohin përjashta, ikin prej meje.

13 Më harruan njerëzit porsì të kisha vdekur, u bëra porsì enë e thyer.

14 Dëgjo pëshpëritiet e të shumëve: tmerr në çdo anë: bëjnë mbledhje kunder meje, pleqërojnë si të ma marrin jetën.

15 E pra, o Zot, unë në ty jam i sigurt, unë them: »Ti je Perëndia im,

16 në duart e tua fati im!«

Më shpëto prej duarve të armiqve të mi dhe prej atyre që më salvojnë.

17 Kthjelle fytyrën tënde ndaj shërbëtorit tënd: më shpëto me mëshirën tënde.

18 O Zot, unë nuk do të turpërohem se ty të thirra në ndihmë, por u turpërofshin keqbërësit dhe u plandosshin në Nëntokë!

19 U thafshin buzët rrenacake, që flasin kundër të drejtit ashpër, me kreni dhe plot përbuzje.

20 Oh, sa e madhe është mirësia jote, o Zot, të cilën e ruan për ata që të druajnë, e ke përgatitur për ata që shpresojnë në ty në sy të bijve të Adamit.

21 Ti i fsheh në strehën e fytyrës sate larg nga ngatërresat e njerëzve, i strehon në Tendën tënde larg nga gjuhët ngatërrestare.

22 Lavdëroftë Zoti që më pajisi me mirësi të mrekullueshme në qytet të fortë!

23 Ndërsa në vështirësinë time mendoja: »I përjashtuarjam prej syve të tu!«, por ti e dëgjove zërin e lutjes sime kur drejt teje lëshova kushtrimin.

24 Duani Zotin, të gjithë shenjtërit e tij: ai i ruan besimtarët e vet,
por edhe atë që vepron me madhështi Zoti e shpagan sipas meritave.

25 Merrni zemër e kini guxim të gjithë ju që shpresoni në Zotin.

KOMENTARI

Këtu kemi të bëjmë me ankimin e individit kundër trajtimit që ka marrë në duart e armiqve të tij. Natyra e përgjithshme e vajtimeve të tij (rr. 1-8) bën prej Atij psalmi zëri i shumë adhuruesve nëpër shekuj të tëra.

Te rr. 9 bëhet fjalë për një intensifikim të problemit.

2-9. **Apel me plotë besim.** *Në ty, o Zot, shpresoj.* Te Zoti besimtari ka kërkuar strehë. Në këtë themel ai mund t'i thërrasë për çlirim dhe siguri. (Përdorimi na Jezusi i rr. 5 në kryq) i ka dhënë mbarë psalmit një zbatim mesianik.

10-19. **Një apel i ngulur.** *Ki mëshirë për mua.* Ndërsa rreshtat e mëparshëm përshkruajnë mrekullitë e së kaluarës, këto rreshta parashtrojnë nevojën urgjente të së tashmës. Ky seksion ka disa paralele të qartë me përvojën e profetit Jeremi. Psalmisti është bërë qortim dhe frikë për armiq të tij. Psalmisti është njeri i harruar dhe i flakur si enë e thyer. Në këtë gjendje të vetmisë dhe dëshpërimit, i vetmi mik i tij është Zoti, dhe e vetmja shpresë e tij është t'i nënshtrohet mëshirës së Zotit..

20-25 . **Shpirti i mirënjohës.** Lavdëroftë Zoti që më pajisi me mirësi të mrekullueshme. Përkujtim i veprave të tij të mëshirshme të kaluara dhe siguria e ndihmës së vazhdueshme ngjall fjalët e

lavdërimit. Ky besim te Zoti e çon t'i nxitë të tjerët për të dashur Zotin dhe të marrin zemër.

PSALMI 32

Kush i pranon fajet, Zoti e liron nga mëkati

1 *I Davidit. Maskil*

Lum ai që iu fal mëkati, që iu mbulua faji!

2 Lum ai njeri që Zoti nuk e numëron ndër mëkatarë, në shpirtin e të cilit nuk ka dredhi.

3 Pse heshtova, eshtrat m'u kalbën prej dënesës së vazhdueshme,

4 sepse ditën, natën dora jote rëndonte mbi mua, fuqia më lëshonte porsë në vapë të verës.

5 Atëherë ta dëftova mëkatin tim, fajin tim më nuk e fsheha.

Thashë: »Do t'ia rrëfej Zotit fajin tim,« e ti ma fale fajësinë e mëkatit tim.

6 Prandaj le të lutet çdo besimtar në kohë të përshtatshme, kur të vërshojnë ujërat e shumta, atë s' do ta zënë.

7 Ti je strehimi im, ti më ruan prej vështirësisë, do të më rrethosh me këngë gëzimi.

8 Do të të bëj të dijshëm, do të ta mësoj rrugën që duhet ndjek sytë e mi do t' i përqendroj mbi ty.

9 Mos u bëni si kali e mushku që nuk kanë mend. Për ta lypset kapistër e fre për t' i sunduar, përndryshe s' do të afroreshin tek ti.

10 Shumë vështirësi e rrethojnë keqbërësin, atë që shpreson në Zotin e rrethon hiri.

11 Gëzohuni në Zotin e galdoni, o të drejtë, brohoritni të gjithë ju që jeni zemërpastër.

KOMENTARI

Në këtë psalm pendimi, psalmisti flet qartë për përjetimin e tij personal. Qëllimi didaktik i këtij psalmi shënon se kjo poemë ka lidhje me letërsinë e urtësisë.

Psalmi mund të ketë lidhje me kohën e kurorëshkeljes së Davidit me Batshevën. Po të jetë kështu, rr. 3 dhe 4 na flasin për ndërjegjen fajtores e Davidit, kurse rr. 5 i përgjigjet fjalës te 2 Sam. 12,13, ‘Davidi i tha Natanit: «Pranoj që jam fajtor para Zotit!» «Meqë e pranon këtë, – iu përgjigj Natani, – Zoti ta ka falur mëkatin. (ose te REB: një tjetër e ka shlyer fajin tënd) Ti nuk duhet të vdesësh. Por, meqë e ke fyer Zotin duke vepruar kështu, djali që do ta lindë Batsheva, do të vdesë.»!’

1,2. **Bekimi i ndjesës.** *Lum* (fj. i bekuar). Mëkatari mund të gëzohet sepse Zoti ia ka falur mëkatin. Vini re disa sinonime për mëkatin: mosbindje e hapur, rebelim, nuk qëlloj në shenjtë, keqësi, shtrembërim, çoroditje, dredhi, dhe vetëmashtrim

3,4. **Ngarkesa e fajësisë.** *Heshtja.* Heshtja e Davidit ishte mospranimi i fajësisë para Zotit. Pasoja e këtij qëndrimi ishte sëmundje. Ditë e natë s’kishte qetësi derisa të mos pranonte ta rrëfente mëkatin e tij para Zotit.

5. **Lehtësimi i rrëfimit.** *Atëherë ta dëftova mëkatin tim, fajin tim më nuk e fsheha... e ti ma fale fajësinë e mëkatit tim* Ky ishte pa dyshim proces e jo veprim i menjëhershëm. Më në fund tha: “do ta pranoj”.

6-11. **Urtësia e përvojës.** *Prandaj.* Për shkak të përvojës së Davidit për rrëfimin dhe ndjesën e mëkatit që meritonte vdekje,

Davidi bëhet mësues i bashkëbesimtarëve në përputhje me rolin e njeriut të urtë në letërsinë e urtësisë.

PSALMI 33

Himn drejtuar Zotit

1 Galdoni, o të drejtë në Zotin, të drejtëve u ka hije lavdërimi!

2 Lavdërojeni Zotin me kitarë, bini gëzueshëm lirës me dhjetë korda!

3 Këndoni atij një këngë të re, përcilleni bukur me cetër brohoritjen!

4 Sepse e drejtë është fjala e Zotit e të gjitha veprat e tij a me besë.

5 E do drejtësinë e gjyqin, plot është toka me mirësinë e Zotit.

6 Prej fjalës së Zotit u krijuan qiejt, prej frymës së gojës së tij çdo trup qiellor;

7 si në rrëshiq i mbiedh ujërat e detit, oqeanet i qet në ujëmbledhës.

8 Le, të dridhet mbarë Toka para Zotit, të gjithë banorët e rruzullit le të tuten para tij!

9 Sepse ai foli – gjithçka u bë, ai urdhëroi – gjithçka u përftua!

10 Zoti i shpartallon synimet e popujve, i pështjellon qëllimet e kombeve.

11 Synimi i Zotit qëndron për amshim, mendimet e zemrës së tij prej breznie në brezni.

12 Lum ai komb që për Hyi e ka Zotin, populli që Zoti e zgjodhi për pronë.

13 Zoti shikon nga qielli e i sheh të gjithë bijtë e njerëzve.

14 Prej vendit të vet të shenjtë i shqyrton të gjithë banorët e tokës,

15 ai që të gjithëve ua ka krijuar zemrat e i kupton të gjitha veprat e tyre.

16 Nuk shpëton mbreti në saje të ushtrisë së madhe, as vigani në saje të fuqisë së madhe.

17 Kot e pret fitoren nga kali, fuqia e tij e madhe nuk do ta shpëtojë.

18 Qe, sytë e Zotit janë mbi ata që e druajnë, mbi ata që shpresojnë në mirësinë e tij:

19 për t'i shpëtuar nga vdekja e për t'i ushqyer në kohën e urisë.

20 Shpirti ynë shpreson në Zotin, ai është ndihma dhe mburoja jonë.

21 Zemra jonë në të e ka shpresën, shpresojmë në emrin e tij të shenjtë.

22 Mirësia jote qoftë mbi ne, o Zot, sikurse ne shpresojmë në ty.

KOMENTARI

Ky psalm është himn lavdërimi drejtuar Zotit, zotërisë së historisë. Psalmi merret kryesisht me Perëndinë si Krijues i gjithëfuqishëm, gjyqtar dhe shpëtimtar. Fillimi dhe fundi i psalmit na ftojnë ta lavdërojmë për këtë. Psalmi ndahet si vijon:

1. Veprimtaria e Zotit te krijimi dhe sundimi i tij i gjithëfuqishëm mbi kombet.

2. Zgjedhja e Izraelit nga Perëndia i cili është objekt i dashurisë së Tij të vazhdueshme.

rr. 1-3 Kënga e re është shkruar për të sjellë ndërmend veprën e re të çlirimit, ose e ka prejardhjen në vetëdijen e re për personin e Perëndisë.

rr. 4-11 Perëndia është i denjë për lavdërim për shkak të:

1. karakterit të fjalës së Tij (4-5). Fjala është vegël e krijimit.

2. veprës së tij të krijimi (6-7). Qiejt janë shprehje e saktë e mendjes së tij (fjalës) dhe produkt i drejtpërdrejtë i vullnetit të tij (gojës). Shpirti i tij (ose fryma), i përfshirë në fjalën e tij, është energjia e Zotit në zbatim. Ujërat (element i pashtuar) ai i qetëson me lehtësi.

3. nderimit të thellë që i përket Atij. (8-9)

4. gjithëfuqishmërisë së Zotit që drejton (10) dhe urdhëron (11)

rr. 12-19 Sundimi i Perëndisë s'është aspak tirani, por themelohet në dijeni të përsosur, kontroll të plotë dhe dashuri të përsosur.

rr. 20 Emri i Perëndisë do të thotë karakteri i tij i zbuluar në veprat e Tij.

PSALMI 34

Lavdi drejtësisë hyjnore

1 I Davidit, kur u shtir si i dalë mendsh para Abimelekut e, i dëbuar prej tij, u largua.

Alef 2 Përherë do ta lavdëroj Zotin, në gojën time përherë lavdi i tij.

Bet 3 Shpirti im mburret në Zotin: le të dëgjojnë të përvujtët e le të gëzohen.

Gimel 4 Bashkë me mua jepni lavdi Zotit, le ta lartësojmë së bashku emrin e tij.

Dalet 5 E kërkova Zotin e ai më dëgjoji edhe më çliroi nga çdo frikë që pata.

He 6 Shikoje atë e do të ndriçoheni, fytyra juaj nuk do të turpërohet.

Zain 7 Ja, ky skamnor e thirri në ndihmë e Zoti e dëgjoji dhe e shpëtoi nga të gjitha vuajtjet e tij.

Het 8 Engjëlli i Zotit ngreh llogore rreth atyre që e kanë frikë dhe i shpëton.

Tet 9 Sprovoni e shihni sa i mirë është Zoti! I lumi ai që shpreson në të!

Jod 10 Nderojeni Zotin, ju shenjtërit e tij, s' u mungon gjë atyre që e druajnë.

Kaf 11 Pasanikët u varfëruan dhe kishin uri, ata që kërkojnë Zotin do të kenë çdo te mirë.

Lamed 12 Ejani, o bij, e më dëgjoni: do t'jua mësoj frikën e Zotit.

Mem 13 A e dëshiron jetën, o njeri? A dëshiron ditë të shumta për të gëzuar të mirat?

Nun 14 Rrudhe gjuhën tënde prej së keqes, gojën tënde prej fjalëve gënjeshtare.

Sameh 15 Ik prej së keqes e bëj të mirën; kërkoje paqen e ndiqe atë!

Ain 16 Sytë e Zotit kë 'qyrin të drejtët, veshët e tij ua dëgjojnë ofshamat.

Pe 17 Fytyra e Zotit është kundër keqbërësve, për ta zhdukur prej dheut kujtimin e tyre.

Tsade 18 Klithin të drejtët, Zoti i dëgjon, i liron prej të gjitha vështirësive të tyre.

Kof 19 Zoti është ngjat atyre që pendohen me zëmër, i shpëton shpirtpërgjirët.

Resh 20 Sado të vështira të ketë i drejti, prej të gjithave do ta shpëtojë Zoti.

Shin 21 Zoti i ruan eshtrat e tyre: asnjë prej tyre nuk do t'u thyhet.

Tau 22 E keqja e vet do ta vrasë keqbërësin, e do ta paguajnë ata që e urrejnë të drejtin.

Vav 23 Zoti e shpagan shpirtin e shërbëtorëve të vet, nuk do të ndëshkohen ata që shpresojnë në të.

KOMENTARI

Mbishkrimi i psalmit bën aludim për ngjarjet te 1 Samuel 21,10-14. Duke ikur nga Shauli, Davidi kërkoj strehim te mbreti filiste në Gat. Emri i tij personal është Akish, por emri i tij dinastik është Avimelek (Zan. 20,2; 21,22; 26,8).

Megjithatë, pas pak, siguria bëhet ndalim (1 Sam. 21,13, 'në duart e tyre') sepse filistenjtë e njohën Davidin dhe e mbajtën peng. Duke u shtrirë i çmendur, Davidi u lirua. Kështu, po të kishim vetëm tregimin që gjendet te libri i Samuelit, do të vinim në konkluzionin që lirimi i tij ishte fryt i mendjemprehtësisë. Por, pasi e mendoj mirë, Davidi vuri re se nuk ishte kështu: shkaku i lirimimit të tij ishte se *E kërkova Zotin e ai më dëgjoj* (rr. 5) ... *Ja, ky skamnor* (d.m.th. Davidi) *e thirri në ndihmë* (7). Dredhi nuk ka hapur derën, por *Zoti ...edhe më çliroi ... më shpëtoi nga të gjitha vuajtjet e mia*. (7).

Psalmi mund të ndahet në dy pjesë:

rr. 2-11, mësimet e përvojës, kryesisht dëshmimi i vetë Davidit me konkluzione të nxjerra;

rr. 12-23, mësimi për të vërtetën, si të drejtosh jetën dhe të ballafaqosh me kriza.

1, 2 **Zotim për lavdërim pa pushim.** *në çdo kohë* – madje edhe në kthetrat e Avshalomit – reagimi i vërtetë është jo aftësi por lavdërimi. Ky është mesazhi për të pikëlluarit, ata në fund të shoqërisë.

4-7 **Dëshmimi i ndarë për nder të Zotit.** Lutja plotësohet me çlirim të plotë (4) – dhe kjo nuk është vetëm përvoja e Davidit, sepse ata që i drejtohen Atij gjejnë shkëlqim të madh (5); ata kurrë nuk korrin turpësi, d.m.th. ata kurrë nuk zhgënjehen pasi iu drejtuan Zotit. Dhe kjo përvojë nuk është veçanti e Davidit, sepse ishte si skamnor që i bëri thirrje Zotit dhe Zoti e dëgjoi (6).

8-11 **Mësimet e nxjerra.** Dëshmia e një personi të vetëm është vetëm i vlefshme për të tjerët në qoftë se themelohet në të vërtetën e pandryshuar të Perëndisë. Por pse Davidi mund t'i gëzonte përjetime të tilla? Sepse engjëlli i Zotit është gjithnjë i pranishëm për të shpëtuar besimtarin. (8). Kur iu shfaq Hagarës, engjëlli i Zotit fliste për Zotin (Zan 16,11) e megjithatë ishte vetë Zoti (Zan. 16,13; krhs. Dal. 3,2, 4; 14,19, 24; 23,20-21; Gjq. 6,21, 22; 13,21, 22). Ky engjëll lidhet posaçërisht me rrethanat kur Zoti dëshiron t'u shfaqet individeve të zgjedhur dhe kështu dëshmon për Trininë. Kështu, dëshmia e Davidit mund të jetë dëshmia e ndokujt sepse engjëlli shoqëron të gjithë ata që e nderojnë. Kështu, të gjithë janë të ftuar ta sprovojë, dhe të strehohen tek Ai (8)

12-15 **Sekreti i jetës së mirë.** *Do të mësoj* cakton temën e pjesës tjetër të psalmit. Këtu janë mësimet që Davidi dëshiron të ndajë me ne. Së pari, kyçi i jetës së mirë është: *të ruash gjuhën tënde* (14) të caktosh dhe t'u përmbahesh qëllimeve morale negative dhe pozitive. (15). Në oborrin e Akishit, Davidi mori lirinë e tij me anë të mashtrimit dhe kompromisit, por njeriu me

nderim të thellë për Zotin respekton të vërtetën dhe nderon vlerësitë e tij.

16-19 **Sekreti i ballafaqjes me telashtet.** Fillimi i telasheve duhet t'i përgjigjet fillimit të lutjes, kurse lutja e besimtarit i bën thirrje Zotit për të na ndihmuar. (18). Meqë besimtarët kontrastohen me keqbërësit, terminogjia përfshin edhe ata që janë në rregull me Perëndinë, edhe zotim për të bërë një jetë të drejtë, sepse këto janë kushtet për plotësimin e lutjes: (16, thirrje); por Zoti identifikohet me ata që janë të pikëlluar, (19. Lev. 21,23; Ru. 2,20; 3,12).

20-23 **Sekreti i çlirimit.** Por ky zotim s'është garanci që gjithçka do të shkojë mbarë, por, kur të ketë telashe, Zoti premtun të na rrijë afër dhe të na ndihmuar në çdo gjendje të vështirë.

Stili themelohet në metodën e pyetjeve dhe përgjigjeve të uriturve. Tema është hakmarrje siç interpretohet në judaizmin orthodox.

PSALMI 35

Lutja e të drejtit të përndjekur

1 *I Davidit.*

Dënoji, o Zot, ata që më paditin, luftoji ata që më luftojnë!

2 Merri armët e shqytin e çohu të më ndihmosh,

3 Vringëllo heshtën e sakicën kundër atyre që më përndjekin,

thuaji shpirtit tim: »Unë jam shpëtimi yt!«

4 U turpërofshin dhe u çnderofshin ata që e kërkojnë jetën time,

u zmbropshin dhe u turpërofshin ata që ma mendojnë të keqen.

5 U bëfshin porsi byku para erës e i dëboftë engjëlli i Zotit!

6 Udha e tyre u bëftë e errët e rrëshqitëse kur në shpinë t'u vihet engjëlli i Zotit!

7 Sepse pa arsye ma ngrehën rrjetën, sepse pa arsye ia hapën gropën shpirtit tim.

8 U ardhte vdekja e papritur, u zënçin në rrjetë që vetë e ngrehën,

rënçin në gropë që vetë e hapën!

9 Kurse shpirti im do të galdojë me Zotin, do ta gëzojë shpëtimin e tij.

10 Të gjithë eshtrat e mi do të thonë: »E kush është, o Zot, si ti

që e shpëton të varfrin prej dhunëtarit, prej çubave të mjerin e skamnorin.«

11 U ngritën dëshmitarë të pashpirtë, më pyesin për gjëra që s'i di,

12 të mirat m'i kthejnë me të këqija: vetmim për shpirtin tim.

13 E pra, unë, kur ata ishin të sëmurë, ngjeshesha me grathore, me agjërim e mundoja shpirtin tim, lutesha për ta me gjithë afsh të zemrës.

14 Sikur ta kisha të afërm, sikur për vëllanë kërrusesha i trishtuar porsi ai që mban, 21 për nënën.

15 E tash që vetë rrëshqita, ata po gëzohen, u bashkuan për të më salvuar papritmas,

16 vazhdimisht më shqyejnë e nuk pushojnë, më përqeshin duke më shpotitur,

kundër meje dhëmbët i kërcëllijnë.

17 O Zot, deri kur ti vetëm do te shikosh? Liroje shpirtin tim nga sulmet e tyre, prej luanëve të vetmen të mirë timen.

18 Do të të falënderoj në kuvendin e dheut, do të të lavdëroj midis popullit të shumtë.

19 Mos lejo të gëzohen mbi mua armiqtë e mi rrenacakë, që të mos bëjnë me sy ata që më urrejnë pa arsye.

20 Sepse ata nuk flasin për paqe, por sendërgjojnë dredhi kundër paqedashësve të dheut.

21 Hapin gojën e vet kundër meje e thonë: »Hë, hë! Me sytë tanë ia pamë të zezën!«

22 Ti po sheh, o Zot, ti mos heshto, o Zot, mos më rri larg!

23 Zgjohu, ngrihu për të më mbrojtur, O Zot, Perëndia im, mbroje ti çështjen time!

24 Më gjyko sipas drejtësisë sate, o Zot, Perëndia im, që të mos gëzohen mbi mua!

25 Të mos thonë në zemrën e tyre: »Lum shpirti ynë!« Që të mos thonë: »E përpimë!«

26 U skuqshin dhe njëherësh u çnderofshin, ata që i gëzohen së keqes sime, turpi dhe marrja i mbuloftë ata që çohen kundër meje!

27 U kënaqshin dhe u gëzofshin, ata që e kanë për zemër drejtësinë time! Thënçin përherë: »Qoftë madhëruar Zoti që e do paqen e shërbëtorit të vet.«

28 Gjuha ime do ta shpallë drejtësinë tënde, ditë për ditë lavdin tënd.

KOMENTARI

Ky psalm i përket një kohe kur armiqësi dhe vajtim ishin, siç duket, pa fund. Periudha e gjatë e urrejtjes paranojake të Shaulit i plotëson kërkesat. Siç te psalmi 34, vetëm lutja drejtuar Zotit është zgjidhja, por në këtë rast plotësimi shtyhet. Lutja ia nënshtron nevojat tona Zotit, kurse kalendari ynë të tijit.

Tri seksionet e psalmit caktohen nga premtimet e lavdërimit kur të hiqet halli. (9-10, 18, 27-28). Brenda çdo seksioni theksohen temat si vijon.: (a) thirrjet për ndërhyrjen e Zotit (1-3, 17, 22-24a), (b) lutjet për hakmarrje (4-6, 8, 24b-26) si dhe (c) arsyet meritohet (7, 11-16, 19-21); ideja kryesore gjendet te rreshtat e fundit: vajtimi është pa shkak (7), ripërtëritja e sjelljes së Davidit (13, 14), plotë me urrejtje personale (19-21). Siç e ka zakon te psalme të tilla, ne jemi të çuditur nga vrulli i lutjeve të Davidit si armë kundërsulmimi kundër armiqve të tij. Na duhet të mbajmë mend se ka inat të pastër, siç dëshmohet tek Jezusi (Mk. 3,5), te besimtarët (Apok. 6,9-10, dhe i shënuar tek Eph. 4,26. Mbarë psalmi është lutje pa armiqësi personale: ai e lë çështjen në duart e Zotit .

PSALMI 36

Fajësia e njeriut e mirësia e Perëndisë

1 *Mjeshtrit të korit. I Davidit, shërbëtorit të Zotit.*

2 Paudhësia pëshpërit mu në zemër të keqbërësit, frika e Perëndisë s'është para syve të tij.

3 Vetë mëkatari ia mbyll sytë vetvetes, të mos e shohë paudhësinë e të mos e urrejë.

4 Fjalët e gojës së tij janë paudhësi e dhelpëri, për urtësi e vepra të mira nuk e vret veshin.

5 Në shtrojën e vet sendërton paudhësinë, ecën vazhdimisht udhës së keqe, djallëzinë nuk e urren.

6 Mirësia jote, o Zot, deri në qiell, bujaria jote deri në majë të reve!

7 Drejtësia jote si malet, më të lartat, gjyqet e tua porsì Humnera e madhe:

njerëz e kafshë ti, o Zot, i shpëton.

8 Sa e çmueshme është, mëshira jote, O Perëndi! Njerëzit strehohen nën hijen e krahëve të tu.

9 Ngihen me begatinë, e Shtëpisë sate, u shuan etjen nga përroi i kënaqësisë sate.

10 Sepse tek ti është burimi i jetës, në dritën tënde ne shohim dritën.

11 Shtrije mëshirën tënde mbi ata që të njohin, drejtësinë tënde mbi ata që zemrën e kanë të pastër.

12 Mos më shkeltë këmba e madhështorit, mos më grahtë dora e mëkatarit.

13 Këtu u thyen keqbërësit, ranë e më s'mund u ngritën!

KOMENTARI

Në këtë psalm, duhet zgjedhje për të caktuar mënyrën e jetesës që përjetojmë tani si dhe fatin që na pret: zgjedhja përbëhet nga reagimi ynë ndaj zbulimit të Perëndisë. Po ta refuzojmë, jemi të detyruar të bëjmë një jetë pa vlerë, por po ta pranojmë, mund të gëzojmë jetën, dritën, furnizim dhe mbrojtje.

2-5. **Shëmtimi i së keqes.** Kjo profeci përshkuan në thelb armikun e keq të psalmistit. Frytet e refuzimit të Perëndisë përshkruhen te vargjet 4-5.

4. Shërbëtori i Zotit: ishte titull nderi për kombin si dhe për udhëheqësit e tyre të shquar. (krhs. 69, 17 135, 14), (krhs. Lp. 34, 5; Jos. 24, 29; Ps. 89, 3)..

5-9. **Madhështia e Perëndisë.** Mirësia jote...Drejtësia..., mëshira jote,

Këto veçoritë e Perëndisë krahasohen me dukuritë e natyrës dhe pastaj me përvojat e njeriut. Përveç kësaj Zoti është burim jete. Kështu dallohet madhështia e tij.

11-12. **Triumfi i dashurisë.** Pas lutjes së shkurtër psalmisti parashikon përmbytjen e keqbërësit.

11. drejtësia jote: (shih 33, 5); këtu, do të jetë sinonim për besnikëri.

PSALMI 37

Fati i të drejtit dhe i keqbërësit

1 *I Davidit*

Alef Mos u zemëro kundër keqbërësve
as mos ua ki lakmi atyre që bëjnë keq.

2 Sepse do të thahen me shpejt si kashta
e do të kalben si bari i njomë.

Bet 3 Shpreso në Zotin e bëj mirë:
kështu do të banosh Tokën e premtuar e do të jetosh në
paqe.

4 Vëre gëzimin tënd në Zotin,
e ai do t'i plotësojë dëshirat e zemrës sate.

Gimel 5 Lëshoje në dorë të Zotit fatin tënd,
shpreso në të dhe ai do të kryejë gjithçka.

6 Do ta bëjë të shndritë si drita drejtësia jote,
të drejtën tënde porsì mesdita.

Dalet 7 Heshto para Zotit e shpreso në të
e mos u zemëro për shkak të atij që punët i ecin
mbarë,
për njeriun që djerron tradhti.

He 8 Hiq zemërimin e largoje hidhërimin,
mos u kastigo se vetëm prish punë,
9 sepse ata që bëjnë keq do të shuhen,
kurse ata që shpresojnë në Zotin do ta trashëgojnë
tokën.

Vav 10 Edhe pak kohë e keqbërësi do të shartojë,
tash ia kërkon vendin e s' do t'ia gjesh,
kurse të butët do ta trashëgojnë tokën
e do të kënaqen në paqe me një mijë të mirat.

Zain 12 Keqbërësi i vë prita të drejtit,
kundër tij kërcëllon dhëmbët,
13 por Zoti e përqesh atë,
sepse e sheh se do t'i vijë dita.

Het 14 Mëkatarët vringëlluan shpatën
dhe ngrehën harkun
për ta shtruar përdhe nevojtarin e skamnorin,
për t'i vrarë ata që ecin udhës së drejtë.

15 Shpata e tyre do të shpojë zemrat e tyre,
harku i tyre copë e grimë do të bëhet.

Tet 16 Më mirë pakica e të drejtit
sesa pasuria e madhe e keqbërësit,

17 sepse krahët e keqbërësve do të thyhen,
ndërsa të drejtët i mban në fuqi Zoti.

Jod 18 Vetë Zoti mendon për jetën e të mirëve,
trashëgimi i tyre do të qëndrojë për amshim.

19 Nuk do të turpërohen në ditë te keqe,
s' do t'u mungojë buka në kohë zie.

Kaf 20 Kurse keqbërësit – armiqtë e Zotit, do të
sharrojnë,
porsi stolia e fushave do të vshken,
do të zhduken porsi tymi.

Lamed 21 I paudhi merr hua e nuk kthen,
ndërsa i drejti ka dhembje e dhuron.

22 Ata që Zoti i lavdëron, do ta trashëgojnë tokën,
ndërsa ata që i Lumi i mallkon, do të shuhen.

Mem 23 Zoti i forcon hapat e njeriut
dhe përcjell me dashuri udhën e tij.

24 Kur rrëzohet nuk thërrmohet,

sepse Zoti e mban për dore.

Nun 25 I ri qesh edhe u plaka,
por nuk e pashë të drejtin të lënë pas dore
as fëmijët e tij duke lypur bukë.

26 Gjithmonë ka mëshirë, dhe huazon,
prandaj edhe pasardhësit e tij janë të bekuar.

Sameh 27 Hiq s'keqes e bëj të mirën
e s'do të jesh i paplang e i pashtëpi për amshim,

28 sepse Zoti e do të drejtën
dhe nuk i lëshon dore miqtë e vet.

Ain Keqbërësit me siguri do të shfarosen,
breznia e tyre do të shuhet.

29 Tokën do ta trashëgojnë të drejtët
dhe në të do të banojnë për amshim.

Pe 30 Goja e të drejtit e shkoqit dijen,
gjuha e tij shpall të drejtën.

31 Ligji i Perëndisë së tij është në zemrën e tij:
nuk shqepojnë hapat e tij.

Tsade 32 I paudhi e përgjon të drejtin: këqyr si ta vrasë.

33 Porse Zoti s'do ta lëshojë në duar të tij
a nëse gjykohet s'lejon ta dënojnë.

Kof 34 Prite me duresë Zotin dhe ec udhës së tij, ai do të të bëjë të madh e do ta trashëgosh Tokën dhe do ta shikosh shfarosjen e të paudhëve.

Resh 35 E pashë të paudhin tepër të lartësuar, të lartë porsi cedrin e kërtthndezët;

36 kalova dhe, ja, nuk ishte, e kërkova e nuk,e gjeta.

Shin 37 Ruaje pafaj ësinë e zbatoje të drejtën: njeriu i paqes pas vetes lë djalin.

38 Të paudhët së bashku të gjithë do të shuhen, bir as bijë keqbërësit nuk do të lënë.

Tau 39 Shpëtimi i të drejtëve vjen prej Zotit, ai është strehimi i tyre në ditë të ngushtë.

40 Vetë Zoti i ndihmon ai i ruan, do t'i lirojë prej keqbërësve sepse shpresuan në të.

KOMENTARI

Autori është njeriu me dijeni të fituar me mundim dhe përvojën e pleqërisë (krhs. rr 25) që kërkon t'i kalojë në brezin më të ri. Qëllimi i tij kryesor është inkurajimi i besimtarëve që të vazhdojnë të kenë besim te Zoti me gjithë padrejtësitë e jetës në të cilat jobesimtarët, siç duket, ia dalin mbarë. Ai nuk merret me problemet teoretike, as me justifikimin e sundimit të Zotit në botë.(krhs. Job). Qëllimi i tij është më praktik dhe baritor: t'i ndihmojë besimtarët e tjerë të bien në ujdi me situatën e tyre

duke i siguruar se çdo padrejtësi në jetë është vetëm e përkohshme. (krhs. Ps. 49; 73).

Ky psalm 37 mund të shërbejë si komentar për rreshtat e fundit të psalmit 36 – lutja kundër këmbëve dhe duarve të armikut, simbolikisht fitore dhe fuqi personale, si dhe pohimi se kudo që të sulmojnë, ata do të dështojnë. Kjo hap tensionin pikëllues në jetën e besimtarit kur dallohet jeta e besimtarit nga ajo e jobesimtarit (ateistit praktik). Psalmi mund të ndahet në katër seksione: të këqijtë thurin intriga (12), të këqijtë huazojnë (21), të këqijtë mashtrojnë (32).

1-11 Lulëzimi i njeriut të keq: Vihet re që, siç duket, mashtruesit kanë sukses (7) kurse ata që duan të bëjnë mirë shpesh mërzhiten nga jeta dhe kanë prirje të kenë zili për të tjerët (1), të shqetësohen (8) dhe të pyesin veten nëse është e vërtetë se të përulurit do të trashëgojnë tokën (9, 11). Përgjigjet që duhet qetësi dhe kënaqje (1, 7, 8), besim dhe angazhim moral (3, 5), durim (7), dhe siguri për përfundimin (10, 11). Themelimet e këtyre urdhërimeve është përkohshmëria e keqbërësit (2), bekimi i sigurt i Perëndisë (4-6), rregullimi i fundit i gjithçkaje. (9-11).

PSALMI 38

Lutja në ngushtim

1 *Psalm. I Davidit. Në kujtim.*

2 Mos më qorto, o Zot, në hidhërimin tënd as mos më ndëshko në zemërimin tënd!

3 sepse shigjetat e tua në mua u ngulën, mbi mua rëndoi dora j ote.

- 4 S'ka vend të shëndoshë në trupin tim për shkak të zemërimit tënd,
s'ka paqe në eshtrat e mi për shkak të mëkateve të mia.
- 5 Sepse fajet e mia kaluan mbi kokën time më ndrydhin porsi barra e rëndë.
- 6 U qelbën dhe u kalbën varrët e mi për shkak të marrëzisë sime.
- 7 U kërrusa dhe u gërmuqa për së tepërmi i trishtueshëm endem gjithë ditën.
- 8 Digjen prej etheve ijët e mia, asgjë në trupin tim nuk kam të shëndoshë.
- 9 I lodhur e i këputur krejtësisht gjëmoj prej dënësës së zemrës sime.
- 10 Para teje, o Zot, i vë dëshirat e mia as britmat e mia nuk janë për ty të fshehta,
- 11 zemra më rreh dhe fuqia më lëshoi edhe drita e syve të mi po fiket.
- 12 Miqtë e shokët e mi u zbrapsën para plagëve të mia edhe më të afërmit e mi më rrinë larg.
- 13 Më ngrehin leqe ata që kërkojnë jetën time, më kërcënohen me vdekje ata që ma dëshirojnë të keqen, gjithë ditën përbluajnë dredhi kundër meje.
- 14 E unë si i shurdhët nuk dëgjoja, si të isha i pagojë, një fjalë nuk e them,
- 15 u bëra njëmend si ai që nuk ndien, si ai që në gojë përgjigje s'ka.
- 16 Pasi në ty, o Zot, e kam vënë shpresën, o Zot, Perëndia im, ti do të më dëgjosh.
- 17 Sepse thashë: »Deh, mos lejo të ngihen në mua, kur të më merren këmbët, të mos krenohen kundër meje.«

18 E unë jam i gatshëm për t' u rrëzuar, dhembjen time përherë e kam para syve.

19 Ja, unë e pranoj fajin tim, jam i prishur për mëkatin tim.

20 E armiqtë e mi janë gjallë e të fortë, u shumuan ata që më urrejnë dijekeqas.

21 Të mirën ma kthejnë me të keqe e më shpifën pse mundohem të bëj mirë.

22 Mos më lër vetëm, o Zot, Perëndia im, mos u largo prej meje.

23 Nxito të më ndihmosh, o Zot, Shpëtimtari im.

KOMENTARI

Siç duket psalmisti e pëson nga një sëmundje që ka që miqtë e tij ta trajtojnë si leprosur. (krhs. rr. 6, 12) dhe u jep armiqtë rast për të thurur shkatërrimin e tij. Ndryshe nga Jobi në gjendje të ngjashme, psalmisti është i bindur se vuan si pasojë e mëkateve të tij dhe dëshmia kryesore për këtë është pranimi i fajësisë dhe kërkimi i tij për çlirim.

Dy rreshtat e fundit përmbledhin temën dhe mrekullinë e psalmit. Kur Zoti është i fyer dhe na pret zemërimi dhe inati i tij dhe shigjetat e tij fillojnë të fluturojnë (3), është i njëjti Zot të cilit i bëjmë thirrje për ndihmë dhe shpëtim (23). Vetëm favori i Zotit mund të na çlirojë nga mosmiratimi i tij. Ky psalm na paralajmëron kundër mëkatit duke treguar pasojat e tij. Mëkati (kryengritja) fyen Zotin dhe e shtyp mëkatarin duke zëvendësuar mirëqenien me plagë, ngjall depresion me dembjen e trupit dhe pikëllimin e zemrës, (rr. 2-9). Rebelimi trishton dhe nuk gjallëron, na izolon nga armiqtë dhe ngjall armiqtë (rr. 10-13); na lë pa shfajësim (14, 15). Por rebelim nuk mbyll portën e lutjes, e as nuk na përjashton nga pendimi. (16-19).

3. *shigjeta*: ndëshkim nga Zoti, posaçërisht në trajtë të sëmundjes., (krhs. Lp. 32, 23; Job 6, 4; Ps. 7, 12 +).

4. *s'ka paqe në eshtrat e mi*: të dy mund ta përfaqësojnë njeriun si tërësi., d.m.th. 'mua ... unë'.

PSALMI 39

Njeriu është asgjë kundrejt Perëndisë

1 *Mjeshtrit të korit. Jedutun, Psalm. 1 Davidit.*

2 Thashë: »Do t'ia vë mendjen sjelljes sime që të mos mëkatoj me gjuhën time,

fre do t'ia vë gojës sime sa të j etë para meje keqbërësi. «

3 Heshtova, nuk fola, verë me gojë nuk bëra, por më kot dhembja ime u përtërit.

4 Flakë u ndez në mua zemra, posa më shkante mendja në të – flakë ndizesha,

5 fola me gjuhën time: »Ma zbulo, o Zot, mbarimin tim, cili është numri i ditëve të mia, që ta di sa e shkurtër është jeta ime!«

6 Qe, në gishta mund të njehen ditët e jetës sime, jeta ime është asgjë para teje, vetëm avull është çdo njeri.

7 Porsi hije kalon jeta e njeriut, e kotë është krejt puna e tij: ai mbledh visare e s' di kush i gëzon.

8 E tani çka mund të pres, o Zot? Shpresa ime është në ty!

9 Më pastro prej të gjitha fajeve të mia, mos lejo të bëhem loj a e të patenzonit!

10 S'bëj zë, gojën nuk e çel sepse je ti ai që vepron;

11 Largoji, deh, prej meje ndëshkimet e tua, se më doli shpirti nën peshën e dorës sate!

12 Ti njëmend me ndëshkim e përmirëson njeriun, porsitenja e bren dëshirën e tij. Vërtet tytësi është çdo njeri!
 13 Dëgjoje, o Zot, lutjen time, vështro klithmat e mia!
 Mos u bëj i shurdhët ndaj lotëve të mi! Para teje unë jam i huaj, endacak porsitetërit e mi.
 14 Më lër një herë të lirë të marr frymë, para se të shkoj e të mos jem më!

KOMENTARI

Situata i përgjigjet asaj të psalmit 38, heshtje në prani të shikuesve (38,12, 13; 39,3), veprim i Zotit kundër mëkatit. (38,1-3; 39,9-11), shpresa te Zoti (38,15, 21, 22; 39,7). Por fokusi është i ndryshëm. Te Psalmi 38 sëmundja ka nxjerrë në dritë mëkatin, duke sjellë nevojën për ndjesë te Psalm 39 sëmundja ka nxjerrë në dritë përkohshmërinë e jetës, duke sjellë kërkim të periudhës së dritës, (14) para se të kalojë përkohshmëria e jetës.

Përkohshmëria e jetës dhe trishtërimi i vdekjes kalojnë nëpër Biblën dhe zbulimi i plotë i botës së përjetshme nuk i zhdukin. Kjo jetë është e çmueshme. Gëzimet dhe dashuritë e saj mund të tejkalohen, por nuk mund të zëvendësohen. Humbja e të afërmit është një pikëllim pas tjetrit. (Fil. 2,27); largimi nga kjo jetë nuk mund të shihet pozitivisht, edhe pse qielli është i sigurt. Davidi e pyet veten, 'A do të vdes?' (5), por tani sheh të ardhmen në perspektivën e drejtë. Ndoshta u sëmur për vdekje (11, f. 'Jam i humbur'), por ka pikërisht të njëjtën sasi kohe tokësore sa ndokush tjetër, atë që Zoti i jep. Kjo është shpresa e tij e sigurt. – e shkurtër ose e gjatë, jeta jepet nga Zoti.

PSALMI 40**Falënderim dhe lutje**

1 Mjeshtrit të korit. i Davidit. Psalm.

2 Me shpresë të gjallë shpresova në Zotin

3 dhe ai u prir drejt meje, e vështroi britmën time.
Ai më nxori nga gropa e mjerimit, nga gropa, plot baltë,
këmbët m'i qiti mbi shkëmb dhe m'i bëri të fortë hapat.

4 Në gojë më vuri një këngë të re, himnin e Zotit,
Perëndisë sonë.
Shumë do të shohin e do të druajnë dhe do të shpresojnë
në Zotin.

5 I lumi ai që shpresën e vet e vë në Zotin
që nuk i nderon krenarët e ata që i mbështeten rrenës.

6 Shumë mrekulli bëre, O Zot, Perëndia ynë, të
mrekullueshme janë qëllimet e tua me ne: nuk gjendet një
tjetër i ngjashëm me ty! Nëse dua t'i shpall e t'i tregoj,
janë aq shumë, saqë s'mund t'i numëroj.

7 Fli e dhurata ti nuk do,
vetë ma zbulove vullnetin tënd:
fli shkumbimi e pendestare nuk kërkon,

8 atëherë thashë: »Ja, po vij unë.

Në Librin e Ligjit shkruan për mua:

9 Të kryej vullnetin tënd, Perëndia im, dëshiroj,
Ligji yt është në thellësinë e zemrës sime.«

10 Drejtësinë tënde e shpalla në kuvendin e dheut, shih,
nuk i mbaj të mbyllura buzët, o Zot, ti e di.

11 Nuk e fsheha drejtësinë tënde në zemrën time,
do ta kumtoj të vërtetën tënde dhe shpëtimin tënd,
kurrë s' e mohova mirësinë tënde
e të vërtetën tënde në kuvendin e dheut.

12 E ti, o Zot, mos m' i moho përdëllimet e tua,
dashuria jote dhe e vërteta jote më ruajtshin vazhdimisht,

13 sepse më rrethuan të këqij a të panumërta,
më pushtuan fajet e mia e nuk më lënë të shoh:
më shumë janë se fijet e flokëve të kresë,
kështu që edhe zemra po më lëshon.

14 Denjo, o Zot, të më shpëtosh, o Zot, nxito të më
ndihmosh!

15 Le të turpërohen e le t' i mbulojë marrja ata që synojnë
të ma marrin jetën! Le të zbrapsen dhe le të mbesin të
turpëruar ata që ma dëshirojnë të keqen! 16 Le të mbesin
të hutuar në turpin e vet
ata që, të kënaqur për të keqen time, më përqeshin.

17 Kurse le të gëzohen e le të galdojnë me ty,
të gjithë ata që të kërkojnë ty
e të thonë vazhdimisht: »I madhërishtëm është Zoti!«,
të gjithë ata që e duan shpëtimin tënd.

18 Njëmend jam skamnor e i vobektë
porse Zoti kujdeset për mua.
Ti je ndihma ime dhe shpëtimi im:
Perëndia im, deh, mos vono.

KOMENTARI

Te Psalmi 38, 39 Davidi i lutej Zotit me shpresë (38,15; 39,7) në krizën e shkaktuar nga mëkati (38,3; 39,8) dhe nga keqdashuria e hapur (38,16; 39,8). Tani mbaron pritja (1-3); besimi është justifikuar (4-5) vijon zotim për të ndjekur vullnetin e Zotit (6-8); bëhet be për të dhënë dëshmi të hapur (9-10) por mbetet pamjaftueshmëri dhe nevoja për ndihmë të shpejtë nga Zoti (11-13). Ka edhe nevojë për vepër të hapur të qortimit (14-15) dhe dhënien e gëzimit (16). Duke ballafaqur të ardhmën, Davidi përsëri pret Zotin: çfarëdo qoftë Zoti ka bërë në të kaluarën, ka nevojë të vazhdueshme për kujdesin e tij si dhe për një çlirim. (17).

6. Paraardhësi i Davidit si mbret u qortua për paçiltërsi të ngjashme (1 Sam. 15,22); por ky varg, bashkë me atë që vijon, vë në pyetje vetë sistemin dhe parashikon profecitë rreth Shërbëtorit të Zotit dhe rreth besëlidhjes së re.

Në Septuagintë, i cituar në Letrën drejtuar Hebrenjve 10,5, lexohet *'më ke përgatitur trup'*. Çfarëdo qoftë leximi fillistar i tekstit, theksohet ideja e përkushtimit..

7 *rrotulli*. Bëhet fjalë për ndonjë dekret lidhur me kurorëzimin (2,7; krhs. Lp. 17,14-20) ose be (krhs. 101) e cila karakterizon natyrën e mbretërisë davidike. Në një ripohimi solemn Davidi ripohon zotimin e tij për përmbajtjen e këtij ideali. Në fund të fundit, vetëm Mesia mund të bëjë një zotim të tillë, dhe Letra drejtuar Hebrenjve 10,5-10 me të drejtë i quan të dy largimi i sistemit të flijimeve si dhe pranimit të detyrës ndaj përmbajtjes së Ligjit siç u realizua te Jezu Krishti.

Në Librin e Ligjit shkruan për mua: d.m.th.. 'mua m'u caktua' (krhs. 2 Mbr. 22, 13).

PSALMI 41**Urata e të sëmurit të lënë pas dore**

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.*

2 I lumi ai që e kujton nevojtarin:

në ditë të vështirë Zoti do ta shpëtojë.

3 Zoti do ta ruajë, do ta kërthndezë në jetë,

të lum do ta bëjë mbi tokë

dhe s' do ta lëshojë në duar të armiqve të vet.

4 Zoti do t'i çojë ndihmë mbi shtratin e dhembjeve të tij:

do ta përtërish në sëmundjen e tij.

5 Unë thashë: »Ki mëshirë për mua, o Zot,

ma shëro shpirtin, sepse mëkatova kundër teje.«

6 Armiqtë e mi flasin keq për mua:

»Kur do të vdesë e do t'i harrohet emri?«

7 Po edhe nëse vien kush të më shohë, flet kotësi,

në zemër mbledh paudhësi, del përjashta e më vë në loj

8 Të gjithë armiqtë e mi pëshpëritin kundër meje së

bashku

e ma mendojnë të keqen:

9»Lëngatë e madhe e ka kapur!

Kë kap kjo sëmundje ai më nuk çohet!«

10 Po edhe miku im, në të cilin pata shpresë,

që hëngri bukën time, u çua kundër meje.

11 Por ti, o Zot, ki mëshirë për mua,

më shëro dhe unë do t'ua kthej huanë!

12 Me këtë do ta marr vesh se më do

nëse nuk lejon të ngihet armiku im në mua,

13 e ma ngjet dorën për shkak të pafajësisë sime
dhe më lejon të rij në praninë tënde për amshim.

14 Lavdëroftë Zoti, Perëndia i Izraelit,
prej amshimit në amshim. Amen. Amen.

KOMENTARI

Psalm 41, Ka të ngjarë që ky psalm të ketë qenë falënderim i recituar në Tempull (shih. rr. 13) pas çlirimit, dhe i shoqëruar me flijimet e mirënjohjes (shih 22, 25). Në këtë rast rr. 4-10 është përshkrimi i vajtimit që përdori psalmisti kur ishte në telashe; rr. 1-3 janë fjalët drejtuar adhuruesve të pranishëm (shih Ps. 34); kurse rr. 11, 12 falënderim për rimëkëmbjen. Shumë komentues e lidhin këtë psalm (krhs. Ps. 55) me përjetimin e Davidit pak para kryengritjes së Avshalomit (2 Sam. 13-18), duke quajtur rr. 9 aludim për Ahitofelin (2 Sam. 15, 31; krhs. 16, 17).

Tema e sëmundjes, mëkatit, armiqësisë dhe largimit e lidhin këtë psalm me Psalmet 38-40 duke sjellë ndërmend një aspekt – keqësi dhe tradhti – të së njëjtës prove të zgjatur. Por posaçërisht provon një parim (1-3) kundër përvojës (11, 12): a është fakt që një qëndrim të kujdesit për të dobëtit ngjall një kujdes reciprok nga ana e Zotit?

1-3 (A') Favori i Zotit, në parim. Kujdesi për nevojtarët theksohet te DhV (Dal. 22,21; 23,9; Lev. 19,10,33; Lp. 10,18). Fjalët e urta 14,21; 19,17 premtojnë bekim si shpërblese (krhs. Mt. 5,7; 18,33). Këtu premtimi përfshin edhe shpëtim në nevojë, (1), mbrojtje dhe rimëkëmbje, bekim tokësor, strehim, forcë dhe ngushëllim gjatë sëmundjes (2-3).

LIBRI II (Ps 42-72)

PSALMI 42

Vajtimi i levitit të mërguar

1 *Mjeshtrit të korit. Poemë. E bijve të Korahut.*

2 Sikurse dreri i dëshiron burimet e ujërave të gjalla, po ashtu shpirti im të dëshiron ty, O Perëndi!

3 Shpirti im ka etje për Perëndinë, për Perëndinë e gjallë: oh, e kur do të shkoj e do të dal para fytyrës së Perëndisë?!

4 Lotët e mi janë buka ime ditë e natë, ndërsa më thonë për çdo ditë:
»Ku është Perëndia yt?«

5 Mallëngjehet shpirti im kur më bie ndërmend si shtegtoja në krye të turmës, – si prijës – drejt banesës së Perëndisë me brohori e këngë lavdi në procesion kremtues!

6 Përse, o shpirti im, lëngon në trishtim?
Përse gjëmon në mua?
Shpreso në Perëndinë, prapë do ta lëvdoj,
Shpëtimtarin tim, Perëndinë tim.

7 Shpirti im është në pikëllim,

prandai ty të kujtoj
nga dheu i Jordanit, i Hermonit,
nga mali Misar.

8 Humnera thërret humnerën
me ushtimën e ujërave të tua,
të gjitha vorbullat e valet e tua
kaluan përmbi mua.

9 Ditën Zoti ma dërgon hirin e vet,
natën kënga e tij me mua:
uratë Perëndisë së jetës sime.

10 Do t' i them Perëndisë:
»Qeta ime, pse më, harron?
Përse endem i trishtuar,
prej armiqsh i rrethuar?«

11 Edhe eshtrat më thërrmohen prej trishtimit
për shkak të armiqve të mi
që më thonë përditë:
»Ku është Perëndia yt?«

12 Përse, o shpirti im, lëngon në trishtim.
Përse gjëmon në mua?
Shpreso në Perëndinë, prapë do ta lëvdoj,
Shpëtimtarin tim, Perëndinë tim.

KOMENTARI

Psalmisti është shkurajuar sepse nuk mund të ndërmarrë pelegrinazhin e tij të zakonshëm në Tempull. Ndryshe mund të ketë qenë këngëtar i tempullit. .. Sfondi i këtij psalmi do të jetë 2 Mbret 14,11-14: «Mbreti Joash marshoi kundër tij. Pranë Bet-Shemeshit, në krahinën e Judës, ushtria e tij u ndesh me atë të mbretit Amacja. Njerëzit e Judës u mundën dhe ikën në shtëpi. Amacja u zu rob. Joashi shkoi në Jerusalem dhe urdhëroi që ta rrëzonin murin e qytetit me një gjatësi prej 200 metrash, nga porta e Efraimit deri në portën e qoshes. Ai mori me vete gjithë arin, argjendin dhe të gjitha sendet me vlerë që ishin në Tempull dhe në thesarin e pallatit mbretëror. Përveç kësaj, mori peng disa njerëz dhe i shpuri në Shomron.»

Në rreshtin e parë psalmisti krahasohet me drerin në mesin e thatësisë që është e dëshpëruar për të gjetur një burim uji..

Armiqtë japin të kuptojë se Perëndia s'çan kokën për të. Qan se nuk mund më të shkojë në pelegrinazhë në Tempull, me rastin e festave të mëdha, sepse është i izoluar nga Juda, mbretëria e jugut.

Në një metaforë tjetër psalmisti krahasohet me një individ që ka humbur pikëmbështetje në rrëmbesa të Jordanit që hasen atje ku lumi fillon pranë Cezaresë së Filipit (sot Banjas). Figura shpreh depresion. Ai shpreh mall që të mbarohet prova, hutim që ndodh dhe paaftësi për ta dalluar Perëndinë në të. Megjithatë, ai ngushëllohet me shpresë te Perëndia, e cila është e sigurt për përfundimin: në fund Zoti do ta çlirojë dhe ai do të mund ta lavdërojë sipas dëshirës.

PSALMI 43

1 Ma jep të drejtën, o Hyi,
mbroje çështjen time prej gjindes së pafe,
më shpëto prej njeriut të keq e dinak.

2 Sepse ti je Perëndia i strehimit tim, përse më dëbon,
përse të endem i trishtuar, i shkelur prej armiqve?

3 Dërgoje dritën tënde dhe të vërtetën tënde:
ato le të më prijnë, le të më përcjellin
në malin tënd të shenjtë, në Tendën tënde.

4 Atëherë do të hyj tek altari i Perëndisë,
tek Perëndia i gëzimit të gaidimit tim.

Do të galdoj, do të të këndoj me harpe,
ty, O Hyi, Perëndia imi

5 Përse, o shpirti im, lëngon në trishtim?

Përse gjëmon në mua?

Shpreso në Perëndinë, prapë do ta lëvdoj,
Shpëtimtarin tim, Perëndinë tim.

KOMENTARI

Psalmi 43, Lutja vazhdon, për shpëtim dhe rimëkëmbje; realizimi vazhdon, duke balancuar problemet e së tashmës me perspektivat e së ardhmes.

1 *Ma jep të drejtën* Jep gjykim në favorin tim.

2 Fakti i kështjellës dhe ndikimi i refuzimit: të jesh i sigurt për Perëndinë, i rrahur nga jeta, shih rr. 9 më lart.

rr. 3, 4 Drita dhe e vërteta shihen figurshëm si ekip shpëtimi. Realitet është të jetosh në prani të Perëndisë dhe të duash fort të vërtetën e tij – ja rruga e vërtetë nëpër vështirësitë e jetës deri në një përfundim të lumtë. Vini re përparimin e afërsisë së ngadalshme – mali...vendi...altari...Perëndia – një kthim i plotë në shtëpi, hap pas hapit.

PSALMI 44

Vajtim kombëtar

1 Mjeshtrit të korit. I bijve të Korahut. Poemë.

2 O Perëndi, e dëgjuam me veshët tanë,
etërit tanë na e treguan,
veprën e madhe që ke bërë në ditët e tyre,
në ditë të kahershme.

3 Me dorën tënde i çrrënjose paganët
e i vendose stërgjyshët tanë në vend të tyre,
i zhbive popujt e stërgjyshët i zgjerove.

4 Nuk e fituan tokën me shpatën e vet,
as krahu i tyre nuk ua solli fitoren,
por e djathta jote dhe krahu yt
e drita e fytyrës sate,
sepse i kishe për zemër.

5 Ti je mbreti im dhe Perëndia im
që ia dhurove fitoren Jakobit!

6 Me fuqinë tënde i dëbuam armiqtë,

me fuqinë e emrit tënd i shkelëm
ata që u çuan kundër nesh.

7 Shpresa ime nuk është në harkun tim,
as shpata ime nuk do të më sjellë fitoren,
8 por ti na shpëton nga armiqtë,
ti i turpëron ata që na urrejnë.
9 Në Perëndinë do të galdojmë gjithmonë,
emrin tënd do ta lavdëroj më përherë.

10 Por tani na lëshove dore dhe na le të turpërohem,
Ti më s' del, O Perëndi, me ushtritë tona.
11 Na bëre të ikim para armiqve tanë,
ata që na urrejnë, na e rrëmbyen pasurinë.
12 Na dhe mish për kërraba si të ishim dele dhe na trete
ndër paganë.
13 E shite popullin tënd me çmim fare të lirë,
as s' u bëre më i pasur me këtë tregti.
14 Na bëre përrallë ndër sytë e fqinjve tanë,
përqeshje e lojë para atyre që na rrethojnë.
15 Na bëre përrallë për popuj':
përmbi ne paganët e tundin kokën!
16 Përditë turpin tim e kam para sysh,
marrja ma mbulon fytyrën
17 prej fjalëve të atij që me qorton e më shan,
prej pranisë së armikut e të hakmarrësit.
18 Të gjitha këto na gjetën edhe pse s' të kemi harruar
as s' e kemi prishur Besëlidhjen tënde,
19 as zemra jonë nuk u largua prej Teje,
as këmba jonë nuk iu shmang udhës sate,

20 e ti na ndrydhe në banesa të dhelprave,
na mbulove me hije të vdekjes.
21 Po ta kishim harruar emrin e Perëndisë sonë,
t'i kishim lartësuar duart tona drejt ndonjë hyji të huaj,
22 pse a Perëndia, që i njeh fshehtësitë e zemrës,
nuk do ta kishte hetuar këtë?
23 E pra, për shkak tënd na vrasin për gjithë ditën, të
çmuar porsì delet për therore.
24 Zgjohu, përse po fle, o Zot?
Zgjohu, mos hiq dorë prej nesh për amshim!
25 Përse e fsheh fytyrën tënde prej nesh,
përse e harron mjerimin e vuajtjen tonë?
26 Se u poshtëruam e ramë përdhe,
zvarrë hiqet trupi ynë për tokën.
27 Çohu, na eja ne ndihmë!
Na shpëto pashë dashurinë tënde!

KOMENTARI

Vajtimi kombëtar pa dyshim u kompozua në kohën kur Izraeli kishte pësuar një serë disfatash të rënda (krhs. Ps. 60), dhe ishte përdorur fillimisht në ditën e agjerimit të shpallur nga udhëheqësi kombëtar për t'i bërë thirrje Zotit për ndihmë. (krhs. 2 Kr. 20, 4 +; Jl 11, 14). Datimi i kompozimit nuk mund të përcaktohet me siguri, por ka të ngjarë të ketë qenë në kohën e monarkisë. Dy datime të mundshme u sugjeruan, ai pas vdekjes së Joashit në Megido. (2 Mbr. 23, 28 +) ose në kohën e invadimit të Judës nga Sinherabi (2 Mbr. 18, 13-19, 37).

Kjo lutje kushtohet në interes të mbarë popullit nga një individ – ka të ngjarë një mbret, ose ndoshta komandanti i ushtrisë ose nga një udhëheqës fetar – i cili flet në vetën e parë njëjës te rr. 4 +,

Strofa e parë (rr. 1-8) është në trajtë himni; sjell ndërmend veprat e shpëtimit të Zotit në pushtimin e Kanaanit (rr. 1-3) dhe pastaj e përdor këtë dëshmi si themel për besim dhe shpresën për fitore. (rr. 4-8. Strofa e dytë tregon për pikëllimin e tashmë në trajtë vajtimi: ata i kanë shpartalluar në betejë (rr. 10); disa janë bërë rob lufte dhe deportuar në një vend të huaj (rr. 11 +); kombin e përbuzin fqinjët e tij (rr. 13 +); më fatkeqësisht, Zoti, udhëheqësi i tyre në betejat e mëparshme (krhs. I Sam. 4, 3 +; 2 Sam. 5, 24), siç duket, nuk pranoi t'u vinte në ndihmë. (rr. 9). Strofa e tretë (rr. 17-26) shpall pafajësinë e kombit në lidhje me akuzat e mundshme të pabesisë (krhs. Lp. 4, 25 +; 6, 14 +), si dhe hutimin pasues për fatkeqësinë e kohës (rr. 17-22), dhe përfundon me lutjen e fortë për ndihmë urgjente, (rr. 23-26).

1. *e dëgjuam me veshët tanë*: do të jetë aludim për deklamimin kultik të historisë së shpëtimit (krhs. Ps. 78) ka mundësi në festën e ripërtëritjes së besëlidhjes (krhs. rr. 17).

PSALMI 45

Këngë dasme mbretërore

1 *Mjshtrit të korit. Me melodi »Lili... « E bijve të Korahut.*

Poemë. Këngë dashurie.

2 Nga zemra më burojnë fjalët e këndshme,
këngën time ia kushtoj mbretit:
gjuha ime si lapsi i shkruesit të shpejtë!

3 Ti je i bukur, më i pashmi ndër bijtë e njerëzve,
u zbraz hiri në buzët e tua, prandaj Perëndia të lavdëroi
për amshim.

4 Ngjeshe shpatën në ijë, o trimi i trimave, vishu me shkëlqim e me madhëri!

5 Nisu, t'u priftë e mbara, hip në karrocë për të mbrojtur të vërtetën, butësinë e të drejtën e të të mësojë të bësh emnesë e djathta jote!

6 Të mprehta janë shigjetat e tua
– popujt do të bien nën sundimin tënd -
në zemra të armiqve të mbretit!

7 Froni yt, O Perëndi, në shekuj të shekujve, skeptër drejtësie skeptri i mbretërisë sate!

8 Ti e do drejtësinë, ti e urren padrejtësinë, prandaj të shuguroi Perëndia, Perëndia yt, me vaj gëzimi çmoskëndin ndër shokët e tu.

9 U vjen era mirë, aloejë e kasje petkave të tua, në pallate – asht elefanti, harpat të argëtojnë.

10 Bija mbretërisë janë në përcjelljen tende, në të djathtë të qëndron mbretëresha, në ar Ofiri e ngrirë.

11 Më vështro, o bijë, shih e dëgjo:
hartoje popullin tënd dhe shtëpinë e babait tënd,
12 atëherë mbretit do t'i pëlqejë bukuria jote.
Ai është zotëria yt, nderoje atë!

13 Populli i Tirit vjen me dhurata, përkrahjen tënde e dëshirojnë princat e popullit.

14 E lavdishme është bija e mbretit përbrenda, e mbështjellë me petk të qëndisur me ar.

15 Në petka lara-lara ia sjellin mbretit,
përcjellja e saj, shoqet e saja, vajza.
16 Me hare u prijnë e me brohori,
ja, po hyjnë në pallatet e mbretit!
17 Në vend të etërve të tu do t'i kesh fëmijët,
do t'i vësh princa mbi mbarë tokën.

18 Do të bëj të përmendet emri yt prej breznie në brezni;
prandaj edhe popujt do të të lavdërojnë në amshim e në
shekuj të shekujve.

KOMENTARI

S'ka dyshim që këngë të tilla i kënduan koret me rastin e dasmave mbretërore në kohën e monarkisë izraelite. Por s'ka mundësi të identifikohet mbreti për të cilin u kompozua kjo këngë – ka mundësi nga një profet ose poet i oborrit. Bëhetfjalë për një mbret të Judës si Salomon (krhs. I Mbr. 3, 1) ose një mbret davidik tjetër. Zakonisht mendohet për një princesë të huaj, ndoshta nga Egjipti. Më vonë, pas fundit të monarkisë, psalmit iu dha një interpretimi mesianik.

6. Khs. 2 Sam. 7, 13, 16. *Froni yt, O Perëndi, në shekuj të shekujve,*

skeptër drejtësie skeptri i mbretërisë sate! (krhs. Heb 1,8).

Megjithëse mbretin izraelit kurrë nuk e quanin hyjnor (si te mbretërit e Egjiptit), ka mundësi që t'i drejtohej si Perëndi, ose në gjuhë hiperbolike ose si përfaqësues i Perëndisë. (krhs. Dal. 21, 6; 22, 8, 9, 28; Ps. 82, 6).

6-9 *Mbreti në madhësinë e tij*. Shtatë lavditë e mbretit:

(i) Natyra e tij hyjnore, (6). Enigma e mbretit i cili është njëkohësisht njerëzor dhe hyjnor realizohet vetëm tek Jezusi, Mesia. (Eph. 1,17; Heb. 1,8);

(ii) Sundimi i tij i drejtë (6, 7): zyrtarisht (skeptri) dhe personalisht (dashuri ... urrejtje) mbreti është i shenjtë, (Is. 11,3-5);

(iii) Epërsia e tij njerëzore (7). Nga pamja e jashtme ai është njeri ndër njerëzit (Perëndia yt ... shokët), por ka edhe sekret të brendshëm të shugurimit të tij hyjnor (Lk. 4,18);

(iv) Personi i tij mirëkëndshëm (8, 2 Kor 2,14);

(v) Situata e tij e pasur (8) ku gjithçka e brendshme flet për pasurinë e tij mbretërore.

(vi) Shërbëtorët e tij të nderuar (9), mbretërit e tokës janë shërbëtorët e tij

(vii) Lavdia e tij e shtatë është nusja e tij (9).

Lista filloi me mbretin që rri në fron (6); pranë tij në fron. (9).

Nënshtrimi i Tirit (12) është motiv mesianik (shih 87,4; krhs. Is. 23). Tiri përfaqësohet si bota me pavarësinë e saj krenare dhe vetësiguri, grumbullimin e saj të pasurisë pa skrupuj. Por një ditë mbretërit e botës do të sjellin pasurinë e tyre për ta vënë te këmbët e mbretit. (Apok. 21,24).

16-17 Dëshira e poetit për mbretin. Sado madhështore mund të ketë qenë e kaluara, mbreti orientohet nga e ardhmja dhe nga fëmijët që do ta realizojnë sundimin e tij mbi mbarë botën

PSALMI 46

Zoti është me ne

1 Mjeshtrit të korit. I bijve të Korahut. Me melodi: » Virgjërat..

2 Perëndia është për ne strehim dhe fuqi,

ndihmë gjithherë e gatshme në çdo vështirësi.

3 Prandaj as s' do të tutemi edhe nëse lëkundet toka

dhe nese malet do të kapërdihen nga deti!

4 Le të gjëmojnë e le të përzihen ujërat e tij,
le të dridhen malet në furinë e tij!

5 Rrëketë e lumit do ta gëzojnë qytetin e Perëndisë,
tendat e shenjta të të Lartit Zot.

6 Perëndia është brenda nuk do të tundet askurrë,
Perëndia i ndihmon herët në agim.

7 Ulëritën popujt, ranë mbretëritë, bubulloi Zoti, toka u
shkri!

8 Zoti i Ushtrive është me ne, strehimi ynë, Perëndia i
Jakobit!

9 Ejani e shikoni veprat e Zotit

– mrekullitë që i bëri ai përmbi dhe!

10 Ndalon luftërat deri në skajet e tokës,
do t'i thyejë harqet, do t'i copëtojë armët, mburojat në
zjarr do t'i djegë.

11 Ndaluni e shihni se unë jam Perëndia,
i madhërueshëm mbi popuj, i madhërueshëm mbi tokë!

12 Me ne është Zoti, Perëndia i Ushtrive, strehimi ynë,
Perëndia i Jakobit.

KOMENTARI

Ky psalm do të jetë kompozuar për t'u përdorur në kultin në Jerusalem për të festuar zgjedhjen nga Zoti i Cionit dhe duhet të klasifikohet si himn i Cionit. (krhs. Ps. 48). Kjo është këngë e Cionit, d.m. th. këngë për Jeruzalemin (shih edhe Psalmet 48, 76, 84, 87, 122). Jerusalemi si vendndodhja e tempullit dhe selia e mbretërisë davidike ishte qendër e vëmendjes për shkak të

rolit që duhet të luajë në kohën e mijëvjeçarit. Në këtë psalm ka një element të fortë (eshatologjik): parashikojmë ngjarjet siç do të jenë pak pas betejës së fundit që inauguron mijëvjeçarin. Një botë e shkretuar do të çarmatoset me dhunë.

Çlirimi është edhe tani i sigurt sepse na mbron Perëndia.
rr. 4-7 Në kundërshtim me ujërat e turbullta, ka një lumë jetëdhënës që furnizon Jeruzalemin, sepse Perëndia është Zoti ndër të. (Ezk. 47). Lumi, i cili është i vërtetë, është gjithashtu simbol për rimëkëmbje dhe bollëk.

Këtu është analiza e psalmit.:

1-3 Fuqia e Zotit mbi natyrën.

4-7 Fuqia e tij mbi sulmuesit e qytetit.

8-11 Fuqia e tij mbi mbarë botën që lufton.

Toni i fortë dhe sfidues jep të kuptojë se është shkruar në kohën e krizës, por nuk e dimë se cila është.

PSALMI 47

Perëndia mbreti i Izraelit e i mbarë botës

1 Mjeshtrit të korit. I bijve të Korahut. Psalm.

2 Duartrokitni, o popuj të gjithë,
brohoritni Perëndisë me zë gëzimi!

3 Sepse Perëndia është i tejetlartë, i tmerrshëm,
Mbretii i madh mbi tokën mbarë.

4 Popujt i vuri nën sundimin tonë,
paganët nën këmbët tona.

5 Ai e rizgjodhi trashëgimin tonë për ne,
nderin e Jakobit, të dashurit të vet.

6 Ngjitet Perëndia me brohori,

Zoti me zë trumbete.

7 Këndoni Perëndisë, këndoni,
këndoni mbretit tonë, këndoni!

8 Sepse Perëndia është mbreti i mbarë tokës:
këndoni këngë me mjeshtëri!

9 Perëndia mbretëron mbi mbarë popujt,
Perëndia rri mbi fronin e vet të shenjtë.

10 Princat e popujve paganë bashkohen
me popullin e Perëndisë së Abrahamit,
sepse Perëndisë i përkasin mburojat e botës,
Ai është i lartësuar mbi të gjithë.

KOMENTARI

Ky është psalm fronizimi. rr. 5, p.sh. është aludim për 2 Sam 6,15 kur arkën e besëlidhjes e sollën në qytetin e Davidit që të banojë atje Perëndia. Më vonë do të jetë përdorur në festën vitore kur dramatizohet fuqia e Zotit mbi armiqtë e tij dhe sundimi i tij mbi krijimin e tij. Sipas Talmudit, ky psalm përdoret me rastin e ditës së vitit të ri.

Psalmi është gjithashtu profetik sepse parashikon mijëvjeçarin. Ftohen të gjitha kombet. Izraelin e quan kombi kryesor, nën Zotin, që banon në tokën e vet (krenari i Izraelit).

Ka aludim për Izraelin të cilin e do Zoti (d.m.th. të cilin e ka zgjedhur). Te rr. 9 parashikohen kombet që adhurojnë Zotin bashkë me popullin e Perëndisë, pasi kanë dërguar delegacionet e tyre në tempull të Jerusalemit..

rr. 5-7 Perëndia përfitohet si ai që hip në fronin e tij tokësor, ndoshta pas kurtëzhit e arkës, ndërsa populli e pret me brohoritje. Të tjerët e quajnë aludim për ngritjen e Zotit pasi i ka dhënë fitore popullit të tij.

Si pasojë, Perëndia (edhe tani) mbretëron suprem.

PSALMI 48

Cioni, mali i shenjtë i Perëndisë

1 *Këngë. Psalm. I bijve të Korahut.*

2 I madhërishëm është Zoti e tejet i lavdishëm,
në qytetin e Perëndisë sonë!

3 Mali i tij i shenjtë, kodrinë e bukur,
gëzimi i mbarë botës:

Mali Cion, në veriun e skajshëm,
Qyteti i Mbretit të madh,

4 Perëndia në përgjet e tij
u tregua kështjellë e pathyeshme.

5 Dhe ja, u bashkuan mbretërit,
sulmuan së bashku,

6 posa panë, u rrudhën, e, të hutuar, ikën praptazi.

7 Aty i kapën të dridhurat si dhimbjet e lindëses,

8 ishin si stuhia e lindjes që i thyen anijet e Tarshishit.

9 Siç kemi pasë dëgjuar, tani po shohim, në qytetin e, Zotit
të Ushtrive, në qytetin e Perëndisë sonë – Perëndia e
themeloi për amshim.

10 Po e kujtojmë, O Perëndi, mëshirën tënde
në mesin e Tempullit tënd.

Sikurse emri yt, O Perëndi, ashtu edhe lavdia jote
arrin deri në skajin e botës,
e djathta jote është plot drejtësi.

12 Le të galdojë mali i Cionit,
le të brohorisin qytetet e Judës

për shkak të gjyqeve të tua!
 13 Silluni rreth e rreth Cionit,
 përshkojeni kryq e tërthor,
 numërojani kullat e tij,
 14 vëreni mirë muret e tij,
 vëzhgoni hollë pallatet e tij
 që të mund t'i tregoni breznisë së ardhshme:

15 Ky është Perëndia, Perëndia yn
 ë për amshim e në shekuj të shekujve;
 Ai na prin në amshim.

KOMENTARI

Ky është gjithashtu psalmi i Cionit që përmban disa koncepte të vështira për tu kuptuar. Ka mundësi që të jetë i lidhur me festën kur pelegrinëve që ishin në Jerusalem për herë të parë, u tregohej qyteti. Pas adhurimit në Tempull, ka mundësi që pelegrinët të kenë marrë pjesë në kortezhin që qarkullohej rreth qytetit. Secili vend i shenjtë do t'i ketë sjellë ndërmend se Zoti do t'i drejtonte sikurse i kishte drejtuar edhe paraardhësit e tyre.

Jeruzalemi përfytyrohet këtu jo si kryeqytet i monarkisë së bashkuar, por edhe si kryeqytet i mbarë botës. Jeruzalemin e kërcënon bashkëpunimi kriminal botëror, site psalmi i dytë. Megjithatë, ka mundësi që të jetë aludim për çlirimin e mrekullueshëm të kohës së fundit kur u hoq rrethimi i Senaheribit më 701.

Mbreti i madh është, kuptohet vetvetiu, Mesia – zëvendësuesi i Zotit.

Veriu i largët është shprehje tradicionale në Izrael dhe ndër fqinjët e tij për selinë mbretërore të Perëndisë.

Cafon: Malin e Cafonit e quanin te mitet e Ugaritit banesa e perëndisë Ba'al-Hadad (krhs. Is. 14, 13) sikurse Malin Olymp e

quanin vendbanim i perëndive greke. Prandaj kuptimi këtu do të jetë se mali i Cionit është veriu i largët i vërtetë, d.m.th. banesa e vërtetë e Perëndisë së Izraelit.

Një lundër i Tarshishit do të thotë një vapor transoqeanik. Lavdërimi është njëkohësisht nderi që i përket Perëndisë si dhe reagimi që ngjall vetë lavdërimi.

Nami i individit është personi i zbuluar me veprat dhe fjalët e tij, dhe kështu reputacioni i tij.

PSALMI 49

Pasuria s'është asgjë

1 Mjeshtrit të korit. I bijve të Korahut. Psalm.

2 Dëgjoni këto, o popuj të gjithë,
degjoni të gjithë banorët e tokës:

3 vegjëli e bujarë,

të pasur e të vobektë së bashku:

4 goja ime do t'ju shpallë dijen,
zemra ime mendime urtësie.

5 Fjalëve të, urta do t'u vë veshin,
me këngë do të zbuloj gjëra të fshehta.,

6 Përse të trembem në ditë të këqija,
kur të më rrethojë paudhëria që më vë pritë?

7 Ata shpresojnë në pasuritë e veta
mburren me kamjen e madhe të veten.

8 E pra, njeriu s'është i zoti ta shpërblejë vetveten,
askush s'mund t'ia paguajë Perëndisë shpërblimin:

9 çmimi i jetës është tepër i shtrenjtë
dhe askurrë nuk mund të paguhet,

10 që njeriu të jetojë gjithmonë
 e të mos e shohë gropën e varrit.
 11 Por do t'i shohë duke vdekur të dijshmit: vdes i marri,
 vdes i patenzoni: të tjerëve ua lënë pasuritë e veta!
 12 Varret e tyre – shtëpia e tyre e përhershme:
 banesë e tyre brezni pas breznie,
 megjithëse tokat e veta i quajtën me emër të vet.
 13 Edhe njeriu në mireqenie erret e nuk ndjeh,
 krahasohet me kafshët që cofin
 dhe është i ngjashëm me to.
 14 I tillë është fati i atyre që shpresojnë në vetvete,
 mbarimi i atyre që me gojë ia bëjnë qejfin vetes.
 15 Porsi delet rresht zbresin në Nëntokë,
 Vdekjen do ta kenë bari.
 Do të zbresin me rrëmbim në varr, duka e tyre me shpejt
 do të mbarojë: Nëntoka do të jetë vendbanimi i tyre.
 16 Ndërsa Perëndia do ta shpëtojë shpirtin tim,
 nga kthetrat e Nëntokës vërtet do të më marre te vega.
 17 Mos u lut kur ndokush pasurohet,
 kur i rritet gjëja e shtëpisë së tij:
 18 kur të vdesë asgjë s' do të marre me vete,
 me të s' do, të zbresë pasuria e tij.
 19 Sa ishte gjallë njëmend thuhej se ishte i lum:
 »Do të të lavdërojnë se ia bëre qejfin vetes«,
 20 por edhe ai do të shkojë të bashkohet me etër,
 të cilët kurrë më s' do ta shohin dritën e diellit.
 21 Njeriu që jeton marrëzisht ndër kënaqje, nuk kupton;
 krahasohet me kafshët që theren, dhe është i ngjashëm me
 to.

KOMENTARI

Psalmi 49 (krhs. 73) shfaq qartë dy mundësi: ka vdekje pa shpresë (13, 14) dhe ka vdekje plotë shpresë (15). Njeriu mund të vdesë si kafshë (12) ose mund të vdesë duke ditur se Zoti do ta presë (20). Së pari (5-12) ai i bën ballë faktit që të gjithë do të vdesin. Pikënisja e mendimeve të tij ishte shtypja nga ana e atyre që janë aq të pasur se mund t'i kërcënojnë të tjerët. (5, 6) dhe ai filloi të ngushëllohej me mendim se pasuria nuk mund të blejë gjithçka (7-9): vdekja shënon pikën ku të hollat e shpagimit nuk vlejné më. Të gjithë, pa përjashtim, do të vdesin (10). Por, së dyti, (13-19) vdekja nuk është fundi: ka fate të ndryshme jashtë varrit që duhen marrë parasysh. Vetësiguri, sado të miratuar në tokë, përfundon me vdekje dhe prishje, kurse ata që janë në rregull me Perëndinë mezi e presin çlirim dhe praninë e Zotit. (13-15). Si pasojë, mos u hutoni nga pabarazitë e jetës së tashme (16); vdekja është niveluesi i madh dhe në kundërshtim me jetimet e tyre tokësore, s'ka dritë për njerëz të tillë jashtë varrit (17-19).

PSALMI 50

Për kultin »në shpirt e në të vërtetë«

1 Psalm. I Asafit.

Flet Zoti, Perëndia i hyjnive

dhe e thërret tokën

që ku lind dielli e deri ku perëndon.

2 Nga Cioni, shkëlqim bukurie, Perëndia ndriçon!

3 Perëndia ynë do të vijë e nuk do të heshtojë:

para i shkon zjarri që përpin,

përreth tmerrshëm tërbohet thëllimi.

4 E thërret qiellin prej së larti edhe tokën për të gjykuar popullin e vet:

5 »Bashkoni para meje besimtarët e mi,
që me fli lidhën Besëlidhjen me mua!«

6 Qiejt shpallin drejtësinë e tij sepse Perëndia është gjykatës!

7»Dëgjo, populli im, dua të flas, o Izrael,
dëshmoj kundër teje: unë Perëndia jam Perëndia yt!

8 Nuk të qortoj për flitë e tua,
flitë e shkumbimit të tuat i kam gjithherë para sysh!

9 S' do të pranoj prej shtëpisë sata mëzat,
as cjan prej tufave të tua.

10 Sepse të gjitha egërsirat e pyjeve janë të miat,
me mijëra kafshë në malet e mia.

11 I njoh të gjithë shpendët e ajrit
dhe imja është gjithçka lëviz mbi tokë!

12 Po të kisha uri, ty nuk do të të thoshja:
imi është rruzulli e gjithçka ai përmban.

13 Pse, a thua unë ha mish mëzetërisht
e pi gjak cjepsh?

14 Kushtoji Perëndisë fli falënderimi
dhe zbatoja Perëndisë kushtet e tua,

15 e më thirr në ditën e travajit:
unë do të të shpëtoj e ti më jep lavdinë! «

16 Kurse mëkatarit Perëndia i thotë:

»Si guxon ti t' i shtjellosh urdhërimet e mia?

Si e merr nëpër gojë Besëlidhjen time,

17 kur ti e urren disiplinën,
pas shpine i hedh urdhrat e mi?

18 Kur e sheh vjedhësin, shok bëhesh me të,
e me lavire vazhdimisht merr pjesë.
19 Gojën tënde e përdor për fitme,
gjuha jote thur dredhi.
20 Me paramendim flet kundër vëllait tënd,
çnderon djalin e nënës sate.
21 Kështu veprova e unë heshtova.
A mendon ti se unë jam si ti?
Po të qortoj e po t'i përplas në fytyrë.«
22 Merrni vesh mirë ju të gjithë që e harroni Perëndinë:
mos më bëni t'ju fus në thonj
se s'gjendet ai që mund t'ju shpëtojë.
23 Më nderon ai që më kështon flinë e lavdit,
do t'ia tregoj shpëtimin e Perëndisë
atij që ecën udhës së drejtë.

KOMENTARI

Psalmet e festimit dhe pohimit ndahen në disa kategori të ndryshme:

Njëra prej tyre është liturgjite për ripërtëritjen e besëlidhjes. Psalmi 50 është shembull për këtë kategori.

Në këtë psalm të fuqishëm, skenari i përfytyruar është dukja e Perëndisë me zjarr dhe stuhi në malin e Cionit për të ftuar mbarë botën për gjykim për t'u bënë dëshmitarë në një proces në lidhje me Izraelin. Mbarë psalmi i drejtohet në të vërtetë popullit të besëlidhjes, së pari njerëzve fetarë, pastaj atyre me zemër të acaruar si dhe hipokritëve, që të vijnë në vetë.

Disa tipare japin të kuptojnë se bëhet fjalë për një ceremoni të ripërtëritjes së besëlidhjes, në të cilë populli duhet të sjellë ndërmend jetën e tyre të kaluar për t'u penduar, dhe të ripërtërinë zotimin e besnikërisë së tyre. Këto tipare janë si vijon:

1. aludimi për malin e Sinait dhe besëlidhjen.
2. aludime për 10 urdhërimet (7, 18-20)
3. aludim për recitimin e kushteve të besëlidhjes si dhe për zotimin ndaj saj.

(16).

Në traktatet e hitasve ata u bënë thirrje qiellit dhe tokës dhe lumenjve për dëshmitarë të traktatit. Këtu u bëhet thirrje për të dëshmuar shkeljen e traktatit. (krhs. Jos. 24, 26 +; Is. 1, 2 +; Jer. 2, 4 +; Mic. 6, 2 +).

rr. 4. Izraelit i drejtohet si popullit të privilegjuar dhe të veçantë, por bashkë me këtë nder përfshihet edhe shumë përgjegjësi . Izraelitët quhen “besnikët e mi”. Besëlidhja dhe flijimet sjellin ndërmend ceremoninë e madhe të Daljes 24,3-8. Zotin e quajnë edhe Çlirimtar i madh dhe bariu i popullit të tij. (rr.11, 15). Si tek psalmet e tjera, ky psalm ka të bëjë me dy grupe brenda Izraelit : besimtarë të vërtetë dhe ata që tregonin me jetët dhe qëndrimet e tyre se ishin vetëm besimtarë me emër. Atë që kërkon Zoti është dashuri e vërtetë dhe angazhim i vërtetë, një sjellje të drejtë ndaj të tjerëve, edhe jo një fe formaliste dhe një standard i dyfishtë dhe hipokrit. Një fe e tillë karakterizohet nga një pikëpamje e shtrembëruar për Perëndinë dhe karakterin e tij. Premtimet e bëra në ngushticë harrohen lehtësisht me arritjen e lulëzimit.

rr. 7-15 nuk janë dënim i vetë sistemit të flijimeve, sepse vetë Perëndia e kishte futur si mjet për të mbajtur popullin e tij në një marrëdhënie të drejtë me vetveten. Ajo që dënohet është një fe hipokrite dhe formaliste që ushtron një ritual sa për sy e faqe, një ndodhi shoqërore, mjet për siguri.

rr. 16 mund të jetë aludim për leximin e hapur të Ligjit siç urdhërohet te Lp 31,10. Një prej ndodhive më të mëdha ishte ripërtëritja e besëlidhjes në kohën e mbretit Joshija.

rr. 22-23 jep një vështrim në karakterin e Perëndisë, me këtë rast, në zemërimin e tij. Ai nuk e lëshon me qejf, por kur të leshohet është gjë e tmerrshme. Ne nuk mund t'i bëjmë një nder

Perëndisë duke ushtruar një ritual fetar. Gjithçka që pret prej nesh është pranimi i shpëtimit të tij si dhe që të bëjmë një jetë mirënjohëse dhe bindje ndaj urdhërimeve të tij.

Ky është gjithashtu psalm për besëlidhjen që bëri Zoti me Davidin (shih 2 Sam 7,1). Psalmi i referohet besëlidhjes së veçantë që bëri Zoti me Davidin, duke i premtuar se dinastia e tij do të zgjaste përgjithmonë. Ky premtim plotësohet në fund me ardhjen e Mesisë, mbretit të përjetshëm (krhs. Lk 1,32-33: «Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Bir i të Lartit (Perëndi). Zoti Perëndi do t'i japë atij mbretërinë e Davidit, të parit të tij. Ai do të sundojë përgjithmonë mbi pasardhësit e Jakobit (Izraelit). Sundimi i tij nuk do të marrë fund kurrë.»

Siç duket, ky premtim anulohet me shkatërrimin e Jerusalemit dhe mërgimin që i dha fundit të papritur dinastisë davidike.

Ky psalm formohet rreth një vajtimi, i cili kthehet në ripohimin e premtimeve drejtuar Davidit. (2 Sam 7,1) dhe kjo jep shpresë për të ardhmen: Zoti do të ketë fjalën e fundit. Nga ana tjetër, te rr. 30-32 pranohet se Zoti do t'i ndeshë mbretërit e dinastisë së Davidit për çdo mosbindje.

Siç duket, ky psalm do të jetë shkruar ose në fillim të mërgimit ose në fillim të kthimit nga mërgimi. Ka të ngjarë që vetë Asafi nuk do ta ketë shkruar, por një kor që mbante emrin e tij. Shkurtimi i rinisë së mbretit duhet të jetë aludim për Jehojahin, i cili ishte vetëm 18 vjeç kur e zunë rob babilonasit që e deportuan deri në Babilon. Meqë mbreti ishte larguar, u largua edhe bekimi dhe nuk do të kthehet derisa të vijë mbreti i madh (Mesia) (shih ditët e Mesisë).

rr. 50 na thotë se mbretin David e kaluan nëpër rrugët e Babilonit si rob luftë dhe u tallën hapur me të. Kjo ishte e njëjtë me atë qëqë do t'i ndodhte Mesisë së vërtetë, i cili u tall si Shërbëtor i Zotit.

rr. 10 Ky aludim na parashton një pyetje interesante. Nganjëherë Bibla përdor një terminologji të nxjerrë nga legendat e Lindjes së Mesme të lashtësisë, ku flitet për fitoren e Zotit mbi

Egjiptin e përfytyruar si dragonj pranë Detit të kuq (Ps 74,13-15; 87,4; Is 51,9.10; Job 9,13). Egjipti këtu quhet Rahab (mburravec). Figurat e përdorura këtu shërbejnë për të theksuar fuqinë e Zotit të Krijimi, fitoren e tij mbi të gjithë kundërshtarët, si dhe sundimin e tij mbi qiellin dhe tokën. Kjo fitore është aq kryesore për DhV sa edhe kryqi për DhR.

PSALMI 51

Rrëfimi i mëkatarit të penduar

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.*

2 Kur erdhi tek ai profeti Natan
pasi kishte mëkatuar me Bat-Shebën.

3 Ki mëshirë për mua, O Perëndi, sipas mëshirës sate,
pashë mirësinë tënde shlyeje mëkatin tim!

4 Më laj krejtësisht prej mëkatit tim e më pastro prej fajit
tim!

5 Sepse e pranoj paudhësinë time: mëkatin tim përherë e
kam para sysh.

6 Ty, vetëm ty të kam rënë në faj dhe kam bërë ç'është
keq para teje, prandaj je i drejtë sado të më ndëshkosh,
dhe i paanshëm në dënimin tënd.

7 Ja, mëkatar unë leva,

8 madje në mëkate nëna ime më ngjizi,
por ti që e do çiltërinë e zemrës,
m'i mëso thellësitë e dijes së shpirtit.

9 Më stërpik me hisop e do të bëhem i pastër,
më laj e do të bëhem më i bardhë se bora.

10 Bëj ta ndiej zërin e haresë e të gëzimit

dhe do të gëzohen eshtrat e thërmuara.

11 Largoje shikimin tënd prej mëkateve të mia,
e resiti të gjitha fajet e mia.

12 Krijoje në mua O Perëndi, zemrën e pastër,
përtërij në mua një shpirt të qëndrueshëm!

13 Mos më flak larg fytyrës sate,
mos e hiq prej meje shpirtin tënd të shenjtë.

14 Ma kthe gëzimin e shpëtimit tënd,
dhe më forco me shpirt të gatshëm.

15 E unë do t'ua mësoj mëkatarëve udhën e shpëtimit
e fajtorët do të kthehen tek ti.

16 Ma fal gjakun e derdhur, O Perëndi, Perëndia i
shpëtimit tim,

dhe gjuha ime do ta shpallë shenjtërinë tënde.

17 Zhdrivilloj, o Zot, buzët e mia, dhe goja ime do ta
shpallë lavdinë tënde.

18 Sepse ti nuk kënaqesh në fli,
e, nëse të kushtoj fli shkrumbimi, s'të pëlqejnë.

19 Flia e vërtetë për Perëndinë: shpirti i penduar;
ti, O Perëndi, nuk e përbuz zemrën e penduar, të
thërmuar!

20 Pashë mirësinë tënde, o Zot, bëji mirë Cionit,
ndreqi përsëri muret e Jerusalemit.

21 Atëherë do t'i pranosh flitë e drejtësisë,
flitë e shkrumbimit e të gjitha kushtet,
atëherë do të mund të kushtohen mëzetër mbi altarin tënd,

KOMENTARI

Ky është i katërti dhe sigurisht më i madhi prej shtatë psalmeve të pendimit. Efikasiteti i pendimit (1-4) është komentuar për 2 Samuel 12,13-14. Davidi i tha Natanit: «Pranoj që jam fajtor para Zotit!» «Meqë e pranon këtë, – iu përgjigj Natani, – Zoti ta ka falur mëkatin. Ti nuk duhet të vdesësh (tjetri ka shlyer mëkatin tënd). Por, meqë e ke fyer Zotin duke vepruar kështu, djali që do ta lindë Batsheva, do të vdesë.» Tjetri është Mesia – flijimi i tij i ardhshëm i llogaritet Davidit, sepse është besimtar i vërtetë. Natyrisht për t'u shpëtuar, Davidi duhet të besojë në ungjill, i cili do t'i predikojë Krishtit kur të jetë zbritur në botën e vdekurve, pas vdekjes së tij.

Problemi që haset te rr. 16, i cili, siç duket, mohon se Zoti pranon flijimet, kur kujtohem se mëkatet e paramenduara të kurorëshkeljes dhe vrasjes nuk ishin të shlyera me kushtimin e një flijimi. Si mbret dhe përfaqësues i kombit, Davidi nuk mund të mëkatojë pa u ndëshkuar si individ privat, sepse mëkati i tij ndikonte në mbarë kombin dhe kjo do të zhvlerësonte mbarë sistemin e drejtësisë në Izrael. Megjithëse, falë Mesisë, mëkati i tij nuk do të ndëshkohej me vdekje: Davidit iu desh të paguante një çmim shumë të lartë në jetën e tij familjare.

8 madje në mëkate nëna ime më ngjizi... Davidi pranon se ka trashëguar një natyrë të mëkatshme nga nëna e tij, por kjo nuk e shfajëson, sepse ai vetë ka mëkatuar dhe kështu meriton vdekje. Në këtë varg theksohet realiteti i mëkatit lindor.

9 Më stërpik me hisop e do të bëhem i pastër, më laj e do të bëhem më i bardhë se bora. Të pastrosh do të thotë të dizinfektosh, të heqësh ndotjen e mëkatit. Hisop ishte vegël që përdorej për të spërkatur gjak dhe kështu të zbatuar ndjesën (Ex. 12,12, 22, 23; Lev. 14, 1 + Nr. 19, 6, 18).

gëzim . . . galdim, janë aludim për rimëkëmbjen e mëkatarit (1).

rr. 13 *mos e hiq prej meje shpirtin tënd të shenjtë* Davidi sigurisht mendon për Shaulin i cili kishte humbur dhuntinë shpirtërore të mbretit, sepse Zoti e kishte refuzuar.

21. *flitë e drejtësisë*: ose flitë e kushtuara me kohë të përshtatshme ose me shpirt të drejtë (usp Lp. 33, 19; Ps. 4, 5).

PSALMI 52

Ndërshkimi i keqbërësve

Mjeshtrit të korit. Poemë. E Davidit. 2 Pasi Doeg edomas shkoi te Shauli e i tha: »Davidi hyri në shtëpinë e Abimelekut.«

3 Pse krenohesh me vepra të këqija ti që je i madh për nga paudhësia?

4 Gjithë ditën djerron tradhti! Gjuhë a jote brisk i mprehtë, o mjeshtër fitmesh!

5 Ti e do të keqen më tepër se të mirën, rrenën se të flasësh të vërtetën,

6 të pëlqejnë, fjalët ngatërrestare, o gjuhë fitmesh!

7 Prandaj Perëndia krejtësisht do të të zhbijë, do të të zhdukë për përgjithmonë, do të të çrrënjosë prej tendës, do të të çrrënj osë nga toka e të gjallëve.

8 Të tmerruar do të shohin të drejtët e do të qeshin mbi të:

9 »Ja, njeriu që nuk e mori Perëndinë për mbrojtës, por shpresoi në kamjen e vet të madhe dhe krenohej me tradhtinë e veta.

10 E unë porsì ulla i gjelbër në Shtëpinë e Perëndisë,
shpresoj në mirësinë e Perëndisë për amshim e në shekuj
të shekujve.

11 Do të të lavdëroj përherë që veprime ashtu,
shpresën do ta ve në emrin tënd sepse është i mirë
në sy të besimtarëve të tu.

KOMENTARI

Pjesa e parë e psalmit (rr. 1-7) i ngjan një vajtimi individual, por i drejtohet njeriut të keq që shtyp besimtarët. Na kujton për lajmin profetik të gjykimit të individit (krhs. Is. 22, 15-19). Pjesa e dytë (rr. 8, 9) i ngjan psalmit të besimit. Sfondi i tij nuk është i qartë. Një ekspert beson se ky psalm u përdor kur keqbërësi paraqitej para kongregacionit, u mallkua dhe përjashtohej nga komuniteti. Atëherë folësi do të jetë profet ose prift si përfaqësues i popullit.

Titulli e lidh këtë psalm me një përvojë të hidhur të Davidit. Gjatë ikjes së tij nga Shauli, Davidi kishte folur me Ahimelekun, priftin, duke i kërkuar disa rezerva ushqimi, dhe tani Ahimelekun e denoncuan publikisht para mbretit dhe si pasojë mbarë komuniteti u masakrua. Informatori ishte edomasi Doeg, dhe ai e kishte zbatuar masakrën.

Pastaj Davidi kishte reaguar si vijon: "Davidi e ngarkoi veten me faj për vdekjen e tyre dhe i tha Avjatarit: «Kur e pashë atë ditë Doegun në Nov, e mora me mend se do ta lajmëronte Shaulin. Jam fajtor! Mbarë familjen tënde e kam në ndërgjegje! Tani qëndro këtu dhe mos ki frikë. Mund të mbështe-tesh tek unë, sepse Shauli na kërkon edhe mua edhe ty.» (1 Sam. 22,22-23). Në fund Davidi e ripërtërit besnikërinë e tij ndaj Zotit, i cili i qëndron pranë.

PSALMI 53

Njeriu (i patenzonë) pa Zot

1 Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Sëmundja... «

Poemë. E Davit

Tha i marri në zemrën e vet: »S'ka Perëndi!«

2 Njerëzit u prishën, bëjnë vepra të urryeshme: s'ka më njeri që bën mirë!

3 Prej qiellit Perëndia vështron mbi bijtë e Adamit, për të parë a ka ndonjë të ndershëm, ndonjë që kërkon Perëndinë.

4 Të gjithë e lanë rrugën, të gjithë së bashku u prishën, s'është asnjë që të bëjë mirë, – s'mbeti pasha një!

5 Po a s'e kuptojnë keqbërësit që e gëlltisnin popullin tim si kafshatë buke e Perëndinë nuk e thërrasin në ndihmë?

6 U dridhën nga frika ku frikë nuk kishte. Perëndia i shpërndau eshtrat e sulmuesve të tu, të turpëruar do të mbesin, sepse Perëndia i përbuzi.

7 Kush do t'ia japë prej Cionit shpëtimin Izraelit? Kur Perëndia ta riatdhesojë popullin e vet nga robëria, do të gëzojë Jakobi, do të galdojë Izraeli.

KOMENTARI

Teksti i psalmit 53 i ngjan atij të Ps 14, por në këtë rast psalmi mund të festojë një çlirim të çuditshëm kur armikun e zuri një panik i papritur. (krhs. 2 Mbr. 7,6). Variacioni kryesor haset te rr. 5. 14,5 ku ka aludim për panikun e armikut kur vërehet se Zoti është ndër popullin e tij. Prandaj, së bashku, këto psalme tregojnë tipare dalluese të së njëjtës situatë: kur kërcënohet

rreziku, armiqtë e tij duhen të kenë frikë, kurse populli i Zotit nuk duhet të ketë frikë.

5 Frika është gjithnjë pa arsye, sepse Zoti gjithnjë kundërsulmon..

PSALMI 54

Urate Perëndisë që jep drejtësi

1 *Mjeshtrit të korit. Me vegla muzikore me korda.*

Poemë. E Davidit

2 *pasi Zifentë shkuan te Shauli e i thanë: »Ja, Davidi fshihet ndër ne.«*

3 Më shpëto, O Perëndi, pashë emrin tënd, me fuqinë tënde mbroje të drejtën time. 4 O Perëndi, vështroje lutjen time, vështroj fjalët e gojës sime!

5 Sepse krenarët u çuan kundër meje, mizorët kërkojnë të ma marrin shpirtin: për Perëndinë ata s'kanë kujdes.

6 Por, ja, Perëndia po më vjen në ndihmë, shpirtin tim ai po e merr ndore.

7 Rëntë e keqja mbi armiqtë e mi: shfarosi, o Zot, pashë të vërtetën tënde.

8 E unë me ëndje do të të kushtoj fli, do ta lavdëroj emrin tënd, o Zot, sepse është i mirë,

9 sepse ti më shpëtove nga çdo vështirësi, me përbuzje syri im i shikon armiqtë.

KOMENTARI

Zifi ndodhej në jug Judes dhe Davidi ndihej thellë i lënduar kur populli i tij u kthye kundër tij, megjithëse ky popull rrinte me të drejtë besnik ndaj Shaulit. Siç e ka zakon në psalme të tilla, përgjithësohet çështja e parashtruar në mbishkrimin e psalmit: Davidi e shfrytëzon rastin që të na mësojë se si situata të tilla duhen ballëfaqur.

(i) **me lutje**(1, 2). Me emrin tënd, do të thotë duke vepruar sipas natyrës sate të zbuluar. Davidin e quanin padrejtësisht tradhtar.

(ii) **me përkujtimin e mësimeve biblike** (3-5). Së pari, karakteri i kundërshtarëve, (3), së dyti, karakteri i Zotit (4), dhe në fund lutje për shpagim drejtuar Zotit. Të huajt ishin në të vërtetë (bashanëtarët) e fisit të Judës, por ata vepronin si të huaj të pa skrupuj, sepse atje ku mungon respekti për Perëndinë, s'ka mundësi për besnikëri e as për njerëzi.

(iii) **me zotim për të ardhmen** (6, 7). Kjo nuk duhet kuptuar si tregti me Zotin, por si reagim shpirtëror ndaj mirëdashurisë së Zotit.

PSALMI 55

Lutja e njeriut të shpifur

1 *Mjeshtrit të korit. Me vegla muzikore me korda.
Poemë.*

2 Vështroje, O Perëndi, lutjen time, mos u fsheh para
uratës sime,
3 më prano e më vështro,

4 se në mjerimin tim u shkriua në vaj, prej britmës së armikut, prej ndrydhjes së mizorit. Hedhin mbi mua paudhësi, më sulmojnë me tërbim.

5 Dridhet zemra ime në mua, më përshkoi tmerri i vdekjes.

6 Frikë e tmerr erdhën mbi mua, më mbuloi një rrëqethje e rëndë.

7 Thashë: »Kush do të më japë krahë porsia pëllumbit për të fluturuar e për të gjetur pushim?

8 Larg, larg do të fluturoja, në shkretëtirë do të banoja.

9 Do ta prisja atë që më shpëton nga furia e erës dhe e stuhisë.«

10 Shpërndaji, o Zot, pështjelloju gjuhët, sepse shoh dhunë e grindje në qytet.

11 Ditën, natën qarkullojnë mbi mure,

12 në qytet paudhësi, vuajtje e prita, nuk mungojnë në sheshe mujshi e tradhti.

13 Sepse po të më shante armiku, disi do të duroja, të ishte ngritur kundër meje ai që më urren, disi do të fshihesha para tij,

14 por ishte ti o njeri, shoku im, miku im, i njohuri im,

15 me të cilin bëra shoqëri të ngushtë: bashkë me turma shkonim në Shtëpinë e Perëndisë!

16 Mordja i marrtë, gjallë i shtifsha në dhe të zi, sepse të keqen e kanë në shtëpi, në vete!

17 Por unë do ta thërras në ndihmë Perëndinë, Zoti do të më japë shpëtim.

18 Në mbrëmje, në mëngjes, në mesditë do të dënes i trishtuar e ai do të ma dëgjojë zërin.

19 Ai do të më shpëtojë, paqe do të më japë prej atyre që më sulmojnë:

sepse të panumërt janë kundërshtarët e mi.

20 Perëndia do të dëgjojë, do t'i përvujtërojë ata, Ai që është para të gjitha jetëve.

Për ata kthim nuk ka e Perëndinë s'e druan!

21 Secili ngre dorën kundër miqve të vet, shkel e thyen besën e dhënë.

22 Më të butë se tëlyeni e kanë gojën, zemrën e kanë të gatshme për luftim, fjalët i kanë më të buta se vaji, e ata – shpatë të nxjerra nga milli!

23 Lëshoja kujdesin tënd Zotit e Ai do të të japë fuqi: kurrë s' do të lejojë të bjerë poshtë i drejti.

24 Ata, O Perëndi, që janë gjakpirës e shpirtkëqij plandosi në gropën e varrit që të mos jetojnë as gjysmën e ditëve të veta. Por unë do të shpresoj ty, o Zot!

KOMENTARI

Lidhjet e mundshme me ngjarjet historike janë:

1. përjetimet e Davidit në kohën e kryengritjes së Avshalomit, dhe posaçërisht në lidhje me tradhtinë e Ahitofelit (2 Sam. 15-17),
2. periudha e përndjekjes nga ana e Shaulit. (1 Sam. 19-27),

Të krishterët e quajnë këtë psalm profeci rreth tradhtisë së Judës dhe rreth kundërshtimit të udhëheqësve çifutë në kohën e Jezusit

Zoti u jep shërbëtorëve të tij forcë për të mbajtur ngarkesat e tyre, në qoftë se ata i besojnë Zotit. Psalmisti mbaron (rr. 23) me bindjen se Zoti do t'i gjykojë keqbërësit, dhe me vendosmërinë se me çdo kusht ai do t'i besojë Zotit.

PSALMI 56**Besimtari nuk do të bjerë poshtë**

1 *Mjeshtrit të korit. Mbi: »Jonat elem rehokim«. I Davidit.*

Poemë. Kur filistenjtë e zunë rob në Gat.

2 Ki mëshirë për mua, O Perëndi, se po më shkel armiku, sulmuesi im po më ngushton gjithë ditën.

3 Armiqtë e mi po më shqelmojnë çdo ditë e sulmuesit e mi janë tepër shumë, o i Tejetlartë!

4 Atë ditë që do të më kapë frika, në Ty do ta vë shpresën!

5 Në Perëdinë, të cilit ia lavdëroj fjalën, në Perëdinë e kam vënë shpresën, nuk trembem: çka mund të më bëjë njeriu?

6 Çdo ditë m'i shpjegojnë mbrapsht fjalët, s'mendojnë tjetër pos për të ma bërë shpellën:

7 kallin grindje, më vënë pusi, m'i ruajnë hapat, mendojnë kryet të ma hanë!

8 Shpaguaji sipas fajeve të tyre, në furinë tënde përplasi, O Perëndi, përdhe paganët!

9 Ti i ke numëruar ditët e mërgimit tim, lotët e mi mblidhi në rrëshiqin tënd!

A thua s'janë të shkruar në librin tënd?

10 Atëherë armiqtë e mi do të zmbropsen kur ta kërkoj ndihmën tënde, sepse e di mirë se Perëndia është me mua.

11 jap lavdi fjalës së Perëndisë, e madhëroj fjalën e Zotit.

12 Në Perëndinë kam vënë shpresën, nuk do të trembem:
çka mund të më bëjë njeriu?

13 Me ty, O Perëndi, më lidhin kushtet e mia, do të të
kushtoj fli falënderimi,

14 sepse ma ke shpëtuar jetën prej vdekjes, këmbët e mia
prej rrëzimit që të mund të eci në praninë e Perëndisë, në
dritën e të gjallëve.

KOMENTARI

Dëshpërimi e kishte çuar Davidin duke ikur nga Shauli, deri në Gat, qytetin e Goliatit. Meqë kjo dredhi kishte dështuar, ai gjendet e rrethuar nga filistenjtë. Deri këtu ka shumë pak ndjekës; 400 (1 Samuel 22,10) i mbledhi rreth vetes vetëm më vonë. Ky është psalmi i parë që e ka prejardhjen në këtë krizë. Por më në fund ka falënderim, i cili është tema e psalmit 34.

Situata regjistrohet te 1 Samuel 21,10-15 me komentar te Psalm 34 ku vihet re që ishte jo dredhi, por lutja që mundësoi shpëtimin e tij (1 Sam. 21,12, 13). Psalmi përbëhet nga gjashtë seksione të balancuara: Davidi, objekt i armiqësisë njerëzore (1, 2) është gjithashtu objekti i kujdesit të Perëndisë (9-11); besimi që kundërshton frikën (3, 4) besimi që ka për pasojë lutje (7-8); Davidi i shtypur nga njeriu (5, 6) bëhet Davidi që i nënshtrohet Zotit (12, 13).

Besimi s'është ndjenja që gjithçka do të dalë mbarë, por bindja ndaj asaj që ka thënë Perëndia, besimi te premtimet e Zotit (shih edhe Ps 27, 1; 36, 9; krhs. Job 10, 21; Ps. 116, 9).

PSALMI 57**Në mes të luanëve**

1 Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Mos shkatërro ..

«E Davidit Poemë. Kur iku prej Shaulit në shpellë.

2 Ki mëshirë për mua, O Perëndi, ki mëshirë për mua,

sepse shpirti im mbështetet në Ty,

po strehohem nën hijen e krahëve të tu

derisa të më kalojë rreziku i pritës.

3 Do ta thërras në ndihmë Perëndinë e Tejetlartë,

Perëndinë që më bën mirë.

4 Do të ma dërgojë ndihmën prej qiellit e do të më

shpëtojë, do t'i turpërojë ata që më shtypin, Perëndia do

ta dërgojë mëshirën e të vërtetën e vet.

5 Shpirti im banon midis luanëve që i përpijnë bijtë e

njerëzve. Dhëmbët e tyre heshta e shigjeta, gjuha e tyre

shpatë e mprehtë.

6 Lartësohu, O Perëndi, përmbi qiell, përmbi mbarë tokën

lavdia jote!

7 Këmbëve të mia u vunë leqe, e ngushtuan shpirtin tim,

para meje e hapën gropën: ata vetë ranë brenda!

8 Zemra ime është gati, O Perëndi, gati është zemra ime:

9 do të këndoj, këngës do t'ia them! Zgjohu, lavdia ime,

Zgjohu, o harpë e cetër, dua ta zgjoj agimin!

10 Do të të lavdëro ndër popuj, o Zot, ty do të të këndoj

ndër kombe.

11 Sepse u madhërua deri në qiell dashuria jote, e deri në

re e vërteta jote!

12 Lartësohu, O Perëndi, përmbi qiell, përmbi mbarë tokën lavdia jote!

KOMENTARI

Në këtë psalm shtrohet pyetja, 'Ku je?' Mbishkrimi thotë se Davidi ishte në shpellë (do të jetë aludim në 1 Sam. 21 e jo 1 Sam. 24), por Davidi vendoset në ty, në hijën e flatrave të tua (1). Duke ikur nga Shauli dhe në prag të kalojë një natë si i arratisur, shpella duket mbi të, por ai e përfytyron si flatrat e hapura të Zotit të tij. Për këtë arsye, thirrja hyrjëse e lutjes (1) kthehet në thirrje mbyllëse të lavdërimit (9, 10); besimi i tij në lutje (2, 3, 1) kthehet në qëndrueshmëri në lavdërim (7, 8); kurse bindja për fuqinë e armiqve të tij (4) kthehet në bindjen se ata janë të humbur (6). Megjithatë për Davidin kryesorja është nderi i Zotit. (5, 11).

PSALMI 58

Gjykatësi i gjykatësve tokësorë

1 *Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Mos shkatërro ... «
E Davidit. Poemë.*

2 Vallë njëmend flisni të drejtën, o pushtetmëdhenj, me drejtësi i gjykoni bijtë e njerëzve?

3 Përkundrazi! Me mendje përbluani rrenën, duart tuaja mbi tokë përgatisin dhunën!

4 E lanë rrugën që në ngjizje mëkatarët, e gabuan rrugën qysh kraharorit të nënës rrenacakët.

5 Janë të helmuar porsi shlligëzat, porsi kapastreci i shurdhët që i mbyll veshët

- 6 të mos e dëgjojë zërin e shortarit, zërin e magjistarit që është mjeshër të magjepsë.
- 7 Ti, O Perëndi, thyjeu dhembët në gojën e tyre, copëtoju nofullat luanëve, o Zot!
- 8 Le të derdhen si uji që rrjedh, le të thahen si bari që shkelet!
- 9 Si kërmill që shkrihet në jargë u bëfshin, si dështaku i gruas që s'e sheh diellin!
- 10 Para se vegshat tuaj ta ndiejnë flakën e krandeve, gjallë i përvëloftë flaka e hidhërimit!
- 11 Do të kënaqet i drejti kur ta shohë hakmarrjen, këmbët e veta do t'i lajë në gjakun e mëkatarit,
- 12 Njerëzit do të thonë: »Ka shpërblim për të drejtin, po, është Perëndia që gjykon mbi dhe!«

KOMENTARI

Cilët janë pushtetmëdhënjtë? Ata do të jenë jo perënditë, por gjykatësit e korrupuar. Ata quhen "perënditë" sepse kanë pushtet jete a vdekjeje. Ka referime të tjera ku gjykatësit i quajnë "perënditë" (krhs. Dal. 21, 6; 22, 8 +, 28; Lp. 19, 17; Ps. 82, 1, 6). Fjala *elim* do të shënojë pushtetmëdhënjtë (khs. Exod. 15, 15; 2 Mbr. 24, 15; Job 41, 25; Ezek. 17, 13; 32, 21).

Ky psalm do të jetë vajtim kombëtar. Te rr. 1, 2 psalmisti (ose Zoti?) i padit ata që duhet të mbështetin drejtësi me dështim të plotë: në vend që të përmbajnë të keqen, ata e nisin. Reshtat 3-5 përshkruajnë keqbërësit si ata që kanë natyrë të prishur qysh nga lindja. Reshtat 6-9 janë lutje për mallkim, duke u lëshuar mallkime keqbërësve. Në fund (rr. 10, 11) psalmisti mezi pret ditën kur Zoti do të hakmerret me ta (krhs. Is. 24, 21) dhe tregon hapur se do të ketë drejtësi në botë (krhs. 94, 2; 128, 2; Is. 3,10.).

PSALMI 59**Kundër të paudhëve**

*1 Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Mos shkatërro .. «
E Davidit, Poemë. Kur Shauli dërgoi njerëzit t'ia
rrethonin shtëpinë e ta vritnin Davidin.*

2 Perëndia im, më shpëto prej armiqve të mi, më mbro
prej sulmuesve të mi!

3 Më shpëto prej atyre që bëjnë të keqen, më shpëto prej
atyre që derdhin gjak!

4 Qe, ia vunë pritën jetës sime, u sulën kundër meje të
fortët!

5 E pra, unë s'kam faj as mëkat, o Zot,
pa pasur në mua paudhësi bëhen gati të më sulmojnë!
Çohu, eja e shiko,

6 ti, O Zot, Perëndia i ushtrive, Perëndia i Izraelit, zgjohu
e ndëshkoji të gjithë paganët, mos përdëlle asnjë që
vepron pabesisht!

7 Kthehen në mbrëmje, ulërijnë si qentë, enden nëpër
qytet.

8 Ja, vjellin për goje padrejtësi, shpatë i kanë buzët,
thonë:»Kush na ndien?«

9 E ti, oZot, i përqesh ata, në lojë i vë të gjitha kombet.

10 Fuqia ime, ty të pres, sepse ti, O Perëndi, je kështjella i
me.

11 Perëndia im, mëshira jote do të më mbërrijë me kohë,
Perëndia do të bëjë nga lart t'i shikoj armiqtë e mi.

12 Mos i vra që populli im të mos harrojë, por shpërndaji me fuqinë tënde, shtroji përdhe, o Zot, Mbrojtësi im!

13 Mëkat është çdo fjalë që del nga goja e tyre: le të sharrojnë në kreninë e tyre! Për shkak të shpifjeve e rrenave që flasin,

14 shfarosi në hidhërimin tënd, shfarosi e të mos jenë, le ta dinë se Perëndia është zotërues në Jakobin e mbarë skajet e tokës!

15 Kthehen në mbrëmje, lehin si qentë, enden nëpër qytet.

16 Le të enden rrotull për të gjetur ushqim; e, nëse nuk do të ngopen, le të ulërijnë!

17 Kurse unë do ta këndoj fuqinë tënde, në mëngjes do ta lartësoj dashurinë tënde, sepse ti ishte kështjella ime, strehimi im në ditën e rrezikut tim.

18 Fuqia ime, ty dëshiroj të të këndoj, sepse, ti O Perëndi, je kështjella ime: Perëndia im, mëshira ime!

KOMENTARI

Sfondi i këtij psalmi gjendet te 1 Sam 19,10-11, ku armiqtë e Davidit e kishin rrethuar shtëpinë e tij për ta vrarë me urdhër të Shaulit, por kërcënimi duket i vazhdueshëm. Gjatë ikjes së tij nga Shauli, Davidi arriti të kalonte nëpër rrethimin e ushtarëve për të shkuar në shtëpinë e gruas së tij, Mikal. Tema e psalmit është siguri e patundur te Zoti, i cil e mbron Davidin nga armiqtë e tij.

Davidi fillon me një lutje (1-5).

Te rr. 11 Davidi flet për popullin e tij, sepse ai është tashmë në fuqi është mbreti i tyre. Mu në mes të telasheve, Zoti i dha Davidit një këngë të triumfit.

PSALMI 60**Uratë kombëtare pas humbjes së luftës**

1 Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Lili i urdhrit«.

Poemë.

E Davidit. Për mësim.

2 Kur luftoi kundër Aram Naharaimit e Aram Cobëse kur Joabi, në kthim, i mundi 12.000 edomas në Luginën e Kripës.

3 O Perëndi, ti na flake tej, na theve: ishe zemëruar! Kthehu prapë tek ne!

4 E tunde tokën, copë e ndave, shëroja plasat se po fundoset!

5 Bëre që populli yt të shohë të vështira të mëdha, na dhe të pimë verë që të merr mendtë!

6 Por ti u dhe shenjë të dashurve të tu të tërhiqen nga goditj a e harkut,

7 por që të shpëtojnë të dashurit e tu ndihmo me të djathtën tënde e na dëgjo!

8 Perëndia foli në Shenjtëroren e vet: »Do të gëzohem, do ta ndaj Shehemin, do ta mas Luginën Sukot!

9 Imi është Giladi, imi Manasheu, Efraimi është përkrenarja ime, Juda skeptri im.

10 Moabi legeni ku unë lahem, në Edom do ta hedh këpucën time, mbi filistenj do të brohoris fitoren!«

11 Kush do të më çojë deri në fortesë! Kush do të më prijë deri në Edom?

12 Vallë, mos jo ti, O Perëndi, që na flake tej, vallë a s' do të dalësh, O Perëndi, me forcat tona? Deh, na ndihmo në

ditë të ngushtimit, sepse s'ka shpëtim prej ndihmës së njeriut!

13 Bashkë me Perëndinë mrekulli do të bëjmë, ai do t'i shqelmojë armiqtë tanë!

KOMENTARI

Këtu përfytyrohet Davidi i cili kthehet nga një disfatë ushtarake. Sfondi i këtij psalmi është 2 Sam 8,3-7. Davidi vetë ishte fajtor për telashet e veta. Davidi nuk kishte marrë asnjë udhëzim nga Zoti për të sulmuar Hadad-Ezerin, mbretin e Sirisë – ai sillej si një mbret oriental oportunist. Si pasojë Zoti kishte lejuar që të sulmoheshin prapavijat e ushtrisë së Davidit, që të vijë në vetë. Nga ana njerëzore, ka mundësi që Hadad-Ezeri t'i ketë bindur edomasit për të hapur një front të dytë. Këtë situatë e re mund ta ndryshojë vetëm lutja e Davidit. Ai duhet ta pranojë me lutje gabimin e tij. Lutja këtu simbolizohet nga flamuri i ngritur (rr. 5), dhe kjo na kujton Moisiun që vepronte po ashtu në shkretëtirë kur korri fitoren me lutje. Sulmi i edomasve ishte aq tradhtar sa edhe ai i amalekasve në kohën e Moisiut.

Lista e emrave gjeografike të përmendura te rr. 6-8 shërben për të theksuar faktin që ato vende janë dhuratë e Zotit – Davidi nuk mund t'i kapë me mjetet njerëzore. Kjo vlen jo vetëm për territorin e premtuar, por edhe për sundimin e tij mbi shtete fqinje që do të bëhen vazalët e tij.

Në fund, te rr. 9-12 komandanti i lutet Zotit për sukses në fushatën e tij kundër edomasve, të simbolizuar nga kryeqyteti i tyre, Petra.

Zifi ndodhej në jug Judes dhe Davidi ndihej thellë i lënduar kur populli i tij u kthye kundër tij, megjithëse ky popull rrinte me të drejtë besnik ndaj Shaulit. Siç e ka zakon në psalme të tilla, përgjithësohet çështja e parashtruar në mbishkrimin e psalmit:

Davidi e shfrytëzon rastin që të na mësojë se si situata të tilla duhen ballëfaqur.

(i) **me lutje**(1, 2). Me emrin tënd, do të thotë duke vepruar sipas natyrës sate të zbuluar. Davidin e quanin padrejtësisht tradhtar.

(ii) **me përkujtimin e mësimeve biblike** (3-5). Së pari, karakteri i kundërshtarëve, (3), së dyti, karakteri i Zotit (4), dhe në fund lutje për shpagim drejtuar Zotit. Të huajt ishin në të vërtetë (bashanëtarët) e fisit të Judës, por ata vepronin si të huaj të pa skrupuj, sepse atje ku mungon respekti për Perëndinë, s'ka mundësi për besnikëri e as për njerëzi.

(iii) **me zotim për të ardhmen** (6, 7). Kjo nuk duhet kuptuar si tregti me Zotin, por si reagim shpirtëror ndaj mirëdashurisë së Zotit.

PSALMI 61

Urata e një të treturi

1 Mjeshtrit të korit. Me vegla muzikore me korda. I Davidit.

2 Vështroje, O Perëndi, për lutjen time, dëgjoje uratën time!

3 Nga skaj i tokës së thërras në ndihmë, se më ka lëshuar zemra:

më qit në qetë që s'mund t'i afrohem.

4 Sepse ti je shpresa ime, kala e forte përballë armikut.

5 Përjetë do të banoj në tendën tënde, do të gjej mbrojtje nën sqetullën tënde,

6 sepse ti, O Perëndi im, i pranon kushtet e mia, u jep trashëgim atyre që e druajnë emrin tënd.

7 Ditë mbi ditë shtoji jetës së mbretit, vjetët e tij zgjati nga breznia në brezni!

8 Le të mbretërojë gjithmonë ndër sytë e Perëndisë: rojë iu bëfshin hiti dhe e vërteta!

9 Kështu do t'i këndoj këngë emrit tënd pa pushim, do t'i plotësoj kushtet e mia si një ditë për ditë!

KOMENTARI

Sfondi i këtij psalmi është ose kryengritja e Avshalomit (2 Sam. 15-19) ose aludim për një kohë kur mbreti ishte larg atdheut duke ushtruar një fushatë ushtarake. (krhs. Ps. 20; 60). Megjithatë, pasi vazhdimi i mbretërimit të Davidit është në pikëpyetje, siç duket, ka të ngjarë se ikja e tij nga Avshalomi të jetë sfondi i vërtetë. (rr. 6, 7) Mund të jetë lutja e mbretit ose lutja për dinastinë e tij.

Pas mërgimit ky psalm përdorej si lutje e kombit të shpërndarë për ardhjen e Mesisë (kështu Targumi).

PSALMI 62

Perëndia e vetmja shpresë

1 Mjeshtrit të korit. Mbi Jedutun. Psalmi. I Davidit.

2 Vetëm në Perëndinë pusho, shpirti im, sepse prej tij vjen shpëtimi im.

3 Vetëm ai është qeta ime e shpëtimi im, kështjella imei më kurrë nuk do të tundem!

4 Deri kur do të suleni kundër një njeriu, do' ta rrëzoni të gjithë së bashku si murin e prishur, si gradhin e thyer?

5 Synojnë ta rrëzojnë prej së larti, kënaqësinë e gjejnë në rrenë.

Me gojë lavdërojnë e me zemër mallkojnë.

6 Vetëm në Perëndinë pusho, o shpirti im, vetëm në te qëndron shpresa ime!

7 Vërtet vetëm Ai ' është Perëndia im e shpëtimi im, kështjella ime: në kurrë nuk do të tundem!

8 Në Perëndinë është shpëtimi im e nderi im, në Perëndinë shpresa e fuqisë sime, strehimi im në Perëndinë.

9 Shpreso në të gjithmonë, o popull, atij hapi zemrën, sepse Perëndia është strehimi ynë.

10 Vërtet si avull janë bijtë e Adamit, rrenë e thjeshtë bijtë e njeriut: në, qoftë se hipin në peshore, të gjithë dalin më të lehtë se tymi!

11 Ruaj se shpresoni në dhullë, ruaj se ju rren preja; në pasuri kur ato shtohen mos e ngjitni zemrën për to!

12 Perëndia një herë foli, unë këto dy herë dëgjova:

»Pushteti i përket Perëndisë, yti, o Zot, është përdëllimi!

13 Ti shpërblen gjithkënd sipas veprave që të ketë bërë!«

KOMENTARI

Psalmisti s'ka nevojë të vazhdojë t'i thërrasë Zotit, sepse është aq i sigurt për besueshmërinë dhe besnikërinë e Perëndisë, saqë i mjafton të presë shpëtimin e Perëndisë (krhs. 40, 1; 123, 2). Pastaj u drejtohet bashkadhuruesve (. 8-10), dhe kjo jap të kuptohet se flet në Tempull ku i nxit të kenë besim te Zoti e tek askush tjetër. Në fund (rr. 11, 12), si mësues i urtësisë, tregon për mësimet që ka mësuar nga zbulim hyjnor –

ose nëpërmjet një profecie ose nga një recitim kultik të veprave madhështore të Zotit (krhs. Ps. 136): Perëndia është në gjendje t'u përmbahet premtimeve lidhur me besëlidhjen dhe të sigurojë që keqbërësit të ndëshkohen kurse besimtarët të shpëtojnë (rr. Dal. 20, 5 +; Lp. 28).

PSALMI 63

Dëshira ndaj Perëndisë

1 Psalm. I Davidit, kur qëndronte në shkretëtirën e Judës.

2 O Zot, Perëndia im je ti, qysh në agim të kërkoj. Ka etje për ty shpirti im, ty të dëshiron trupi im, si toka e shkretë, e thatë, e paujë,

3 kështu erdha në Shenjtëroren tënde për ta parë fuqinë tënde e lavdinë tënde.

4 Sepse më e mirë është dashuria jote se jeta: buzët e mia do të të lavdërojnë.

5 Kështu do të të lavdëroj në jetën time e në emrin tënd do t'i lartësoj duart e mia,

6 do të ngihem si në gosti të shkëlqyeshme, me buzë të hareshme do të të lavdërojë goja ime.

7 Ty do të të kujtoj edhe ne shtratin tim, në përgim natën do të mendoj për ty,

8 sepse ti je bërë ndihma ime, prandaj do të brohoris nën hijen e krahëve të tua

9 Shpirti im u mbështet në ty, e djathta jote më merr për dore.

10 E ata që kërkojnë të ma marrin shpirtin, do të zbresin në thellësitë e dheut, 11 do të bien nën pushtetin e shpatës, do të bëhen pre e çakejve.

12 Mbreti do të gëzojë në Perëndinë, do të galdojnë të gjithë ata që përbehen në të, kurse rrenacakëve do t'u mbyllet goja.

KOMENTARI

Mbishkrimi i psalmit e lidh me përjetimet e Davidit, ka të ngjarë me ato të ikjes së tij nga Avshalomi dhe ushtria e tij (rr. 2 Sam. 15, 23-28; 16, 2, 14; 17, 2 +, 29) e jo ato të Shaulit dhe ushtarët e tij (krhs. 1 Sam. 23, 14; 24, 2), pasi te rr. 11 siç duket, i referohet vetvetes si mbret.

Situata ishte ajo e luftës që duhet zgjidhur me fitore dhe disfatë. Meqë ata janë të vendosur për të shkatërruar Davidin, ata do ta shkaktojnë shkatërrimin e vet.

11 Avshalomi kishte kërcënuar Davidin me shfronizim. (krhs. 2 Sam. 15,4, 10), por Davidi i cili flet për vetveten si mbret, kështu pohon se “dhuratat dhe grishja e Perëndisë nuk tërhiqen.” (Rom. 11,29).

PSALMI 64

Ndërshkimi i shpifësve

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.*

2 Dëgjoje, O Perëndi, zërin e vajtimit tim, ma ruaj jetën prej tmerrit të armikut,

3 më mbro nga përbetimi i të mbrapshtëve, prej grumbullit të atyre që veprojnë keq.

4 Prej atyre që e mprehën gjuhën e vet si shpatë, që vjellin si shigjeta fjalë të helmuara,

5 për ta shigjetuar në moh të pafajshmin; e shigjetojnë papritmas e frikë nuk kanë.

6 Ata marrin guxim në synimet e veta të këqija, shestojnë si t'i vënë fshehtas leqet e veta e thonë: »Kush mund t'i shohë?«

7 Synojnë paudhësi, i çojnë në vend synimet e parapara, humnerë është njeriu, greminë zemra e tij!

8 Por Perëndia i shigjetoj ata, papritmas i mbuluan plagët.

9 Gjuha e vet ata i sharroi, kush i sheh, i habitur, luan kokën.

10 Të gjithë njerëzit do t'i kapë frika, do t'i kumtojnë veprat e Perëndisë, mirë do ta kuptojnë ç'bëri Ai.

11 I drejti do të gëzohet në Zotin, në Të do ta ketë shpresën,

me Të do të mburren të gjithë të ndershmit në zemër.

KOMENTARI

Përvoja personale dhe ngjarjet publike shpeshherë vënë në pyetje ekzistencën e një perëndie të drejtë. Në qoftë se një perëndi e mirë me të vërtetë sundonte botën, a do të kishte mungesa e barashpesës ndërmjet fatit të keqbërësve dhe fatit të besimtarëve? Përse keqbërësit, siç duket, kanë sukses? Ky psalm i përgjigjet pyetjes duke pohuar se në fund Zoti do t'i ndërshkojë keqbërësit kurse të shpërblejë besimtarët. Kundërshtarët e Davidit e sulmojnë me fjalët e hedhura, me akuza.

Theksohet që veprat e Perëndisë nuk janë medoemos të menjëhershme, por janë të papritura kur realizohen. Ndërkohë

ata që janë në rregull me të, kanë një gëzim që nuk varet nga fati tokësor.

PSALMI 65

Himn falënderimi

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit. Këngë.*

2 Ty, O Perëndi, të përket himni në Cion, për nderin tënd u plotësoftë kushti në Jerusalem!

3 Tek ti që i dëgjon uratat do të vijë çdo njeri i ngarkuar me mëkate.

4 Fajet tona janë më të forta se ne, por ti i zhbin mëkatet tona.

5 Lum ai që ti zgjodhe dhe e more ngjat vetes: ai banon në Shtëpinë tënde.

Do të ngihemi me të mirat e Shtëpisë sate, me shenjtërinë e Tempullit tënd.

6 Ti na ndihmon me mrekullitë e drejtësisë sate, O Perëndi i shpëtimit tonë,

shpresa e mbarë skajeve të tokës e të detit të largët.

7 Ti i forcon malet me fuqinë tënde, i ngjeshur me pushtet,

8 ti qetëson tërbimin e deteve, gjëmën e valëve të tij dhe rrëmujën e popujve.

9 Edhe ata që jetojnë në skajet e botës mbesin të habitur nga mrekullitë e tua, me gëzim i mbush dyert e mëngjesit e të mbrëmjes!

10 Ti kujdesesh për tokën dhe e ujit, e ngarkon me prodhime të begatshme. Lumi i Perëndisë është plot me ujë: ti bën të rriten drithëra për njerëz!

Tokën ti kështu e përgatit:

11 hullitë ia lag, bucat ia imtëson, me shi e zbrun, të mbjellat ia lavdëron.

12 E kurorëzon vitin me mirësinë tënde, gjurmëve të tua rrjedh begatia,

13 kullotat e shkretëtirës rijnë njomësi, mballesat bregoreve ngjeshen me hare,

14 livadhet janë të veshura me dhen, luginat mbulohen me drithëra: gjithkrah këngë e brohoritje me hare!

KOMENTARI

Psalmi 65 është himn falënderimi i mbarë bashkësisë pas një shpëtimi të mrekullueshëm dhe pas të korrave të jashtëzakonshme. Në të gjitha këto ngjarjet Perëndia shihet si shpagimtar, krijimtar dhe furnizues.

Çdo vit ishte kurorëzuar (d.m.th. kulmonte me) Ditën e Pajtitimit dhe Festën e tëbanave. d.m.th. me heqjen e mëkatit (Lev. 16) si dhe me festën e të korrave (Lev. 23,39; Lp. 16,13-15). Por ky psalm pasqyron një vit të jashtëzakonshëm. Perëndia ia plotësoi lutjen popullit. (2, 5); mëkati kishte qenë realitet i rëndë (3); Zoti kishte bërë vepra të mrekullueshme (5), me qetësimin e kombeve (7) me vendosjen e namit të tij botëror (2, 5, 8); të korrat ishin jashtëzakonisht të mëdha. (9-13).

Ngjarja historike që mund t'i përgjigjet asaj të këtij psalmi, kur Zoti ia plotësoi lutjen Davidit pas një periudhe prej 3 vjeteve të thatësisë. Kjo do të ketë ndodhur në fillim të mbretërimit të tij, kur Davidi trashëgoi një situatë, për të cilën Shauli ishte fajtor. Ky kishte shkëlur besëlidhjen që kishte lidhur me banorët e Givonit.

Shauli, jo vetëm që kishte sulmuar filistenjtë (kërcënim i jashtëm), por kishte masakruar banorët e Givonit (asnjë kërcënim). Si pasojë barazpesha e natyrës ishte ngatërruar dhe Zoti kishte ndëshkuar Izraelin me një thatësi të rënde. Davidi kishte kërkuar të rimëkëmbë barazpeshën me ekzekutimin e të afërmeve të Shaulit.

Një interpretim tjetër do të ishte situata pas çlirimit të Izraelit nga asiranët, por kjo përjashtohet sepse do të mohojë autorësinë e Davidit.

rr. 5-8 Çlirim do të thotë fij. “drejtësi”. Drejtësia e Perëndisë është dinamike sepse vë në rregull atë që nuk ishte në rregull (mëkat, fajësi), dhe kështu sjell shpëtim; por qëllimi i saj është moral, sepse qëllimet dhe mjetet janë të drejta.

rr. 9 *Lumi i Perëndisë*. Kjo do të thotë se Zoti është burimi i vërtetë i pjellorisë, e jo aftësi e njeriut ose perënditë pagane.

rr. 9-10 Vizita e Perëndisë është figurë për ndërhyrjen e tij.

rr. 12 Në Izrael kodrat janë zakonisht të thata, por në pranverë ato lulëzojnë me bar pas kalimit të shiut. Prandaj është sikurse kodrat të vijnë të veshura me teshat e tyre më të mira për të kënduar dhe për të festuar mirësinë e Zotit. Në fund të fundit kjo parashikon ardhjen e Mesisë dhe mikpritjen për mbarë krijimin.

PSALMI 66

Falënderim botëror

1 *Mjeshtrit të korit. Këngë. Psalm.*

Mbarë toka le t'i brohorisë Perëndisë, 2 këndon lavdisë se emrit të tij, lartësojeni lavdinë e tij të pamasë!

3 Thoni Perëndisë: »Sa të mrekullueshme janë veprat e tua! Pse je tejet i fuqishëm, armiqtë e tu të përkëdhelin.

- 4 Le të të adhurojë mbarë toka e le të të këndojë, le t'ia thotë këngës për nder të emrit tënd!«
- 5 Ejani e shikoni veprat e Perëndisë: bëri mrekulli shtanguese mes bijve të njerëzve!
- 6 Ai e shndërroi detin në terik, këmbë e kaluan lumin për këtë galdojmë me gëzim.
- 7 Ai sundon për amshim me pushtetin e vet, sytë e tij vërejnë përmbi popuj që të mos çojnë krye njerëzit kryengritës.
- 8 Lavdërojeni, o popuj, Perëndinë tonë dhe shpalleni lavdinë e tij!
- 9 Ai i dha shpirtit tonë jetën, këmbët na i ruan nga hapat e gabuar.
- 10 Ti vetë, O Perëndi, na vure ne provë, porsi argjendin nëpër zjarr na kalove.
- 11 Ti vetë na qite në leqe, barrë të rëndë na ngarkove mbi shpinë.
- 12 Ti lejove të na hipin në qafë njerëzit, na përshkove nëpër zjarr e ujë, por më vonë na dhe pushim.
- 13 Me fli shkumbimi në Shtëpinë tënde do të hyj, para teje do t'i çoj në vend kushtet,
- 14 që i premtova me buzët e mia, që i thashë me gojë kur isha në rrezik,
- 15 Do të kushtoj fli shkumbimi te majme, bashkë me dhjamë të erëndshëm deshësh, do të të kushtoj ishte edhe cjep!
- 16 Ejani, dëgjoni, të gjithë ju që e druani Perëndinë, do t'ju tregoj çfarë i bëri shpirtit tim.
- 17 Me gojën time e thirra në ndihmë, dhe me gjuhën time e madhërova.

18 Po të mendoja të keqen në zemrën time, Zoti nuk do të ma dëgjonte uratën.

19 Prandaj Perëndia ma dëgjoi uratën, i vuri vesh zërit të lutjes sime.

20 Lavdëroftë Perëndia që s' ma hodhi poshtë lutjen time e nuk ma mohoi mëshirën e vet!

KOMENTARI

Psalmi mund të ndahet në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë (rr. 1-7) e thërras botën për të adhuruar Zotin dhe për të pranuar fuqinë e tij të madhe, pasi ka parë se çfarë bëri për Izraelin kur e kishte nxjerrë nëpër Detin e kuq, e bëri të kalonte nëpër lumin Jordan për në Tokën e Premtuar. Pjesa e dytë (rr. 8-12) vazhdon t'u bërë thirrje kombeve për të lavdëruar Perëndinë, kësaj here për çlirimin e popullit të tij nga provat e rënda të kohës së fundit (krhs. Ps. 67; Is. 37, 20). Pjesa e tretë (rr. 13-20) shpall falënderimin dhe dëshmimin e një individi (ka të ngjarë një udhëheqës kombëtar), ndërsa hyn në tempull për të plotësuar betimet e tij që bëri kur ishte në ngushticë.

Psalmist i bën aludim për betimet. Në Izraelin e lashtë ligji kërkonte që ata që kishin bërë ndonjë betim për shërbim të Zotit (në qoftë se lutjet e tyre u plotësuan) ishin të detyruar të plotësojnë betimin duke kushtuar një fli, dhe pastaj duke shtruar një gosti që mund të zgjaste dy ditë. (Lv 7,16). Shërbëtorët dhe skamnorët ishin të ftuar. Ata u detyruan të tregojnë hapur për atë që Zoti kishte bërë për ta, duke u bërë thirrje të merrnin pjesë në këndimin e psalmit të falënderimit..

Holokaustët (*olot*) shënojnë përkushtim të plotë. Adhuresi ishte aq mirënjohës ndaj Zotit sa që pohon se tërësia e flive të mundshme nuk do të mjaftonin për të shpallur mirënjohjen e tij.

PSALMI 67**Lutje e përbashkët pas korrjes vjetore**

1 *Mjeshtrit të korit. Me vegla muzikore me korda. Psalm.
Këngë*

2 Perëndia pastë mëshirë për ne e na lavdëroftë, bëftë të
ndriçojë fytyra e tij mbi ne,

3 që në tokë të njihet udha e tij, në të gjitha kombet
shpëtimi i tij.

4 Të dhënçin lavdi mbarë popujt, O Perëndi, mbarë
popujt e botës ty të lavdërofshin!

5 Le të galdojnë e le brohorisin popujt, sepse popujt i
gjykon me drejtësi, sepse kombet mbi tokë ti i sundon.

6Të lavdërofshin mbarë popujt, O Perëndi, mbarë popujt
e botës ty të lavdërofshin!

7Toka e dha frytin e vet: na lavdëroftë Perëndia,
Perëndia ynë!

8 Na lavdëroftë Perëndia! Frikë e paçin mbarë skajet e
botës!

KOMENTARI

Këtë psalm zakonisht e quan himn për festën e të korrave, i kënduar me rastin e festës së tëbanave. Në këtë psalm kërkohet jo vetëm bekimi i Zotit, por edhe njohja se Zoti është i denjë për lavdërim (rr. 2-5). Para së gjithash psalmi duhet konsideruar si zgjerimi i bekimit priftëror (krhs. Nr.. 6, 24 +) i pasqyruar te rreshti i parë, por i cili dëgjohej rregullisht në shërbesat e Tempullit. Pasojat e bekimit do të përhapen në mbarë botën.

PSALMI 68**Epopeja e lavdishme e Izraelit**

1 *Mjeshtrit të korit. I Davidit. Psalm. Këngë.*

2 U ngrittë Perëndia dhe u shpërndafshin armiqtë e tij,
u zhdukshin prej syve të tij ata që e urrejnë!

3 Si zhduket tymi ashtu ti i shpërndan,
si shkrihet dylli përballë zjarrit,
ashtu të zhbihen keqbërësit përpara Perëndisë!

4 Kurse të drejtët le të gëzohen në praffinë e Perëndisë,
le të gëlojnë e le të brohorisin me hare.

5 Këndoni Perëndisë, madhërojeni emrin e tij, bëni udhë
Atij që kalëron mbi re:

»Zot« është emri i tij, vallëzoni në praninë e tij!

6 Ati i bonjakëve, mbrojtësi i të vejave është Perëndia në
banesën e vet të shenjtë.

7 Perëndia u siguron banesën të pashtëpive, u hap të
burgosurve derën e lirisë,
kundërshtarët i flak në shkretëtirë të thatë.

8 O Perëndi, kur dilje para popullit tënd, kur ti kaloje
nëpër shkretëtirë:

9 tundej toka, qielli rigonte para Perëndisë së Sinait, para
Perëndisë së Izraelit.

10 Shi të mbushullim të lëshoje, O Perëndi, e ripërtërije
trashëgimin tënd të lodhur.

11 Gjëja e gjallë jotja banonte në atë vend që në mirësinë
tënde, O Perëndi, e përgatite për të mjerin.

- 12 Zoti shpall një lajm e vajzat sihariqtare jane një ushtri e tërë:
- 13 »Mbretërit e ushtrive ikin e ikin e bukuroshja e shtëpisë prenë e ndan!
- 14 Ndërsa ju pushoni në mesin e grigjave, krahët e pëllumbeshës shkëlqejnë si argjendi, e pendlat e saj porsin ari i verdhë.
- 15 Ndërsa aty i Gjithëpushtetshmi mbretërit i thyente, Calmoni zbardhonte me dëborë!«
- 16 Mali i Perëndisë, mali Bashan, mal i thepisur mali Bashan!
- 17 Përse ju, o male të thepisura, me smirë shikoni malin ku Perëndisë i pëlqeu të banojë? Zoti në të do të banojë gjithherë!
- 18 Qerret e Perëndisë dhjetëra mijëra mijërash: Zoti vjen nga Sinai në Shenjtërore!
- 19 U ngjite lart, skllave skllavërinë e bëre, dhuratë njerëzve i more,
- që edhe ekryengritësit të banojnë te Zoti; Perëndi.
- 20 Lavdëroftë Zoti si një ditë për ditë! Për ne kujdeset Perëndia i shpëtimit tonë.
- 21 Perëndia ynë është Perëndi që shpëton, e Zotit, e Zotit është dera e vdekjes!
- 22 Patjetër Perëndia armiqve të vet kryet do të na thyejë, butin flokëshumë të atyre që ecin rië udhë të këqija.
- 23 Tha Zoti: »Nga Bashani do t'i kthej, do t'i kthej nga thellësia: e detit,
- 24 që ta lashë këmbën tënde në gjak, që edhe gjuha e qenve të tu të ketë pjesë në armiq!

- 25 U panë, O Perëndi, procesionet e tua, procesionet e Perëndisë tim, mbretit tim ne Shenjtërore:
- 26 Përpara këngëtarët, muzikëtarët pas, në midis vashat duke u rënë defave!
- 27 »Të gjithë lavdërojeni Perëndinë në bashkime, lavdërojeni Zotin, o izraelitët!«
- 28 Aty djaloshi Benjamin u prin, princat e Judës me togat e veta, princat e Zebulonit, princat e Naftaliut!
- 29 Tregoje, O Perëndi, fuqinë tënde, përforcoje, O Perëndi, çfarë bëre për ne,
- 30 prej Tempullit tënd në Jerusalem. Mbretërit le të sjellin dhuratà!
- 31 Kërcënoju egërsirës së kallamit, lorisë së mëzetërve e viçave të popujve, le të përulen e le të sjellin pllaka argjendi; shpërndaji popujt që luftës i gëzohen!
- 32 Do të vijnë bujarët nga Egipiti, Nubia do t'i drejtojë duart nga Perëndia!
- 33 Mbretëri të tokës, këndon Perëndisë, këndoni Zotit, këndon Perëndisë,
- 34 që kalëron mbi qiellin e qiellit të amshueshëm. Ja, ai e ngre zëririn, zërin e fuqishëm:
- 35 »Pranojeni gjithëpushtetësinë e Perëndisë!« Mbi Izraelin madhëria e tij, përmbi re fuqia e tij!
- 36 I mrekullueshëm je, O Perëndi, nga Shenjtërorja jote! Perëndia i Izraelit i jep pushtet e fuqi popullit të vet. Lavdëroftë Perëndia!

KOMENTARI

Në këtë psalm tregohet për marshimin e Izraelit për në Sinai, drejt Tokës së premtuar. (rr. 1-3. Shih edhe Nr. 10,35).

Marshuesit janë ish-robërit (6), të cilët Zoti ka udhëhequr nga Egjipti, dhe për të cilët Ai është bërë Atë dhe Mbrojtësi i tyre në udhëtimin e tyre nëpër shkretëtirë. (rr. 4-6). Ata i solli Ai në shiun të bollshëm të Kanaanit (rr. 7-10) ku shpartalloi edhe mbretërit e paganëve (14), duke shpallur fitoren e tij ndër popuj (11-14). Në Kanaan Ai kishte zgjedhur (për zhgënjimin e maleve të tjera) malin e Cionit, në të cilin u ngjit me triumf, (rr. 15-18), si Perëndia që shpëton popullin e vet dhe shkatërron armiqtë e tij (vg, 19-23). Ndërsa Zoti kalon nëpër radhët e vajzave që u bien dajreve (rr.), Ai është i shoqëruar nga këngëtarët dhe muzikantët dhe nga përfaqësuesit e popullit të tij në prani të kongregacionit të madh që e lavdërojnë (24-27). Me lutje ata i kërkojnë Zotit nënshtrimin e mbarë botës për t'u bashkuar në lavdërim. (28-31)

Pastaj vjen kortezhi që mund të identifikohet me ndodhinë kur Davidi e solli arkën në malin e Cionit (2 Sam. 6,12-16; 1 Ch. 15,1-28).

rr. 11-13 dhe 17-18 bëjnë aludim për kohën kur Baraku dhe Devora mundën Siserën dhe kështu çliruan robërit e tij izraelitë, duke sjellë dhurata (d.m.th. plaçkitje). Pali tek Ef 4 citon nga rr. 17-18 në lidhje me zbritjen e Krishtit në botën e të vdekurve si dhe ngritjen e tij në qiell, kur çliroi besimtarët e kohës së DhV (pasi u kishte predikuar ungjillin) dhe, duke u ngritur në qiell i solli me vete. Dhjetë ditë më vonë ndau dhuntinë e Shpirtit të shenjtë ditën e Rreshajëve (10 ditë pas ngritjes së tij në qiell).

Katërmbëdhjetë ditët e kohës të tij në tokë pas ringjalljes ishin ndalesë, kur ndërpriti udhëtimin e tij për në qiell. Ka paralel të qartë ndërmjet ngritjes triumfale të Krishtit në qiell dhe ngritjes së arkës së besëlidhjes në Tempull. Në të dy rastet Zoti e merr nderin që i përket.

me retë: krhs. rr. 33; Në letërsinë e Ungaritetit është kuptimplotë se Ba'alín e quajnë kalorës i reve, d.m.th. dhënësi i shiut (shih Ps. 29; krhs. 18, 10 +; 104, 3).

PSALMI 69

Vajtim

1 *Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Lilat.« I Davidit.*

2 Më shpëto, O Perëndi, sepse ujët më arriti deri në fyt!

3 Jam ngulur thellë në baltë, s'kam ku ta vë këmbën time në të fortë: kam rënë në pellgun e ujërave e valët po më mbulojnë.

4 U këputa duke lëshuar kushtrim, m'u tha krejtësisht gurmazi,

m'u mor drita e syve duke pritur Perëndinë tim.

5 Më shumë se flokët e kresë sime janë ata që më urrejnë pa të drejtë. U forcuan ata që më salvuan, armiqtë e mi rrenacakë: çka nuk vodha më duhej të ktheja .

6 O Perëndi, ti e njeh marrëzinë time, fajet e mia nuk janë të fshehura para teje.

7 Mos lejo të skuqen në mua ata që shpresojnë në ty, o Zot, Zoti i ushtrive, mos lejo të turpërohen në mua ata që të kërkojnë ty, Perëndia i Izraelit!

8 Sepse për shkak tëndin e mbarta poshtërimin, marrja ma mbuloi fytyrën,

9 u bëra i huaj për vëllezërit e mi, i panjohur për bijtë e nënës sime.

- 10 Pse shkrihem në zell për Shtëpinë tënde, përbuzjet e atyre që ty të përqeshin ranë mbi mua.
- 11 E ndëshkova veten me agjërim, por kjo m'u kthye në çnderim;
- 12 për petk veshà grathoren, përrallë e lodër u bëra për ta.
- 13 Kundër meje flasin ata që rrinë në derë, pijanecët po më vënë në bisht të lahutës.
- 14 E pra, unë ty të lutem, o Zot, në kohën e përshtatshme, O Perëndi, më vështro pashë dashurinë tënde, pashë të vërtetën e shpëtimit tënd!
- 15 Më nxirr nga lymë të mos humbas, më shpëto prej atyre që më urrejnë, prej ujërave të thella!
- 16 Mos lejo të më mbulojnë valët e ujërave, mos lejo të më përpijë thellësia, të mos e mbyllë pusi gojën e vet mbi mua!
- 17 Më dëgjo, o Zot, se bamirës është përdëllimi yt, shiko mbi mua sipas mëshirës sate të madhe,
- 18 mos e fsheh fytyrën tënde prej shërbëtorit tënd, sepse jam tëpër ngushtë, më shpëto pa vonesë!
- 19 Avitju shpirtit tim e shpaguaje atë, për shkak të armiqve të mi, më shpërble.
- 20 Ti e sheh çnderimin tim, marrjen time e »nderimin« tim:
para teje, janë të gjithë ata që më salvojnë.
- 21 Poshtërimi ma këputi zemrën e më lëshuan fuqitë, prita të gjendet dikush që të më ankojë, por s'qe, ndokush që të më ngushëllojë, por s'e gjeta.
- 22 Në ushqim më qitën vrer e në etje më dhanë të pi uthull.
- 23 Tryeza e tyre për ta lak u bëftë, shpagim e kurth.

- 24 U terratisshin sytë e tyre e mos pafshin, bëj gjithmonë të jenë të këputur në kryq.
- 25 Zbraze mbi ta hidhërimin tënd, i djegtë flaka e felgrimit tënd!
- 26 Banesa e tyre u ktheftë në shkretëtirë, në çadër të tyre mos pastë kush të banojë!
- 27 Pse salvuan atë që ti qortove, pse i shtojnë dhembjen atij që plagose.
- 28 Fajësisë së tyre u shto faje mbi faje, që të mos mund të shfajësohen para teje,
- 29 që të resiten prej librit të të gjauëve, të mos numërohen në radhët e të drejtëve!
- 30 Mua të mjerin e të pikëlluarin: më shpëtoftë, O Perëndi, shpëtimi yt!
- 31 Do të lëvdoj emrin e Perëndisë me këngë, do ta lartësoj me këngë falënderimi.
- 32 Kjo i pëlqen Zotit më tepër se mëzati, më tepër se demi me brirë e me thundra!
- 33 Le të shikojnë të përvujtët e le të gëzohen; kërkojeni Perëndinë e zemra do t'ju kërthndezet.
- 34 Sepse Zoti i dëgjon skamnorët, s'i përbuz të vetët që janë të robëruar.
- 35 Le ta lavdërojnë qielli e toka, detet dhe gjithçka lëviz në to.
- 36 Sepse Perëndia do ta shpëtojë Cionin, Ai do t'i rindërtojë qytetet e Judës, aty do të banojnë e do ta trashëgojnë.
- 37 Fara e shërbëtorëve të tij do ta trashëgojë, në të do të ngulë kush e do emrin e:tij!

KOMENTARI

Davidi po përjetonte urrejtje të vazhdueshme (rr. 1-4). Shkaktarët e kësaj urrejtjeje përbuznin besimtarët në tokën e Izraelit (rr. 6), largoi familjen e tij (rr. 8), talleshin për ata që i ishin besnikë Zotit (rr. 10-12), e bindte se Zoti e kishte braktisur (rr. 17), e linte zemërthyer dhe pa miq (rr. 20). Qarkullonin fjalë se Davidi ishte ndërlikuar në shpërdorim financiar (rr. 4), por arsya e vërtetë e urrejtjes ishte devotshmëria e tij ndaj Zotit. (rr. 7) dhe ndaj Tempullit – në të vërtetë vetë Zoti ishte objekti i sulmit.

Asnjë situatë e regjistruar nuk i përgjigjet kësaj paditjeje, por ka shumë mundësi që një gjë e tillë të ketë ndodhur. Davidi ishte ndërlikuar në planet për ndertimin e Tempullit (1 Ch. 28,11-21) si dhe me furnizim financiar (rr. 29,2-5) për Tempullin. Pasuria ngjall xhelosi dhe mund të ketë qenë në tokë ata që mendonin se nevojat e skamnorëve dhe nevojat e shtetit ishin lënë pas dore nga një mani mbretërore. Paditjet për shpërdorim do të ishin lehtë për t'i bërë Davidit, kurse të vështira për të hedhur poshtë. Ky psalmi citohet shpeshherë te DhR, posaçërisht nga Jezusi (Jn. 15,25), 9 Jn. 2,17; Rom. 15,3), 21 (Gjn. 19,28; krhs. Mt. 27,34, 48), 22 (Rom. 11,9+), 25 (Veprat 1,20). Rreshta të tjera (12, 20) janë në pajtim ne përjetimin e armiqësisë së egër të pësuar nga Jezusi (Mt. 27,27-31, 39-44; Mk. 14,50).

PSALMI 70

Kushtrim për ndihmë

1 Mjeshtrit të korit. I Davidit. Për kujtim.

2 O Perëndi, deh, më eja në ndihmë, O Zot, nxito të më ndihmosh!

3 U marrofshin dhe u turpërofshin të gjithë ata që kërkojnë të ma marrin jetën. U zbrapsshin dhe u turpërofshin ata që ma dëshirojnë të keqen!

4 U zbrapsshin të turpëruar ata që më thonë: »Mirë, shumë mirë!«

5 Le të galdojnë e le të gëzojnë të gjithë ata që të kërkojnë ty, le të thonë përherë: »I madh është Perëndia!«, ata që e duan shpëtimin tënd.

6 E unë j am i vobektë e skamnor: O Perëndi, shpejto të më ndihmosh, sepse ti je ndihmëtari e shpëtimtari im, o Zot, deh, mos vono!

KOMENTARI

Ajo që shfaqet me zgjatësi te Psalmi 69, Psalmi 70 e shpreh shkurt, me një thirrje urgjente. Në të dy ka ndjenje kërcënimi personal (69,1-4; 70; 1, 2, 5). Haset e njëjta lutje kundër sulmuesve (69,22 +; 70,2-3) si dhe për popullin e Zotit (69,6; 70,4), Ky psalm do të jetë kristalizimi i mendimeve të Davidit për përdorim personal me rastin e krizës.

PSALMI 71

Urata e një plaku

1 Në ndore tënde, o Zot, askurrë mos u turpërofsha.

2 Më shpëto e më dil zotësh drejtësinë tënde, pure mbi mua veshin tënd e më shpëto!

3 Ji për mua shkëmb mbrojtjeje, kullë e pamposhtur për të më shpëtuar,
sepse ti je kështjella ime e strehimi im.

- 4 Perëndia im, më shpëto prej dorës së mëkatarit, prej dorës së derhuzdit e të dinakut.
- 5 Sepse ti, o Zot, je shpresa ime, shpresa ime, o Zot, qysh prej rinisë sime.
- 6 Në ty jam mbështetur qysh prej kraharorit të nënës, qysh prej prehrit të nënës ti je mbrojtësi im, mburrja ime është gjithmonë në ty.
- 7 Për shumë njerëz u bëra çështje habie: ti ishe mbrojtësi im i fuqishëm.
- 8 Goja ime të lavdëron pa pushim, gjithë ditën të madhëron.
- 9 Mos më lësho dore në pleqëri, kur të më lënë fuqitë, mos hiq dorë prej meje.
- 10 Sepse thonë armiqtë e mi për mua, e ata që më vërejnë zunë njëzëri të këshillohen:
- 11 »Perëndia hoqi dorë prej tij, salvojeni, bini në të se s'ka kush i del zot.«
- 12 O Perëndi, mos më rri larg Perëndia im, shpejto të më ndihmoh.
- 13 Le të turpërohen e le të shuhen kundërshtarët e shpirtit tim le të mbulohen me marrje e me turp ata që ma dëshirojnë në të keqen.
- 14 E unë gjithmonë do të shpresoj në ty e unë do t'i shumoj gjithnjë lavdet e tua.
- 15 Goja ime do ta shpallë drejtësinë tënde, gjithë ditën shpëtimin tënd: që s'di të ketë masë në madhëri.
- 16 Do ta shpall pushtetin e Zotit, o Zot, do të kujtoj vetëm drejtësinë tënde
- 17 Ti më ke mësuar, O Perëndi, qysh prej rinisë sime dhe ende sot i kumtoj mrekullitë e tua.

18 E tani në pleqëri ngarkuar me vjet, O Perëndi, mos hiq dorë prej meje, derisa t'ia shpall pushtetin tënd mbarë breznisë që do të vijë.

19 Pushtetî yt e drejtësia jote, O Perëndi, arrijnë deri në qiell, sepse bëre punë të mrekullueshme! O Perëndi, e kush është i ngjashëm me ty?!

20 Sepse ti më çove prova shumë të mëdha, por përsëri më kërthndeze në jetë e përsëri më ktheve nga thellësia e tokës.

21 Rrite madhërinë time, sillu prej meje e më ngushëllo.

22 Kështu edhe vetë do të të lavdëroj, me harpë do të këndoj, O Perëndi, të vërtetën tënde, me cetër do të të këndoj ty, o Shenjti i Izraelit!

23 Do të galdojnë buzët e mia duke të kënduar ty, edhe shpirti im që e ke shëlbuar.

24 Gjuha ime gjithë ditën do të flasë për drejtësinë tënde, le të turpërohen e të marrohen ata që kërkojnë të keqen për mua.

KOMENTARI

Ky është psalm vajtimi i individit që ka pësuar fatkeqësi të madhe gjatë jetës së tij të gjatë në tokë: persekutime, sëmundje, fatkeqësitë dhe prova. Megjithatë ka mbajtur marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë qysh nga femijëria. Thirrja e tij për ndihmë është themeluar në përjetimet e tij të bekimit në të kaluarën. Dëshira e tij e madhe është të jetojë sa gjatë që mund t'i mësojë diçka që ka mësuar nga jeta për hir të brezit të ri. Përsa i përket temës dhe rrethanave ky psalm i përgjigjet situatës së Davidit të paditur padrejtësisht, ndërsa në ditët e tij të fundit ka bërë përgatitjet për ndërtimin e Tempullit.

PSALMI 72**Mbreti i premtuar**

1 *I Salomonit.*

O Perëndi, jepja mbretit gjyqin tënd dhe drejtësinë tënde birit të mbretit,

2 që ta gjykojë popullin tënd me drejtësi e skamnorëve të tu t'u japë të drejtën.

3 Malet le t'i sjellin paqen popullit e kodrat drejtësinë.

4 Ai do t'i gjykojë të, vobektët e popullit, do t'i shpëtojë bijtë e skamnorit do ta përulë shpifësin.

5 Ai do të jetojë sa dielli e hëna, nga breznia në brezni.

6 Do të zbresë porsì vesa mbi bar, porsì shiu që e lag tokën.

7 Në ditët e tij do të lulëzojë drejtësia dhe paqe e madhe deri sa të jetë hëna.

8 Do të sundojë prej detit në det, prej Lumit e deri në skajin e botës.

9 Para tij do të bien përmbys banorët e shkretëtirës, kundërshtarët e tij do të lëpijnë tokën.

10 Mbretërit e Tarshishit edhe të ishujve dhurata do të sjellin,

mbretërit e arabëve e të Shabës do të lajnë të dhjetat

11 të gjithë mbretërit para tij përmbys do të bien e popujt mbarë do t'i shërbejnë.

12 Ai do ta shpëtojë skamnorin që fshan, të varfrin që nuk ka ndihmëtar.

13 Mëshirë do të ketë për të mjerin e të vobektin, dhe skamnorëve do t'ua shpëtojë jetën.

14 Do t'i shpëtojë prej padrejtësisë e dhunës, gjaku i tyre do të jetë i çmueshëm përpara tij.

15 Do të jetojë e do t'i jepet prej arit të Arabisë, gjithmonë do të luten për të, gjithë ditën do ta lavdërojnë.

16 Toka do të japë drithëra me shumicë, në maja të maleve do të valëviten kallëzit, pors i Libani frytet e tokës, do të lulëzojnë pors i bari i tokës banorët e qytetit.

17 Lavdëroftë emri i tij në shekuj, sa të jetë dielli mos iu harroftë emri!

Nëpër të do të lavdërohen të gjitha fiset e dheut, të gjithë paganët të lumtur do ta quajnë.

18 Lavdëroftë Zoti, Perëndia i Izraelit, që i vetmi bën mrekulli!

19 Lavdëroftë emri i tij i madhërueshëm, toka mbarë u mbushtë me lavdinë e tij. Amen! Amen!

KOMENTARI

Përveç në rastin e këtij psalmi, vetëm psalmi 127 mban një titull që i jep autorësinë Salomonit. Në të dy rastet mund të jetë dedikim: lutja e Davidit për birin e tij. Megjithatë psalmi i përgjigjet më mirë kohës dhe mendjes së Salomonit. Vetëm Salomoni mund të jetë lutur për vetveten si biri mbretëror (1, fjfj. ' biri i mbretit'); kishte përjetuar homazhin e mbretërve të huaj (rr. 10; 1 Mbr. 10,1-13) dhe se si pasuria e kombeve sillej në Jerusalem (rr. 15; 1 Mbr. 10,22). Salomoni ishte mbret, nën të cilin paqja dhe lulëzimi ishte në rend të ditës dhe mund ta ketë quajtur mbretërinë e tij frytet e para të sundimit mesianike. Lutja e tij pranë Givonit (1 Mbr. 3,6-9) dhe psalmi pajtohen me njeri-tjetrin. Por njëkohësisht psalmi kalon jashtë hiperbolës për të shënuar mbretin më të madh, Mesinë dhe mbretërinë e tij.

LIBRI III (Ps 73-89)**PSALMI 73****Drejtësia e sprasme**

1 *Psalmi. I Asafit.*

Sa i mirë është Perëndia për njerëzit e drejtë, Zotynë për ata që janë të pastër në zemër.

2 E mua veçse nuk më rrëshqitën këmbët, përpak që nuk më lëshuan këmbët,

3 sepse ua pata lakmi krenarëve duke parë mirëqenien e keqbërësve .

4 Sepse për ta vuajtje nuk ka, shëndoshë e plot dhjamë është trupi i tyre.

5 Nuk jetojnë në vuajtje të vdekatarëve, nuk i rreh frushkulli i vështirësive të njerëzve.

6 Prandaj edhe gjerdan për qafë e kanë, madhështinë e dhunën për petk që i mbulon.

7 Nga zemra e majme u kullon e keqja, dhelpëritë u shpërthejnë nga zemra.

8 Përqeshin e dijekeqas flasin, me dhunë kërcënohen krenarisht prej së larti.

9 Vënë gojë edhe kundër qiellit, gjuha e tyre e përshkon tokën.

10 Prandaj lart e vendosin veten dhe ujërat e shumta nuk arrijnë tek ata.

11 Kështu edhe thonë: »Si mund ta dijë Perëndia? A mund të dijë gjë i Tejetlarti?«

12 Ja, këta janë mëkatarët: gjithmonë të qetë e grumbullojnë pasuri.

13 Atëherë thashë: »Vallë kot e paskësh ruajtur të pastër ze dhe në pafajësi i lava duart e mia,

14 kot e frushkullova veten përditë duke bërë pendesë që herët në mëngjes!«

15 Të kisha thënë: »Do të flas porsia ata«, unë do ta tradhtoj a fisin e bijve të tu. 16 U mundova ta kuptoja këtë gjë: porse disi mjerisht sytë m'u morën.

17 Derisa disi hyra në shënjtëroren e Perëndisë: atëherë pashë mbarimin e tyre.

18 Vërtet i vë në vend rrëshqitës, i lejon të shkojnë në rrënim.

19 Oh, sa me vrap mbaruan, u zhdukën, mjerimi i përpiu!

20 Po, sikurse ëndrra e atij që zgjehet, O Zot, kur të zgjohesh e bën asgjë fytyrën e tyre.

21 Kur shpirtin e kisha të trazuar, mundohesha në brendinë e zemrës sime,

22 isha i marrë e nuk kuptoja, isha bërë si bagëti para teje.

23 Por unë qysh tash gjithmonë do të jem me ty, sepse më more për dorën time të djathtë.

24 Ti do të më prish me këshillën tënde për të më marrë pastai me lumturi.

25 Kë tjetër pos teje kam unë në qiell. Edhe në tokë s' dua tjetërkënd veç teje! 26 Ligështuar më janë trupi dhe zemra:

ti je Perëndia i zemrës sime, pjesa ime, Perëndia i amshueshëm.

27 Po se do të sharrojnë të gjithë ata që largohen prej teje,
ti zhbën të gjithë ata që të tradhtojnë.

28 Kënaqësia ime është të qëndroj në praninë e Perëndisë,
ta vë shpresën në Zotin, Perëndinë tim, që t'i shpall të
gjitha veprat e tua në dyert e Qytetit Cion.

KOMENTARI

Gjatë shërbesave në Tempull kishte vend për një kohë
adhurimi të hapur në të cilën disa individë mund të jepnin dëshmi
drejtuar bashkëbesimtarëve të tyre rreth trajtimit të Zotit me ta.
Këtu psalmisti tregon hapur për një përjetim për dyshim që e
robëronte, por nga e cila ai doli në fund fitimtar.

Duket qartë se psalmisti ishte formuar në shkollat e urtësisë
të cilat kishin prodhur vepra të atilla si Fjalët e Urta, Jobi dhe
Koheleti. Mësuesit e urtësisë kërkonin t'ia përshatnin fenë jetës
dhe problemeve të saj. Sipas traditave pasuria mbahej si bekim
i Zotit të besimtarët, kurse telashe si ndërshtim për pabesi
fetare, por gjithnjë e më shumë njihnin përjashtime të këtij
rregulli, që i sillnin ankth dhe mundim besimtarit. Ky është
problemi që psalmisti nxjerr në pah, për hir të
bashkëbesimtarëve të tij. Pas shërbesës në Tempull, psalmisti
mund të vijë në vetë, të orientohet përsëri. Tani është përsëri i
bindur se ai i përket Perëndisë, i cili e mban në duart e tij, e
këshillon dhe e bind për një të ardhme të mrekullueshme.
Marrëdhënia e tij me Zotin e bindin se asgjë, madje as vdekja,
nuk mund ta ndajë nga Zoti dhe kështu sigurohet ringjallja e tij.

PSALMI 74**Vajtim pas plaçkitjes së Tempullit**

1 *Poemë. E Asafit.*

Përse, O Perëndi, të na përbuzësh deri në mbarim, të ndizet flakë flegrimi yt kundër deleve të kullotës satë?

2 Të të bjerë në mend bashkësia jote që e fitove qysh në filli fisi që e bëre pronë për vete dhe mali Cion ku e vendose: banesën tënde.

3 Drejtoji hapat e tu nga rrënoja e përhershme,
– gjë s’la pa shkretuar armiku në Shenjtërore!

4 Armiqtë e tu ulërijnë midis kuvendit tënd, i vunë shenjat e veta për shenja!

5 Na u dukën si ata që në pyll të dendur sjellin sakicë,
6 me sakica e sëpata i dërmuan dyert e tij.

7 Me zjarr e dogjën Shenjtëroren tënde,

8 të rrafshuar përdhe e dhunuan banesën e emrit tënd.

9 Thanë në zemrën e vet: »T’i shfarosim të gjithë së bashku. I dogjën të gjitha vendet e shenjta në vend!

10 Nuk i shohim me shenjat tona, profet më nuk ka, dhe askush ndër ne s’di se deri kur kështu...

11 Deri kur, O Perëndi, do të të poshtërojë armiku, përgjithmonë do ta përbuzë armiku Emiin tënd? Përse e rrudh ti dorën tënde, të djathtë tënde pse po e mban në ijë?

12 E pra Perëndia është mbreti ynë që nga fillimi, ai që çliron mbi tokë:

13 Ti me fuqinë tënde detin e ndave, u copëtove kokën përbindëshave të ujit.

14 Ia shtype kryet Leviatanit, na dhe për ushqim
përbindëshave të detit!

15 Ti bëre të rrjedhë burim e përrua, ti thave lumenjtë e
pashtershme.

16 Jotja është dita, jotja është nata, ti i krijove yjet edhe
Diellin.

17 Ti i caktove kufijtë e Tokës, ti i përfitove verën edhe
dimrin.

18 Mos e harro këtë: armiku e vuri në lojë Zotin, një
popull i marre përbuzi emrin tënd.

19 Mos ua jep bishave jetën e atyre që të lavdërojnë, mos
e harro kurrë jetën e skamnorëve të tu!

20 Shiko me mirësi mbi Besëlidhjen tënde, sepse shpellat
e vendit u bënë banesa dhune.

21 Mos lejo që i mjeri të kthehet i turpëruar: i vobekti dhe
skamnori le ta lëvdojë emrin tënd!

22 Çohu, O Perëndi, mbroje çështjen tënde, mos i harro
poshtërimet që i marri t' i bën gjithë ditën.

23 Mos e harro britmën e armiqve të tu: rropama e
kundërshtarëve gjithnjë ngrihet tek ti.

KOMENTARI

Si në një ëndërr të keqe në këtë psalm përjetohet sërish viti
587 p.e.s. dhe ngarjet te 2 Mbr 24-25. Psalmisti sheh përsëri
tempullin e Jerusalem në gërmadha (3), dëgjon rishtas britmat e
armikut atje kur njëherë dëgjohej fjala e Perëndisë (4) dhe
shikon se si vringëllojnë mjetet e shkatërrimit (5). Sot e kësaj dite
s'ka gjurmë mëshire.

Megjithatë ai që reciton psalmin nxitet të fillojë të këndojë. Besimi i tij ngrihet më lart se dëshpërimi i kongregacionit, ndërsa i bën thirrje të besojnë përsëri te mbreti. Besimi dhe jo të pamët duhet të ketë fjalën e fundit. Fjalori i letërsisë së lindjes së afërt përdoret si metaforë për Daljen nga Egjipti. Poetët paganë përshkruanin tradicionalisht fitoren e perëndisë së tyre mbi detin dhe kuçedrat si veprimi i leviatanit. Izraeli adoptoi një fjalor të tillë për të përshkruar atë që realizoi Zoti për hir të izraelitët kur Deti i kuq u nda dhe kur kufomat e shtypësve të tyre u hodhën në breg, kur uji u furnizua në shkretëtirë dhe kur lumi Jordan u tha. Ky Zotëri i historisë së shpëtimit është gjithashtu Perëndia i fuqishëm i krijimit dhe providencës.

PSALMI 75

Gjyqi i plotë dhe i gjithmbarshëm

1 *Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Mos shkatërro. I Asafit. Këngë.*

2 Do të të këndojmë lavde, O Perëndi, do të lavdërojmë e do ta thërrasim emrin tënd, do t'i shpallim mrekullitë e tua.

3 »Kur unë të caktoj kohën, do të gjykoj me drejtësi.

4 Në dashtë, le të lëkundet toka me të gjithë banorët e vet, unë jam ai që ia kam forcuar shtyllat.

5 U thashë krenarëve: »Mos u krenoni!« të paudhëve:
»Mos çoni krye!

6 Mos e lartësoni ashtu kryet tuaj, mos folni kundër Perëndisë poshtërsi!«

7 As prej lindjes, as prej perëndimit,

8 as prej shkretëtirës nuk vjen lartësimi, sepse gjykatës është Perëndia:

këtë e përul e lartëson atë.

9 Sepse në dorë të Zotit është gota plot verë shkumuese me dra përzier. Prej saj ai jep të pihet: do ta pinë veç deri me fundërri mëkatarët, krejtësisht do ta pinë deri edhe draun.«

10 E unë do ta shpall përgjithmonë, do t'i këndoj Perëndisë së Jakobit.

11 »Kryet do t'ua thyej të gjithë keqbërësve, kurse kryet e të drejtit do të lartësohet.«

KOMENTARI

Çfarë ishte situata? A ishte rimëkëmbja e Davidit pas kryengritjes së Avshalomit (2 Sam. 15 – 19)?, apo Hiskija dhe populli i tij i shtangur pas shpartallimit të Sinaheribit dhe asirianëve? (2 Mbr. 18 – 19) Nuk e dimë, por kuptimi ynë e mësimit të madh nuk varet nga ndonjë ndodhi që do ta ketë ilustruar këtë mësim. Ngjarjet me rëndësi kolosale nuk mund të tundë dorin që mban në ekuilibër planetin tonë. (3). 'Perëndia ende rri në fron'. Sado të fuqishëm që të jenë keqbërësit, zëri i Perëndisë flet kundër tyre (4, 5) dhe rrënimi i tyre është i sigurt. (8). Ata nuk i takojnë Perëndisë dhe do të zhduken. (Veprat 5,38). Mrekullitë e Perëndisë duhet të ngjallin nga ana e popullit të tij falëndërim dhe zotim për të riprodhuar në tokë vlerat e tij. (4, 5).

Gjatë meditimit, shpërthen një lajm nga Zoti, i cili ilustron parimin: *Madje edhe më parë se të më thërrasin, unë atyre do t'u përgjigjem* (Is. 65, 24). Pa dyshim një profet i personelit të Tempullit i frymëzuar ndërhyr (krhs. 2 Chr. 20, 14); Perëndia e di problemin e popullit të tij dhe ka ndërmend ta zgjidhë. Populli

është viktimë e njerëzve mendjemëdhën timer dhe të këqij. Gjykatësi i mbarë botës nuk e ka hedhur dorë nga kontrolli i gjithësisë dhe do të ndërhyjë në kohën e duhur. Besimi i Izraelit forcohet nga ky paralajmërim drejtuar shtypësve të tyre: ata nuk mund të rebelohen kundër Tij pa u ndëshkuar.

PSALMI 76

Odë për nder të Perëndisë së tmerrshëm

*1 Mjeshtrit të korit. Me vegla muzikore me korda.
Këngë.*

2 I njohur është Perëndia në Jude, i madh është emri i tij në Izrael.

3 Në Salem është tenda e tij, vendbanimi i tij në Cion.

4 Atje ai i theu shigjetat e harkut, shqytin, shpatën e luftën.

5 Shkëlqen, o i Madhërishëm, mbi malet e presë!

6 Qenë rrëmbyer të fortët, gjumi i kapi, asnjë trim s' diti ti përdorë duart e veta

7 nga kërcënimi yt, Perëndia i Jakobit, shtang mbetën qerre e kalë!

8 Ti je i tmerrshëm e kush mund të të bëjë ballë?

Atëherë kur shfrenohet felgrimi yt!

9 Nga qielli e jep vendimin gjykatës; Toka u tund dhe heshti,

10 kur të ngrihet Perëndia në gjyq për t' i shpëtuar të përvujtët e dheut.

11 Të goditurit nga felgrimi yt të lavdërojnë, të shpëtuarit nga felgrimi do të të bëjnë festë.

12 Bëni kushte dhe plotësojani zotit, Perëndisë tuaj, të gjithë ju përreth tij jepni dhurata të Tmerrshmit,
 13 Atij që ua merr frymën princave, që është tmerr për mbretërit e tokës.

KOMENTARI

Ky psalm, i ngjashëm me psalmet 46 dhe 48, shpall një fitore vendimtare të korrur pranë Jerusalemit. Fillimisht do të ketë kremtuar pushtimin e Jerusalemit nga Davidi dhe disfatën e filistenjve që u kishin ardhur në ndihmë. (2 Sam. 5). Kjo ngjarje e lashtë ishte përjetësuar si arketip i epërsinë së Zotit dhe si garanci e veprimit të tij në të ardhmen. Kur Juda dhe monarkia e tij ishin të dobët, besimtarët do të nxirrnin shpresë të re nga një psalm i tillë. Kur asirianët nuk arritën të pushtonin Jerusalemin më 701 p.e.s, shpëtimi i tij do ta ketë përforcuar këtë shpresë. Adhuresit e Zotit ishin krenarë të qëndrojnë në qytetin e Tij. Ky psalm do t'i ketë emocionuar me përkujtimin e mbizotërimit e Zotit, të themeluar parimisht kur Davidi e pushtoi Jerusalemin.

PSALMI 77

Përsiatje mbi të kaluarën e Izraelit

1 Mjeshtrit të korit. Sipas Jeditunit. I Asafit. Psalm.

2 Drejt Zotit e ngrita zërin tim, drejt Perëndisë e çova zërin: Ai më dëgjon.

3 Në ditët e vështira unë e kërkoja Perëndinë, natën drejt tij i lartësoj duart e mia e nuk lodhem,

- 4 por shpirti im nuk gjen ngushëllim, më bie në mend
Perëndia dhe fshaj,
e kujtoj e më paket fryma.
- 5 Hapur m'i mban qepallat e syve të mi, i tronditur jam e
nuk mund të flas.
- 6 Mendoj ditët e kaluara, më bien në mend vitet e lashta.
- 7 Mendoj natën në zemrën time, përsiat dhe shpirti im
shqyrton:
- 8 Vallë, për amshim Perëndia ka hequr dorë, dhe kurrë,
thua, më s' do të ketë mëshirë?
- 9 A thua përgjithmonë u zhdok mëshira e tij, premtimi i tij
mbaroi, vallë, përgjithmonë?
- 10 Ndoshta harroi Perëndia të ketë dhembje, i zemëruar
thua cak i vuri mëshirës së vet?
- 11 Dhe thashë: »Ja, plaga ime: është shndërruar e djathta e
Tejetlartit.«
- 12 Në mend me bien veprat e Zotit, i kujtoj mrekullitë e
tua qysh prej fillimit.
- 13 Me mend i përbluaj të gjitha veprat e tua, meditoj mbi
veprat e tua të larta.
- 14 O Perëndi, të shenjta janë udhët e tua, cili hyj është i
madh si Perëndia ynë?
- 15 Vetëm ti je Perëndia që bën mrekulli, mbi popujt ti e
tregove fuqinë tënde.
- 16 Me të dhjathtën tënde ti e shpërbleve popullin tënd,
bijtë e Jakobit e të Jozefit.
- 17 Të panë ujërat, O Perëndi, të panë ujërat e u
zbrapsën, u trazuan deri edhe humnerat!
- 18 Riguan retë ujëra, dhanë retë gjëmët e veta shigjetat e
tua fluturuan!

19 Bubullima jote jehoi në stuhi, vetëtimat shndritën rruzullin e tokës, u tund toka dhe u tund!

20 Nëpër det udha jote, shtigjet e tua nëpër ujëra të mëdha, gjurmët e tua askush nuk i njeh.

21 Porsi grigjës i prive popullit tënd, me dorë të Moisiut e të Aronit.

KOMENTARI

Psalmisti i raporton kongregacionit për provën me të cilën ai është vënë dhe se si doli fitimtar nga kjo. Fatkeqësi ka rënë në kombin e Izraelit; ky individ i ndjeshëm i mori shumë seriozisht telashet e tij.

Përvoja e psalmistit përfaqësohet më mirë me përdorimin e kohës së kryer. Ky psalm është kthim mbrapa, i cili përshkruan mundimin e tij të mëparshëm. Kishte një kohë kur përkujtimi i Perëndisë ishte burim pikëllimi të thellë. Psalmisti nuk mund të flinte dhe sipas tij Zoti e kishte braktisur. Kaloi netë të tëra në lutje. Mezi mund t'i krahasonte ditët e shkuara me fatin e mjerueshëm të Izraelit, i cili krijoi dyshime rreth besnikërisë së Perëndisë. A kishte mundësi që Zoti ta ketë braktisur popullin e tij? A nuk vlente më premtimi i tij? Ç'ishte kuptimi i këtyre ngjarjeve? Psalmisti mendohet mirë. Zoti është i pa shok, pa rival. Sjellja e tij karakterizohet nga shenjtëria e tij, në kuptim kryesor të fjalës, d.m.th. fuqia e tij e pakapshme. (krhs. Is. 6, 3). Ndodhia arkitipike e Daljes kur adoptoi mbarë kombin, është dëshmi e përjetshme për zgjedhjen e Izraelit (krhs. Ob. 18), Jo, Perëndia nuk kishte ndryshuar.

Psalmisti tani mendohet për mrekullinë e Daljes nga Egjipti. Ka të ngjarë që psalmisti të citojë nga psalmet duke përdorur një këngë të lashtë plot me arkaizme. (rr. 16-20), Dalja mbulohet me gjuhën mistike të teofanisë. DhV shpesh përfytyron ndërhyrjen e

Zotit në histori me madhështi të stilizuar (krhs. Gj. 5, 4 +; Ps. 18, 7-15; Hab. 3, 3-10).

Ujërat, simbol i kaosit dhe forcave armiqësore (krhs. 74, 13), ikën nga frika kur u duk Zoti, dhe kështu e kaluan Detin e kuq. Ndërhyrja e tij për hir të popullit të tij përshkruhet si stuhi. (shih Ps 74,13-15) «Ti me fuqinë tënde detin e ndave, u copëtove kokën përbindëshave të ujit. Ia shtype kryet Leviatanit, na dhe për ushqim përbindëshave të detit! Ti bëre të rrjedhë burim e përrua, ti thave lumenjtë e pashtershëm.» Pas kalimit të detit, Zoti kujdesej për popullin e tij si bari nën udhëheqjen e udhëheqësve të caktuar.

Kështu mbaron psalmi. Dalja ishte garanci që Perëndia do të rrijë besnik ndaj popullit të tij.

«Ai që në ju e filloi veprën e mirë, Ai edhe do ta kryejë deri në Ditën e Krishtit Jezus» (Fil 1,6).

PSALMI 78

Mësimi që jep historia e Izraelit

1 *Poemë. E Asafit.*

Dëgjoje me kujdes, populli im, mësimin tim, vëru vesh fjalëve të gojës sime.

2 Po e hap gojën time për të mësuar me shëmbëlltyra, do t'ju tregoj fshehtësi të kohëve të shkuara.

3 Ato që dëgjuam e mësuam, çka na treguan etërit tanë,

4 nuk do t'i fshehim para fëmijëve të tyre, do t'i kalojmë gojë më gojë në breznitë e ardhshme lavditë e Zotit e mrekullitë e tij, veprat e bindshme që ai bëri.

5 Ai e ngriti Dëshminë në Jakobin, dhe e vuri Ligjin në Izrael, që ç' u urdhëroi etërve tanë ato t'ua shpallin fëmijëve të vet,

6 që breznia e ardhshme t'i ketë të njohura, që fëmijët që të lindin e t'ua tregojnë fëmijëve të vet:

7 që ta mbështetin shpresën e vet në Perëndinë, të mos i harrojnë veprat e Perëndisë e t'i mbajnë urdhërimet e tij.

8 E të mos bëhen si etërit e tyre – brezni kryengritëse dhe e padëgjueshme, brezni e paqëndrueshme në zemër e me shpirt të pabesë ndaj Perëndisë.

9 Bijtë e Efraimit, luftëtarë me hark, ditën e përleshjes kthyen shpinën e ikën. 10 Nuk e mbrojtën Besëlidhjen e Perëndisë, e nuk deshën të ecin udhëve të tij.

11 I harruan veprat e tij, mrekullitë e tij a që ua dëftoi.

12 Në sy të etërve të tyre bën mrekulli, në tokën e Egjiptit, në fushën Taneos.

13 E ndau detin dhe ata i kaloi, i ndali ujërat si të ishin në rrëshiq.

14 Ditën u printe me re, e gjithë natën me zjarr ndriçues.

15 Në shkretëtirë qetën e plasi dhe u dha të pinë si nga humnera e pafund:

16 nga shkëmbi nxori përrenj, bëri të rrjedhë ujët si lumë.

17 Por ata gjithnjë vazhduan të, mëkatojnë kundër tij, i kundërshtuan të Tejetlartit në shkretëtirë,

18 Perëndi in e tunduan në zemrat e veta duke kërkuar ushqim për grykësinë e vet.

19 Nynkatën kundër Perëndisë e thanë: »A është i zoti Perëndia të shtrojë tryezë ne shkretëtirë?

20 »Ja, shkëmbit i ra e rrodhi ujë, gurgulluan përrenjtë!

A mund të japë edhe bukë e mish për popullin e vet?«
21 Dëgjoi Zoti dhe u zemërua, zjarr u ndez kundër
Jakobit, flakë u ndez hidhërimi kundër Izraelit,
22 sepse nuk besonin në Perëndinë, nuk shpresonin në
shpëtimin e tij.
23 Kështu u urdhëroi reve prej së larti, i hapi pendët e
qiellit,
24 porsi shi e lëshoi manën për ushqim, u dha bukë nga
qielli:
25 njeriu hëngri bukë engjëjsh, u dha ushqim me
mbushulli.
26 Pastaj në qiell e zgjoi erën e lindjes, me pushtet të vet
bëri të fryjë shiroku,
27 bëri të bjerë mbi ta mish thujse pluhur, shpend me
pupla porsi rëra e detit:
28 ranë mes tëbanishtës së tyre, përreth çadrave të tyre.
29 Hëngrën dhe u ngopën, ua plotësoi dëshirën.
30 Ende plotësisht nuk ishin ngirë, ende ushqimin e kishin
në gojë,
31 kur qe, zemërimi i Perëndisë u ndez kundër tyre, ikositi
me vdekje më të fortët e tyre, i vrau të zgjedhurit e Izraelit.
32 Megjithatë – vazhduan të mëkatojnë dhe nuk besuan në
veprat e mrekullueshme të tijt.
33 Ditët e tyre i zhduku si avullin, vitet e tyre kaluan me
ngutësi.
34 Kur i vriste, atëherë e kërkonin e përsëri ktheheshin tek
Perëndia;
35 u binte në mend se Perëndia është strehimi i tyre,
Perëndia i tejetlartë Shpëtimtari i tyre.

- 36 Porse prapë e gënjenin me gojën e tyre, e rrenin me gjuhën e vet:
- 37 zemra e tyre nuk ishte me të, besë nuk kishin në Besëlidhjen e tij.
- 38 E Ai, i mëshirshëm, e falte fajin, në vend që të shkatërronte, shpeshherë e ndalte zemërimin e vet e nuk ndizej në furinë e vet.
- 39 I binte në mend se janë njerëz të ligshhtë – avull që shkon e nuk kthehet.
- 40 Sa herë e hidhëruan në shkretëtirë, sa herë e zemëruan në vise të pabanuara!
- 41 Prapë e prapë e ngucnin Perëndinë, e trishtonin Shenjtin e Izraelit
- 42 duke mos e kuituar dorën e tij të pushtetshme, ditën kur i shpëtoi nga armiku,
- 43 as mrekullitë që i bëri në Egjipt, as veprat e mrekullueshme që i bëri në fushën Taneos.
- 44 Kur lumenjtë i shndërroi në gjak dhe përrenjtë e tyre që të mos mund të piheshin.
- 45 Dërgoi mbi ta gretha që t'i thernin dhe bretkosa që t'i pranin.⁴⁶ Të korrat e tyre ua dha karkalecave, vemjeve mundin e tyre.
- 47 Me breshër ua rrënoi vreshtat, e me brymë manat e tyre.
- 48 Me breshër ua shfarosi bagëtinë, me rrufe ua vrau grigjat.
- 49 Lëshoi mbi ta felgrimin e zemërimit të vet, hidhërimin, urrejtjen dhe vuajtjet, dërquesë engjëjsh që u sollën të keqen.

- 50 I rrafshoi udhën felgrimit të vet, nuk ua kurseu jetën prej vdekjes, jetën e tyre në dorë ia lëshoi kolerës.
- 51 I vrau të gjithë të parëlindurit e Egjiptit, frytin e parë të fuqisë së tyre në çadrat e Hamit.
- 52 Porsi dhen prej andej e nxori popullin e vet, i priu porsi grigjës nëpër shkretëtirë.
- 53 U printe me kuj des pa farë frike, kurse armiqtë e tyre dhe i kapërdiu.
- 54 I çoi në Tokën e vet të shenjtë, në bjeshkën që pushtoi e djathta e tij.
- 55 Para tyre i dëboi paganët, okën e tyre me konop ua ndau për pronë, në çadrat e tyre i vendosi fiset e Izraelit.
- 56 E ata prapë e ngucën dhe e hidhëruan Perëndinë e tejelartë, nuk ia mbajtën urdhërimet e tij.
- 57 U shmangën, nuk i mbajtën besën si etërit e tyre, u kthyen prapazi porsi harku i prishur.
- 58 E hidhëruan me lartësiat e tyre, dhe e ngucën me gdhendjen e idhujve.
- 59 Dëgjoji Perëndia dhe u ndez në hidhërim, për së t epërmi iu ndy Izraeli.
- 60 E lëshoi banesën Shilo, tendën ku banonte në mes të njerëzve.
- 61 Fuqinë e vet e la të bjerë në robëri, nderin e vet në duar të armiqve.
- 62 Popullin e vet ia dorëzoi shpatës, kundër pronës së vet u ndez tërë hidhërim.
- 63 Djelmoshat e tyre i përpiu zjarri, vajzat e tyre s'patën me kë të martoheshin.
- 64 Ranë prej shpatës priftërinjtë e tyre, e vejushat e tyre nuk i vajtuan!

65 E u ngrit, si kush zgjohet nga gjumi, Zoti, si luftëtari kur kllapia e verës e lëshon,

66 e t'u ra pas shpine armiqve, i mposhti një herë e përgjithmonë.

67 E përjashtoi tendën e Jozefit, nuk e zgjodhi fisin e Efraimit.

68 por zgjodhi fisin e Judës, malin e Cionit që e ka për zemër.

69 Të lartë si qiellin e ndërtoi Shënjtëroren, porsi tokën e themeloi për amshim.

70 Zgjodhi Davidin, shërbëtorin e vet, e hoqi nga grigjat e dhenve,

71 prej pas dolesh nëna atë e mori të kullotë Jakobin, popullin e vet,

Izraelin, trashëgimin e vet!

72 Ky i udhëhoqi me zemër të përsosur dhe u priu me dorën e vet të vyer.

KOMENTARI

Ky është një psalm me temën e historisë së shpëtimit. Përkujtohen veprat e mrekullueshme, bekimit dhe drejtimit për të shërbyer si mësim për brezin e psalmistit. Është gjithashtu paralajmërim që të mos ripërtëriten gabimet e historisë.

Rasti i shkrimit të këtij psalmi do të jetë fundi i mbretërimit të Salomonit, kur ky filloi të merrte rrugë të shtrembër. Pyetja që bën psalmisti është si vijon: Dinastia e Shaulit mori fund sepse nuk pranoi të kujtojë (d.m.th. të nxjerrë mësim nga e kaluara). Pyetje: A do të mbijetojë dinastia e Davidit apo do të bëjë Salomoni të njëjtin gabim? A do të harrojë edhe ai mësimet e historisë?

Mësimet janë drejtuar banorëve të Judës, duke ilustruar zgjedhjen e Jerusalemit dhe dinastisë të Davidit si marrësit e premtimeve, sepse fisi i Efraimit (me të cilin Shauli ishte posaçërisht i lidhur) ishte skualifikuar për shkak të rebelimit. (vg. 9 11, 57, 60, 67, 68).

PSALMI 79

Vajtim kombëtar

1 Psalm. I Asafit.

O Perëndi, e pushtuan paganët pronën tënde, e dhunuan Tempullin tënd të shenjtë, Jerusalemin e bënë një grumbull rrënojash!

2 Ua dhanë kufomat e shërbëtorëve të tu për ushqim shpendëve të qiellit, mishin e shenjtërve të tu bishave të malit.

3 Gjakun e tyre e derdhën si ujë përreth Jerusalemit e s'kishte kush t'i varroste!

4 U bëmë çnderim ndër sy të fqinjëve tanë, përqeshje e lojë për ata që i kemi përreth.

5 Po deri kur, o Zot? A do të rrish përgjilthmonë i hidhëruar? Do të digjet si zjarti zemërimi yt?

6 Shfreje hidhërimin tënd mbi paganët që nuk të njohin, mbi mbretëri, që nuk të thërrasin në ndihmë

7 se e përulanë Jakobin dhe e shkatërruan selinë e tij!

8 Mos i kujto fajet e etërve tanë, le të na vijë në ndihmë sa më parë mëshira jote, sepse jemi bërë tepër të mjerë.

9 Na ndihmo, O Perëndi, Shpëtimtari ynë, për nder të emrit tënd e na çliro: pashë nderin e emrit tënd na i fal fajet!

10 Pse të thonë paganët: »Ku është Perëndia i tyre?« Le ta pranojnë ndër sy tanë paganët hakmarrjen e gjakut të derdhur, të shërbëtorëve të tu.

11 Le të arrijë tek ti gjëma e të robëruarve, me fuqinë e krahut tënd shpëtoji të dënuarit me vdekje.

12 Mbi zemrën e fqinjëve tanë ktheje shtatëfish dhunën që ta bënë ty, o Zot.

13 E ne, populli yt – delet e kullotës sate, do të të lavdërojmë për amshim, do ta shpallim nga brezi në brez lavdinë tënde.

KOMENTARI

Jo të gjitha fatkeqësitë e jetës janë dëshmi për zemërimin e Zotit, siç e konstatoi në fund Jobi. Por paralajmërimet e profetëve e bindën popullin se kur ra Jerusalemi, babilonasit ishin agjentët e nëshkimit prej Zotit (2 Mbr. 24 – 25). Nga koha kur u shkrua ky psalm, rrënimi vijues kishte kaluar gjatë (5), por ndjenja e dëshmisë okulare është e fortë dhe jep të kuptojë se psalmisti është banor i devotshëm i Jerusalemit i cili mbeti në Judë pas mërgimit, duke vajtuar shkretimin e qytetit dhe duke shpresuar për ditë më të mira. (2 Mbr. 25,12), (rr. 13).

PSALMI 80**Uratë për ripërtëritje të Izraelit**

1 Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Lili i urdhrit«. I Asafit. Psalm.

2 Dëgjo ti, o Bariu i Izraelit, ti që, i prin Jozefit si grigjës, ti, që rri në fron mbi kerubinë, shkëlqe

3 para Efraimit, Benjaminin e Manasheut: zgjoje pushtetin tënd dhe eja në ndihmë për të na shpëtuar.

4 O Perëndi, deh, na përtërij, kthj elle fytyrën tënde e na, shpëto!

5 O Zot, Perëndia i ushtrive, deri kur do të hidhërohesh në lutjen e popullit tënd?

6 Deri kur do të na ushqesh me bukë lotësh, e do të na japësh të pimë ujë lotësh me shumicë.

7 Na bëre shkak grindjeje për fqinjët tanë e armiqtë tanë po qeshen me ne.

8 O Perëndi i ushtrive, deh, na përtërij, kthjelle fytyrën tënde e na shpëto!

9 Vreshtin nga Egjipti e nxore, e, për ta mbjellë atë, paganët i dëbove.

10 Tokën ia përgatite, lëshoi rrënjë dhe e mbushi tokën.

11 U mbuluan malet me hijen e tij, me gema të hardhisë u mbushën cedrat e Perëndisë,

12 pinjollët e tij arritën deri në det, shermendet i qiti deri në Lumë.

13 Gardhin pse ia theve që ta vjelë çdo kalimtar?

14 E dëmtoi derri i egër, e kulloti çdo egërsirë.

15 Kthehu, Perëndia i ushtrive, shikoje nga qielli e shihe,
 eja, shihe këtë vresht,
 16 dili zot se ti vetë e mbolle: djalit që për vete e rrite.
 17 Ata që e dogjën dhe e prenë le të sharrojnë prej
 kërcënimit të fytyrës sate. 18 Dora jote qoftë mbi njeriun e
 të djathtës sate, mbi birin e njeriut që për vete e rrite.
 19 Kurrë më nuk do të largohemi prej teje: na përtërij e do
 ta thërrasim emrin tënd, 20 O Zot, Perëndia i ushtrive, deh
 ti, na përtërij, kthjelle fytyrën tënde e na shpëto!

KOMENTARI

Malli i Palit për bashkëçifutët që të shpëtojnë (Rom. 9, 13; 10, 1) parashikohet te ky psalm i kënduar në Tempullin e Jerusalemit (krhs. 2 Mbr. 19, 14 +) lidhur me fiset jugore, mbretërimin i të cilit kishte pushtuar asirianët. Ka të ngjarë të jetë kompozuar gjatë mbretërisë së mbretërve Hiskija ose Joshija ku kishte lëvizje të fortë për integrimin kombëtar. (krhs. 2 Mbr. 23, 15, 29; 2 Chr. 30). S'ka kritikë keqdashëse, por vetëm ndjenjë zbrazëtie të pafund dhe malli për ribashkim kombëtar: ata që Zoti i kishte bashkuar duhen ribashkuar në një hardhi ose në një dru ulliri të vetëm Rom. 11, 17-24; Gjn 17, 11, 22). Perandoria e mëparshme e Davidit duhet rikthyer.

PSALMI 81

Për të kremten e Tendave

1 *Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Shtrydhësit... « I Asafit.*

- 2 Duartrokitni Perëndisë, ndihmëtarit tonë, brohoritni
Perëndisë së Jakobit!
- 3 Le të tingëllojë cetra, të ushtojë tupani, harpa e
këndshme e cetra të jehojnë!
- 4 Le të ushtojë boria e hënës së re, në hënën e plotë, ditën
e të kremtës sonë!
- 5 Sepse kjo është ligj për Izraelin, urdhëresë e dhënë prej
Perëndisë së Jakobit,
- 6 urdhër që iu dha Jozefit, kur doli prej tokës së Egjiptit.
Dëgjova një zë që s'ë njihja:
- 7 »Nga barra krahët ia çlirova, nga duart ia hoqa
shportën.
- 8 Në ditë të vështirë më thirre e unë të shpëtova, të jam
përgjigjur i fshehur në stuhi, të vura në provë tek uji i
Meribës.
- 9 Dëgjo, populli im, dua të të qortoj: oh sikur të më
dëgjoje, ti, o Izrael! ´
- 10 Pranë teje tjetër zot të mos kesh, zot të huaj mos
adhuro!
- 11 Sepse unë Zoti jam Perëndia yt, unë që të nxora nga
dheu i Egjiptit, hape gojën tënde se dua ta mbush!
- 12 Por populli im s'ë dëgjoi zërin tim, Izraeli nuk ishte në
kujdes për mua.
- 13 Prandaj i lashë në ngurtësinë e zemrës së tyre, le të
jetojnë si u pëlqen atyre.
- 14 Po sikur të më dëgjonte mua populli im, sikur të ecte
Izraeli udhëve të mia,
- 15 po, atëherë shpejt do t'i përulja armiqtë e tij, do ta
rëndoja dorën mbi kundërshtarët e tij.

16 Armiqtë, e Zotit do ta përkëdhelnin atë, fati i tyre do të ishte i vulosur për amshim.

17 Unë do t' i ushqeja me më të mirin grurë, do t' i ngija me mjaltë të nxjerrë nga shkëmbi.«

KOMENTARI

Sfondi i këtij psalmi është festa e vjeshtës që inaugurohej me festën e borive (më mirë me bjerjen e borive) në ditën e parë të muajit (hëna e re; krhs. Lev. 23, 24; Nr. 29, 1+) dhe mbaroi me festën e tëbanave që zgjaste një javë duke filluar nga ditën e 15. të muajit. Çdo resurs zëri dhe vegle duhet përdorur për të brohoritur Zotin. Zoti duhet lavdëruar për çlirimin në kohën e Daljes, kur Ai ndërhyri për ta shpëtuar Izraelin nga kthetrat e egjiptianëve. Ai shkoi në luftë kundër shtypësve të tyre duke i ndëshkuar me katastrofa. Kështu mëshira e Perëndisë është motivacion i madh për lavdërim..

PSALMI 82

Kundër princave paganë

1 Psalm. I Asafit.

Perëndia u ngrit në kuvendin hyjnor, po gjykon midis hyjnorëve.

2 »Deri kur do të gjykoni padrejtësisht e krah do t' u mbani të paudhëve?

3 Dilni zot të ligishtit e të mjerit, jepjani të drejtën të përvujtit e skamnorit!

4 Lironi të ndrydhurin e të vobektin, shpëtojeni prej thonjve të të paudhit!«

5 Por ata s'kuptojnë, vesh nuk marrin, ecin nëpër errësirë; po lëkundén të gjitha themelet e tokës!

6 E pra, unë thashë: »Ju jeni zota, bij të Tejetlartit të gjithë!«

7 Por të gjithë do të vdisni si njerëzit, poshtë do të bini si një, ju, o princa!

8 Ngrihu, O Perëndi, gjykoje tokën, sepse me të drejtë je Pronari i të gjitha kombeve!

KOMENTARI

Hyjnitë janë gjykatësit e korruptuar, sepse kështu edhe Jezusi jep këtë interpretim (Gjn 10,35). Detyrat e caktuara te rr. 2-4 janë ato të gjyqtarëve të Izraelit. (Dal. 22,22-24; 23,6-7; Lp. 1,16-17; 10,17-18; 16,18-20); detyra e tyre është ushtrimi i gjyqit të Zotit, d.m.th. të japim vendime gjyqësor në përputhje me parimet e Ligjit të Zotit (Lp. 1,17). Të sjellësh një proces para Zotit do të thotë ta sjellësh para priftërve dhe gjyqtarëve (Dal. 21,6; 22,8, 9; Lp. 17,8-13; 19,17). Ata quhen perëndi, sepse përfaqësojnë Perëndinë dhe kanë pushtet jete a vdekjeje. Problemi themelor është se gjyqtarët e korruptuar favorizojnë njerëzit me influencë në gjyq. Këta gjykatës qortohen që të mos vazhdojnë të gjykojnë me anësi, që të ndajnë drejtësi dhe të mbrojnë të shtypurit.

Psalmi mbaron me thirrje drejtuar Zotit që të përfundojë veprën e tij si gjyqtar i gjithëfuqishëm i kombeve. Ai duhet së pari t'i shtijë në dorë kombet dhe të japë vendimin e tij gjyqësor, para se të ndahet drejtësia e vërtetë..

PSALMI 83**Kundër armiqve të Izraelit**

1 *Këngë. Psalm. I Asafit.*

2 O Perëndi, mos rri në qetësi, mos hesht, as mos u përmbaj, o Perëndi!

3 Sepse, ja, armiqtë e tu po zhurmiten, dhe ata që të urrejnë, po çojnë krye!

4 Sendërgojnë plane të këqija kundër popullit tënd, këshillohen kundër të mbrojturve prej teje.

5 Thonë: »Ejani t'ua tresim farën, të mos jenë më popull, të mos përmendet më emri i Izraelit!«

6 Vërtet janë bërë një mendjeje të vetme, kundër teje kanë bërë besëlidhje:

7 tendat e idumeasve e jishmaelasit, moabazit e hagarasit,

8 Gebali, Amoni e Amaleku, Filisteja me banorët e Tirit,

9 Po ashtu edhe Ashuri u bashkua me ta, u bënë ndihmëtarë të bijve të Lotit.

10 Bëjua dhe këtyre si Midianit e Siserës, porsi Jabinit në përroin e Kishonit,

11 që u rrahuan vdekur në Endor, me kufoma e plehëruan tokën.

12 Bëjua princave të tyre si Orebit e Zeebit, si Zebahut e Calmunës, krerëve të tyre

13 që thanë: »T'i pushtojmë kullotat e Perëndisë!«

14 Perëndia im, flaki ata në shakullinë, porsi bykun kur fryn stuhia!

15 Porsi zjarri që e përpin pyllin, porsi flaka që i djeg bjeshkët.

16 Po ashtu dëboji ata me furinë tënde, tmerroji ti me thëllimin tënd!

17 Mbuloju fytyrën me marre që ta kërkojnë emrin tënd, o Zot.

18 Le të skuqen e le të turpërohen përgjithmonë, le t'i mbulojë marrjale le të sharrojnë,

19 që ta dinë se emri yt është Zot: se je i Larti Perëndi mbi botën mbarë.

KOMENTARI

Juda është në rrezik pushtimi nga një koalicion kombësh. Kjo i përgjigjet situatës kur Asiria, duke qenë tepër e dobët për të ndërhyrë për shkak të telashave të brendshme, nxit kombet e tij satelite të sulmojnë Izraelin.

Populli i Perëndisë i lutet me ngulm Zotit. Kërcënimi për kombin e zgjedhur është tërthorazi kërcënim për vetë Zotin. Si mund ai të rrijë pa vepruar? Sepse armiqtë e Judës janë armiqtë e Tij ndërsa thurrit intrigat kundër popullit të tij. (krhs. Mt. 25, 42-45). Ata e parashtrojnë problemin para Zotit me lutje, sepse Ai ka bërë besëlidhje me ta për të kujdesur për ta dhe i ka vënë nën mbrojtjen e Tij. Kështu, me ekzistencën e tyre në rrezik, ata kërkojnë ndihmën e tij dhe e paralajmërojnë për mendjemadhësinë e tyre. Një rreth armiqësor i rrethojnë. Nga Lindja moavasit dhe amonasit, pasardhësit e Lotit (Lp. 29, 19), janë kundërshtarët kryesorë, kurse nga jugu vijnë edomasit me disa satelite nomade. Nga perëndimi janë filistenjtë dhe tirasit, kurse nga veriu vijnë përforcime asiriane të koalicionit, ndoshta nga provincat asiriane në Palestinë.

Popullit i kujtohet periudha e gjyqtarëve kur, me ndihmën e Zotit, Devora dhe Baraku mundën kananasit (Gjyq. 4, 5) si dhe

kur Gidoni mundi midjanasit. Zoti i kishte mbrojtur qengjat e tij kur armiqtë kërkuan t'ua marrin kullotët. Tani historia ripërsëritet, por ata i kërkuan ndihmë të njëjtit Zot për të ndërhyrë përsëri.

PSALMI 84

Këngë shtegtimi

1 Mjeshtrit të korit. Sipas melodisë: »Shrydhësit...» 1 bijve të Korahut. Psalm.

2 Sa të dashura janë banesat e tua, o Zoti i rruzullimit!

3 Shpirti im shkrihet e meket për pallatet e Zotit.

Zemra ime e trapi im i brohoritin Perëndisë së gjallë.

4 Edhe trumcaku e gjen bunin e vet edhe turtulli çerdhen e vet

ku i vë zogjtë e vet: e unë altarët e tu, o Zoti i ushtrive, Mbreti Im e Perëndia im!

5 Lum ata që banojnë në shtëpinë tënde: do të të lavdërojnë për amshim.

6 Lum ai që në ty gjen forcën dhe vendos për shtegtim të shenjtë.

7 Kur kalojnë nëpër luginën e thatë e shndërrojnë në burim uji të gjallë, sepse shiu i mëngjesit e vesh me bekime.

8 Shtegtojnë e shtegtojnë gjithnjë e më të kërtundeztë derisa të shohin Perëndinë e hyjnive në Cion.

9 O Zot, Perëndia i ushtrive, dëgjo uratën time, më vështro, O Perëndi i Jakobit.

10 Shiko, O Perëndi, Mbrojtësi ynë, shikoje fytyrën e të shuguruarit tënd!

11 Vërtet, më e mirë është një ditë në Shtëpinë tënde se të tjera me mijëra!

Parapëlqej të qëndroj te pragu i Shtëpisë së Perëndisë tim, më tepër se të banoj në tentat e mëkatarëve.

12 Sepse diell e shqyt është Zoti Perëndi, ai dhuron hirin e nderin.

Zoti nuk ua mohon të mirat atyre që jetojnë të pafajshëm.

13 O Zot Sabaot, lum njeriu që shpreson në ty!

KOMENTARI

Një shtegtar dëshmon hapur për dëshirën e tij ta adhurojë Perëndinë në Tempull të Jerusalemit.

‘Sa e dua tempullin tënd!’ është dëshmimi i pelegrinit duke u inspiruar nga fakti se në DhV tempulli ishte vendi i caktuar ku Perëndia shfaqej në mënyrë unike. Kështu ka vend të veçantë në zemrën e tij. Ndien një raport të veçantë me zogjtë që ngrejne foletë e tyre në zonën e tempullit.

Jerusalemi strehonte tempullin si dhe pallatin e mbretit: monarkia dhe feja ishin dy kanalët e qëllimit të Zotit për popullin e tij. Nderi për mbretin hyjnor kërkonte nder për përfaqësuesin e tij njerëzor. Favori i Zotit për përfaqësuesin ose mesinë e tij njerëzor kishte për pasojë lulëzimin e kombit.

PSALMI 85

Lutje për paqe

1 *Mjeshtrit të korit. I bijve të Korahut. Psalm.*

2 Përsëri e pëlqeve, o Zot, tokën tënde,

i riadhesove të treturit e Jakobit.

3 Ia fale fajet popullit tënd,
i mbulove të gjitha mëkatet e tyre.

4 I vure cak felgrimit tënd të madh,
zure vend nga shfrimi i zemërimit tënd.

5 Na përtërij, O Perëndi, Shpëtimtari ynë,
largoje zemërimin tënd prej nesh.

6 A thua gjithmonë do të jesh i hidhëruar me ne
e do ta shtrish hidhërimin tënd nga breznia në brezni?

7 Pse a s' do të kthehesh për të na përtërirë në jetë
që populli yt të gëzohet në ty?

8 Na e trego, o Zot, mëshirën tënde
e na jep shëlbimin tënd!

9 Do të dëgjoj çka thotë Zoti, Perëndi,
ai premtan paqe për popullin e vet,
për të dashurit e vet e për ata që me gjithë zemër kthehen.

10 Shpëtimi i tij është ngjat atyre që e druajnë,
lavdia e tij do të banojë në vendin tonë.

11 Mëshira dhe e vërteta do të përpiqen,
drejtësia e paqja do të merren ngrykë.

12 E vërteta do të mbijë nga toka
e drejtësia do të shikojë prej qiellit.

13 Sepse Zoti ka për të dhënë çdo të mirë

edhe toka jonë do ta japë frytin e vet.
 14 Drejtësia do t'i shkojë përpara
 dhe do t'u tregojë udhën hapave të tij.

KOMENTARI

Telashet e jetës nuk shënojnë medoemos mosmiratimin e Perëndisë, por reagimi ynë duhet gjithnjë të na shtyjë të shqyrtojmë vetveten që të mos haset te ne ndonjë mëkat që duhet rrëfyer ose gabim që duhet ndrequr. Ky është sfondi dhe tema e psalmit. Kongregacioni i adhuruesve, në nevojë të madhe, i drejtohen Perëndisë së tyre në lutje duke i kujtuar për mëshirën e tij të kaluar, ndoshta kthimin nga mërgimi në Babiloni. Shumë të ndjeshëm për mekatet e kaluara, ata konstatojnë se gjithçka ishte fryt i mëshirës, sepse meritonin zemërimin e Perëndisë.

Një profet i Tempullit (krhs 75, 2; 81, 5) jep përgjigjen e Zotit, por thekson se ndjesa varet nga pendimi i sinqert: duhet të heqin dorë nga marrëzia e tyre. Atëherë do të rikthehet marrëdhënia e drejtë (paqja).

PSALMI 86

Urata në vështirësi

1 *Lutje. E Davidit.*

1 Ma vër veshin, o Zot, e më dëgjo,
 sepse jam i mjerë e skamnor.

2 Ma ruaj shpirtin se jam i devotshmi yt,
 Perëndia im, shpëtoje shërbëtorin tënd që shpreson në ty

3 Ki mëshirë për mua, o Zot,
se gjithë ditën të thërras në ndihmë.

4 Gëzoje shpirtin e shërbëtorit tënd,
sepse tek ti, o Zot, e lartësoj shpirtin tim.

5 Sepse ti, o Zot, je i ëmbël e i butë,
plot mëshirë për ata që të thërrasin në ndihmë.

6 Dëgjoje, o Zot, uratën time,
vështroje zërin e lutjes sime.

7 Në ditë të vështirë klitha tek ti
pse e di se ti më dëgjon.

8 Nuk ka hyjrë që të përngjat ty, o Zot,
asgjë s'mund të matet me veprat e tua.

9 Të gjithë paganët prej teje të krijuar,
do të vijnë e do të të adhurojnë, o Zot,
dhe do të madhërojnë emrin tënd,

10 sepse ti je i madhërueshëm e bën mrekulli,
ti je i vetmi Perëndi.

11 Ma mëso, o Zot, udhën tënde,
që të eci sipas drejtësisë sate,
mësoje zemrën time ta nderojë emrin tënd.

12 Do të të falënderoj, o Zot, Perëndia im, me gjithë
zemrën time,

per amshim do ta madhëroj emrin tënd.

13 Sepse e madhe është mëshira jote mbi mua,
ti e nxore shpirtin tim nga thellësia e Nëntokës.

14 O Perëndi, krenarët u çuan peshë kundër meje,
një grumbull të marrësh ma helmuan jetën e për ty nuk
janë kujdes.

15 Por ti, O Zot, Perëndi i mëshirshëm e i dhimbshëm,
i ngadalshëm në zemërim, plot dashur i e duresë,
16 shiko mbi mua e ki mëshirë për mua,
jepi fuqi shërbëtorit tënd
dhe shpëtoje birin e shërbëtores sate

17 Bëj për mua një shenjë mirësie,
që të shohin urryesit e mi e të turpërohen
se ti, o Zot, më ndihmon e më ngushëllon

KOMENTARI

Te Psalmi 86 njohim lutjen e sinqertë e individit të pikëlluar. Natyra e përgjithshme e pikëllimit të tij mund të lidhet me çdo person në nevojë. Psalmisti parashton nevojat e tij. Çdo kërkesë përfshin arsyen pse Perëndia duhet ta plotësojë. Psalmisti ka besim te Perëndia sepse është i mëshirshëm dhe i gjithëfuqishëm. Kombet e tjera kanë perënditë e veta, por në fund edhe ato do të detyrohen të adhurojnë Perëndinë e vetëm.

PSALMI 87**Cioni, nëna e të gjithë popujve**

1 I bijve të Korahut. Psalm. Këngë.

Themelet e tij janë mbi, malet e shenjta,

2 Zoti i do më shumë dyert e Cionit

se të gjitha banesat e Jakobit.

3 Gjëra të mrekullueshme fliten për ty, o Qyteti i

Perëndisë!

4 »Po përmend Rahabin e Babiloninë

ndër ato që më njohin;

ja, Filisteja, Tiri e Nubia

– edhe ato lindën atje.«

5 Për Cionin do të thuhet... »Të gjithë në të lindën,

sepse e forcoi vetë i Tejetlarti!«

6 Zoti do të shkruajë në librin e popujve:

»Këta lindën atje!«

7 Dhe duke hequr valle do të këndojnë:

»Të gjitha burimet e mia janë në ty!«

KOMENTARI

Tre tema bashkohen në këtë psalm.:

(i) **Tema a qytetit:** (Is. 2,2-4; 26,1-4; 54 – 55; 60; Heb. 12,22-24). Përpjekja e parë e njeriut për të organizuar botën pa

Perëndinë kishte për pasojë qytetin (Gn. 11,1-9) kurse në fund bëhet fjalë për një qytet mbinatyror, Jerusalemin e ri (Rev. 21,1-2, 15-27).

(ii) **Tema e lindjes.** Kur Nehemia donte të popullonte Cionin e ri, qytetarët u deshën të kishin të drejtën e banimit, sipas gjenealogjisë së tyre. (Neh. 7,4+, 64; krhs. Ezr. 2,59. 62). Ky kusht i përgjigjet lindjes mbinatyrore me anë të Shpirtit (Gjn. 1,12-13; 3,3-8).

(iii) **Tema e librit:** (Dal. 32,32; Ps. 56,8; 69,28; Ezk. 13,9; Dan. 12,1; Lk. 10,20; Fil. 4,3; Heb. 12,23; Apok. 3,5). Isaia 4,3 është me rëndësi sepse e lidh temën e librit me Cionin.

Ky psalm në thelb parashikon ardhjen e Jerusalemit të ri, në të cilin do të banojnë njerëzit e të gjitha kombeve.

Një nga këngët e se krentrës realizohet në mënyrë të re. Siç duket, ishte këngë që fliste për lumin e parajsës në Jerusalem, Edenin e mëvonshëm. Simbolikisht lumi ishte burimi shpirtëror i jetës së Izraelit (krhs. 36, 8; 46, 4; Ezek. 47, 1-12). Tani degët e lumit fillojnë ta mbysin botën me ujin e jetës (krhs. Is. 2, 2). Kështu parashikohet përhapja e ungjillit.

Vini re. 4 Rahab, është nofkë për Egjiptin (Is. 30,7). Egjipt dhe Babilonia ishin dy shtypësit kryesorë të botës, kurse Filistia dhe Tiri ishin fuqi luftëdashëse dhe tregtare të botës. Kushi përfaqëson kombin më të largët.

PSALMI 88

Uratë në ditën e ngushticës së madhe

1 *Këngë. Psalm. I bijve, të Korahut. Mjeshtrit të korit.*
Me melodi: »Sëmundja«. Këngë mësimi. E Etan Ezrahifit.

2 O Zot, Perëndia i shpëtimit tim,
ditë e nate qes kushtrim para teje.

3 Le të mbërrij ë te ti urata ime,
vëru vesh dënësive të mia.

4 Sepse shpirti im është plot me vuajtje,
jeta ime është në grykën e varrit;

5 po më mbajnë me ata që zbresin në gropë,
jam porsì ai për të cilin s'ka më ndihmë:

6 i lirë si ata që vdiqën,
porsi të vvarët që pushojnë në varre,
të cilët ti më nuk i kujton,
qe janë shkëputur nga dora j ote.

7 Më plandose në shpellë pa
në errësirë e në hijen e vdekjes.

8 Felgrimi yt rëndon mbi mua,
valët e tua i hodhe mbi mua.

9 Prej meje i largove të njohurit e mi,
për ta më bëre të jem i neveritshëm,
jam i mbyllur, jashte s'mund të dal,

10 prej mjerimit sytë e mi po shteren.
Gjithë ditën në ndihmë t' thërras, Zot,
duart e mia drejt teje i shtrij.

11 Vallë për të vdekur bën ti mrekulli?
A thua hijet ngrihen për të lëvduar?

12 Flet ndokush për mirësinë tënde në varr,
për besën tënde në vendin e shkatërrimit?

13 Në errësirë njihen mrekullitë e tua,
në vend të harresës drejtësia jote?

14 E unë, o Zot, prej teje kërkoh ndihmë,
urata ime në mëngjes mbërrin para teje.

15 Pse, o Zot, e përbuz shpirtin tim?
Përse fytyrën tënde e fsheh para meje?

16 I mjerë jam dhe vdes që prej fëmijërisë sime,
më këputi barra e tmerrimeve të tua.

17 Përmbi mua kaluan hidhërimet e tua,
përdhe më shtruan provat e tua!

18 Më kanë rrethuar pa pushim si uji,
grumbullohen mbi mua njëherësh.

19 M'i largove mik e të afërm,
bëj shoqëri veç me errësirën.

KOMENTARI

Psalmisti, siç duket, është braktisur nga Zoti. Ky duhet të ketë qenë një nga pionerët e esnafëve këngëtarësh të caktuara nga Davidi. Autori do të jetë i dëshpëruar dhe i pikëlluar nga mërgimi babilonas. Ky psalm është kompozuar në të njëjtin humor si libri i vajtimeve të profetit Jeremi..

Autori flet për sheolin, nëntokën, si gropë, vend i errësirës ku të vdekurit janë izoluar nga Perëndia. Siç duket, ndihet se Zoti e ka braktisur, prandaj llogaritet si i vdekur. Ai është i bindur se në botën e të vdekurve do të jetë tepër vonë, prandaj Zoti duhet t'ia plotësojë lutjen tani.

PSALMI 89

Himn e lutje Perëndisë besnik

1 *Poemë. E Etan Ezrahitit.*

2 Dashurinë e Zotit gjithmonë do të këndoj, brez pas brezi
goja ime
do të shpallë besnikërinë tënde.

3 Sepse the: »Hiri im qëndron për amshim«,
në qiell është e themeluar besnikëria jote!

4»Bëra besëlidhje me të zgjedhurin tim,
i jam betuar Dàvidit, shërbëtorit tim:

5 Farën tënde do ta ruaj për amshim,
froni yt do të qëndrojë brez pas brezi.«

6 Qiejt i këndojnë veprat e tua, o Zot,
kuvendi i shenjtërve besnikërinë tënde!

7 E kush ndër re është i barabartë me Zotin?
Kush është i ngjashëm ndër zota me Zotin?

8 I tmerrshëm është Perëndia në logun e shenjtërve,
i madh e i përfrikueshëm mbi të gjithë
ata që i rrinë përreth.

9 O Zot, Perëndia i ushtrive, kush është si ti?
I pushtetshëm je, o Zot, e besnikëria të rrethon!

10 Ti zotëron kreninë e detit,
ua ul kryet valëve të tërbuara.

11 Ti e copëtove Rahabin dhe e shelmave.
me krah të fuqishëm armiqtë i shpëmdave.

12 Yti është qielli, jotja është toka,
ti e krijove tokën dhe gjithçka ajo përmban.
13 Veriun e jugun ti i krijove,
Tabori e Hermonit i brohoritin emrit tënd.

14 Krahu yt është plot fuqi
e fortë është dora jote,
e lartësuar e djathta jote!

15 Drejtësia dhe e drejta janë themeli i fronit tënd,
dashuria dhe e vërteta gjithkund të shkojnë përpara.

16 Lum ai popull që di të brohoritë,
që ecën në dritën e fytyrës sate, o Zot!

17 Përherë do të gëzojë në emër tënd,
e do të mburret në drejtësinë tënde.

18 Sepse ti je stolia e fuqisë së tyre
e me hirin tënd rritet fuqia jonë

19 Sepse i Zotit është shqyti ynë,
mbreti ynë i Shenjtit të Izraelit!

20 Dikur, në një vëgim, fole me miqtë e tu e u the:
»Trimit të trimit ia dhashë ndihmën time,
e lartësova një djalosh nga populli.

21 Gjeta Davidin shërbëtorin tim,
e leva me vajin tim të shenjtë.

22 Dora ime gjithmonë, do të jetë me të,
dhe krahu im përherë do ta kërthndezë.

23 Armiku askurrë nuk do të ngadhënjejë mbi të,
i paudhi nuk do të mund ta ndrydhë.

24 Unë do t'i thyej para tij armiqtë e tij,
do t'î zhbij kundërshtarët e tij.

25 Besa ime dhe mëshira ime do të jenë me të,
në saje të emrit tim do t'i rritet pushteti.

26 Dorën e tij do ta shtrij mbi det, të djathtën e tij përmbi
lumenj.

27 Ai do të më thërrasë: 'Ati im,
Perëndia im, Qeta e shpëtimit tim!'

28 kurse unë do ta bëj të Parëlindurin tim,
më të madhin ndër mbretërit e tokës.

29 Për të, gjithmonë do ta ruaj mëshirën,
Besëlidhjen me të kurrë s' do ta thyej.

30 Trashëgiminë e tij do ta bëj të amshueshme,
fronin e tij porsi ditët e qiellit.

31 Nëse bijtë e tij e lënë Ligjin tim,
e në mos ecshin ligjeve të mia,

32 po nuk zbatuesn vendimet e mia,
po i shkelën urdhërimet e mia,

33 Me thupër do t' i ndëshkoj mëkatet e tyre, me frushkull
të rreptë paudhësitë e tyre.

34 Por; nuk do ta këpus dashurinë me të
as nuk do ta prish besnikërinë time.

35 Nuk do ta thyej besëlidhjen time
as s' do t' i zhbëj premtimet e mia.

36 Një herë u përbeta me shenjtërinë time:
'Askurre Davidin nuk do ta lë në rrenë!'

37 Fara e tij do të qëndrojë për amshim,
froni i tij para meje si dielli,

38 do të qëndrojë për amshini si hëna,
dëshmitare besnike mbi re.«

39 Por tani e flake dhe e përbuze,
u zemërove kundër të shuguruarit tënd.

40 E prishe Besëlidhjen me shërbëtorin tënd, në llom e
hodhe kezën e tij.

41 I rrënove të gjitha muret e tij,
rrënoja të frikshme kështjellat e tij.

42 Pre po e bëjnë gjithsa udhës kalojnë,
për të gjithë fqinjët u bë i neveritshëm.

13 E lartësove të djathtën e armiqve të tij
i gëzove të gjithë armiqtë e tij.

44 Tykë ia bëre tehun e shpatës së tii,
e nuk deshe në luftë t'i jepje ndihmë.

45 I dhe fund shkëlqimit të tij,
e përdhe fronin ia rrëzove.

41 Ia shkurtove ditët e rinisë,
e mbulove me poshtërim e turp.

47 Po deri kur, o Zot, do të fshihesh kështu,
flakë do të ndizet hidhërimi yt?

48 Të të bjerë në mend sa e shkurtër është jeta ime
Vallë, thua kot i krijoye njerëzit?

49 Kush i gjallë vdekjen s' do ta shohë,
prej Nëntokës kush do ta shpëtojë jetën?

10 Ku janë, Zot, mëshirat e dikurshme të tuat
që me be ia premtove Davidit?

51 Të shërbëtorëve të tu, Zot, kujto çnderimin;
në zemër e mbaj poshtërimin e paganëve,

52 që na bënë armiqtë e tu, o Zot,
çnderojnë gjurmët e të shuguruarit tënd.

53 Lavdëroftë Zoti për amshim. Amen! Amen!

KOMENTARI

Në këtë psalm bëhet fjalë për situatën pas rënies së Jerusalemit (597, 586 p.e.s), pas mërgimit të mbretërve të fundit (2 Mbr. 24,8-12; 25,6-7), kur psalmisti mendohet për kuptimin e këtyre ngjarjeve. Shtrohet pyetje: A premtton Zoti pa plotësuar fjalën e tij? Jo, premtimet e tij nuk kanë dështuar.

rr. 5-8, 9-12 Kuptimi i këtyre strofave është ky: meqë asnjë pushtet në gjithësi mund të kundërshtojë Zotin, çfarë mund të parandalojë plotësimin e premtimeve të Tij?

rr. 9, 10 Deti përdoret shpesh për një gjithësi të pashtuar ku kundërshtarët e pareshtur ngrehin krye kundër Zotit. Te mitologjia pagane kjo ishte personalizuar në një betejë të zhvilluar ndërmjet Krijuesit, Mardukut, dhe kuçedrës së kaosit, Rahabit. Rahabi

është njofkë për Egjiptin (Is. 30,7),. sepse ajo që gjoja bëri Marduku kur s'kishte dëshmitarë, e bëri hapur Zoti kur shpartalloi Egjiptin duke ndarë Detin e kuç. (Is. 51,9-11), në praninë e shumë dëshmitarëve (Lp. 1,30). Teologjia biblike themelohet në ngjarjet historike. .

LIBRI IV (Ps 90-106)**PSALMI 90**

*Kotësia e jetës së njetiut
Lutje e Moisiut, njeriut të Perëndisë.*

1 O Zot, ti u bëre strehimi ynë
nga breznie në brezni.

2 Para se të lindnin malet,
para se të bëhej toka
dhe rruzullii prej amshimit të amshimit ti je Perëndi!

3 Ti e kthen njeriun në pluhur duke thënë: »Kthehuni, bijtë
e Adamit!«

4 Sepse mijëra vjet për sy të tu janë si dita e djeshme që
kaloi,
porsi ndërresa e rojës së natës!

5 Ti i zhbin në gjasim të gjumit që në mëngjes kalon si
bari;
lulëzon në mëngjes edhe gjelbëron, në mbrëmje korret
edhe vyshket!

7 Sepse na shkatërroi felgrimi yt,
na tmerroi furia e zemërimit tënd.

8 Para vetes i vure fajet tona,
të fshehtat tona në dritë të fytyrës sate.

9 Ditët na shkuan në hidhërimin tënd,
si një ofshamë mbaruan vitet tona.

10 Jeta jonë zgjat shtatëdhjetë vjet,
po qemë të shëndoshë edhe tetëdhjetë,
por shumica me mundim e dhembje,
kalojnë shpejt e ne prej këndeje përkasim.

11 Kush ia di fuqinë zemëritnit tënd,
felgrimin tënd siç e lyp frika jote?

12 Na mëso ashtu t'i njehim ditët tona
që zemra jonë dijes t'ia mbërtijë.

13 Kthehu, o Zot! Deri kur kështu?
Deh, ki mëshirë për shërbëtorët e tu!

14 Na e diko në mëngjes mëshirën tende
e do të gëzohemi e do të galdojmë
të gjitha ditët e jetës sonë.

15 Gëzoni për ditët që na mundove,
për vjetët që i kaluam në mjerim.

16 Vepra jote të shfaqet në shërbëtorë të tu, shkëlqimi yt
mbi bijtë e tyre!

17 Rëntë mbi ne mirësia e Zotit, Perëndisë sonë, bëj të
shkojë mbarë vepra e duarve tona, të përparojë vepra e
duarve tona.

KOMENTARI

Asnjë situatë i përshtatet më mirë këtij psalmi se sa Moisiu në kohën e viteve të mërzitshme të largimit nga Zoti në shkretëtirë (Nr. 14,34). Për 40 vjet Moisiu shikonte se si koha si lumi pa fund largonte të gjithë bijtë e tij (3-6, Nr. 14,23, 29; Lp. 2,14-16) dhe konstatoi se prapa gjithçka që shihte ishte zemërimi i Zotit kundër mëkatit (7-11). Por mësimi që nxori vlente edhe për të gjithë njërezimin: ishte kërcënuar nga përkohshmëria (3-6), dhe i demtuar nga zemërimi (7-11).

Ky psalm s'është fryt i cinicizmit fatalist. Vdekshmëria është jo vetëm dekret i Zotit, por edhe fenomen për të cilin përgjigjet njeriu. Interpretohet si pasoja e mëkatit: ka lidhje ndërmjet mortalitetit dhe moralitetit. Vitet tona të pleqësisë u ngjajnë fantazmave që do të bëhemi kur të zbresim në nëntokë, në sheol (krhs. Is. 29, 4). Bekimi i Zotit është sekreti i jetës me qëllim dhe i punës që do të zgjasë. (krhs. 1 Kor. 15, 58). Pesimizmi i mëparshëm i psalmistit tani është zhdukur, sepse jeta nën sundimin e Perëndisë sjell gëzim dhe plotësim.

PSALMI 91

Nën mbrojtjen hyjnore

- 1 Kush banon nën mbrojtjen e të, Tejetlartit,
do të qëndrojë nën hijen e të Gjithëpushtetshmit.
- 2 Do t'i thotë Zotit: »Strehimi im,
kështjellà ime, Perëndia im, do të shpresoj në të.«
- 3 Sepse Ai do të të çlirojë nga laku i gjahtarëve
dhe nga fjala dijekeqe.
- 4 Do të të bëjë hije me krahët e vet do të strehohesh nën
fletët e tij,

shqyt e pancir e vërteta e tij.

5 Nuk do të tutesh prej tmerrit të natës,
as prej shigjete që fluturon ditën,

6 as prej murtaje që shëtit në errësirë,
as prej shfarosjes ishte shkretëron në mesditë..

7 Le të bien me mijëra rreth teje,
dhjetëra mijëra në të djathtë tënde, ty nuk do te të
ndodhë asgjë!

8 Porsa ti me sy të vetëtish,
shpagimin e mëkatarit do ta shikosh!

9 Pasi Zoti është mburoja jote
dhe e zgjodhe të Tejetlartin për strehimin tënd,

10 e keqe nuk do të të gjejë,
dhe frushkull s' do t' i afrohet tendës sate:

11 sepse engjëjve të vet urdhër u dha
të të ruajnë në të gjitha udhët e tua.

12 Do të të mbajnë para duarsh
që gand të mos e ndeshësh këmbën tënde për gur.

13 Do të shkelësh mbi shlligë e kapastrec,
do të kalosh mbi luanë e gjarpërinj.

14 »Do ta shpëtoj sepse më do,
do ta marr ndore sepse e njeh emrin tim.

15 Ai do të më thërrasë e unë do ta ndihmoj,
në vështirësi do të jem me të,
do ta shpëtoj dhe do ta madhëroj

16 Do t'i dhuroj jetë të gjatë,
do t'ia tregoj shpëtimin tim.«

KOMENTARI

Disa elemente ku bëhet fjalë për kështjella ose mburoja, na kujtojnë për Davidin, të cilit Septuaginta i atribuohet autorësia, kurse elemente të tjera na kujtojnë për këngën e Moisiut.

rr. 1-2 Të rrish nën shtrehën e Zotit është aludim për frekuentimin e Tempullit, por aludon gjithashtu për qëndrimin adhurues të adhuruesit që gjen siguri te Zoti (krhs. 27, 4+).

rr. 3-8 Mbrojtja nga kërcënimet e jetës. Ajo që premtohet është jo paprekshmëri, lirim nga telashet, por siguri në telashet. Zoti i do të tijët, i di emrat e tyre dhe ua plotëson lutjet.

rr. 6 *as prej shfarosjes ishte shkretëron në mesditë*. Do të jetë aludim për pikën e diellit.

PSALMI 92

Këngë e të drejtit

1 Psalm. Këngë. Për të shtunën.

2 Është punë e mirë ta lavdërosh Zotin,
ti këndohet emrit tënd, o Zot i tejetlartë.

3 Të shpallim dashurinë në mëngjes
e gjatë natës bësnikërinë tënde,
4 me harpë dhjetëkordash e me lirë,
me këllgë përcjellë me cetër.

5 Se ti, o Zot, më gëzove nie veprat e tua,

kënaqem për veprat e duarve të tua.

6 Sa të madhërishtme janë veprat e tua, o Zot,
sa të thella mendimet e tua!

7 Njeriu i pamend nuk i di,
dhe i marri nuk do t'i kuptojë.

8 Po edhe në mbifshin mëkatarët porsi bari,
e në lulëzofshin ata që bëjnë keq,
janë të caktuar për bjerje të pasosur,

9 vetëm ti je i Tejetlartë për amshim, o Zot!

10 Sepse qe, o Zot, armiqtë e tu,
sepse qe, o Zot, armiqtë e tu do të birren,
do të shpërndahen të gjithë keqbërësit .

11 Ti ma rrite fuqinë porsi të buallit,
më shugurove me, më të pastrin vaj.

12 Prej së larti i shikon syri im ata që më urrejnë,
veshët e mi pa tronditje i dëgjojnë kundërshtarët e mi

13 I drejti lulëzon si palma, rritet porsi cedri i Libanit.

14 Të mbjellë në Shtëpinë e Jakobit lulëzojnë në banesat e
Perëndisë sonë.

15 Japin fruta edhe në pleqëri,
I janë të kërtshme të plot shëndet,

16 për të shpallur se Zoti është i drejtë:
Qeta ime, në të cilin nuk ka të meta!

KOMENTARI

Kjo këngë e shabatit është dëshmi e mjaftueshme se shabati i DhV ishte jo vetëm ditë pushimi, por edhe ditë e adhurimit të përbashkët me qëllim që të jetë kënaqje e jo ngarkesë. Ishte njëkohësisht provë besnikërie kundër vetëinteretit. (‘Ju thoni: «Kur do të kalojë festa e hënës së re, kur do të kalojë dita e shtunë? Atëherë do të mund të hapim depot dhe të shesim drithë, ta zvogëlojmë masën e drithit dhe ta rritim peshën, me të cilën peshohet argjendi për pagesë, t’i renditim ndryshe peshoret dhe madje t’i shesim me fitim mbeturinat.» (Am 8,5. krhs Is 58,13)

Shabati është ditë lavdërimi (1-3,14-15) (8); një ditë për të njohur shenjtërinë e tij, të ripohuar ndryshimet ndërmjet së mirës dhe së keqës (6-7, 9); ditë për t’u kujtuar atë që ka bërë Zoti (4-5) dhe posaçërisht atë që ka bërë Zoti për ne (10-11).

9. Ky rresht u ngjan rreshtave nga letërsisë së Ugaritit, të shkruar disa shekuj më parë. Zoti është e jo Baali, i cili do të korrë fitoren, do të largojë të keqen nga kjo botë, e jo të heqë rivalët e një perëndie të natyrës.

PSALMI 93

Perëndia i madhërishëm

1 Perëndia mbretëron! U vesh me madhëri!

Zoti u vesh, me fuqi u ngjesh.

Të palëkundshme e bëri botën: assesi s’do të tundet!

2 I patundshëm është froni yt qysh prej fillimit, ti je i amshueshëm!

3 Lumenjtë e ngritën, o Zot,

4 lumenjtë: e ngritën zërin e vet

lumenjtë e ngritën ushtimën e vet shurdhuese!
 Më i fortë se ushtima e ujërave të mëdha,
 më i përfrikueshëm se deti i tërbuar:
 i madhërueshëm është Zoti në lartësi!

5 Dëshinitë e tua janë plotësisht të besueshme,
 shenjtëria i përket Shtëpisë satë përgjithmonë e jetës, o
 Zot.

KOMENTARI

Psalmet 93-100. 'Lavdërimi nga Jerusalemi': Himnet e Mbretit të Madh

Do të kemi këtu, në këtë mbledhje psalmesh, himnet për t'u përdorur në festën e tebanave. Meqë kjo festë shënonte grumbullimin vjetor të popullit (Dal. 23,16; Lp. 16,13) dhe festonte fitoren e Zotit mbi Egjiptin dhe kujdesin për popullin e tij në një botë armiqësore (Lev. 23,39-43) është një kalim i lehtë për të festuar mbretërinë e Tij (Zak. 14,16). Ka edhe mundësi që kjo mbledhje psalmesh të ekzistojë për të festuar Mbretin e Madh (Mesinë). Sidoqoftë këto 7 psalme i takojnë njëri-tjetrit dhe, dy nga dy ndajnë aspektet e temës së mbretërisë: 93, 94, Mbreti i mbarë botës; 95, 96, Mbreti i të gjitha perëndive; 97, 98, Mbreti në zemrat e popullit të tij; 99, 100, Mbreti në karakterin e vet.

Psalms 93, 94. Vendi i besimit dhe vendi i lutjes.

Sipas traditës së paganëve thellësitë ishin nën sundimin e Molehut, kreshtat e maleve nën sundimin e Baalit, kurse deti nën sundimin e Tiamatit, por sipas Biblës gjithësia është nën sundimit të Zotit, sepse në fillim i ka krijuar Ai..

Psalm 93. Mbreti i përjetshëm

1,2. Mbretëria e Perëndisë. Këto fjalë hyrjese mund të përkthehen edhe si Zoti është (sërish) bërë mbret. Ai është gati për veprim. Psalmisti na thotë menjëherë se sundimi i Zoti s'është gjë e re, por u vendos qysh nga lashtësia. (krhs. Gjyq 8,23).

3,4. Fuqia e Perëndisë. Është fuqia e Zotit që siguron qëndrueshmërinë dhe pandryshmërinë e tij. Stuhitë dhe valët nuk mund të tundin fronin e tij. Theksohen epërsia e tij në krijim si dhe fitorja e tij mbi fuqitë pagane.

5. Sundimi i Perëndisë. Mbretëria e Perëndisë dhe fuqia e tij dëshmohen te ligjet morale dhe urdhëresat e tij.

PSALMI 94**Perëndia i drejtësisë**

1 O Zot, Perëndia shpagues, dëftohu, O Perëndi shpagues!

2 Çohu, Gjykatësi i dheut, shpaguaji madhështlorët!

3 Deri kur mëkatarët, o Zot,

4 deri kur do të galdojnë mëkatarët?

Do të shpotisin e do të flasin me përbuzje,

do të krenohen ata që bëjnë paudhësi?

5 E poshtërojnë popullin tënd, o Zot,

e shtypin pronën tënde,

6 vrasin vejushën e ardhacakun,

mbysin bonjakët

7 e thonë: »Zoti nuk sheh, s'di gjë Perëndia i Jakobit!«

- 8 Merrni vesh, o marrashat e popullit, ju, o të marrë, kur do të zini mend?
- 9 Ai që krijoi veshin nuk do të dëgjojë? Ai që përftoi syrin nuk do të shohë?
- 10 Ai që qorton popujt nuk do të ndëshkojë, ai që ia mëson njeriut dijen?
- 11 Zoti i di mendimet e njerëzve: ato janë të zbrazëta!
- 12 Lum ai njeri që ti e mëson, o Zot, të cilit ti ia mëson Ligjin tënd,
- 13 për t'i dhënë paqe në ditë fatzeza ndërkohë që bakeqit t'i hapet gropa.
- 14 sepse Zoti nuk e përbuz popullin e vet, as s' do të heqë dorë nga prona e vet,
- 15 sepse e drejta do t'i jepet drejtësisë e pas saj do të shkojnë të gjithë zemërmirët.
- 16 Kush do të ngrihet për mua kundër bakëqijve? Kush do të gëndrojë bashkë me mua kundër të paudhëve?
- 17 Po të mos e kisha pasur në ndihmë Zotin, përpak shpirti im do të banonte në vendin e Heshtjes!
- 18 Kur unë kujtoja: »Më rrëshqiti këmba!«, dashuria jote, o Zot, ma ngjiti dorën!
- 19 Kur në shpirtin tim grumbullohen vështirësitë, ngushëllimet e tua ma gëzojnë zemrën.
- 20 A mund të shoqërohet me ty selia e paudhësisë që stërhollon ligjin për të krijuar mjerim?
- 21 Sulen kundër jetës së të drejtit e dënojnë gjakun e pafajshëm.
- 22 Por Perëndia u bë kështjella ime, Perëndia është Qeta ku unë strehohem,

23 do t'i shpagojë sipas paudhësisë së tyre, me të keqen e tyre ai do t'i zhbijë, farën do t'ua tresë Zoti, Perëndia ynë.

KOMENTARI

Ndërsa ka mundësi që bëhet fjalë për shtypësit e huaj, autori merret kryesisht me ata udhëheqësit në Izrael që shtypin besimtarët.

1-7. Gjyqtar i kërkuar. Psalmisti i bën thirrje Zotit si Perëndi i hakmarrjës dhe gjyqtar i mbarë botës, i cili ka pushtet të ndëshkojë me të drejtën e shpagimit. Pyjetja e madhe është nëse Perëndia mund të marrë hak për krimet e njerëzve apo jo, por sa kohë do të rrijë pa ndarë drejtësi.

8-11. Të paurtët e qortuar. Shtypësit janë të egër dhe pa gjykim të shëndoshë. Theksohet që Zoti e di mirë gjithçka që ndodh në botë.

12-15. Justifikimi i besimtarëve. Lum njeriu të cilin Zoti e mëson. Ai do të ketë forcë në ditët e vështira dhe sigurohet për justifikimin përfundimtar.

16-23. Realizimi i gjykimit. Nga përvoja e tij me Perëndinë, psalmisti i përgjigjet pyetjes së vet: Perëndia sigurisht do të marrë hak për armikun e psalmistit.

PSALMI 95

Grishje për t'i dhënë lavdi Perëndisë

1 Ejani t'i këndoi Zotit,
t'i brohorisirn Perëndisë, Shpëtimtarit tonë.
2 T'i dalim para the falënderie,

t'i këndojmë këngë hareje!

3 Sepse Hyi i madhërishën! është

Mbret i madhërueshëm mbi të gjithë zotat!

4 Sepse në dorën e tii janë thellësitë e tokës,

të tijt janë edhe majat e maleve,

5 i tiji është deti – ai e krijoi,

duart e tij a e formuan tokën.

6 Ejani ta adhurojmë,; të biem përmbys para tii,

të biem në gjunjë para Zotit që na krijoi!

7 Sepse ai është Perëndia yne, ne jemi populli i kullosës

së tij,

grigja që ai ruan.

8 Oh sikur ta ndienit sot zërin e tij:

»Mos e bëni zemrën tuaj gur porsì në Meribë,

9 porsì në ditë të Masës në shkretëtirë,

kur etërit tuaj më vunë në sprovë:

më provuan megjithëse i kishin parë veprat e mia

10 Dyzet vjet më mërziti, ajo brezni

e thashë: 'Popull zemërlyhatshëm është ky,

11 që s'i njeh udhët e mia.'

Prandaj u përbetova ne hidhërimin tim:

“Askurrë s' do të hyjnë në prehjen time!”«

KOMENTARI

Ky psalm bashkon një himn me një profeci (d.m.th. një mesazh të frymëzuar nga Zoti) për adhurim në grup. Pjesa e dytë është lëndë mësimore drejtuar adhuruesve, që të mos bien në të njëjtat gabime si pasardhësit e tyre në shkretëtirë. Pjesa në formë himni ishte caktuar për një kortezh (kori levitik) që hyn në

Tempull. Siç duket, ishte i kompozuar për përdorim në Tempullin e Dytë. Zoti lavdërohet, sepse është Shpëtimtari (rr. 1), Bariu (rr. 6-7), dhe Ligjdhënësi (rr. 7-11) i Izraelit.

PSALMI 96

Zoti mbret dhe gjykatës

1 Këndoni Zotit një këngë te re!

Mbarë toka le t'i këndojë Zotit!

2 Këndojini Zotit, lavdërojeni emrin e tri,
shpalleni si një ditë për di të shpëtimin e tij

3 Kumtojeni ndër paganë lavdinë e tij,
ndër mbarë popujt mrekullitë e tij!

4 Sepse i madh është Zoti,
- tejet i denjë për t'u lavdëruar,
më i përfrikueshëm se të gjitha hyjnitë!

5 Një asgjë janë të gjithë zotat e paganëve,
kurse Zoti e ka krijuar qiellin.

6 Para tij është shkëlqimi e lavdia,
në Shenjtëroren e tij pushteti e bukuria!

7 Jepni Zotit, familjet e popujve, jepni Zotit nder e fuqi,

8 jepjani Zotit nderin e emrit të tij!

Kushtoni dhurata e hyni në pallatet e tij,

9 adhuroni Zotin në stoli të shenjtë!
Dridhu, o rruzull, para fytyrës së tij!

10 Shpallni ndër paganë: »Mbret është Zoti!«
Ai e mban botën që të mos shkatërrohet;
i gjykon popujt me drejtësi.

11 Galdo, o qiell! Gëzo, o tokë!
Le të buçasë deti me ç'ka në të,

12 le të gëzojë fusha me ç' gjendet në të,
le të gërthasin me hare lëndët e pyjeve,

13 para fytyrës së Zotit, sepse Ai po vjen,
sepse po vjen për të gjykuar tokën!
Do ta gjykojë botën me drejtësi,
do t'i gjykojë popujt me të vërtetën e tij.

KOMENTARI

Ata që gëzohen për shpëtimin që i'u dha Perëndia, duhet ta përhapin lajmin, duke nxitur botën për të lavdëruar namin e tij (d.m.th. Zotin dhe veprat e tij), të vijnë në praninë e tij në Tempull (shenjtëria = shenjtërore) nëpërmjet flijimit që ai kërkon, për ta adhuruar

Gjykoj do të thotë të vësh gjërat në rregull – qiellin, tokën dhe detin, dhe të sundosh mbi botën, sepse të gjitha janë të molepsura nga pasojat e mëkatit të njeriut.

PSALMI 97**Zoti ngadhënjën**

1 Zoti mbretëron! Le të galdojë toka,
le të gëzohen ishujt e shumtë!

2 Re e errësirë janë përreth tij,
e Drejta e Drejtësia themeli i fronit të tij.

3 Zjarri shkon përpara tij
dhe i djeg armiqtë e tij përreth.

4 Vetëtimat e tij e shndritin botën,
sheh toka e dridhet!

5 Para fytyrës së Zotit si dylli shkrihen malet,
para fytyrës së Zotit të mbarë botës!

6 Qiejt e shpallin drejtësinë e tij,
të gjithë popujt e shohin lavdinë e tij.

7 I mbuloftë turpi të gjithë idhujtarët,
të gjithë që mburren në trupore idhujsh!

Adhurojeni Atë të gjithë ju, o engjëjt e tij!

8 Dëgjoji Cioni e u gëzua, galduan bijat e Judës.
për shkak të gjyqeve të tua, o Zot.

9 Sepse ti je, o Zot, i Tejetlarti mbi mbarë tokën,
ti je tejet i lartë mbi të gjithë zotat.

10 Urreni të keqen ju që e doni Zotin,
Zoti e ruan shpirtin e të devotshmëve të vet,
i shpëton prej dorës së mëkatarit.

11 Lindi drita për të drejtin, e gëzimi për zemërmirët.
12 Gëzohuni, o të drejtë, në Zotin,
nderojeni emrin e tij të shenjtë.

KOMENTARI

Në këtë himn lavdërimi theksohen shpallja e mbretërisë së Zotit dhe pasojat eskatologjike..

1-6. Shfaqja e mbretit. Zoti është bërë mbret, d.m.th. mbretëria e Zotit ripohohet. Madhështia mbresëlënëse karakterizon ardhjen e mbretit. Megjithatë drejtësia e sundimit të Zotit është themeli i shfaqjes së tmerrshme të fuqisë.

7-12. Efekti mbi njerëzimin. Shfaqja e Zotit bën dallim midis popullit. Adhuresit e idhujve turpërohen kurse adhuresit e Zotit gëzohen. Ata që gëzohen për ardhjen e Zotit duhet ta duan, të urrejnë të keqën, të brohorasin dhe të falënderohen.

PSALMI 98

Zoti gjykatës i tokës

1 Psalm.

Këndoni Zotit një këngë të re,
sepse bëri vepra të mrekullueshme!
Ngadhënjëu me fuqi të së djathtës së vet,
me fuqi të krahut të vet të shenjtë.

2 Zoti e dëftoi shpëtimin e vet,
përpara paganëve e zbuloi drejtësinë e vet.

3 I ra ndër mend dashuria dhe besnikëria e vet
kundrejt shtëpisë së Izraelit.

Të gjitha skajet e botës e panë shpëtimin e Perëndisë sonë

4 Mbarë toka le t'i brohorisë Zotit,
le të gëzojë, të duartrokasë e të këndojë.

5 Këndoni Zotit me harpë,
me tinguj veglash muzikore,
6 me trumbetë e me zë të pipëzës së bririt,
brohoritni para fytyrës së Zotit, Mbret!

7 Le të buçasë deti me ç'ka në të, rruzulli me banuesit e
tij;

8 lumenjtë le të duartrokasin e malet le të gërthasin me
hare,

9 para Zotit që po vjen për të gjykuar tokën.

Ai do ta gjykojë botën me drejtësi
e popujt me maturi.

KOMENTARI

Në këtë psalm theksohet sërish mbretëria e Zotit. Mbarë natyra thirret të lavdërojë Zotin për çlirimin e saj nga kthetrat e mallkimit të shkaktuar nga rënien në mëkat e njeriut...

7-9 Në këto reshta del në dritë një element i ri. Perëndia mbreti vjen si gjyqtar (d.m.th. si sundimtar) i botës. Meqë i gjithë krijimi do të gjykohet (d.m.th. të vihet nën sundimin e drejtëpërdrejtë të Zotit) ky duhet të bashkohet në lavdërim.

Psalmi mbaron me parashikimin që gjykimi (d.m.th. sundimi i Zotit me anë të Mesisë) do të karakterizohet nga drejtësia dhe paanësia.

PSALMI 99

Zoti, mbret i drejtë e i shenjtë

1 Zoti mbretëron! Le të dridhen popujt! Rri mbi kerubinë, le të tundet toka!

2 I madh është Zoti në Cion, i madhërueshëm mbi të gjithë popujt.

3 Le ta lavdërojnë emrin tënd të madh e të tmerrshëm sepse është i shenjtë.

4 Mbreti i pushtetshëm e do të drejtën: ti ke caktuar ç'është e drejtë, gjyq e drejtësi ti i ushtron në Jakobin.

5 Lartësojeni Zotin, gyjin tonë, bini përmbys para shtrojës së këmbëve të tij, sepse është i shenjtë.

6 Moisiu e Aroni ndër priftërinjtë e tij, Samueli ndër ata që e thërrasin emrin e tij: e thërrisnin në ndihmë dhe Zoti i dëgjonte.

7 Nga shtylla e resë fliste me ta: i dëgjonin urdhërimet e tij edhe Ligjet që ua kishte dhënë.

8 O Zot, Perëndia ynë, ti i dëgjoje ata. O Perëndi, ti me ta ishe i durueshëm'

edhe pse i ndëshkoje fajet e tyre.
 9 Madhërojeni Zotin, Perëndinë tonë,
 adhuroni në malin e tij të shenjtë,
 sepse i shenjtë është Zoti, Perëndia ynë.

KOMENTARI

Në këtë psalm theksohet shenjtëria e Zotit, që është shprehje e natyrës së lartë të Perëndisë

1-3. Perëndia i shenjtë është i gjithëfuqishëm. Sundimi i Zotit ripohohet. Perëndia përfytyrohet si Zoti që rri në fron midis dy kerubimeve, vendi i shfaqjes së tij tokësore në Tempull. Një fronizim i tillë shkakton tmerr dhe dridhje ndër njerëzit dhe natyrën, por shkakton përplasjen e lavdërimit nga ana e besimtarëve.

4,5. Perëndia i shenjtë është i drejtë. Jo vetëm që Perëndia është i gjithëfuqishëm, por edhe i drejtë në vendimet e tij gjyqësore.

6,9. Perëndia i shenjtë është besnik dhe i besueshëm. Moisiu, Aroni, dhe Samueli citohen si ndërmjetësit e mëdhenj të së kaluarës. Ky është i vetmi vend ku Moisiun e quajnë prift, megjithëse ka ushtruar disa detyra priftërore dhe kishte hyrje të lirë në Tendën e shenjtë. Ndërsa Perëndia ua plotësoi lutjet këtyre gjigantëve shpirtërorë, e quajti të nevojshëm të ndëshkonte popullin e tij për të keqen e tij të vazhdueshme.

PSALMI 100

Grishje për të lavdëruar Zotin

1 *Psalm. Përfalënderim.*

2 Toka mbarë le t'i brohoritë Zotit, shërbeni Zotit me hare,

dilni para tij me brohoritje!

3 Dijeni mirë se vetëm Zoti është Perëndi:

Ai na krijoi e atij i përkasim:

jemi populli i tij dhe delet e kullosës së tij.

4 Hyni nëpër dyert e tij duke i dhënë lavdi

hyni në treme të tij e këndojini himne,

lavdërojeni e madhërojeni emrin e tij!

5 Sepse i mirë është Zoti,

e amshuar dashuria e tij,

nga breznia në brezni besnikëria e tij.

KOMENTARI

Ky psalm do të jetë përdorur si himn i kënduar në kortezh dhe, siç duket, u shkrua për këtë qëllim..

rr. 1-3 Thirrja e parë për adhurim do të jetë dhënë nga kori jashtë zonës së Tempullit. Kushti i domosdoshëm për një adhurim të tillë është njohja e Zotit (d.m.th. një fe vepruese). Kjo përfshin njohjen që Zoti është Perëndia, Krijimtar dhe Bariu i popullit të tij. Kjo njohje me radhë ngjall lavdërim të gëzueshëm, brohoritje dhe këndim..

rr. 4-5 Thirrja a dytë për adhurim do të ketë qenë ftesë drejtuar korit brenda zonës së Tempullit. Ndërsa adhuruesit u afrohen portave, i ftojnë të hyjnë me brohoritje dhe pastaj në oborret e Tempullit. Elemente të domosdoshme të mëtejshme të adhurimit identifikohen si falënderim, lavdërim për mirësinë, dashurinë dhe besnikërinë e tij, si dhe lutje.

PSALMI 101**Pasqyra e sunduesit të mirë
1 I Davidit. Psalm.**

- Dua të këndoj dashurinë e drejtësinë,
për nderin tend, o Zot, do t'i bie muzikës!
- 2 Do të përparoj në udhën e pafajësisë: kur do të vish ti tek unë?
Do të jetoj në pastërtinë e zemrës sime, brenda shtëpisë sime.
- 3 S' do të vë para syve të mi asnjë padrejtësi,
e urrej njeriun që vepron të keqen: nuk do të qëndrojë ngjat meje.
- 4 Zemra e keqe do të jetë larg meje, keqbërësin s' dua ta njoh.
- 5 Atë që fshehtas i shpifet të afërmit të vet unë do ta zhbij.
Mendjemadhin dhe krenarin nuk do ta duroj.
- 6 I kam sytë mbi të, drejtët e vendit që të banojnë bashkë me mua,
ai që ecën udhës së pafajësisë, do të jetë shërbëtori im.
- 7 Nuk do të banojë brenda shtëpisë sime ai që gënjen,
ai që flet rrena nuk do të qëndrojë para syve të mi.
- 8 Çdo mëngjes do të shfaros keqbërësit e vendit,
do t'i zhbij prej qytetit të Zotit të gjithë ata që bëjnë paudhësi.

KOMENTARI

Manifesti mbretëror

Ky është psalm mbretëror në të cilin mbreti betohet për shërbimin e Atij të cilit është nënmbret (rr. 8). Quhet edhe “pasqyra e mbretit”, sepse mban idealin sfidues për çdokush në pozitën e udhëheqësisë, qoftë civile (krhs. Rom. 13, 1-7) qoftë kishtarë (krhs. 1 Pjet. 5, 1-4).

Tema e dyfishtë (v. i)

Besëlidhja davidike i jepte mbretit privilegje të mëdha (krhs. 89, 19-37), por i impononte gjithashtu përgjegjësi të rëndë si p.sh. besnikëria personale (dashuri) ndaj besëlidhjes dhe ndaj drejtësisë shoqërore (krhs. 1 Mbr. 9, 4).

Besnikëria personale (rr. 2-4)

Mbreti premton të përkrahë integritet moral si parimi kryesor i jetës. Motivacioni i tij është që të përjetojë kështu praninë e Perëndisë me bekim (krhs. Gjn 14, 23). Mbreti heq dorë nga çdo qëllim të pabesë dhe pohon se do të qëndrojë larg çdo pabesie. Ai dë të përkrahë jo të keqën, por standarde të drejta në vendime të tij gjyqësore.

Drejtësia shoqërore (rr. 5-8)

Mbreti, si kryetar i gjyqit, kishte për detyrim të përkrahte ligjet e besëlidhjes. Këtë detyrim ai e merr përsipër me qejf. Shpifjet do të shpallen të paligjshme. Mendjemëdhenjve, që nuk meritonin pozitën e tyre në shoqëri, do t’u tregohet vendi. Qëllimi i tij ishte një shoqëri e paanshme, ku shpërbleza do të varet nga meritat. Anëtarët e administratës së tij do të ishin njerëz të drejtë dhe me besim të vërtetë te Zoti. Tradhtarët dhe gënjeshtarët nuk do të kishin hyrje në oborr as nuk do të mbanin gjatë pozitën e tyre. Te sesionet mëngjesore e gjyqit në Jerusalem, ku mbreti do

të zgjidhte proceset më të vështira, mbreti premton ta shpëtojë vendin nga kriminelët (krhs. 2 Sam. 15, 2 + Jer. 21, 12).

PSALMI 102

Lutja në fatkeqësi

1 Lutja e të mjerit të rënë ngushtë që derdh ankthin e vet para Zotit.

2 O Zot, dëgjoje lutjen time
e britma ime le të mbërrijë tek ti.

3 Mos e fsheh fytyrën tënde para meje
në ditën time të vështirë,
prire veshin tënd drejt meje:
kurdo të të thërras më dëgjo shpejt!

4 Sepse ditët e mi po zhduken si tymi,
e eshtrat e mia po digjen si zjarri.

5 Zemra po më thahet si bari i kositur
e po harroj të ha edhe bukën time.

6 Prej gjëmave të mia të mëdha
u bëra asht e lëkurë.

7 U bëra i ngjashëm me pelikanin në shkretëtirë,
u bëra pors i kukuvajka në rrënoja.

8 Rri zgjuar e rënkoj
porsi trumcaku qyqevetëm mbi pullaz.

9 Gjithë ditën më fyejnë armiqtë e mi,

kur më zemërohen,
e nëmin emrin tim.
10 Ha hi porsi bukël
e pijen time e përziej me lot.

11 Për shkak të zemëri mit të felgrimit tënd,
sepse më lartësove e më mposhte.

12 Ditët e miajanë porsi hija e zgjatur
e unë u thava porsi bari.

13 Por ti, o Zot, qëndron për amshim,
prej breznie në brezni emri yt.

14 Ngrihu, ki dhembje për Cionin:
ka ardhur koha të kesh mëshirë për të
– shi tani është koha!

15 Sepse shërbëtorët e tu i duan gurët e. tij
e u dhembet edhe pluhuri i tij.

16 Paganët do ta druajnë emrin tënd, o Zot, të gjithë
mbretërit e tokës lavdinë tënde.

17 Sepse Zoti e ndërtoi Cionin, u dëftua në lavdinë e vet.

18 E mori parasysh lutjen e të vobektëve
dhe nuk e përbuzi uratën e tyre.

19 Le të shënohet kjo për brezninë e ardhshme
dhe populli që do të vijë le ta lavdërojë Zotin.

20 Sepse Zoti shikon nga Shenjtëroja e vet e lartë,

nga qielli ai vrojton mbi tokë,
21 për t'i dëgjuar ofshamat e robërve,
për t'i shpëtuar të dënuarit me vdekje,

22 që në Cion të shpallet emri i Zotit e lavdia e tij në
Jerusalem,
23 kur të mblidhen së bashku popujt e mbrëtëritë për t'u
vënë në shërbimin e Zotit.

24 Udhës m'i shpenzove fuqi të e mia,
ditët m'i shkurtove.
Do të them: »Perëndia im,

25 mos më rrëmbe në gjysmën e ditëve të mia, vitet e tua
zgjasin nga brezdia në brezni.

26 Qysh në fillim themelove Tokën
edhe qielli është vepër e duarve të tua.

27 Këto do të mbarojnë ndërsa ti mbetesh për amshim,
gjithçka do të vjetrohët si petku.

Ti i shndërron porsitë të veshmet e zhduken,

28 kurse ti i vetnii je gjithmonë i njejtë,
- vitet e tua kurrë nuk kanë të sosur.

29 Fëmijët e shërbëtorëve të tu; do të jetojnë në paqe,
pasardhësit e tyre do të qëndrojnë para teje.«

KOMENTARI

Plotësimi i lutjes

S'ka lutje pa përgjigje.

Nganjëherë përgjigjja është thjest 'Jo', kur, në dritën e urtësisë së përsosur, lutja jonë është marrëzi. Shpeshherë përgjigjja është 'Ende jo', kur orari ynë dhe ai i Zotit nuk pajtohen. Po ta dinte, lutja e Elijahut për të vdekur (1 Mbr. 19,4) pranohej në qiell me buzëqeshje dhe me fjalët 'Mos u bëj budalla!. Aspak nuk do të vdesësh!' Lutja e psalmistit që të jetojë në tokë për të parë atë që dëshironte përgjigjet me 'Jo'. (rr. 23-24); besimi i tij që të ketë arritur koha për plotësimin e lutjes së tij përgjigjet me 'Ende jo' (rr. 13); dhe lutja e tij për Cionin përgjigjet me 'Mos u bëj budalla!.

Nuk e dimë se kush ishte autori i psalmit as kur jetonte, Shumë komentatorë interpretojnë shprehjet "gurë dhe pluhur". (rr. 14) si aludim për shkatërrimin e Jerusalemit nga babilonasit dhe e vendosin psalmin në kohën e mërgimit, por sa dimë mërgimtarët në Babiloni nuk ishin robër, as nuk ishin nën dënimin me vdekje. (rr. 21) – në fakt, rrethanat ishin jo fortë të këqija (Jer. 29) dhe në fund vetëm një pakicë dëshironte të ktheheshin në atdhe. (Ezr. 1). Prandaj e kemi të vështirë ta shohim autorin midis të mërguarve, dhe më lehtë ta vendosim në një krizë të mëparshme, kur qyteti pësoi shumë dëmtime kur shihte se si bashkëqytetarët e tij u morën në robëri (ndoshta pas një inkursioni të mbretërisë veriore?). Sidoqoftë, kur e përballte një vdekje të parakohshme. (rr. 23-24), kur dëshironte ta shihte Cionin me lavdi të plotë, të rimëkëmbur dhe si qendra e botës, e bëri këtë lutje të madhe (rr. 12-22).

PSALMI 103**Perëndia është dashuri**

1 *I Davidit.*

Lavdëroje, shpirti im Zotin,
dhe krejt qenia ime emrin e tij të shenjtë.

2 Lavdëroje, shpirti im Zotin,
e mos i harro bamirësitë e tij.

3 Ai i fal të gjitha fajësitë e tua,
Ai i shëron të gjitha sëmundjet, e tua;

4 Ai ta shpëton jetën prej varrit,
ai të kurorëzon me mirësi e dashuri,

5 me të mira t' i mbush vitet e tua:
do të përtërihet si e shqiponjës renia jote.

6 Zoti bën veç vepra të mira,
u jep të drejtën atyre që pësojnë padrejtësi.

7 Synimet e veta ia zbuloi Moisiut,
izraelitëve veprat e veta.

8 Zoti është i mirë e i mëshirshëm,
i ngadalshëm në zemërim e shumë i dashur.

9 Nuk zemërohet gjithherë
as s' e mban hidhërimin përjetë të jetës.

10 Nuk sillet me ne sipas mëkateve tona
as nuk na shpague sipas të këqijave tona.

11 Sepse sa është lartësia e qiellit mbi tokë,
 aq e madhe është mëshira e tij ndaj atyre që i druai
 12 Sa është lindja larg perëndimit
 aq larg i tret prej nesh fajet tona.

13 Sikurse baba ka dhembje për fëmijët e vet,
 ashtu Zoti ka dhembje për ata që e druajnë.

14 Sepse mirë e di si jemi të përbërë
 s'e harron se ne jemi pluhur,
 15 Njeriu! Ditët e tij a janë porsì bari:
 porsì lulja e fushës lulëzon,
 16 sa e prek era e më s'është,
 më s'e kujton as vendi i vet.

17 Vetëm dashuria e Zotit është prej amshimit e në
 amshim mbi ata që e druajnë
 18 dhe drejtësia e tij mbi bijtë e njerëzve,
 mbi ata që e mbajnë besëlidhjen e tij dhe i kujtojnë
 urdhërimet e tij për t'i zbatuar.

19 Zoti e forcoi fronin e vet në qiell,
 mbretëria e tij mbizotëron të gjithë.

20 Lavdërojeni Zotin, të gjithë engjëjt e tij, ju të fortët nga
 fuqia, që kryeni urdhrat e tii, duke i dëgjuar urdhrat e tii.
 21 Lavdërojeni Zotin, të gjitha ushtritë e tij,
 shërbëtorët e tij që zbatoni vullnetin e tij.
 22 Lavdërojeni Zotin, të gjitha veprat e Zotit,
 në çdo vend të sundimit të tij!

Shpirti im, lavdëroje Zotin!

KOMENTARI

Ky psalm mund të klasifikohet si falënderim vetjak. Ndjesa është gjithashtu temë e rëndësishme në këtë psalm. Por të gjithë këto shpallen në kontekst të kujdesit atëror të Zotit dhe sundimit të tij të gjithëfuqishëm. Atributet e tij thelbësore theksohen: hiri, mëshira, qëndrueshmëria, ndjesa dhe atësia, por, para së gjithash, dashuria, angazhim dhe besnikëria e tij ndaj nesh.

rr. 1 Bekoj do të thotë në thelb “lavdëroj”. Shpirti im do të thotë Mbarë qenia ime, e jo ndonjë pjesë të veçantë të personalitetit tim.

rr. 7-8 dhe 14-16 flasin për natyrën e mëshirshme të Perëndisë. Mëshira a tij do të thotë se ai është emocionalisht i prekur prej nesh, kurse hiri i tij do të thotë se ai na e zgjat dorën me gjithë dëshimet tona. Ai është gjithashtu i ngadaltë për t'u zemëruar: ai na i fal fajët, shëron, kënaq dhe rimëkëmb.

vg 9-10 dhe 12-13 janë aludime për mëkatet, d.m.th. ato gjëra që dëmtojnë shoqërinë e Zotit me ne, por jo marrëdhëniet me ne, që nuk mund të anulohen.

1) *fajet* – prishja e natyrës sonë të brendshme (mëkati i lindur)

2) *mëkatet* – rebelim i hapur kundër vullnetit të Perëndisë.

rr. 19-22 Cila është reagimi i duhur ndaj Atij që sundon mbi gjithçka? Përgjigjja e familjes qiellore të Perëndisë është: Zbatojmë atë që dëshiron Ai.

PSALMI 104**Himn Perëndisë Krijues**

1 Lavdëroje, shpirti im, Zotin!

O Zot, Perëndia im, sa i madh je!
i veshur me madhëri e me bukuri,
2 i mbështjellë me dritë porsì me petk!
E ngreh qiellin porsì tendë,

3 mbi ujëra ndërton banesat e tua.
Retë i bëre kaffocë për vete, ecën mbi krahët e erës!

4Erërat i bën lajmëtarë të tu, zjarrin zharitës shërbëtorë të
tu.
5 Tokën e vendose mbi qëndrueshmërinë e saj,
nuk do të lëkundet në shekuj të shekujve.

6 E mbulove si me petk me ujërat e humnerave,
majat e maleve i mbulonin ujërat:

7 Ti u kërcënehesh e ato tërhiqeni dridhen nga zëri i
bubullimës sate:

8 ngjiten në male, zbresin në lugina drejt vendit që ti u
cakton:

9 u ke vënë cakun që s'guxojnë ta kalojnë, ishte persëri të
mos e mbulojnë tokën.

10 Burimet ti i kthen ne përrenj rrjedhin përmidis malesh;

11 ato ngijnë ujë të gjitha kafshët e pyllit, ua shuajnë etjen gomarëve të egër.

12 Përskej tyre banojnë zogjtë e ajrit, gem më gem ia thonë këngës së vet.

13 Ti i ujit malet nga pallatet e tua, toka ngihet me frytet e duarve të tua.

14 Ti bën të mbijë bar për kafshë, bimë të tjera të nevojshme për njeriun, për të nxjerrë prej tokës bukën

15 e verën që gëzon zemrën e njeriut, që me vaj ta lyejë fytyrën e që buka t'ia kërkhndezë njeriut zemrën.

16 Ngihen me ushqim lëndët e Zotit, cedrat e Libanit që ai vetë i mbolli.

17 Në ta trumcakët i ndërtojnë çerdhet, lejlekët banesën e bëjnë në majat e tyre.

18 Malet e larta strehim u japin shutave, e shpellat vjedullave banesën.

19 Për të shënuar stinët ka krijuar hënën edhe diellin që e njeh përendimin e vet.

20 Shtrin errësirën e bëhet natë: nëpër të enden egërsirat e pyllit.

21 Këlyshët e luanit ulërojnë pas presë e Perëndisë i kërkojnë ushqim për vete.

22 Kur lind dielli ata tërhiqen e struken në strofujt e vet.

23 Atëherë del njeriu për të vepruar për t'i kryer punët deri në mbrëmje.

24 Sa të shumta janë, o Zot, veprat e tua! Të gjitha i ke bërë me urti të madhe: plot është toka me krijesat e tua.

25 Ja, këtu deti i madh, i hapët e i gjerë, atje zvarranikë saqë numri s'u dihet, kafshë të vogla të përziera me të mëdha!

26 Nëpër të kalojnë anijet,
Leviatani që ti e krijove për të luajtur me të!

27 Të gjitha këto presin me shpresë që t'u japësh ushqim në kohën e duhur.

28 Po u dhe ti ato mbledhin, kur ti e hap dorën tënde, mbushen me një mijë të mira

29 Po e fshehe ti fytyrën, ato trazohen,
po ua more frymën, ato ngordhin
dhe kthehen në pluhur përsëri.

30 Po e dërgove frymën tënde, përsëri përtërihen
dhe e rinon fytyrën e dheut.

31 E amshueshme qoftë lavdia e Zotit,
u gëzoftë Zoti në veprat e veta!

32 E shikon tokën dhe e bën të dridhet,
i prek malet e i bën të tymoje,.

33 Do t'i këndoje Zotit në jetën time,
do ta lavdëroj Perëndinë derisa të jem gjallë.

34 I pëlqeftë Zotit kënga ime,
kënaqjen time e kam vënë në Zotin!

35 U zhdukshin mëkatarët nga faqja e dheut
e bakëqinj askurrë më mos pastë mbi tokë!

Lavdëroje, shpirti im, Zotin.,

KOMENTARI

Kjo poemë e bukur është himn lavdërimi kushtuar gjatë adhurimit të përbashkët në Tempull, meditimi i psalmistit rreth fuqisë së madhe dhe kujdesit të dashur të Zotit për krijesën e tij. Si i tillë, ky meditim pasqyron temat e kapitujve të parë të Zanafillës.

Theksohet që forcat e natyrës janë vetëm puthadorët e Zotit në shërbim të madhështisë së tij. Dielli dhe nëna nuk janë perënditë, siç mendonin kombet e fqinjë të Izraelit, por orat e Zotit dhe kalendari për gjallesat e tij..

PSALMI 105

Historia e mrekullueshme e Izraelit

HALELUJA!

Lavdëroni Zotin e thirreni në ndihmë emrin e tij
shpallni midis popujsh veprat e madhërueshme të tij

2 Këndoni, luani në vegla muzikore për nder të tij,
kujtoni të gjitha mrekullitë e tij!

3 Mburruni me emrin e tij të shenjtë:
le të galdojë zemra e atyre që e kërkojnë Zotin.

4 Kërkojeni Zotin dhe fuqinë e tij,
kërkoje gjithmonë fytyrën e tij!

5 T'iu bien në mend mrekullitë që bëri,
mrekullitë e tij dhe gjyqet e gojës së tij:

6 ju fara e Abrahamit, shërbëtorët e tij,
ju, o bijtë e Jakobit, të zgjedhurit e tij!

7 Ai është Zoti, Perëndia ynë,
mbi mbarë tokën gjyqet e tij a!

8 Ai s'e harron Besëlidhjen e vet askurrë,
premtimin që ua bëri një mijë breznive,

9 lidhjen që e bëri me Abrahamin
dhe përbedmin që i bëri Izakut.

10 Premdmin e vet e ngriti ligj për Jakobin,
për Izraelin ë bëri testament të përhershëm

11 kur tha: »Ty do të ta jap tokën Kanaan,
për pronë tuajën që ju ra me short!«

12 Kur ende ishin pak me numër,

krejtësisht të paktë dhe endacakë në të,

13 kur kalonin nga një komb në një tjetër,
nga një mbretëri në një popull tjetër,

14 nuk lejoi njeri t'u bëjë keq

dhe i ndëshkoi mbretërit për shkak të tyre:

15 »Mos i prekni të shuguruarit e mi,

mos u bëni asnjë të keqe profetëve të mi!«

16 Ai e grishi urinë përmbi dhe,

ua sosi të gjitha rezervat e bukës.

17 Para tyre dërgoi një njeri:

Jozefin e shitur skllav.

18 I qitën në pranga këmbët e tij,

në qafë i mbërthyen hekurat,

19 ditët kalonin e profecia iu plotësua,

fjala e Zotit i dha të drejtë.

20 Mbreti urdhëroi të zgjidhej prej prangash,
kryetari i popujve, e çliroi.

21 E bëri zot shtëpie të shtëpisë së vet,

kujdestar përmbi pasurinë e vet,

22 princat e mbretit t'i mësonte sipas urtisë së vet,
pleqtë e tij t'i udhëzonte në urti.

23 Atëherë Izraeli hyri në Egjipt,

Jakobi banoi në tokën e Kamit,

24 Zoti bëri të shtohet populli i vet,

e bëri më të forte se armiqtë e tij.

25 Ua shndërroi zemrën ta urrenin popullin e tij,
të silleshin me dredhi kundër shërbëtorëve të tij.

26 Atëherë dërgoi Moisiun, shërbëtorin e vet,
edhe Aronin, të zgjedhurin e vet.

27 Me anë të tyre bëri mrekullitë e veta,

shenja të mrekullueshme në tokën e Kamit.

28 Çoi errësirën dhe u bë terr,

por ata kundërshtuan fjalët e tij.

29 Ujët e tyre e shndërroi në gjak dhe i mbyti peshqit e
tyre.

30 Vendin ua mbuluan bretkosat,

depërtuan edhe në pallatet e mbretit.

31 Tha Zoti dhe i mbuluan shema mizash,

mushkonjat ua mbuluan krejt vendin.

32 Në vend të shiut u dërgoi breshër,

rrufe të zjarra mbi vendin e tyre.

33 U copëtoi vreshta dhe fiq,
ua theu drurët në tokën e tyre.

34 Ai urdhëroi dhe ia behën karkalecat,
e me ta edhe veme të panjehura.

35 Ua hëngrën të gjitha bimët e tokës,
i përpinë të gjitha prodhimet e tokës së tyre.

36 I vrau të gjithë të parëlindurit e vendit të tyre,
frytin e parë të fuqisë lindëse të tyre.

37 I nxori izraelitët me argjend e ar,
në fiset e tyre nuk kishte asnjë të sëmurë.

38 U gëzua Egjipti kur ata e lëshuan vendin,
sepse i kishte tmerruar frika e tyre.

39 E shtriu renë për t'i mbrojtur
edhe zjarrin për t'u bërë dritë natën.

40 U lutën dhe u dërgoi shkurta
dhe i ngiu me bukë të ardhur prej qiellit.

41 Çau shkëmbin e buroi uji,
rrodhën lumenj nëpër shkretëtirë.

42 Sepse i ra ndër mend fjala e vet e shenjtë
që ia dha Abrahamit, shërbëtorit të vet.

43 E nxori popullin e vet me brohori
plot gëzim të zgjedhurit e vet.

44 Ua dha tokat e paganëve trashëguan djersën e popujve
të ndryshëm,

45 për t'i mbajtur urdhërimet e tij e për t'i ruajtur ligjet e tij.

HALELUJA!

KOMENTARI

Populli i Perëndisë është mbledhur për ta adhuruar. Ky psalm është menduar për të shërbyer si mjet për adhurimin e tyre. Tema kryesore është besnikëria e Zotit ndaj premtimeve të tij. (rr. 8, 42). Historia e shpëtimit të Izraelit rishikohet, kështu që forcohet mësimi shpirtëror që Zoti është plotësisht i besueshëm dhe i aftë për të shpëtuar dhe të mbajtur ata që kanë besim tek Ai.

Jashtë kufijve të Izraelit gjendeshin kombet pagane, por Izrael ishte enklavë ku nderohej Zoti. Gjatë këtij kulti jepeshin dëshmi për shembujt e shpëtimit të Izraelit në të kaluarën. Festoheshin plotësimet e premtimeve të Zotit, posaçërisht ato rreth tokës së premtuar. Citohej para se gjithash çlirimi nga robëria në Egjipt, kur faraoni u desh të pranonte se Izraeli ishte komb i veçantë nën mbrojtjen e Zotit. E atëherë, cili duhet të jetë reagimi i duhur ndaj plotësimit të këtyre premtimeve? Adhurim fetar (rr. 1-6) dhe dëgjesa morale.

PSALMI 106

Rrëfim kombëtar

HALELUJA!

Lavdëroni Zotin, sepse është i mirë,
sepse e amshuar është dashuria e tij!

2 Kush mund t'i tregojë veprat e madhërueshme të të bëjë të jehojnë të gjitha lavdet e tij?

3 Lum ata që i mbajnë urdhërimet e tij a dhe veprojnë me drejtësi në çdo kohë.

4 Na kujto, o Zot, në mirësinë tënde ndaj popullit të na eja në pasi me shëlbimin tënd

5 që ta shijojmë fatin e të zgjedhurve të tu, të gëzohemi në gëzimin e popullit tënd, të mburremi me trashëgimin tënd.

6 Mëkatuam, po, porsi etërit tanë, padrejtësisht vepruam, bëmë të keqen.

7 Etërit tanë në Egjipt

nuk i kuptuan mrckullitë e tua,
nuk e kujtuan përdëllimin tënd të madh,
e të hidhëruan pranë detit, pranë Detit të Kuq.

8 Por Zoti i shpëtoi për nder të emrit të vet, për ta bërë të njohur pushtetin e vet.

9 Zoti iu kërcënua Detit të Kuq e ky u tha dhe i kaloi nëpër det si nëpër shkretëtirë.

10 I shpëtoi prej duarve të armiqve,
i shpërbleu prej kthetrave të urryesve.

11 mbyd me ujë ata që i mundonin: asnjë prej tyre nuk shpëtoi!

12 Atëherë u besuan fjalëve të tij dhe i kënduan lavdet e tij.

13 Por shpejt i harruan veprat e tij
e nuk u mbështetën në synimet e tij.

14 U leshquan për së tepërmi në shkretëtirë
dhe e ngucën Perëndinë në vend të parë.

15 Ua plotësoi kërkesën e tyre
ua ngiu grykësinë e tyre.

16 Smirë i morën Moisiut, në tëbanishtë
edhe Aronit, shenjtit të Zotit.

17 U hap toka dhe e përpiu Datanin
e groposi turmën e Abiramit.

18 U ndez zjarri në mbledhjen e tyre edhe flaka i dogji
mëkatarët.

19 E punuan një viç në Horeb,
adhuruan një shtatore metali.

20 E ndërruan Perëndinë e tyre
me truporen e një kau që ha sanë.

21 Harruan Perëndinë që i shpëtoi,
që bëri mrekulli në Egjipt,

22 punë të madhërishme në tokën e Kamit,
emnesë në Detin e Kuq.

23 Mendoj Perëndia farën t'ua shuante,
por iu lut Moisiu, i zgjedhuri i tij,
ndërmjetësoi përpara fytyrës së tij
për ta ngurruar zemërimin e tij,
e dëgjoi e nuk ua treti farën.

24 Nuk shfaqën kujdes për tokën e dëshirueshme,
nuk i besuan premtimit të tij.

25 Nynykatën në çadrat e tyre,
nuk i vinin veshin zërit të Zotit.

26 Zoti e ngjiti dorën e vet mbi ta, për t'i shtruar rrah në
shkretëtirë,

27 se do t'i shpërndante trashëgimtarët e tyre për të
kërkuar vend më vend dherat e huaja.

28 Iu kushtuan hyjit Baalpegor,
hëngrën flitë e të vdekurve.

29 E zemëruan Zotin me veprat e veta të këqija e mbi ta u
sul plaga.

30 Flakëroi Pinhasi e bëri gjyq e atëherë u zhduk plaga.

31 E iu çmua kjo vepër drejtësi brez pas brezi për
amshim.

32 Prapë e hidhëruan tek ujërat Meriba,
për shkak të tyre ishte ndëshkuar edhe Moisiu!

33 sepse shpirtin aq fort ia helmuan
saqë foli marrëzisht me buzë të veta.

34 Ata nuk i zhdukën popujt

sikurse Zoti u kishte urdhëruar,

35 por u përzier me paganë dhe i mësuan veprat e tyre.

36 U shërbyen idhujve të tyre dhe këta u bënë kurth për
ta.

31 U flijuan djemtë e vet e vajzat e veta djajve.

38 Derdhën gjakun e pafajshëm,

gjakun e djemve dhe të vajzave të veta duke na bërë
therore idhujve të Kanaanit, vendi mbarë ishte njollosur
prej gjakut.

39 U përlyen me veprat e veta,
nuk ia mbajtën besnikërinë me vepra të këqija.

40 Flakë u ndez Zoti me hidhërîm kundër popullit të vet iu
ndy ndër sy trashëgimî i vet.

41 I lëshoi në duar të paganëve:
i sunduan ata që i urrenin.

42 Armiqtë e tyre i pëmdoqën
dhe qenë mposhtur nën kthetrat e tyre.

43 Shpeshherë Ai i shpëtonte,
por ata e hidhëronin me synimet e tyre
dhe njolloseshin më zi në poshtërsitë e veta.

44 Përsëri i priri sytë e vet mbi ta kur e dëgjoji uratën e
tyre.

45 I ra ndër mend Besëlidhia me ta
dhe i erdhi keq sipas përdëllimit të vet të madh.

46 Bëri të gjejnë mëshirë tek ata që i mbanin në robëri.

47 Na shpëto, o Zot, Perëndia ynë, dhe na bashko prej
popujve paganë që ta lavdërojmë emrin tënd të shenjtë e
të mburremi me lavdinë tënde!

48 Lavdëroftë Zoti, Perëndia i Izraelit,
nga shekulli në shekull!

Mbarë populli le të thotë: Amen! Amen!

KOMENTARI

Kryesisht te psalmi 106 rishikohet historia e Izraelit nga Dalja nga Egjipti (rr. 6-12, Dal. 14) në shkretëtirë (rr. 13-18, Nr. 11,4-34; 16), në Sinai (rr. 19-23, Dal. 32,1-6, 9-14), më tej deri në kufijtë e Kanaanit (rr. 24-27, Nr. 14), ndodhitë te Baal-Peori dhe te Meriba (rr. 28-33, Nr. 25,1-15; 20,2-13) dhe më në fund hyrja në Tokën e Premtuar (rr. 34-38, Gjyq. 1,21, 27-36; 3,3, 5; etc.).

Është një tregim i trishtuar për mëkatin (rr. 6), pakujdesje dhe harresë (7, 21), përgjigje pozitive jetëshkurtër (12-13), rehatidashje (14), moskënaqësi me furnizimet e Perëndisë (rr. 16), idhujtari (rr. 19), mosbindje (rr. 24-25), dështim për të trashëguar (26), pabesë (28), provokim (32), kompromis (rr. 34-35) dhe korrupsion fetar (rr. 37-39). Por (e e theksuar më fortë) nga ana e Zotit është historia e shpëtimit me fuqinë e Tij (rr. 8-11), përgatitje për të pasur mëshirë (rr. 23, 30), shtyrje e vazhduar të gjykitimit të merituar (rr. 40-43), dëgjim i mëshirshëm i thirrjeve për ndihmë (rr. 44), dhe besnikëri ndaj besëlidhjes dhe dashuri (rr. 45). Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për pabesinë tonë dhe besnikërinë e Zotit tonë. Në të gjitha këto, Izraeli duhet të kuptojë se besëlidhja vë në detyrime adhuruesit dhe kërkon një mënyrë tjetër jetese.

LIBRI V (Ps 107-150)**PSALMI 107****Perëndia e shpëton njeriun nga çdo rrezik**

HALELUJA!

Lavdërojeni Zotin sepse është i mirë,
sepse e amshueshme është dashuria e tij.

2 Le të thonë të shpërblyerit prej Zotit,
që i çliroi nga kthetrat e armikut
3 dhe i bashkoi nga vendet e ndryshme nga ku lind dielli e
ku perëndon,
nga veriu e nga ana e detit.

4 U endën në shkretëtirë, në vend të thatë,
nuk e gjetën udhën drejt qytetit të banimit.

5 Të uritur e të etur
shpirti i tyre ishte mekur në ta!

6 Të ngushtuar i lëshuan kushtrimin Zotit
dhe Ai i shpëtoi nga vështirësitë e tyre.

7 Ai i qiti në udhën e drejtë që të shkonin në qytetin e
banimit.

8 Le t'ia dinë për nder Zotit për dashurinë e tij,
për mrekullitë që u bëri bijve të njerëzve,

9 që ngiu shpirtin e të eturit,
e mbushi me të mira shpirtin e të uriturit.

10 Banonin në errësirë e në hijen e vdekjes,
të lidhur në mjerim edhe në pranga,

11 sepse kishin kundërshtuar urdhrin e Perëndisë
dhe kishin përbuzur këshillën e të Tejetlartit.

12 Prandaj zemrën ua mposhti me vuajtje,
rrezoheshin e s'kishte kush t'i ndihmonte.

13 Të ngushtuar i lëshuan kushtrimin Zoti
dhe Ai i shpëtoi nga vështirësitë e tyre.

14 I nxori nga errësira dhe nga hija e vlekjes
e i këputi zinxhirët e tyre.

15 Le ta lëvdojnë Zotin për shkak të përdëllimit të tij,
për mrekullitë e tij ndaj bijve të njerëzve,

16 sepse i theu dyert e bronzta dhe i këputi shulat e
hekurt.

17 Të marrë për shkak të jetës së paudhë,
të mjeruar pse ndoqën udhën e mëkatit,

18 shpirtit të tyre iu neverit çdo ushqim,
arritën në dyert e vdekjes.

19 Atëherë të ngushtuar e thirrën në ndihmë Zotin,
Ai i çliroi nga vështirësitë e tyre.

20 E dërgoi fjalën e vet dhe i shëroi, i shpëtoi nga gropa e
varrit.

21 Le ta lëvdojnë Zotin për shkak të mëshirës të tij,
për mrekullitë e tij a ndaj bijve të njerëzve,

22 le t'i flijojnë flinë e lavdit,

me hare le t'i shpallin veprat e tij!

23 Ata që me anije lundruan deteve
 që nëpër ujëra të mëdha të bërin tregti,
 24 ata i panë veprat e Zotit,
 mrekullitë, e tij në thellësitë e detit.

25 Ai urdhëroi dhe u ngrit era e stuhisë, lart u ngritën valet
 e stuhishme.

26 Ngrihen deri në qiell,
 zbresin deri në pështjerrë:
 shpirti i tyre mekej prej së keqes.
 27 Çohu e rrëzohu si të ishin të dehur,
 asgjë s'i ndihmonte mjeshtëria e tyre.

28 Atëherë të ngushtuar e thirrën në ndihmë Zotin,
 Ai i çliroi nga vështirësitë e tyre.

29 Stuhinë e shndërroi në pui
 e valet e detit e shuan gjëmën e vet.
 30 Iu gëzuan qetësimit të valëve,
 ai i qiti në portin e dëshiruar.
 31 Le ta lëvdojnë Zotin për shkak të përdëllimit të tij,
 për mrekullitë e tij ndaj bijve të njerëzve,
 32 le ta madhërojnë në kuvendin e popullit,
 le ta lavdërojnë në kuvendin e pleqve.
 33 Ai i shndërroi lumenjtë në shkretëtirë,
 ne vende të thata burimet e ujërave,

34 tokën e pëlleshme në kënetë

për shkak të veprave të këqija të banorëve.
 35 Shndërroi shkretëtirën në liqen me ujëra,
 tokën e thatë e begatoi me buri me të gjalla.

36 Aty i vendosi njerëzit e munduar nga uria
 dhe themeluan qytetin e banimit.

37 Mbollën arat e vunë vreshtat
 dhe u prodhuan fryte me shumicë.

38 Zoti i lavdëroi e ata u shumuan fort,
 as grigjat e tyre nuk u pakuan.

39 Pastaj qenë dhjetuar e munduar nga vuajtjet edhe nga
 dhembjet.

40 Ai që e shfryn përbuzjen mbi princa,
 i la të enden rrugë pa rrugë në shkretëtirë.

41 I shpëtoi skamnorët nga mjerimi
 dhe i shumoi si grigjat familjet.

42 Shohin të drejtët e le të gëzohen,
 kurse mbrapshtia le ta mbyllë gojën e vet.

43 Kush është i mençur le t'i kujtojë këto,
 do ta shohë mirësinë e Zotit.

KOMENTARI

Fraza “të shpërblyerit prej Zotit “ na bën të kuptojmë se datimi i këtij psalmi do të jetë pas mërgimit. Jo vetëm se është kthyer pjesa kryesore e pelegrinëve, por edhe zvarranikët, pasi kanë përjetuar çlirimin e Zotit me rrethana të vëshira.

Nga ana tjetër, ka mundësi që psalmisti të meditojë për festa të mëdha pelegrinazhitë erës para mërgimit. Ai sheh të mblidhen

njerëzit nga vendndodhjet e izoluara dhe i kujtohen premtimet drejtuar Abrahamit, që tani fokusohen te shtëpia e Davidit, që premtohet për një grumbullim nga mbarë bota. Siç duket, në fund të fundit ky kthim ka edhe një dimension eskatologjik.

Katë ngjarë që kemi të bëjmë me katër grupe të ndryshme. Më mirë ndërtimi hebraik jep të kuptojë se të njëjtët individë përshkruhen nga anë të ndryshme.– rreziqet tipike nga të cilat Zoti shpëton popullin e tij..

Nëpër mbarë psalmin dashuria e Zotit, për të cilën bëhet fjalë, shënon qëndrueshmëri e patundur për të mos heqë dorë nga ata që Zoti i ka zgjedhur. Kjo dashuri shprehet në shpëtimin e atyre që e duan Zotin.

Një temë tjetër është ndërhyrja e Zotit për të shpëtuar ata që i janë lutur. Psalmi përmban përshkrimet e vazhdueshme për situata kërcënuese, drejtime të vazhdueshme ndaj lutjes dhe përgjigjet e vazhdueshme ndaj lutjeve. Në këtë psalm ka aludime për gjithfarë problemesh dhe situatësh të vështira, në të cilat njerëzit – për disa ata vetë janë fajtorë, por për disa të tjera Zoti i ka vënë në situata të tilla. Së pari, trajtohen probleme të jashtme (shpëtim në tokë dhe në det), por se dyti probleme shpirtërore – njerëzit rebelohen kundër Zotit dhe gjenden në robëri. Por, sado të jenë rrethanat, asnjë situatë s'është tepër e vështirë për Zotin për t'u zgjidhur.

PSALMI 108

Himn mëngjesor e lutje kombëtare

1 Këngë. Psalm. I Davidit.

2 E gatshme është zemra ime, O Perëndi,

e gatshme është zemra ime;
do të këndoj e do të luaj në harpë!
Ja, lavdia ime!
3 Zgjohu, harpë e cetër,
agimin dua ta zgjoj!

4 Do të të lavdëroj ty, o Zot, midis popujve,
për ty do të luaj me harpë midis kombeve,

5 sepse e madhërueshme është deri në qiell mëshira jote,
deri në re e vërteta jote!

6 Lartësohu, O Perëndi, lart përmbi qiell,
përmbi mbarë tokën le të shndritë lavdi a jote!

7 Që të çlirohen të dashurit e tu, le të më shpëtojë e
djathta jote e më dëgjo!

8 Perëndia u përбетua në Shenjtëroren e vet: »Do të
kënaqem, dua ta ndaj Shehemin, masën do t'ia vë luginës
Sukot.

9 Imi është Giladi, imi është Menasheu,
Efraimi është përkrenarja ime,
Juda skeptri im!

10 Moabi legeni ku unë lahem;
mbi Edom do ta hedh këpucën time,
mbi Filiste do të këndoj fitoren.«

11 Kush do të më prijë deri në qytet – fortesë?
Kush do të më prijë deri në Edom?

12 Vallë, a jo ti, O Perëndi, që na braktise?
Pse a s' do të dalësh, O Perëndi, me ushtritë tona?

13 Na ndihmo, deh, kundër armiqve
 sepse i kotë është shpëtimi që vjen prej njerëzve.
 14 Me ndihmën e Perëndisë do të bëjmë trimëri të madhe,
 Ai do t'i shkelë armiqtë tanë!

KOMENTARI

Në këtë psalm kombinohen një himn dhe një vajtim: të dy gjenden te psalmet e tjera. Rreshtat 1-5 gjenden gjithashtu te Ps 57,7-11, kurse rreshtat 6-13 gjenden te Ps 60,5-12 me ndyshime të pakta. Pasi emri i Zotit përdoret vetëm te rr. 3 e jo Adonai i Ps 57, psalmisti këtu pa dyshim ka nxjerrë materialin e vet nga dy vepra të mëparshme. Ka mundësi që kombinimi të ketë formuar për të plotësuar nevojat e një situatë historike të re.

PSALMI 109

Psalm nëmës

1 *Mjeshtrit të korit. I Davidit. Psalm.*

O Perëndi, nderi im, mos rri në heshtje,
 2 sepse goja e mëkatarit e goja e dinakut u çel kundër
 meje
 Folën kundër meje me gjuhë ziliqare,
 3 më rrethojnë me fjalë urretjeje, më sulmojnë pa farë
 arsyeje.
 4 Dashurinë time e shpërblejnë me shpifje e unë vetëm
 lutem.

- 5 Të mirën ma kthejnë me të keqe e dashurinë time ma shpaguajnë me urrejtje. »Lëshoje kundër tij të paudhin, paditësi le t' i rrijë në të djathtë.
- 7 Kur të gjykohet le të dalë i dënuar, lutj a e tij në mëkat iu ktheftë.
- 8 Ditët e tij iu pakofshin, shërbesën e tij e marrtë një tjetër!
- 9 Fëmijët e tij mbetshin bonjakë, gruaja e tij vejushë.
- 10 Të bijtë iu bëfshin endacakë e lypës, u dëbofshin jashtë rrënojës së tyre!
- 11 Kamatari ia rrëmbëftë pasurinë, të huajt ia përpifshin frytin e mundit të tij!
- 12 Askush për të mos pastë dhemshuri, askujt mos iu dhimbshin fëmijët e tij!
- 13 Dera e tij me ferra u mbylltë, në brezin e parë emri iu harroftë!
- 14 Zoti e pastë gjithnjë para sysh fajin e të parëve të tij mos u shleftë as mëkati i nënës së tij.
- 15 Para syve të Zotit qofshin përherë dhe e zhduktë nga toka kujtimin e tyre!«
- 16 Sepse askurrë s' u kujtua të bëjë mëshirë, por e përndoqi skamnorin e lypësin, deri në vdekje e ndiqte njeriun zemërpërvëluar.
- 17 E deshi mallkimin – mbi të rëntë; s' e deshi bekimin – kurrë mos e pastë!
- 18 Me mallkim u vesh porsi me petk: e përshkoftë si uji në përmbrendësat e tij, porsi vaji në eshtrat e tij!
- 19 Iu bëftë porsi petku me të cilin mbulohet,

porsi brezi me të cilin ngjeshet!

20 Këtë shpagim paçin para Zotit paditësit e mi,
ata që flasin keq kundër shpirtit tim.

21 E ti, o Zot, o Zot, sillu me mua sipas emrit tënd:
më shpëto sepse e mirë është mëshira jote,

22 se unë jam nevojtar e skamnor,
sepse e plagosur është zemra ime në mua.

23 Mbarova porsi hija kur shkon në të sosur,
më dëbojnë si të isha karkalec!

24 Gjunjët po më lëshojnë prej agjërimit,
mishi im u tha pa pikën e dhjemit.

25 Përqeshje për ta unë u bëra,
tundin kokën kur mbi mua shikojnë.

26 Më ndihmo, o Zot, Perëndia im,
më shpëto në saje të mëshirës sate,

27 le ta dinë se kjo është dora jote:
se ti, o Zot, e bërë këtë vepër!

28 Ata le të mallkojnë, por ti lavdëro;
le të turpërohen ata që më salvojne,
kurse shërbëtori yt le të gëzohet!

29 I mbuloftë turpi shpifësit e mi,
le të mbulohen si me llahik me turpin e vet!

30 Me gjithë shpirt do ta lavdëroj Zotin,
në logun e burrave do ta nderoj,

31 sepse Ai i rri në të djathtë skamnorit,
për ta shpëtuar nga gjykatësit shpirtin e tij.

KOMENTARI

Ka të ngjarë që skenari i këtij psalmi të ketë qenë një gjyq fetar (krhs. Dal. 22, 8 + Lp. 17, 8-13). Para gjykatësve priftërore që përfaqësojnë Perëndinë, psalmisti i akuzuar shpall pafajësinë e tij dhe padit akuzuesit e tij.

Vini re: 18. *e përshkoftë si uji në përmbrendësat e tij*: do të jetë aludim për pasazhin vijues te Nr. 5, 16-28). «Prifti e afron gruan tek altari. Pastaj, merr një enë prej balte me ujë të shuguruar dhe në të hedh pak dhe prej truallit të Tendës së shenjtë. Ai i zgjidh flokët e gruas dhe ia vë në duar blatimin e xhelozisë. Ai e merr vetë enën me ujin, i cili sjell hidhërim dhe mallkim. Atëherë i thotë gruas: «Në qoftë se nuk ke fjetur me asnjë tjetër, përveç burrit tënd, atëherë ky ujë i hidhur, që sjell mallkim, nuk do të të bëjë asnjë dëm. Por, në qoftë se e ke shkelur kurorën, atëherë Zoti do të të bëjë një shembull të frikshëm për popullin tënd. Uji do të depërtojë në zorrët e tua, kështu që ty do të të ënjtet mitra, dhe organet e tua seksuale do të thahen.

Gruaja duhet të përgjigjet: «Amen, kështu le të bëhet!»

31. Siç duket edhe paditësi edhe dëshmitar i akuzës qëndronin në anën e drejtë të akuzës (rr. 6; krhs Zak. 3, 1).

PSALMI 110

Priftëria e Mesisë

1 *I Davidit. Psalm.*

I tha Zoti Zotit tim: »Rri në të djathtën time,
derisa t'i vë armiqtë e tu shtrojë për këmbët e tua!«

- 2 Skeptrin e pushtetit tënd Zoti do ta shtrijë nga Cioni:
sundo midis armiqve të tu!
- 3 Ty të përket më i larti pushtet në ditën e fuqisë sate
në shkëlqime të shenjta nga kraharori para Yllit të Dritës
unë të linda.
- 4 Zoti u përbetua, assesi s' do të pendohet:
»Ti je prift për amshim në mënyrën e Melkizedekut.«
- 5 Zoti është në të djathtën tënde, i dërrmon mbretërit ditën
e zemërimit të vet.
- 6 Popujt do t' i gjykojë: grumbuj kufomash, koka të prera
me shumicë mbi dhe!
- 7 Në udhëtim uj ë do të pijë prej përroit, prandaj lart do ta
ngrejë kokën.

KOMENTARI

Fillimisht ky ishte psalm mbretëror i recituar nga një poet i frymëzuar për nder të mbretit davidik, siç duket, me një rast të veçantë, ndoshta me rastin e kurorëzimit të tij. Dy profeci citohen, dhe secila me radhë zgjerohet nga psalmisti.

Ftesa e Perëndisë (rr. 1-3)

Profecia e parë që 5 merr poeti është siguri për prestigj dhe pushtet. Mbreti ftohet në vendin e nderit pranë vetë Perëndisë. sepse funksionon si përfaqësuesi i Tij dhe nënmreti i tij në tokë. Na ana rituale, fronizimi pranë Zotit do të jetë aludim për vendin e tij të zakonshëm pranë shtyllës në Tempull (krhs. 2 Mbr. 11, 14; 23, 3). Fitorja sigurohet (krhs. Josh. 10, 24). Armiaqtë e huaj shpesh shfrytëzonin periudhën e turbulluar të mbretërimit të ri të një mbreti të ri, por me këtë rast mbreti merr zemër duke marrë parasysht premtinin për ndihmën nga Zoti. (krhs. 2, 8).

Psalmisti vazhdon të shpallë pasojat e profecisë. Skeptri me të cilin furnizohet mbreti duhet të ketë ndikim të madh. Nga kryeqyteti fetar dhe mbretëror Zoti do të zgjerojë sundimin e tij midis fqinjve të tij armiqësorë. Mbreti sigurohet se do të ketë përkrahjen besnike të trupave të tij. Ata do të identifikohen me zell me komandantin e tyre mbretëror. Të rinjtë e vendit do të mblidhen në ditën e betejës, të freskët dhe plot vrull për të luftuar si vazalë për zotërinë e tyre.

Premtimi i Perëndisë (rr. 4-7)

Profecia e dytë është bërë solemn për rolin e shenjtë në qëllimet e Perëndisë. Njëherë mbretëronte në Jerusalem një mbret jevusas që ishte prift i të lartit Perëndi. Abrahami e takoi për t'i shprehur nderimet e tij Melkizedekut si anëtar i lashtë i kësaj dinastie mbretërore (Zak. 14, 18-20). Kur Davidi e pushtoi Jerusalemin, ai ua shtoi të drejtat e tij mbretërore izraelite privilegjet e mbretërisë jevusase. Kështu mbreti i Izraelit, i cili mbretëronte nga Jerusalem, ishte prift me emër, ndërmjetësi i shenjtë ndërmjet Perëndisë dhe popullit të tij. Por praktikisht ky nder përdorej rrallë (krhs. 2 Sam. 8, 17 dhe me dallim 2 Kr. 26, 16-21); ndoshta për këtë arsye psalmisti nuk e zgjeron këtë temë. Theksohet karakteri i përhershëm i këtij emërimi: Perëndia nuk do ta ndërrojë mendjen. Ndryshe nga dinastia jevusase, dinastia davidike kurrë nuk do të zëvendësohej.

Te rr. 7 aludohet për mbretin. Ka mundësi që të ketë aludim për freskimin e mbretit gjatë marshimit, por më mirë do të ketë aludim për ceremoninë mbretërore pranë burimit të Gihonit, nga i cili mbreti pinte sipas ritualit për të marrë forcat e nevojshme për zbatimin e detyrave të tij. (krhs. 1 Mbr 1, 45). Ndërsa armiqtë e tij ishin të humbur, fati i tij ishte një jetë ngadhënjimtare.

Me rënien e dinastisë davidike ky psalm riinterpretohej në dritën e ardhjes së Mesisë. Jezusi e forcoi këtë interpretim kur pohoi se kjo figurë mesianike duhet të jetë hyjnore. (Mk 12, 35-37; krhs. edhe Mt. 26, 64). Apostujt, duke ndjekur interpretimin e

Jezusit, këtë titull e përdorën për Jezusin. Në të vërtetë ky varg citohet më shumë se ndonjë varg tjetër. (krhs. Vap. 2, 34 +; 1 Kor. 15, 25; Ef 1, 20; Kol. 3, 1; 1 Pjet. 3, 22). Autori i Letrës drejtuar Hebrenjve (d.m. th. Pali – sipas Klementit të Aleksandrisë, origjinali ishte shkruar hebraisht, por me kërkesën e Palit Luka e përktheu në greqisht) e përdor këtë psalm për të dëshmuar shërbimin priftëror të Jezusit pas ngritjes në qiell (Heb. 3, 13; 5, 6-10; 6, 20-10, 21).

PSALMI 111

Lavdi veprave të Perëndisë

1 HALELUJA!

Alef Me gjithë shpirt do ta lavdëroj Zotin,
Bet në kuvendin e të drejtëve, në mbledhjen e tyre.

Gimel 2 Të mëdha janë veprat e Perëndisë,
Dalet për t'u shqyrtuar prej atyre që i duan.
He 3 Stoli e shkëlqim është vepra e tij,
Vav drejtësia e tij qëndron në shekui të shekujve.

Zain 4 U ngreh përmendore mrekullive të veta,
He ti mëshirshëm e mëshirëdhënës është Zoti.
Tet 5 U jep ushqim atyre që e druajnë,
Jod kurrë s'e harron Besëlidhjen e vet.

Kaf 6 Popullit të vet ia kumtoi fuqinë e veprave të veta,
Lamed duke ua dhuruar pronën e paganëve

Mem 7 Veprat e duarve të tij janë drejtësi e
 besnikëri,
Nun urdhërimet e tij janë të vërteta,
Samek 8 të qëndrueshme në jetë të jetëve,
Ain të themeluara mbi të vërtetën e drejtësinë.
Pe 9 Shpërblim i dha popullit të vet,
Tsade Besëlidhjen e vet e bëri të amshueshme:
Kof i shenjtë dhe i tmerrshëm është emri i tij.
Resh 10 Fillimi i dijes është frika e Zotit,
Sin janë të mençur të gjithë ata që veprojnë sipas
 saj,
Tau lavdia e Tij qëndron për amshim.

KOMENTARI

Ky psalm si dhe psalmi pasues formojnë një çift plotësues. Të dy janë poema akrostike që përfshijnë 11 rreshta, prej të cilit çdo gjysmë-rresht fillon me shkronjen e alfabetit hebraik. Halleluja qëndron jashtë kësaj skeme.

Psalmisti ka ndjekur një prej festave të mëdha në Tempull. Ai dëshmon për çfarë rëndësie kishte festa për të, me një herë të recituar para mbledhjes. Gjatë adhurimit të Izraelit kishte nganjëherë disa individë që nuk adhuronin me gjithë mend: ata nderonin Zotin «me buzët e tyre, por zemrat e tyre ishin larg Atij» (Is. 29, 13). Të paktën ky adhurues i ka falur Zotit me shpirt dhe me të vërtetë: ai u kënaq me temat për shpëtimin e Izraelit dhe ka adhuruar Zotin me devotshmëri dhe me gjithë zemër.

Ai është mirënjohës sepse Zoti i ka futur festat që na japin mundësi ta adhurojmë e të kremtojmë mrekullitë e tij (rr. 4) si p.sh. Dalja, dhënia e Ligjit dhe Pushtimi i tokës së premtuar. Zoti kishte qëndruar besnik megjithë pabesinë e kombit. Në këtë psalm drejtësia e tij do të thotë besnikëria e tij ndaj besëlidhjes. Njeriu duhet të reagojë me adhurim dhe respekt të thellë ndaj Tij.

Respekt i thellë për Perëndinë (d.m.th. urtësi) është në të vërtetë pikënisja e aftësisë për të përballur kuptimin e jetës dhe problemet e saj. Sekrete të tilla i janë hapur jo mistikut ose filozofit por besimtarit që do të zbatojë urdhrat e Perëndisë. Populli i tij duhet të reagojë në shfaqjen dhe shpagimin e tij me dëgjuesë dhe lavdërim pa fund.

PSALMI 112

Lumturia e njeriut të drejtë

1 HALELUJA!

Alef Lum ai njeri që e druan Zotin,
Bet që kënaqet në urdhërimet e tij.
Gîmel 2 Fara e tij do të jetë e fortë mbi tokë,
Dalet do të lavdërohet breznia e të drejtëve.
He 3 Pasuri e mirëqenie në shtëpinë e tij,
Vav drejtësia e tij qëndron në shekuj të shekujve.
Zain 4 Ka lindur për të drejtët një dritë në errësirë:
Het i butë e i mëshirshëm është njeriu i drejtë.
Tet 5 I ëmbël është njeriu që përdëllen e huajon,
Jod punët e veta i kryen me ndër gjegje,
Kaf 6 ai askurrë nuk do të bjerë poshtë.

Lamed Në kujtim të përhershëm mbetet i drejti,
Mem 7 nuk i trembet lajmit të keq.
Nun E patundshme është zemra e tij me shpresë në
 Zotin
Samek 8 të fortë e ka zemrën, nuk do të trembet
Ain armiqtë e vet i bën asgjë.

Pe 9 Është dorëdhënë, u fal skamnorëve;
Tsade drejtësia e tij qëndron në shekuj të shekujve,
Kofballi i tij ngallit për nder.

Resh 10 E sheh keqbërësi dhe hidhërohet,
Sin me dhëmbë kërcëllon e vyshket.
Tau Dëshira e mëkatarëve shkon huq.

KOMENTARI

Ky psalm në formë akrostike vazhdon temën e psalmit 111. Sigurisht autori është i njëjti. Është gjithashtu transferim i attributeve të Perëndisë në njeriun besimtar.

Perëndia mund të lavdërohet vetëm nga ata, jeta e së cilës është karakterizuar nga respekt i thellë dhe bindje. Një individ i tillë mund të gëzojë premtimet e besëlidhjes së vjetër në lidhje me pasuri dhe lulëzim material. Familja e tij do të ndajë bekimin e tij (krhs. Dal. 20, 6). Jo vetëm që drejtësia e Zotit qëndron përgjithmonë, por edhe ata që i takojnë. Besimtari i vërtetë bëhet dritë në errësi dhe burim ndihme për të tjerët (rr. 3-4).

PSALMI 113

Perëndisë së lavdishëm e të mëshirshëm

1 HALELUJA!

Lavdërojeni, shërbëtorët e Zotit,
 lavdërojeni, emrin e Zotit!

2 Lavdëroftë emri i Zotit

qysh tash e deri në amshim,

3 Që kur lind dielli e derisa perëndon

qoftë bekuar emri i Zotit!

41 madhërueshëm është Zoti mbi të gjithë popujt,
lavdia e tij i tejkalon qiejt.

5 Kush është si Zoti, Perëndia ynë, që fronin e ka në
Lartësi,

6 e nga lart vrojton qiellin e tokën?

7 Nga pluhuri e ngre skamnorin,
nga llomi e lartëson të vobektin

8 për ta vënë të rrijë me princa,
me princat e popullit të vet.

9 Ai bën të banojë beronia në shtëpi të vet
nënë fëmijësh të gëzueshme.

KOMENTARI

Psalmet 113-118. Halleli egjiptian: kënga e shpëtimit

Ky grup psalmesh, i cili do të ketë formuar një pjesë e festimeve të pashkëve, është me interes për të krishterët, sepse Jezusi dhe dishepujt e tij do të kenë kënduar psalmet 113-114 para darkës së fundit kurse 115-118 pas darkës (krhs. Mt. 26,30). Pa dyshim çdo psalm e ka historinë e vet letrare, por ato quhen së bashku Halleli egjiptian (Dal 6,6-7).

Psalm 113 themelon mbarë ndërmarrjen e Daljes në Zotin – është tipik për karakterin e tij t'i ngrjë skamnorët dhe nevojtarët (d.m.th. besimtarët). Psalmi 114 flet për ngjarjet e Daljes kur Zoti drejtoi krijimin e vet për hir të popullit të tij. Psalmet 115, 116 e balancojnë njeri-tjetrin ndërsa komuniteti dhe individi respektivisht shpëtohen nga vdekja dhe humbja. Psalmi 117 zgjeron mësimin për Daljen në kufi botërore – ajo çfarë u realizua për Izraelin mund të vlejë edhe për ne. Në fund psalmi

118 na aftëson ti bashkohemi kortezhit të madh ndërsa kalon nëpër portat e Tempullit për të hyrë në praninë e vetë Zotit.

(a) **Psalmi 113.** Ky i pari i psalmeve të Hallelit. (Ps. 113 – 118) që këndoheshin rregullisht me rastin e festave të mëdha të Izraelit.

Nga shekulli i parë këto psalme këndoheshin rreth tavolinës kur familja izraelit festonte pashkët. Bota e natyrës dëshmon që Krijuesi i saj ëshë më i madh se ajo. Zoti është gjithashtu Perëndia e Izraelit, i cili i përballur nga kombet më të fuqishme, ka një mbrojtës më i madh se ato, Perëndia e Izraelit.

PSALMI 114

Himn Pashkësh

1 HALELUJA!

Kur Izraeli doli nga Egjipti,
Shtëpia e Jakobit nga populli barbar,

2 Judeja u bë Shenjtërorja e tij,
Izraeli zotërimi i tij.

3 Pa deti dhe i bëri rrugë,
Jordani u kthye prapazi,

4 malet kërcyen si desh,
kodrat porsi qengja delesh!

5 Ç' pate, o det, që ike?

E ti, o Jordan, që u ktheve prapazi?

6 Ju, o male, pse kërcyet si desh,
e ju, o kodra, porsi qengja delesh?

7 Dridhu, o tokë, para fytyrës së Zotit,
 para fytyrës së Perëndisë së Jakobit,
 8 që e shndërron shkëmbin në liqen ujërash edhe qetën në
 burim uji të gjallë!

KOMENTARI

Në këtë psalm shpjegohen themelet e fesë së Izraelit, burimi i kuptimit të vetvetes dhe raporti i tij me Perëndinë.

Izraeli e quan veten popull i çliruar, i lirë për të hyrë në shërbimin e Perëndisë. Falë Daljes Izraeli u bë popull i shenjtë, populli vazal nën Zotin, mbretin e tyre. (krhs. Dal. 119, 6; Apok 1,6). Perëndia kreu mrekulli të mëdha duke përdorur veprimtari sizmike: Deti i kuq iku, Jordani nuk rridhte më, malet “kërcyen si desh”

Perëndia shfaqet në histori, shfaqet ende në Tempull: ai bën mrekulli dhe mund të kthejë shterpësinë në bekim. (krhs. Dal. 117, 6; Nr. 20, 11).

PSALMI 115

I vetmi Perëndia i vërtetë

1 Jo neve, o Zot, jo neve, por emrit tënd jepi lavdi për nder të mëshirës sate e të besnikërisë sate.

2 Pse të thonë paganët:

»Ku është Perëndia i tyre?«

3 Perëndia ynë është në qiell, ai bën gjithçka i pëlqen.

4 Idhuj t e paganëve janë argjend e ar – prodhim i dorës së njeriut.

5 Gojë kanë e nuk flasin, sy kanë e nuk shohin,

6 veshë kanë e nuk dëgjojnë, hundë kanë e nuk nuhasin.

7 Duar kanë e nuk prekin, këmbë kanë e nuk ecin, – zë nuk qesin prej gurmazit të tyre!

8 Të tillë qofshin edhe ata që i punojnë, të gjithë ata që shpresojnë në ta!

9 Shtëpia e Izraelit shpreson në Zotin: Ai është ndihma dhe mburoja e tyre.

10 Shtëpia e Aronit shpreson në Zotin:

Ai është ndihma dhe mburoja e tyre!

11 Kush e druan Zotin në Zotin shpreson: Ai është ndihma e mburoja e tij!

12 Zotit i bie ndër mend për ne e do të na lavdërojë:

do ta lavdërojë shtëpinë e Izraelit,

do ta lavdërojë shtëpinë e Aronit;

13 do t'i lavdërojë të gjithë ata që e druajnë Zotin, si të vegjëlit ashtu të mëdhenjtë.

14 Bëftë Zoti e u shumofshi ju vetë e fëmijët tuaj!

15 Ju lavdëroftë Zoti,

Krijuesi i qiellit e i tokës!

16 Qielli është qielli i Zotit,

kurse tokën ua dhuroi njerëzve.

17 Jo, nuk janë të vdekurit që të lavdërojnë, o Zot,

dhe asnjë prej atyre që zbresin në heshtim,
18 por ne që jetojmë, ne e lavdërojmë Zotin tash e
përgjithmonë e jetë.

KOMENTARI

Populli i Perëndisë është në ngushticë. Ata i sjellin lutjet dhe lavdërimet e tyre. Si pasojë zhduket depresioni i tyre dhe atyre u rikthehet morali në tempull. Reputacioni i Zotit është në lojë, prandaj ata mbështetin në premtimet e Zotit dhe marrëdhëniet besëlidhjeje me Të.

Prifti merr një lajm nga Zoti: ai do të qëndrojë besnik ndaj premtimeve të tij. Populli do të shtohet. Siç duket, këtu ka aludim për situatën e mjerueshme të Izraelit pas kthimit të popullit nga mërgim. Në atë kohë popullsia e Izraelit ishte e vogël.

PSALMI 116

Falënderim

1 HALELUJA!

E dua Zotin sepse e dëgjon zërin e lutjes sime,
2 sepse mbi mua e priri veshin e vet
atë ditë që e thirra në ndihmë.

3 Më kishin rrethuar leqet e vdekjes,
4 më kishin shtrënguar leqet e Nëntokës,
më ndrydhën trishtime e dhembje,
emrin e Zotit e thirra ne ndihmë:

»Deh, o Zot, ma shpëto jetën!«

4 I mirë e i drejtë është Zoti,
Perëndia ynë është vetë mirësi!

6 Zoti është mbrojtësi i të vegjëlve: isha ngushtë e Ai më shpëtoi!

7 Kthehu, shpirti im, në qetësinë tënde, sepse Zoti është barmirësi yt!

8 Ai ma shpëttoi jetën prej vdekjes, sytë e mi prej lotëve, këmbët e mia prej rënies.

9 Do të eci në praninë e Zotit në tokën e të gjallëve.

10 Besoj edhe atëherë kur më duhet të them: »Jam i pafat për së tepërmi!«.

11 Në hutimin tim kam thënë: »Rrenacak është çdo njeri!«

12 Si do t'ia shperbej Zotit
për të gjitha të mirat që m'i ka dhënë?

13 Do të ngre gotën e shpëtimit
e me nderim do të thërras emrin e Zotit.

14 Do t'i kryej kushtet e mia bërë Zotit
në praninë e mbarë popullit të tii.

15 E çmueshme është para Zotit
vdekja e shenjtërve të tij.

16 O Zot, unë jam shërbëtori yt,
shërbëtori yt dhe biri i shërbëtores sate.

Ti i këpute hekurat e mia:

17 ty do të ta kushtoj flinë e lavdit,
me nderim do të thërras emrin e Zotit.

18 Do t'i kryej kushtet e mia bërë Zotit në praninë e
mbarë popullit të tij,

19 në oborret e Shtëpisë së Zotit,
midis teje, o Jerusalem!

KOMENTARI

Situata ishte kërcënim i vdekjes (rr. 3, 8, 15), i shkaktuar nga mashtrimi i njerëzve (11) nga mungesa e dallimit (rr. 6). Por në këtë situatë hyri lutja (rr. 1-4). Zoti dëgjon (1-2), është i mëshirshëm (u jep favor atyre që nuk e meritojnë), i drejtë (kurrë nuk largohet nga angazhimi i tij ndaj popullit të tij as nga premtimet e tij), i dhëmbshur (është emocionalisht i prekur nga ngushtica e tyre) (rr. 5), dhe i ndjeshëm për vdekjen e atyre që e duan (15). Kështu erdhi shpëtimi (rr. 4-6), çlirim nga vdekja (8) dhe robëria (16), dhe furnizim i plotë (rr. 7, 12). Prandaj ka betime për t'u bërë dhe përmbajtur.

Betimet e bëra në ngushticë nuk ishin aspak ujdi për tu bërë me Perëndinë, por dëshmi për qëllim serioz për të mësuar nga përvoja dhe të dalë nga përvoja si individ më i mirë më i përkushtuar Zotit .

PSALMI 117**Grishje për të lavdëruar Zotin**

HALELUJA!

Lavdërojeni Zotin, o kombe të gjitha, madhërojeni së bashku, o popuj të gjithë!
2 Sepse e madhe është dashuria e tij ndaj nesh,
besnikëria e Zotit qëndron për amshim!

KOMENTARI

Ky psalm citohet te Rom 15,11 për të përkrahur bindjen e Palit se Jezusi është Mesia botëror, dhe kjo plotësohet tek Apok 7,9. Qysh në fillimi, nëpërmjet besëlidhjes me Avrahamin, qëllimi i

Perëndisë ishte të shpëtojë jo vetëm Izraelin por edhe njerëzit nga të gjitha kombet e tjera. Ashtu edhe lutja e Salomonit ka parasysh edhe kombet e huaja që do të adhuronin në Tempull. (1 Mbr. 8,41-43. shih edhe Ps 96-98).

PSALMI 118

Liturgjia për të kremten e Tëbanave

HALELUJA!

Lavdërojeni Zotin, sepse është i mirë, sepse e amshuar është dashuria e tij!

2 Le të thotë tashti Izraeli, sepse është i mirë, e amshuar është dashuria e tij!

3 Le të thotë tani shtëpia e Aronit, e amshuar është dashuria e tij!

4 Le të thonë tani ata që e druajnë Zotin, e amshuar është dashuria e tij!

5 Në vështirësi e thirra në ndihmë Zotin, Zoti më dëgjoi edhe më shpëtoi.

6 Zoti është me mua, s' druaj se ka ç'më bën njeriu.

7 Me mua është Zoti, ndihmëtari im, për asgjë i bëj armiq të mi.

8 Më mirë është të strehohesh te Zoti se të kesh besim në njerëz.

9 Më mirë është të strehohesh te Zoti, se të kesh besim në princa.

10 Më rrethuan të gjithë paganët;
i shfarosa me fuqi të emrit të Zotit.

11 Rreth e përqark më rrethuan,
por i shfarosa në fuqi të emrit të Zotit.

12 Më rrethuan porsi bletët,
porsi zjarr që merr flakë ndër ferra,
por i shfarosa në fuqi të emrit të Zotit.

13 Më shtytën, më dhanë shtytje për të më rrëzuar,
por më ndihmoi ndihma e Zotit.

14 Fuqia ime e lavdia ime është Zoti,
ai është shpëtimtari im.

15 Ja, britma gëzimi e ngadhënjimi në tendat e të drejtëve:

16 »E djathta e Zotit u madhërua! E djathta e Zotit më
lartësoi! E djathta e Zotit u madhërua!«

17 S' do të vdes, të jetoj dua,
do t' i kumtoj veprat e Zotit!

18 Me ndëshkim të rëndë Zoti më ndëshkoi,
por nuk më lëshoi në duar të vdekjes.

19 M' i hapni dyert e drejtësisë, dua të hyj e t' i thurr lavde
Zotit.

20 Ja, këtu është dera e Zotit; nëpër të do të hyjnë të
drejtët.

21 Do të të falënderoj, sepse më ke vështruar, dhe u bëre Shpëtimtari im.

22 Guri, që e qitën jashtë përdorimit ndërtuesit, erdhi e u bë guri i këndit;

23 Zoti e bëri këtë gjë: sa mrekulli për sytë tanë!

24 Kjo është dita që na e dhuroi Zoti:
të galdojmë e të gëzojmë në të!

25 Ma jep, o Zot, shpëtimin tënd,
deh, o Zot, jepe të mbarën!

26 Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit!
Po ju lavdërojmë nga shtëpia e Zotit.

27 Perëndia është Zot, ai na ndriçoi:
rendituni të gëzuar në reshtin kremtor
me rrema në dorë deri në ballë të altarit!

28 Ti je Perëndia im, ty të falënderoj,
Ti je Perëndia im, unë të madhëroj!

29 Lavdërojeni Zotin, sepse është i mirë,
sepse e amshuar është dashuria e tij!

KOMENTARI

Ky psalm e ka prejardhjen në festimet e fitores së mbretit dhe popullit të Izraelit (krhs. 2 An. 20, 27 +). Më vonë ky psalm do të jetë përdorur në përkujtim të mirësisë së kaluar ndaj dinastisë

Davidike dhe ndaj Izraelit. Është psalmi i fundit i psalmeve të Hallelit të kënduar në shtëpi me rastin e pashkëve. Sipas traditës çifute ky psalm përdorej në festën e tëbanave. Do të ketë aludim për të te rr. 27. Ishte një psalm i kënduar në kortezhet jashtë portave të Tempullit dhe vazhdoi në brendësinë e Tempullit (rr. 19 +, 26).

Së pari, prifti u bën thirrje laikëve dhe pastaj bashkëpriftërve të tij për ta falënderuar Zotin për mirësinë e tij. Pastaj mbreti jep dëshmi (rr. 5-18) për ndihmën e Zotit në betejë kur luftoi kundër kombeve pagane: «Më rrethuan porsi bletët, porsi zjarr që merr flakë ndër ferra, por i shfarosa në fuqi të emrit të Zotit.» Por me anë të lutjes dhe besimit të fuqia e Zotit, doli ngadhënjimtar. (krhs. 1 Sam. 17, 45). I ngjashëm me mbretin Asa, nuk doli vetëm kundër armikut, por me emër të Zotit (2 Kr. 14, 21). Te rr. 14 mbreti mund të përvetësojë këngën e Moisiut. (krhs. Exod. 15, 2

Mbreti kërkon leje të hyjë nëpër portat e Tempullit: vetëm ata që janë në rregull me të e kanë këtë të drejtë. Ai merr një përgjigje pozitive dhe mund të kalojë (krhs. Ps. 15; 24). Mbreti i jep nder Zotit për fitoren e tij. Pastaj jepet urdhër për mbarë popullin që të hyjë në tempull me brohoritje duke valëvitur degët e psalmave. Si përgjigje prifti jep bekimin e Zotit, sigurisht duke përdorur fjalët e Nr. 6, 24-26.

PSALMI 119

Lavdi Ligjit të Perëndisë

HALELUJA!

Alef

Lum njeriu me sjellje të pastër,
që ecën në Ligjin e Zotit!

2 Lum kush i mban vendimet e tij,
që e kërkon me gjithë zeniër.

3 Sepse ai nuk vepron keq,
por ecën udhëve të tij.
4 Ti i shpalle urdhërimet, e tua
që të mbahen përpikërisht.

5 Oh, sikur të ishin të drejta udhët e mia
për t' i zbatuar rregulloret e tua!

6 Atëherë s' do të skuqem
nëse do t' i mbaj urdhërimet e tua.

7 Do të të lavdëroj në pastrinë e zemrës,
i mësuar ndër gjyqet e drejtësisë sate.

8 Ûnë do t' i zbatoj rregulloret e tua,
por ti askurrë mos hiq dore prej meje!

Bet

9 Si do ta ruajë të pastër djaloshi udhën e vet?
Duke i zbatuar fjalët e tua.

10 Të kërkoj me gjithë fuqinë e shpirtit tim:
mos lejo t' u shmangem urdhërimeve të tua.

11 Fjalët e tua i fsheha në zehlrën time,
që të mos gaboj kundër teje.

12 I bekuar je, o Zot,
ma mëso vullnesën tënde.

13 Me buzët e mia i shpall një nga një të gjitha gjyqet e
godes sate.

14 Më shumë i gëzohem udhës së dëshmimeve të tua se pasurisë tejet te madhe.

15 Do të ushtrohem në urdhërimet e tua,
do t' i kujtoj udhët e tua.

16 Do të kënaqem në rregulloret e tua,
s' do ta harroj fjalën tënde.

Gimel

17 Bëja këtë të mirë shërbëtorit tënd:

që të jetoj e ta mbaj fjalën tënde.

18 M' i hap sytë të shikoj mrekullitë e ligjit tënd.

19 Ravgues jam unë përmbi dhe,
mos i fsheh para meje urdhërimet e tua.

20 Shpirti im meket gjithherë prej dëshirës së qjyqeve
të tua.

21 Ti u kërcënohesh krenarëve:

të mallkuar janë ata që u shmangen urdhërimeve të

22 Më liro nga poshtërimi e turpi,
sepse i ruaj vendimet e tua.

23 Nëse edhe princat bëjnë mbledhje e flasin kundër s
hërbëtorit yt ushtrohet në rregulloret e tua.

24 Sepse vendimet e tua janë kënaqja ime,
rregulloret e tua këshillëtarët e mia

Dalet

25 Shpirti im hiqet zvarrë nëpër pluhur:

më përtërij sipas zotimit që më dhe.

26 I kam treguar udhët e mia e ti më dëgjove:
m' i mëso rregulloret e tua.

27 Bëj ta kuptoj udhën e urdhërimeve të tua
e do t' i kujtoj mrekullitë e tua.

28 Prej trishtimit shpirti im qan me lot,
më forço shpirtërisht sipas premtimit që më dhe.

29 Më mbaj larg nga udha e rrenës, më pajis me
Ligjin tënd.

30 E kam zgjedhur udhën e së vërtetës,
në zemër i kam urd hërimit e tua.

31 Jam lidhur pas vendimeve të tua, o Zot,
mos lejo të turpërohem.

32 Vrapoj udhës së urdhërimeve të tua,
sepse ti ma ke shndritur zemrën,

He 33 Ma trego, o Zot, udhën e ligjeve të tua,
dhe unë do ta mbaj gjithmonë.

34 Më jep kuptim që ta mbaj Ligjin tënd
e do ta zbatoj me gjithë zemrën time.

35 Më prij udhës së urdhërimeve të tua,
sepse në të e kam kënaqjen time.

36 Prire zemrën time drejt urdhërimeve të tua e jo drejt
lakmimit të pasurisë.

37 Largoji sytë e mi të mos e shohin kotësinë,
më përtërij në udhën tënde.

38 Plotësoj a shërbëtorit tënd premtimin tënd që ua
dhe atyre që të druajnë.

39 Më shpëto nga çnderimi që aq fort i trembem,
sepse gjyqet e tua janë të mrekullueshme.

40 Oh, sa fort i dua urdhërimet e tua,
më përtërij në drejtësinë tënde!

Vav 41 Ma jep, o Zot, mëshirën tënde,
shpëtimin tënd sikurse m'u zotove.

42 Do t'u përgjigjem atyre që më poshtërojnë

se shpresoj ne fjalën tënde.

43 Kurrë mos e hiq prej gojës sime fjalën e së vërtetës,

sepse kam besim në gjyqet e tua.

44 E unë do ta mbaj Ligjin tënd përherë,
në shekuj e në jetë të jetës.

45 Do të eci udhës së gjerë,
sepse i kërkoj urdhërimet e tua.

46 Para mbretërve do të flas për vendimet e tua e nuk
do të më vijë turp.

47 Do të kënaqem në urdhërimet e tua,
që aq shumë i kam për zemër.

48 I lartësoj duart e mia drejt urdhërimeve të tua që i
dua e do t'i bluaj në mendje rregulloret e tua.

Zain

49 Të të bjerë ndër mend zotimi që i dhe shërbëtorit
tënd

me të cilin më ke dhënë shpresë.

50 Në vështirësinë time e kam këtë ngushëllim
sepse fjala jote ma përtëris jetën.

51 Krenarët po më përqeshin së tepërmi
por unë nuk i shmangem Ligjit tënd.

52 I kujtoji, O Zot, gjyqet e tua të lashta
dhe në to gjej ngushëllim.

53 Unë zemërohem tepër në mëkatarë që i shmangen
Ligjit tënd.

54 Këngë janë për mua urdhërimet e tua,
në tokën e shtegtimit tim.

55 Natën e kujtoj, o Zot, emrin tënd,

dhe e zbatoj Ligjin tënd.
 56 E mua më ndodh kështu,
 sepse i mbaj urdhërimet e tua.

Het

57 Zoti është pjesa e trashëgimit tim:
 e dhashë fjalën t' i mbaj urdhërimet e tua.
 58 T' u përluta me gjithë fuqi të zemrës:
 ki dhimbje për mua sipas fjalës që më dhe.
 59 I shqyrtova hollë udhët e mia
 dhe i ktheva hapat e mi në urdhërimet të tua.
 60 Nxitova e nuk vonova
 për t' i zbatuar urdhërimet e tua.
 61 Më rrethuan leqet e të patenzonëve,
 nuk e harrova Ligjin tënd.
 62 Në mesnatë ngrihem për të të thur lavdi
 për shkak të vendimeve të tua të drejta.
 63 Jam mik me të gjithë ata që të druajnë,
 me ata që i zbatojnë urdhërimet e tua.
 64 Plot është toka, o Zot, me dashurinë tënde,
 m' i mëso rregulloret e tua.

Tet

65 I bëre mirë, o Zot, shërbëtorit tënd
 ashtu si ia dhe fjalën.
 66 Ma mëso mirësinë, urtinë e dijen,
 sepse u besoj urdhërimeve të tua.
 67 Para se sprovova vuajtjen u enda larg teje,
 por tani unë e mbaj fjalën tënde.
 68 Ti je i mirë e bën mirë,

ma mëso vullnesën tënde.

69 Krenarët përbluajnë kundër meje tradhti,
por unë me gjithë zemër do t'i mbaj urdhërimet e tua.

70 U trash zemra e tyre si dhjami,
ndërsa unë kënaqem në Ligjin tënd.

71 Është mirë për mua që vuajta,
kështu do ta mësoj vullnetin tënd.

72 Më i mirë është për mua Ligji yt
se me mijëra ar e argjend.

Jod

73 Duart e tua më bënë e më dhënë trajtë,
më jep kuptim t'i mësoj urdhërimet e tua.

74 Kur më shohin ata që ty të druajnë, gëzohen,
sepse shpresova në fjalën tënde.

75 E di, o Zot, se gjyqet e tua janë të drejta,
me plot të drejtë më përulë

76 Le të më ngushëllojë, pra, mëshira jote sipas
premtimit që i dhe shërbëtorit tënd.

77 Ardhtë mbi mua mëshira jote e do të j etoj,
sepse Ligji yt është kënaqja ime.

78 Le të turpërohen krenarët pse dijekeqas më,
poshtërojnë, e unë do t'i kujtoj urdhërimet e tua.

79 Le të sillen drejt meje ata që ty të druajnë,
ata që i njohin vendimet e tua.

U përsostë zemra ime në rregulloret e tua,
që kurrë të mos turpërohem.

Kaf

81 Po më shkrihet shpirti në pritje të shpëtimit tënd,
kam besim të plotë në premtimin tënd.

82 Sytë po më shteren prej dëshirës së fjalës sate e
them: »Kur do të ma japësh ngushëllimin?«

83U bëra si rrësheku në tym,
por nuk i harrova rregulloret e tua.

84 po edhe sa ditë do të rrojë shërbëtori yt?
Kur do t'i gjykosh përndjekësit e mi?

85 Më hapën gropa krenarët
që s'jetojnë sipas Ligjit tënd.

86 Të gjitha urdhërimet e tua janë të vërteta;
dijekeqas më kanë salvuar: deh, më eja në ndihmë!

87 Për pak sa s'më rrëzuan përdhe,
megjithatë unë nuk u shmangem urdhërimeve të tua.

88 Më përtërij pashë dashurinë tënde
e unë do t'i ruaj vendimet e gojës sate.

Lamed

89 E amshueshme është, o Zot, fjala jote,
e qëndrueshme porsiqielli.

90 Brez pas brezi e vërteta jote;
e themelove tokën dhe ajo qëndron.

91 Me urdhrin tënd gjithçka qëndron deri më sot,
sepse çdo gjë është në shërbimin tënd.

92 Po të mos ishte Ligji yt kënaqja ime,
do të kisha mbaruar në mjerimin tim.

93 Kurrë e për këtë jetë s'do t'i harroj urdhërimet e tua,
në saje të, tyre ti më mban nëjetë.

94 Yti jam: deh, më shpëto,
 sepse i kërkuj me zell urdhërimet e tua.
 95 Të mbrapshtët mundohen të më humbasin;
 por unë i kujtoj porositë e tua.
 96 Çdo përsosmërie unë i shoh kufirin:
 por Ligji yt kufi nuk ka.

Mem

97 Sa shumë e dua, o Zot, Ligjin tënd:
 gjithë ditën e bluaj me mend!
 98 Urdhri yt më bëri më të dijshtëm se armiqtë e mi,
 sepse gjithmonë është me mua.
 99 Jam më i dijshtëm se të gjithë mësuesit e mi,
 sepse i kujtoj urdhërimet e tua.
 100 Më i dijshtëm j am edhe se pleqtë,
 sepse i mbaj urdhërimet e tua.
 101 Larg i mbaj këmbët e mia nga çdo udhë e së keqes
 për t' i ruajtur urdhërimet e tua.
 102 Nuk u shmangem gjyqeve të tua,
 sepse ti ma dhe Ligjin.
 103 Sa të ëmbla janë për qiellzën time fjalët e tua,
 më të ëmbla se mjalti për gojën time.
 104 Me anë të urdhërimeve të tua fitoj urtinë,
 prandaj urrej çdo udhë gënjeshtre.

Nun

105 Fjala jote është dritëz për këmbët e mia,

dritë për udhët e mia.

106 U përbetova dhe do ta mbaj fjalën:
do t'i ruaj gjyqet e drejtësisë sate.

107 Jam për së tepërmi i përvuajtur, o Zot,

ma përtërit jetën sipas premtimit tënd.

108 Pranoji, o Zot, dhuratat e gojës sime
dhe m'i mëso gjyqet e tua.

109 Jeta ime është gffithmonë në rrezik,
por nuk e harroj Ligjin tënd.

110 Të mbrapshtët vunë leqe kundër meje,

por nuk iu shmanga porosive të tua.

111 Dëshmitë e tua janë trashëgimi im i përhershëm,
janë kënaqësia e shpirtit tim.

112 E përul zemrën time që t'i kryej urdhërimet e tua
përherë e deri në fund.

Samek

113 1 urrej ata qëjanë si mësalla me dy faqe

dhe e dua Ligjin tënd.

114 Përkrenarja dhe shqyti im je ti,
kam besim të plotë, në fjalën tënde.

115 M'u hiqni sysh, o bakëqij,

se dua t'i zbatoj urdhërimet e Perëndisë tim!

116 Më përkrah si më premtove e do tëjetoj

dhe mos më tradhtoftë shpresa ime.

117 Më përkrah e do të shpëtoj,
do të kënaqem vazhdimisht në rregulloret e tua.

118 Ti i urren ata që u shmangen urdhërimeve të tua,

sepse mendimi i tyre është gënjeshtër.

119 Porsi ndryshkun ti i zhbin nga faqja e dheut
bakëq prandaj unë i dua vendimet e tua.

120 Trupi im më dridhet prej frikës sate,
sepse i kam frikë gjyqet e tua.

Ain

121 Veprova me drejtësi e me të drejtë,
mos më dorëzo te shpifësit e mi.

122 Hyr dorëzanë për të mirën e shërbëtorit tënd,
që të mos më shpifën krenarët.

123 Sytë po më shteren prej dëshirës së shpëtimit tënd
dhe të fjalës së drejtësisë sate.

124 Bëj me shërbëtorin tënd sipas dashurisë sate dhe
m'i mëso rregulloret e

125 Unë jam shërbëtori yt,
më jep kuptim t'i njoh vendimet e tua.

126 Koha është të dëftohesh, o Zot,
se e prishën Ligjin tënd.

127 Oh, sa i dua urdhërimet e tua:

më tepër se arin, se gurin e paçmueshëm.

128 Ndërgut i mbaj urdhërimet e tua të gjitha, e urrej
çdo udhë gënjeshtre.

Pe

129 Të mrekullueshme janë vendimet e tua, prandaj i
mban shpirti im.

130 Zbulesa e fjalëve të tua ndriçon:
të miturit i bën të urtë.

131 Hap gojën e marr frymë
i mallëngjyer për porositë e tua.

132 Kthehu prej meje e ki mëshirë për mua
ti që je i drejtë për ata që e duan emrin tënd.

133 Drejtoji hapat e mi sipas fjalës sate,
të mos më sundojë asnjë e keqe.

134 Më shpëto prej shpifjeve të njerëzve,
që t' i ruaj urdhërimet e tua.

135 Ndrite fytyrën tënde mbi shërbëtorin tënd
dhe m' i mëso urdhërimet e tua.

136 Sytë e mi derdhën rrëke lotësh,
sepse nuk mbahet Ligji yt.

Tsade

137 I drejtë je, o Zot,
edhe gjyqet e tua janë të drejta.

138 Ti e ke dhënë Ligjin tënd të drejtë dhe shumë
besnik.

139 Zelli im po më shkrin
kur shoh se armiqtë e mi i kanë harruar fjalët e tua.

140 Fjalët e tua janë me zjarr të sprovuara,

prandaj shërbëtori yt i do ato.

- 141 Jam i ri edhe i përbuzur,
por nuk i kam harruar urdhërimet e tua.
142 Drejtësia jote, drejtësi e përhershme,
Ligji yt është i vërtetë.
143 Vuajta shumë dhe pata vështirësi,
urdhërimet e tua janë kënaqja ime.
144 Dëshmitë e tua janë drejtësi e ămshueshme,
më bëj të kuptoj e do, të kem jetë.

Kof

- 145 Me gjithë zemër të thërras, o Zot, më dëgjo,
dhe do t'i mbaj urdhërimet e tua.
146 Klitha drejt teje, deh më shpëto,
që t'i ruaj vendimet e tua.
147 Para aginiit zgjohem e të thërras në ndihmë,
shpresoj në fjalën tënde.
148 Sytë e mi zgjohen para rojës së natës
për të përsiatur fjalët e tua.
149 Ma dëgjo zërin sipas mëshirës sate, o Zot,
e bëj të jetoj sipas gjyqit tënd.
150 U afruan ata që më salvojnë dijekeqas,
janë larg nga Ligji yt.
151 Por ti, o Zot, je afër,
besnike janë të gjitha urdhërimet e tua.
152 Që moti di për urdhërimet e tua,
se i themelove për ămshim.

Resh

- 153 Shikoje mjerimin tim e më liro,
se nuk e kam harruar Ligjin tënd.
154 Mbroje çështjen time e më shpaguaj,
për hir të Ligjit tënd më përtërit në jetë.
155 Larg është prej mëkatarëve shpëtimi, sepse nuk e
çajne kokën për urdhërimet e tua.
156 Mëshira j ote është e madhe, o Zot,
në fuqi të gjyqeve të tua më përtërit në jetë.
157 Shumë janë ata që më salvojnë e më poshtërojnë,

por unë nuk iu shmanga dëshmime të tua.

- 158 I pashë ata që e lanë rrugën e m'u velën,
sepse nuk i mbajnë fjalët e tua.
159 Shiko, o Zot, se i dua urdhërimet e tua,
më kërthndez në jetë sipas dashurisë sate.
160 Për parim fjalët e tua kanë të vërtetën,
të gjitha gjyqet e drejtësisë sate janë për amshim.

Sin

- 161 Të mëdhenjtë më salvojnë pa arsye,
zemra ime trembet vetëm prej fjalëve të tua.
162 Unë u gëzohem fjalëve të tua porsia ai që fiton pre
të madhe.
163 E urrej rrenën dhe më velet,
kurse Ligjin tënd e kam për zemër.
164 Shtatë herë në ditë ty të thur lavde për gjyqet e
drejtësisë sate.
165 Dashamirësit e Ligjit tënd gëzojnë paqe të madhe,
ata askurrë nuk marrin në thua

166 Ndhimën tënde, o Zot, e pres dhe i mbaj
urdhërimet e tua.

167 Shpirti im i ruan ligjet e tua dhe i desha ato me
gjithë shpirt.

168 I mbaj ligjet e tua e dëshminë tënde,
sepse të gjitha udhët e mia janë para syve të tu.

Tau

169 Le të arrijë tek ti, o Zot, britma ime,
ma ndriço mendjen sipas fjalës sate.

170 Le të dalë lutja ime para fytyrës sate, më libro
ashtu si ma ke dhënë fjalën.

171 Buzët e mia do ta këndojnë këngën e lavdit sepse ti
m'i mësove rregulloret e tua.

172 Gjuha ime le ta këndojë fjalën tënde,
sepse të gjitha urdhërimet e tua janë të drejta.

173 E paça në ndihmë të djathtë tënde,
sepse i zgjodha urdhërimet e tua.

174 E dëshiroj shumë, o Zot, shpëtimin tënd,
kënaqësia ime është Ligji yt.

175 Do të jetojë shpirti im dhe do të të lavdërojë,
në ndihmë do t'i kem gjyqet e tua.

176 U enda poshtë-lart porsi delja e humbur,
kërkoje shërbëtorin tënd
sepse urdhërimet e tua nuk i kam harruar.

KOMENTARI

Ky psalm i përket letërsisë së urtësisë. Shpjegon hollësisht Torën (Ligjin): për këtë qëllim përdoren sinonime të ndryshme për Ligjin si p.sh: kushtet e besëlidhjes, rregullat, vendime gjyqësore, urdhrat, urdhëresat, udhë, rrugë etj. Në të vërtetë

shumica e këtyre fjalëve përdoret te 8 rreshtat e parë. Kuptimi i këtyre fjalëve jepet te psalmi 19.

Ky theks i vazhdueshëm në fjalën e shkruar i ka çuar disa teologë ta paditin psalmistin për idhujtarinë e fjalës, por kjo do të ishte gabim, sepse çdo aludim për Shkrimin e shenjtë ka lidhje me Autorin e tij. Në fakt, qysh nga rr. 4 dhe deri në fund të psalmit, çdo rresht i drejtohet Perëndisë. Psalmi është shkruar në formë akrostike: çdo strofë (8 rreshta) fillon me një shkronjë të ndryshme të alfabetit hebraik.

Në vend që të komentojmë për çdo rresht, e kemi për detyrë të shqyrtojmë çdo temë të psalmit.. Këto janë:

a. KËNAQJE: Tema e vazhdueshme është kënaqja që sjellin këto thënie.. Aludimi i parë për këtë e hasim te rr. 14 dhe 16, të cilët i jep ton për ato që vijnë, me fjalët që përdorin për kënaqje dhe në krahasimin e Shkrimit me pasuritë që ua kalojnë (krhs. «mijëra ar e argjend» te rr. 72; shih edhe rr. 111, 127, 162). Kjo është kënaqja e dishepullit, që gëzohet për bindjen e tij: «Do të ushtrohem në urdhërimet e tua, do t'i kujtoj udhët e tua» (14; krhs. rr. 1: «Lum njeriu me sjellje të pastër, që ecën në Ligjin e Zotit!»)

b. DASHURI: Dashuria është më e thellë se kënaqësia. Këtu te rr. 132 shkojmë në zemrën e çështjes me shprehjen, «ata që duan emrin Tënd» (d.m.th. ty)'. Është për hir të Zotit që i duam Shkrimet në të cilat shfaqet Zoti.. Dëshira e fortë e psalmistit që herë përfytyron si oreks i këndshëm (20, 40), («fjalët e tua . . . , më të ëmbla si mjaltë», 103), herë si urgjencë («me gojë të hapur marr frymë me zor», 131), i referohezt Zotit, siç jep të kuptojë konteksti. rr. 57, mund të parafrazohet «Ti, o Zot, je gjithçka dëshiroj.»

c. FORCA: Por, meqë Shkrimi është tërheqës dhe i hijshëm, këto cilësi kombinohen me forcat. E ngjashme me zërin e Perëndisë, Shkrimi është i tmerrshëm, dhe kjo kuptohet me

përdorimin e shprehjes së fortë «zemra ime trembet vetëm prej fjalëve të tua» te rr. 161 si dhe për metaforën që thotë se Shkrimi i fus të ngjethurat dikujt (120): «Trupi im më dridhet prej frikës sate». Kjo shprehje përdoret për të përshkruar vëgimin e fantazmës së Elifazit te Jb. 4, 15: «flokët e kresë m'u çuan përpjetë ». Forca më qëndruese shprehet në faktin se fjala e Zotit është e drejtë (7, 75, 123, 138, 144, 172), e besueshme (43, 142; dhe aq e patundshme sa qiejt dhe toka (89-91, 152; por Zoti ynë shkoi edhe më tutje kur pohoi se «Qielli e toka do të zhduken, por fjalët e mia nuk do të bien poshtë» (Mt. 24,35).

PËRPARËSITË E SHKRIMIT TË SHENJTË

a. ÇLIRIMI

Thënia «Atje ku Zoti sundon shërbimi i tij ka liri të përsosur» gjendet jo vetëm te rr. 96 por edhe te rr. 45, liri haset te rregullat e Zotit, e jo në lirinë nga ato. Dy elemente në këtë liri janë: thyerja e sundimit të mëkatit (rr. 133), dhe hasje me një urtësi mbinatyrore (rr. 45): «Ty të dëgjoj për të të hapur jetën time. »

b. DRITA

Dy rreshta flasin për dritën. Te rr. 105 ka aludim për «këmbët e mia» dhe «udha ime»: është drita me të cilën mund të ecim (krhs. 128). Por rr. 130 dallon fuqinë e dritës për të zhvilluar një mendje krijimtare, sepse të shikuarit pa dallim nuk vlen asgjë. Lutja e vazhdueshme e autorit është, «Më jep kuptim dhe dallim» (34, 73, 125, 144, 169). Për syrin që mund të dallojë, mashtrimi humb tërheqjen e tij dhe urtësia nga Zoti vjen nga në nivel më të lartë sa urtësi njerëzore..

c. JETA

Kjo është tema e vazhdueshme e shumë lutje, posaçërisht në fundin e psalmit. (pesë herë midis 144 dhe 159). Herë lidhja ndërmjet Shkrimit dhe dhuratës së jetës përbëhet nga një premtim që përvetëson autori (rr. 25, 50, 107, 154); herë

përmbajtja e ligjeve të Zotit e rimëkëmb njeriun (rr. 37) dhe i jep jetë (rr. 93; krhs. Ps. 19,7), sepse drita na drejton tek Ai. Disa herë, përkundrazi, psalmisti lutet për jetë për ta aftësuar t'u përmbahet këtyre rregullave (rr. 88, dhe ndoshta rr. 40).

Frazeologjia e ndryshme si «më përtërij» (25), «jepma jetën» (37, 40, etc.), «ma kurse jetën» (88), «më kërthndez në jetë» (149, 159) – pasqyrojnë nuancat e kontekstit.; por në hebraishten shprehja është e njëjta, që do të thotë 'bëj që të jetoj» dhe kjo 5 pranon varësinë tonë nga gjallëria e Zotit.

Psalmisti s'është legalist, i kënaqur me rendin e ditës: ai kërkon para së gjithash prekjen gjallëzuese të Perëndisë, ndryshe e di se feja e tij do të jetë e vdekur.

d. STABILITET

Rëndësia e stabilitetit shihet mirë te situata kërcënuese te rr. 23, ku Shkrimi mbush një vend të pavëmendshëm. Kjo nuk do të thotë ikje nga realiteti por vëmendje në lidhje me këshillat më të mira («Sepse vendimet e tua janë kënaqësia ime, rregulloret e tua këshillëtares e mia» fq. 24) dhe me çështjet kryesore: vullneti dhe premtimet e Perëndisë që janë më reale dhe më përkatës sa intrigat e keqbërësve. Vg 49, 50 tregojnë psalmistin duke vepruar kështu: Mes shembujve të tjerë sheh rr. 76, 89-92, 95, 114-118; para së gjithash, dëshmia te rr. 165, «Dashamirësit e Ligjit tënd gëzojnë paqe të madhe, ata askurrë nuk marrin në thua. »

JETA DHE KOHA E PSALMISTIT

a. Një botë armiqësore

Ndërsa Perëndia si gjithnjë ka besnikët e tij, dhe psalmisti ka njerëzit e mendimit të tij, (63, 74), pikëpamja e shumicës ishte, siç duket, ajo e skepticizmit fetar (rr. 126), që leviznin nga ata që nuk pranojnë të angazhohen (rr. 113), nëpër ata që ishin plotësisht profanë (rr. 126) deri në ata që kërkojnë të më vrasin (rr. 95).

Sulmet mbi psalmistin përbëhen nga tallja (rr. 22), shpifje, vrasja e karakterit (69) dhe intriga (23, 85). Fakti se autoritetet e persekutojnë duke përdorur dredhi jep të kuptojë se regjimi s'ishte apostat, por rreshta të tilla si te . 87 dhe . 109 tregojnë sa i madh ishte presioni mbi të. Ai është i ri, siç duket (. 9) si dhe i ndjeshëm ndaj përbuzjes (. 39): izolimi i tij e bën depresiv (rr. 141), dhe i tharë (rr. 25, 28, 83). Si Jeremi, edhe një personazh i ndjeshëm, psalmisti është me radhë i trishtuar dhe i zemëruar nga ajo që sheh, duke reaguar herë me lotët (rr. 136) herë me indinjatë (rr. 53, 158).

b. Lufta për mbijetim

Të gjitha këto e shtrëngojnë kapjen e tij për fjalën e Zotit. Si Pali dhe Sila, ai ngrihet në mesnatë për të lavdëruar Zotin megjithëse "Më rrethuan leqet e të patenzonëve" (rr. 61 + ; krhs. 54, 147 +, 164); dhe në shumë pika në këtë psalm është mbresëlënëse të krahasohet depresioni i tij me rreshtin e dytë të strofës ku flitet për qëndrueshmërinë e tij (p.sh. te rr. 81-83). Është gjithashtu me rëndësi të vihet re njerëzimi i tij, sepse njeh tundime për natyrën tokësore të tij (rr. 36 +) si dhe paqëndrueshmëri, dhe ia ka zbuluar veprat e tij Perëndisë (rr. 26), duke ditur se ndërsa parimisht nuk largohet nga rregullat e Perëndisë (rr. 110), në praktikë ai është larguar si dele e humbur dhe duhet kërkuar dhe gjetur (rr. 176). Madje edhe është mirënjohës për pikëllimin që i duhej për të ardhur në vete (67, 71, 75). Përsa u përket vajtimeve të tij të tjera, ato i kalon thesari (162) që ka gjetur te Fjala e Perëndisë. Kështu është gati ta dëshmojë dhe t'ua rekomandojë të tjerëve. (42+, 46) edhe para bashkëbesimtarëve të tij. (79).

c. Dëshira e fortë për të përparuar

Te të gjithë rreshtat, shndrit qëndrueshmëria e qetë e individit që ka zgjedhur të jetojë sipas vendimeve të Perëndisë, duke refuzuar udhë të rremë, duke pranuar persekutim, dhe duke luftuar kundër depresionit. E me gjitha këtë qëndrueshmëri, ai është entuziast për vrapim, dhe siç e tregojnë dy lutjet e tij të

preferuara, i dhënë pas mësimit dhe të ripërtëritet dhe ndezur nga fuqia krijuese e Perëndisë..

PSALMI 120

Armiqtë e paqes

1 *Këngë shtegtimi.*

Në ngushticë e thirra në ndihmë Zotin dhe ai më dëgjo.

2 Më shpëto, o Zot, prej buzëve gënjeshtare,
prej gjuhës qëllimisht gënjyese.

3 Vallë, ç' duhet të të jepet
ose si të shpaguhesh,
o gjuhë qëllimisht gënjyese?

4 Shigjeta luftëtari të mprehta,
të, skuqura me gaca pishash!

5 I mjeri unë që rri në Meshek
dhe banoj në tendat e Kedarit!

6 Tepër gjatë jetoi shpirti im me këta
që e urrejnë paqen!

7 Unë jam për paqe, por kur flas, ata kërkojnë luftë.

KOMENTARI

Këtu fillon një grup prej 15 psalmesh (Ps. 120-134): secili mban të njëjtin titull, Këngë pelegrinazhi ose shtegtimi, hebraisht *aliya*. Kjo fjalë përdoret sot për të shënuar ata që imigrojnë në

Izrael: ata «bëjnë alija». Skenari i këtyre psalmeve do të jetë situata në Izrael pas mërgimit babilonas.

Kuptimi i këtij titulli do të jetë i lidhur me pelegrinazhet për në Tempull në Jerusalem, kështu që ato janë këngë shtegtimi. Para se të mblidheshin për këtë qëllim, siç duket, ato janë me prejardhje të ndryshme. Psalmi 120 ishte kryesisht falënderimi i individit për plotësimin e lutjes. Shumë izraelitë që ishin të pranishëm në festë jo vetëm do të merrnin pjesë në adhurimin e përbashkët, por do ta shfrytëzonin rastin për t'i paraqitur problemet e tyre personale para Zotit me lutje dhe do të pritnin përgjigjen e Tij mëngjesin tjetër. (krhs.1 Sam. 1,3-18).

'Në ngushticë e thirra në ndihmë Zotin dhe ai më dëgjo!' thotë psalmisti. Siç duket, ka aludim për një profeci që ia dha prifti në shërbim: Perëndia do t'ia plotësojë lutjen. Kishte qenë viktimë e gënjeshrave dhe përshtypjes së gabuar. Por tani, pasi e kishte zbrazur zemrën para Zotit dhe pasi kishte marrë sigurimin e Perëndisë, ai ndihet i justifikuar.

Drejtësi hyjnore (rr. 3, 4)

Siç duket, përnjekësit e psalmistit kishin mallkuar veten e tyre për t'u lërë mbresë të tjerëve pohimin e akuzave të tyre të gabuara kundër tij. Psalmisti i përkujton dëshmitë e tyre të rreme dhe i paralajmëron se ata do t'i presë humbja. Meqë kanë pushtuar shigjetat e tyre helmuese (d.m.th. fjalët e tyre hakmarrëse) kundër tij, Zoti do t'i ndëshkojë ata duke u dërguar «shigjeta luftëtari të mprehta, të skuqura me gaca pishash»

Siç e shjeron psalmisti, jetën e ka të vështirë. Njerëzit rreth tij e kanë trajtuar si armik. Ai ka jetuar ndër të huaj paganë: ata nuk janë sjellë me korrektësi. Prandaj ai e ka paraqitur situatën e tij para Zotit.

rr. 6. Populli i Meshekut banonte midis Detit të Zi dhe Detit Kaspik, ndërsa Kedari ishte një fis beduin që banonte në shkretëtirën sirio-arabe. Banorët e këtyre krahinave ishin shumë të larguar nga njeri-tjetri dhe u zgjodhën si shembujt e të huajve

midis të cilëve izraelitët aspak do të ndiheshin në shtëpi, por në rrezik.

PSALMI 121

Rojësi i Izraelit

1 *Këngë shtegtimi.*

Sytë e mi i çoj drejt maleve -
prej nga do të më vijë mua ndihma?

2 Ndhurma ime vjen prej Zotit, i cili krijoi qiellin e tokën.

3 S' do të lejojë të të merren këmbët, nuk do të kotet ai që të ruan.

4 Ja, s' do të kotet as s' do të flejë, ai që e ruan Izraelin.

5 Zoti është rojtari yt,
Zoti është hija jote,
Zoti është në të diathtën tënde!

6 Dielli nuk do të të bëjë keci ditën, as hëna natën.

7 Zoti do të të ruajë nga çdo e keqe, Zoti do ta ruajë jetën tënde.

Zoti do të ruajë vajtjet e ardhjet e tua që tani e përgjithmonë e jetë.

KOMENTARI

Këtë psalm mund ta quajmë ekuivalenti i rreshtit të Fil 4,7:
«Dhe paqja e Perëndisë, që është më e vlefshme se mund ta

mendojmë do t' i ruajë zemrat tuaja dhe mendimet tuaja në Krishtin Jezus.» Fjala kyç është folja *ruaj* që përdoret pesë herë në këtë psalm.

Siç duket, ky psalm është bërë këngë shtegtimi, por fillimisht do të ketë qenë dialog ndërmjet një besimtari izraelit dhe priftit në shërbim në Tempull. Besimtari kërkon bekimin e tij. (krhs. Ps. 91).

Psalmisti është në gjendje të tensionuar. Pyetja e tij zbulon ankthin dhe pamjaftueshmërinë e tij. Për shtegtarin malet do të ishin krahina malësore rreth Jerusalemit, ku gjendej tempulli në të cilin do të adhuronte dhe ku do të forcohej feja e tij. Ndoshta perspektiva e një udhëtimi të rrezikshëm e frikësonte, ose ndoshta malet përfaqësojnë vendet e larta (hebr. *bamot*) ku adhuroheshin idhujtë e pjellorisë. Në këtë rast përgjigjja është negative.

Hëna në lashtësi ishte objekti i frikës për shkak të ndikimit të menduar mbi sistemin nervoz të njeriut. Te Mt. 4, 24; 17, i 5 fjala 'epileptik' do të thotë fffj. 'i goditur nga hëna'

PSALMI 122

Përshëndetje Jerusalemit

1 *Këngë shtegtimi. E Davidit.*

Seç u gëzova kur më thanë:

»Eja të shkojmë në, Shtëpinë e Zotit!«

2 Ja, tashmë këmbët tona shkelën në dyert e tua, o Jerusalem!

3 O Jerusalem, qytet i ndërtuar me mjeshtëri, thuaj se i tëri një, cope të vetme je!

4 Atje ngjiten fiset, fiset e Zotit, sipas rregullores në Izrael për të kremtuar emrin e Zotit.

5 Atje janë selitë e gjykatores së drejtësisë, selitë e shtëpisë së Davidit!

6 Lutuni për paqen e Izraelit:

»U priftë e mbara atyre që, të duan ty!

7 Mbretëroftë paqja në muret e tua dhe qetësia në pirqjet e tua!«

8 Për dashuri ndaj vëllezërve e miqve të, mi do të them:

»Paqja me ty!«

9 Për dashuri ndaj Shtëpisë së Zotit, Perëndisë sonë, do të lutem t'i kesh të gjitha të mirat!

KOMENTARI

Te psalmi 122 skenari është ai i shtegtarit që ka arritur në Jerusalem, por është tani në prag të kthehej në shtëpi, pasi ka ndjekur festën.

rr. 1-2 na thotë se ishte i gëzuar të bashkangjite një grup pelegrinazhesh që ngjitet në Jerusalem. Tani u plotësua qëllimi i udhëtimit dhe ai mund të thotë: «Ja, tashmë këmbët tona shkelën në dyert e tua, o Jerusalem!»

rr. 3-5 na flet për mbresën e tij për Jerusalemin. Fakti që i bën përshtypje është që Jerusalemi shërben për ta bashkuar (*habar*) popullin në një bashkësi (*habarim*) të ngushtë.

Ata që hyjnë në Jerusalem vijnë nga fise të ndryshme, por ata të gjithë i takojnë Zotit: të gjithë janë të motivuar nga bindja ndaj Tij dhe me qëllim ta falënderojnë e ta lavdërojnë. Ata arrijnë në një vend ku, nën mbretin e caktuar nga Zoti, ndahet drejtësi, ku

jepen vendime gjyqësore, d.m.th. ku gjithçka vihet në rregull. (rr. 5).

Te rr. 6-9 është fjalë për lutjen për Jerusalemin. Para nisjes së tij ai i nxit bashkështegtarët e tij të luten për paqen dhe lulëzimin e qytetit, sepse atje ndodhet Tempulli, ku banon Perëndia.

PSALMI 123

Lutja e njeriut të pafat

1 Këngë shtegtimi. E Davidit.

Drejt teje po i lartësoj sytë, e mi, drejt teje që banon në qiell.

2 Qe, porsì sytë e shërbëtorëve drejt dorës së zotërinjve të vet,

porsì sytë e shërbëtores

drejt duarve të zonjës së vet,

ashtu priren sytë tanë drejt Zotit, Perëndisë sonë,

derisa të ketë mëshirë për ne.

3 Ki mëshirë për ne, o Zot, ki mëshirë për ne,

sepse për së tepërmi na kanë mbuluar me përbuzje.

4 Sepse u ngi tepër më shpirti ynë, me përqeshje të të ngopurve,

me përbuzje të krenarëve.

KOMENTARI

Komuniteti fetar vajton nën thundrat e shtypësit. Në këtë psalm vajtimi besimtarët paraqitin lutjet e tyre urgjente para Zotit. Ky është skenari origjinal i këtij psalmi që më vonë u bë kënga e besimit të shtegtarit.

Besimtarët janë viktimat e përbuzura të shtypësve mendjemëdhenj, jeta luksose e të cilëve janë tallja e egër e situatës së tij. Pasi kanë paraqitur problemin e tyre para Zotit, presin me shpresë të tejkalohen rrethanat e tyre.

PSALMI 124

Shpëtimtari i Izraelit

1 Këngë shtegtimi. E Davidit.

Po të mos kishte qenë Zoti me ne – le ta pohojë ballafaqe Izraeli -

2 po të mos kishte qenë Zoti me ne, kur njerëzit u ngritën kundër nesh:

3 atëherë do të na kishin përpirë gjallë, kur u mori flakë zemërimi kundër nesh.

4 Atëherë ujët do të na kishte marrë,
rrjedha e përroit do të na kishte marre,

5 do të na kishin mbytur valet e ujërave të tërbuara!

6 Lavdëroftë Zoti që s'na dha kafshatë për dhëmbët e tyre!

7 Shpirti ynë shpëtoi si trumcaku
prej gracke të gjuetarëve:
laku u këput e ne shpëtuan!

8 Ndihma jonë është në emër të Zotit,
që krijoi qiellin e tokën.

KOMENTARI

Me prejardhje ky ishte psalm falënderimi të përbashkët. Kombi izraelit u mblodh për të lavdëruar Zotin për një çlirim dramatik nga një krizë që kishte kërcënuar ekzistencën e mbarë popullit. Me kalimin e kohës ky psalm përdorej si këngë shtegtari që përmbodhi ndihmën e Zotit në të kaluarën. Po të mos ishte Zoti në anën tonë, do të shfaroseshim. Herë pas here populli shpëtoi tamam në kohë. Drejtuesi i korit këndon rreshtin e parë, dhe kongregacioni bashkohet për të kënduar.

PSALMI 125

Perëndia i mbron të vetët

1 Këngë shtegtimi.

Kush shpreson në Zotin është si mali Cion: s'ka gjë që e tund, mbetet për amshim!

2 Malet e rrethojnë Jerusalemin: edhe Zoti rreth e rreth i rri popullit të vet qysh tash e për amshim.

3 Askurrë s'do të sundojë skeptri i të pafeve mbi trashëgimin e të drejtëve që të drejtët të mos i shtrijnë duart në paudhësi.

4 Bëju mirë, o Zot, njerëzve të mirë edhe atyre që e kanë zemrën të drejtë.

5 Kurse ata që shkojnë udhëve të ligësisë le t'i zhbijë Zoti bashkë me keqbërësit Paqja qoftë mbi Izraelin!

KOMENTARI

Juda ishte, siç duket, nën thundrat e një fuqie të huaj me të cilën disa çifutë bashkëpunonin dhe kështu mohonin fenë e të parëve. Nga një situatë e tillë doli ky psalm i besimit të Zotit. Ekvivalenti në DhR është 2 Tim. 2, 12. 19. «Nëse qëndrojmë besnikë, bashkë me Të do të mbretërojmë. Nëse i biem mohit, edhe Ai do të na bjerë mohit. Nëse ne nuk i jemi besnikë — Ai mbetet besnik! Sepse Ai kurrësesi nuk mund ta mohojë vetveten!»..... «Megjithatë, themeli i fortë i vënë prej Zotit qëndron i palëkundshëm — është nën këtë vulë: »Zoti i njeh ata që janë të tijtë.« dhe: »Secili që e rrëfen emrin e Zotit, le t'i largohet së keqes!«

Jerusalemi është simbol i fuqisë mbrojtëse të Zotit dhe fuqia shtypëse nuk do të ketë fjalën e fundit. Një ditë Zoti do të rimëkëmbë Cionin. Në fund kolaboracionistët do të humben. Vetëm besimtarët e vërtetë do ta trashëgojnë tokën e premtuar. Siç thotë apostulli Pali: »por çifuti i vërtetë është në brendësi, edhe rrethprerja e vërtetë është në zemër, sipas shpirtit e jo sipas gërmës së Ligjit. Lavdia e çifutit të vërtetë nuk vjen nga njerëzit, por prej Perëndisë.« (Rom 2,29).

PSALMI 126

Këngë riatdhesimi

1 *Këngë shtegtimi.*

Kur Zoti i ktheu robërit e Cionit, na dukej si të ishim në ëndërr.

2 Atëherë goja na u mbush me gaz

3 gjuha jonë ia thoshte këngës së gëzimit!

Asohere thuhej ndër paganë: »Zoti bëri për ta punë të mëdha!«

3 Vërtet Zoti bëri për ne mrekulli e zemrat na u mbushën me gëzim!

4 Ktheji, o Zot, robërit tanë porsì përrrenjtë e mesditës!

5 Ata që mbjellin me lot, deh, le të kortin me gëzim!

6 Në të shkuar ecnin e qanin
duke mbajtur farën për ta mbjellë,
kurse në kthim do të vijnë plot gëzim
duke mbajtur dorëzat e veta.

KOMENTARI

Ky psalm shtegtari e kishte prejardhjen në kohën e ngushticës kombëtare. Psalmisti sjell ndër mend bekimet e kaluara, lutet për ripërtëritje dhe shënon përgjigjen e Zotit të kësaj lutjeje.

Te rr. 4 «Kur Zoti i ktheu robërit e Cionit» do të jetë aludim për kthimin nga mërgimi babilonas. Madje edhe paganëve u la mbresë të mirë: ata duhet ta pranojnë se Perëndia i Izraelit përgjigjet për këtë çlirim. Megjithatë për komunitetin çifut situata vijuese ishte «dita e fillimeve të pakreni» (Zak 4,10). Kështu komuniteti i lutet Zotit për bekime të ardhshme. Sikurse në stinën e shiut, waditë e Negevit bëheshin rrëke, edhe ata kërkonin rimëkëmbjen shpirtërore të Zotit.

Te rr. 6 ka edhe një interpretim shpirtëror: Izraelitët i përshpirtshëm u shpërndanë si misionarë në mbarë botën, por do të kthehen së bashku me paganët e kthyer (kisha) në fe të vërtetë, frytin e të korrave shpirtërore. Kisha e herët në fillim përbëhej pothuajse nga çifutë të kthyer.

PSALMI 127**Dorëzimi provanisë**

1 *Këngë shtegtimi. E Salomonit.*

Nëse Zoti nuk e ndërton shtëpinë,
kot mundohen ata që e ndërtojnë.

Nëse Zoti nuk e ruan qytetin,
kot rri zgjuar ai që e ruan.

2 Kot e keni të çoheni para drite dhe vonë të shkoni në
pushim,
ju që e hani bukën e mundit: të dashurve të vet u j ep edhe
në gjumë.

3 Ja: bij të janë dhuratë e Zotit, fryti i barkut është
shpërblimi i tij.

4 Porsi shigjetat në dorën e trimit të tillë janë djemtë e
rinisë.

5 Lum ai burrë që e mbushi kukurrën me të tillë: s' do të
turpërohet kur të fjaloset me armiq në log.

KOMENTARI

Në Izraelin e lashtë mësohej që besimtari duhet të lidhë me Zotin çdo aspekt të jetës së përditshme. Kështu lulëzim lidhej me bekimin e Zotit, kurse dështim me pakënaqësinë e Tij, dhe ky ishte parim i dobishëm (krhs. Mt. 6, 33), por më vonë u konstatua që jeta mund të jetë më komplekse: nganjëherë Zoti na vë në provë. (krhs. Job; Hab. 3, 17 +; Rom. 8, 35-39). rr. 3-4 «Lum ai burrë që e mbushi kukurrën me të tillë: s' do të turpërohet kur të fjaloset me armiq në log». Bijtë do të jenë bekim sepse do të mund ta mbrojë atin në pleqëri të tij. Po të

ishte paditur padrejtësisht, bijtë e tij mund ta mbronte. Familja vërtetohet si njësi themelore e shoqërisë, si burim ngushëllimi dhe force, por edhe sferë e përgjegjësisë.

rr. 26 Mund të kuptohet se Zoti aq bekon punën e ditës sa që puna jashtë orarit s'është e nevojshme. Ka mundësi që fjala gjumë të jetë aramaizant për lulëzim.

PSALMI 128

Bekimi – dhuratë për besimtarin

1 *Këngë shtegtimi.*

Lum njeriu që e druan Zotin, që ecën udhëve të tij!

2 Do të ushqehesh prej punës së duarve të tua,
i lumi ti, mirë do të kalosh!

3 Gruaja jote: vresht plot fruta në dhomat e shtëpisë sate;
djemtë e tu: pinjoj ulliri përreth tryezës sate!

4 Ja, se si lavdërohet njeriu që e druan Zotin!

5 Të lavdëroftë Zoti prej Cionit e pafsh lumturinë e
Jerusalemit në të gjitha ditët e jetës sate

6 dhe i pafsh djemtë e djemve të tu! Paqja qoftë mbi
Izraelin!

KOMENTARI

Ky psalm është shembull i mësimit priftëror të dhënë me rastin e festës drejtuar popullit të mbledhur.

Sekreti i bekimit është jeta kushtuar Zotit me bindje ndaj vullnetit moral të tij. (rr. 1, 4). Ç'është bekimi? Bekimi është gëzimi i kënaqur i fryteve së punës së drejtë (krhs Lev. 26, 15 +; Is. 65, 21 +). Bekimi është kënaqësia e gruas dhe familjes.

Hardhia dhe ulliri janë simbole për pjellori që jep Zoti. (krhs. Lp. 8, 7-10).

PSALMI 129

Kundër armiqve të Cionit

1 Këngë shtegtimi.

Shpeshherë më luftuan që prej rinisë sime – le të thotë tashti Izraeli -

2 shpeshherë më luftuan që prej rinisë sime, por s'ia dolën dot kundër meje!

3 Mbi shpinën time lëvruan lavëtarët, bënë hulli të gjata!

4 Por Zoti i drejtë i këputi leqet e mëkatarëve.

5 U turpërofshin dhe u zbrapsshin të gjithë ata që e urrejnë Cionin.

6 Bar pullazesh u bëfshin që thahet para se të nxirret,

7 me të cilin s'e mbush dorën ai që korr, as sqetullën ai që mbledh duajt,

8 e ata që kalojnë përbri nuk thonë: »Bekimi i Zotit qoftë mbi ju! Ju lavdëroj më në emër të Zotit! «

KOMENTARI

Psalmet 129 -131.

Treshja e katërt, ndryshe nga psalmet e mëparshme, ka vetëm një aludim për Cionin. (129,5). Ndërsa psalmet 121 dhe 124 kanë për temë kundërshtimin e jashtëm (të varura nga rrethinat njerëzore), te psalmet 129 dhe 130 theksohen kërcënime të brendshme, personale si p.sh. ankthi dhe mëkati. Por shtegtimi mbetet tema kryesore. Te Ps 120, falë Zotit të

drejtë, Izraeli shpëtoi (1-4) kurse armiqtë janë të humbur. Për të tijtë, Zoti është burim dashurie (4) dhe lirimi (7). Këtej, te psalmi 131, theksohet që ka pushim zemre dhe shpresë te Zoti.

Komuniteti pas mërgimit është mbledhur rreth Jerusalemit, por është viktimë e shtypjes. Në praninë e Zotit ata i japin zemër njëri-tjetrit dhe i luten Zotit që të bëjë të dështojnë qëllimet e armikut.

Drejtuksi i korit thyen heshtjen e popullit të mbledhur të dëshpëruar për ta ftuar të bashkohet me të për të kujtuar të kaluarën, për ta parë situatën e tyre nga perspektiva e historisë. Persekutimi s'është gjë e pazakonshme për popullin e Zotit. (krhs. 1 Pjet. 4, 12). Kombi, këtu i personifikuar, ka njohur vajtim qysh nga robëria e tij në Egjipt. (krhs. Hos. 2, 15; 111, 1). Isaia 51,23: "Përndjekësve të tu në dorë do t'ua vë, atyre që ty të thoshin: »Bëju urë të kalojmë mbi ty!«, urë ua bëre shpinën tënde, porsì udhë për kalimtarë." Por të shpëtuar, po, por jo të lënë, të hedhur andej-këndeì po, por jo të rrëzuar», (2 Kor. 4, 9). Por çfarë ishte shkaku i qëndrueshmërisë së tyre? Besnikëria ndaj besëlidhjes: çdo herë Perëndia theu zgjedhën e robërisë.

Cioni është gur prove të qëllimeve të Zotit. Kundërshtarët e tij do të humbasin. Qëndrimi i të tjerëve ndaj popullit të Perëndisë cakton qëndrimin i Tij ndaj tyre.. «Kush do t'ju prekë ju, prek beben e syrit tim!» (Zak. 2, 12; krhs. Mt. 25, 31-46, 34, 41).

PSALMI 130

Shpresa në Zotin

1 Këngë shtegtimi.

Prej humnerës klitha tek ti, o Zot,

2 o Zot, dëgjoje britmën time!

Le ta dëgjojnë veshët e tu, zërin e lutjes sime.

3 Nëse do t'i pash mend paudhësitë, o Zot, O Zot,

e kush do të qëndrojë para teje?

4 Por tek ti gjendet falj a që të dimë të të druajmë.

5 Shpresoj në ty, o Zot,

shpirti im shpreson në premtimin e tij.

E pret

6 shpirti im Zotin

më tepër se rojtarët agimin.

Më tepër se rojtarët agimin

7 le të shpresojë Izraeli në Zotin,

sepse te Zoti është mëshira

dhe i madh është tek Ai shpërblimi.

8 Ai do ta nxjerrë Izraelin

prej të gjitha paudhësive të tij.

KOMENTARI

Një individ izraelit merr pjesë në shërbesën në Tempull, duke rrëfyer nevojën e tij për ndjesë. Ky psalm u bë psalm shtegtimi sepse e përgatit adhuruesin për adhurimin vijues të Perëndisë së shenjtë në Tempull. Ai ishte i bindur që rebelimi i tij është fajtor për rrezikun në të cilin gjendet, dhe ai e rrëfen.

(Rom. 3,23; krhs. 1 Mbr. 8,46; Ps. 143,2). Psalmisti është i ndjeshëm për largimin e tij nga Zoti. Ai e di se ndjesa nuk mund të pranohet pa pendim dhe respekt të thellë. Reagimi i tij duhet të jetë devotshmëria dhe dëgjesa.

Psalmisti i drejtohet kongregacionit dhe ndan me ta shpresën e tij personale. Ai pret sigurinë e mëkateve të falura, të cilën do ta japë prifti në mëngjes. (krhs. 107, 20; 143, 8; Vaj. 3, 57).

PSALMI 131**Shpirti i femijërisë**

1 *Këngë shtegtimi. E Davidit.*

O Zot, nuk krenohet zemra ime as s'madhështohen sytë e mi, as nuk jepem pas punëve të mëdha, as pas sendeve që janë mbi fuqi të mia.

2 Vërtet shpirtin e kam të qetë e të kthjellët, si foshnja e mëkuar në parzmën e nënës, si kërthi është shpirti im në mua.

3 Le të shpresojë Izraeli në Zotin tash e për gjithmonë e jetë.

KOMENTARI

Individi sjell kontributin e tij në shërbesën në Tempull: është besimi dhe nënshtrimi. Ky ka kuptuar vlerën e besimit të qetë të Zoti si dhe marrëzinë e mendjemadhësisë. Nuk merret me gjërat që s'i rrok truri..

Lë të kuptohet se u desh të kalojë nëpër shumë stuhi të egoizmit. Por tani ka arritur në një marrëdhënie të pjekur me Zotin.

Ashtu si te Ps. 130 kjo poemë zhvillohet nga lutja drejtuar Zotit në nxitimin e besimtarëve të tjerë. Duke nisur nga pjekuria e fesë psalmisti e këshillon kongregacionin të mbajë një qëndrim besimi dhe shprese.

PSALMI 132**Në përvjetorin e kalimit të Arkës së Besëlidhjes**

1 Këngë shtegtimi.

Të të bjerë në mend, o Zot, Davidi
e gjithë mirësia e tij,

2 si iu përbetua Zotit,

si iu kushtua të Pushtetshmit të Jakobit:

3» Nuk do të hyj nën pullazin e banesës sime,
nuk do të bie në shtrojën e shtratit tim,

4 nuk do t'u jap gjumë syve të mi,
s' do t'i lë të koten qepallat e mia,

5 pa e pasë gjetur një vend për Zotin, një banesë për të
Pushtetshmin e Jakobit.«

6 Ja, dëgjuam se është në Efratë, e kemi gjetur në Fushat e
Jaarit!

7 Le të hyjmë në tendën e tij,

të adhurojmë te shtroja e këmbëve të tij!

8 Ngrihu, o Zot, eja në vendin e pushimit tënd,
ti dhe arka e Pushtetit tënd

9 Priftërinjtë e tu le të veshen me drejtësi,
shenjtërit e tu le të brohoritin me galdim.

10 Për dashuri të shërbëtorit tënd Davidit,
mos e përbuz fytyrën e Mesisë tënd!

11 Zoti iu përbetua Davidit për të vërtetën,

asses i s' do ta shkelë fjalën e dhënë: »Bamin e kraharorit
tënd

do ta vë mbi fronin tënd!

12 Nëse bijtë e tu do ta ruajnë Besëlidhjen time dhe vendimet e mia që do t'ua mësoj, po edhe bijtë e tyre përgjithmonë do të rrinë përmbi fronin tënd.«

13 Sepse Zoti e zgjodhi Cionin,
e pëlqeu për banesë të veten:

14 »Ky do të jetë vendi i pushimit tim përjetë,
këtu do të banoj sepse vetë e dëshirova.

15 Do t'i lavdëroj e do t'i rilavdëroj prodhimet e tij,
skamnorët e tij do t'i ngij me bukë.

16 Priftërinjtë e tij do t'i vesh me shpëtim,
shenjtërit e tij do të brohoritin me galdim.

17 Atje do të bëj t'i ngallitë Pinjolli Davidit,
do ta përgatis dritëzën për të shuguruarin tim.

18 Armiqtë e tij do t'l veàh me turp, kurse mbi kokën e tij
do të shkëlqejë kurora e tij!«

KOMENTARI

Ky kompozim para mërgimit i takon ceremonisë që sillte ndërmend transferimin e arkës nga Davidi në Jerusalemin. Ndahet në dy pjesë: lutjet për mbretin që sundon kushtohen në kuadër të kësaj ceremonie 1-10) dhe pastaj plotësohen pozitivisht. (11-18).

Davidi i betohet Zotit (rr. 1-5)

Perëndia nxitet të bekojë mbretin e tanishëm për shkak të veprave të themeluesit të dinastisë (krhs. rr. 10). Davidi u mund

me ngulm ta sjellë arkën nga Kiriati Jearimi dhe të planifikojë banesën e përhershme për të në trajtë të Tempullit. (2 Sam. 6-7; 1 Kr. 28-29). Bëri një premtim solemn që të mos pushojë derisa të plotësoheshin ambiciet e tij. Përkrahësi i popullit të besëlidhjes e meritonte.

Kortezhi dhe lutjet e publikut (rr. 6-10)

Siç duket, ceremonia e shenjtë të 2 Sam. 6, 12-15 riprodhon këtë ngjarje. Kori luan rolin e Davidit dhe burrat e tij që dëgjuan për vendndodhjen e arkës dhe shkuan në Kirjat Jearim (Jaar) për ta transportuar në Jerusalem. Kori i nxit bashkardhuresit të shkojnë në kortezh në Tempull për ta përfunduar ceremoninë para arkës, e cila ishte mbështetësa e fronit të Zotit (krhs. 1 Anal. 28, 2), pasi të jetë vendosur rishtas në shenjëroren e brendshme. Por tani pret për t'u mbajtur në kortezh. Te rr. 8 brohoritet me ngritjen e arkës (krhs. Nr. 10, 35), duke iu drejtuar Perëndisë për të cilën arka ishte simbol i pranisë së tij. Shpresohet që mbartësit do të jenë të denjë për këtë detyrën e shenjtë (fj. drejtësi). Te lutja përfundimtare shprehet dëshira për bekimin e mbretit.

Në përputhje me besëlidhjen së lidhur me Davidin, e drejta hyjnore e përkrah mbretin e tanishëm në pozitën e tij të fuqisë (brirë) dhe stabilitet (llamba që ndizet përherë. krhs. Lev. 24, 2; 1 Mbr. 11: 36).

PSALMI 133

Jeta vëllazërore

1 Këngë shtegtimi. E Davidit.

Oh, sa punë e mirë e gjë e bukur është kur vëllezëit jetojnë së bashku:

2 si vaji ai më i miri në krye, që zbret në mjekër, në mjekrën e Aronit, që zbret kindeve të petkave të tij, 3 porsiva në Hermon, që bie në malet e Cionit. Sepse atje Zoti e jep bekimin, jetën e amshueshme.

KOMENTARI

Vëllazëria e shtegtarëve

Sfondi i këtij psalmi do të jetë harmonia që mbretëronte ndërsa shtegtarët po takoheshin në Jerusalem. Uniteti i vërtetë e ka prejardhjen në dëgjesën e shtegtarëve, sepse Perëndia u jep, (krhs. foljen – *jored*, zbritet) dhe nuk mund të prodhohet artificialisht.

Ky unitet i cili është pasoja e përkushtimit të përbashkët krahasohet me fragrancën që vinte nga ulja që u derdh mbi kokën e kryepriutit që zbritet në jakën e rrobave të tij kështu që vetë rrobat e tij kundërmonin me fragrancën e uljes. Ky unitet krahasohet gjithashtu me vesën që zbret nga mali Hermon, i cili ishte burim i jetës fizike të kombit që varej nga uji. Fjala Jordan vjen nga folja *jarad* (zbritet). Gjithkund në vend shtegtarët do t'i afroheshin Jerusalemit për të kremtuar festën. Turma ishte simbol për unitetin e komunitetit, të lidhur me një fe të përbashkët.

PSALMI 134

Lavdi për liturgji nate

1 *Këngë shtegtimi.*

Tani lavdërojeni Zotin
të gjithë ju, shërbëtorët e Zotit,
që qëndroni natën në Shtëpinë e Zotit.

2 Ngritni duart tuaja drejt Shenjtërores
e lavdërojeni Zotin!

3 Prej Cionit të lavdëroftë Zoti
që krijoi qiellin e tokën!

KOMENTARI

Ky psalm përdorej në një sërë shërbesash të përnatshme sipas traditës çifute që mbaheshin gjatë festës së tëbanave (krhs. 1 Kr. 9, 33; Is. 30, 29). Ka alternim midis kongregacionit dhe priftërinjve. Në fund priftërinjtë e bekojnë kongregacionin me një bekim që do t'i shoqërojë ata që kthehen në shtëpi nën mbrojtjen e Zotit.

PSALMI 135

Himn lavdie

HALELUJA!

Lëvdojeni emrin e Zotit,
lëvdojeni ju, o shërbëtorët e Zotit,
2 që qëndroni në Shtëpinë e Zotit,
në oborret e Shtëpisë së Perëndisë sonë.

3 Lavdëroni Zotin sepse i mirë është Zoti,
këndoni emrit të tij sepse është i ëmbël!

4 Sepse Zoti e zgjodhi Jakobin për vetc, Izraelin për
pronën e vet.

5 Unë e di mirë se i madh është Zoti, Perëndia ynë është mbi të gjithë hyjtë.

6 Gjithçka do Zoti bën në qiell e në tokë, në det e në të gjitha humnerat.

7 Bën të mblidhen retë prej skajeve të tokës, me vetëtima e prodhon shiun, erën e nxjerr nga vendet e strehimit.

8 Ai Egjiptit ia mbyti të parëlindurit si të njerëzve ashtu edhe të, bagëtimeve.

9 Bëri shenja e mrekulli midis teje, o Egjipt, kundër faràonit e të gjithë shërbëtorëve të tij.

10 Shfarosi një numër të madh paganësh, vrau sa mbretër të fortë:

11 Sihonin, mbretin e amorasve e Ogun, mbretin e Bashanit, i rroposi të gjitha mbretëritë e Kanaanit,

12 e tokën, pronën e tyre, ia dha Izraelit, popullit të vet, për trashëgim.

13 O Zot, ri yt është i madhërueshëm, kujtimi yt, o Zot, prej breznie në brezni!

14 Zoti e mbron popullin e vet, ka mëshirë për shërbëtorët e vet.

15 Idhujt e paganëve janë ar e argjend, prodhim i duarve të njerëzve:

16 e kanë gojën, por nuk flasin, i kanë sytë, por nuk shohin,

17 i kanë veshët, por s'dëgjojnë,

as nuk kanë frymë në gojën e tyre.

18 Porsi ata do të jenë edhe ata që i punuan,
të gjithë ata që shpresojnë në ta.

19 Shtëpia e Izraelit, lavdëroje Zotin,
shtëpia e Aronit, lavdëroje Zotin,
20 shtëpia e Levit, lavdëroje Zotin,
lavdërojeni Zotin të gjithë ju, që e druani Zotin!

21 Nga Cioni qoftë bekuar Zoti
që banon në Jerusalem. Haleluja.

KOMENTARI

Ky himn i festës kremton madhësinë dhe hirin e Perëndisë së Izraelit që është besnik ndaj besëlidhjes që ka lidhur me popullin e tij. Fenomenet e kohës të rr.7 japin të kuptojnë se bëhet fjalë për festën e tëbanave në vreshtë.

Thirrja e parë për adhurim (rr. 11-4)

Kongregacioni nxitet të këndojë lavdërimet e Perëndisë (krhs. 113, 1). Adhurimi në kohën e DhV ishte themeluar në personin dhe veprën e Perëndisë (d.m.th. në namin e tij) Shkaku i parë është vetëshfaqja e Zotit. Shkaku i dytë është zgjedhja e komunitetit dhe fakti se ata i takojnë Atij. (krhs. Lp. 7, 6; 1 Pjt. 2, 9). Ata me mirënjohje sjellin ndërmend kohën e lidhjes së besëlidhjes të mali i Sinait (Dal. 19, 3-6).

Soloisti këndon për bindjen e tij rreth madhësisë dhe karakterit unik të Zotit. Mbarë gjithësi është në shërbim të vullnetit të Tij të gjithëfuqishëm, e jo të ashtuquajturve perëndi të

kombeve të tjera. Stina e shiut me stuhi dhe erën është nën kontrollin e Zotit, e jo nën kontrollin e baalit kananas, me gjithë pretendimet e adhuruesve të tij. Ai është gjithashtu zoti i historisë dhe autori i veprave të shpëtimit si p.sh i Daljes dhe Pushtimit të tokës së premtuar (krhs. Veprat 4, 24, 27 +). Sihoni dhe Ogu në Transjordani kanë luajtur një rol të rëndësishëm në traditën e Izraelitit, sepse ishin fryti i parë i pushtimit (Nr. 21, 21-24, 33-35). Zoti e formoi historinë në sajë të popullit të zgjedhur për t'i dhënë tokën e premtuar. Ky citim krenar i veprave të lashta s'është preokupim me ngjarjet e kaluara. Zbulimi i tij i natyrës dhe vullnetit të tij do të jetë përherë relevant dhe meriton përkujtim të përhershëm me adhurim. Patronati i kaluar i popullit të tij është garanci që Zoti do të kujdeset për ta edhe në të ardhmen (krhs. Lp. 32, 36; Rom. 5, 9 +; Gal. 2, 20).

Perënditë e kombeve përreth që ishin gjithnjë tundim për Izraelin. (krhs. Lp. 6, 12-15), mohohen formalisht. Kështu nënkuptohet se shpallet lavdërimi i Perëndisë vepruese të vërtetë.

Çdo sektor i komunitetit fetar nxitet të bëjë kontributin e tij në shërbesën, kështu që sigurohet harmonia e lavdërimit. (krhs. Rom. 15, 6). Jofetarët, priftërit aronikë dhe levitët ndihmës mblidhen në Tempull, banesën e Zotit, për të adhuruar mikpritësin e tyre.

PSALMI 136**Litani të mëdha falënderimi****1 HALELUJA!**

Lavdëroni Zotin, sepse është i mirë, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

2 Lavdëroni Perëndinë e hyjnive, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

3 Lavdëroni Zotin e zotave, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

4 Ai i vetmi bëri mrekulli të mëdha, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

5 Me dije të madhe Ai e krijoi qiellin, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

6 Ai e forcoi tokën mbi ujëra, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

7 Ai i krijoi dritëdhënësit e mëdhenj” sepse e amshueshme është, dashuria e tij!

8 Diellin që ta sundojë ditën, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

9 Hënë dhe yjet që ta sundojnë natën, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

10 Ai e goditi Egjiptin në të parëlindurit e tii, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

11 Ai e nxori Izraelin nga mesi i tyre, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

12 Me dorë të fortë e me krah të fuqishëm, sepse e amshueshme është dashuria e tij!

- 13 Ai e ndau dysh Detin e Kuq, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 14 E kaloi Izraelin për mjedis të tij, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 15 E plandosi faraonin e ushtrinë e tii në Detin e Kuq, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 16 E udhëhoqi popullin e vet nëpër shkretëtirë, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 17 Ai i goditi mbretërit e mëdhenj, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 18 Vrau mbretër të fuqishëm, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 19 Sihonin, mbretin e amorasve, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 20 Edhe Ogun, mbretin e Bashanit, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 21 Dhe i dhuroi tokën, pronën e tyre, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 22 për trashëgim Izraelit, popullit të vet, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 23 Ai na kujtoi në përvujtërimin tonë, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 24 Ai na shpëtoi nga armiqtë tanë, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 25 Ai u jep ushqim të gjitha gjallesave, sepse e amshueshme është dashuria e tij!
- 26 Lavdërojeni Perëndinë e qiellit, sepse e amshueshme është dashuri a e tij!

KOMENTARI

Ky psalm është gjithashtu himn lavdërimi në të cilin Perëndia lavdërohet për shfaqjen e tij në krijim dhe në histori. Është antifonik: gjysma e parë e çdo strofe recitohet nga një këngëtar priftëror, kurse refreni këndohet nga kori ose kongregacioni (krhs. 2 Kr. 7, 3; Ezr. 3, 11).

Adhurimi në DhV s'ishte sentimental ose i paqartë, por i themeluar në aspektet praktike dhe personale të Perëndisë. Theksohen këtu dashamirësia dhe gjithëfuqishmëria e Zotit: ato të gjitha janë garanci për qëndrueshmërinë e dashurisë të tij ndaj popullit të tij.

Kur Perëndia sjell ndërmend, kjo do të thotë se ai vepron në përputhje me një premtim të kaluar ose në përputhje me një marrëdhënie të lidhur. Është falë Tij se Izraeli gëzoi liri dhe fitore kundër të gjitha parashikimeve. Përveç kësaj bekimi i tij nuk i përket së kaluarës, por ende vlen për të gjithë ata që besojnë tek Ai. Dëshmia e fundit për kujdesin e tij është furnizim i ushqimit për të gjitha krijesat e tij, dhe kjo do ta lidhë këtë psalm me kremtimin e të korrave. (krhs. 104, 27 +).

PSALMI 137

Baladë mërgimi

1 Mbi lumenj të Babilonit, atje rrinim e lotonim e nëpër mend shkonim Cionin. 2 Në shelgje, në mes të tij, qestet tona në gem i varëm.

3 Shi atje shpërngulësit tanë t' u këndojmë prej nesh
kërkuan, të gëzohemi shtypësit urdhëronin: »Na i këndoni
këngët e Cionit!«

4 Po si mundim t' i këndojmë këngët e Zotit në dhe të
huaj?

5 Oh, m' u thaftë-o krahu mua, Jeruzalem për në të
harrofsha,

6 për qellzë gjuha m' u kaptë mua, të të kujtoj ty nëse unë
pushhofsha, në mos e vënça Jerusalemin mbi të gjitha
gëzimet e mia!

7 Mbajua mend, Zot, edomasve që në ditë të zezë të
Jerusalemit:

»Rrënojeni – të pashpirtët thoshin rrënojeni gjer në
themele!«

8 Bijë shkatërruese e Babilonit, i lumi ai që ty të hakmerret
për të këqijat që na i bëre; i lumi ai që foshnjat e tua i kap
e i përplas për shkëmbi!

KOMENTARI

Librat e historisë së Izraelit kanë prirje të jenë emocionalisht
neutralë, por ky psalm vajtimi zbulon ndjenjat e një mërgimtari
çifut i kthyer në shtëpi, i cili rijeton ngjarjet tragjike lidhur me
rënien e Jerusalemit dhe me deportacionin për në Babiloni.
Fjalët kyç që lidhin tri sektoret e psalmit janë *Kujtohu* dhe
Jerusalem (ose Cion). Mjerimi i këtyre ndodhive theksohet me
përdorimin e mbaresave hebraike *-nu* (ne, e mi), siç haset tek Is.
53, 4-6.

Mërgimtarët e kthyer në atdheun e tyre dëshmonin përsëri shkretimin që sillnin ndërmend. Vetëm pas kalimit të 22 viteve pas kthimit nga mërgimi më 538 B.C. u rindërtua tempulli i dikurshëm që rrinte në gërmadha. Nxiheshin gjakrat kundër edomasve, kombit të afërm, të cilët i kishin tradhtuar vëllezërit e tyre duke plaçkitur Jerusalemin dhe duke i dorëzuar ata te babilonasit (krhs. Ob. I I-14). I kërkohet Perëndisë që të ndëshkojë kolaboracionistët. Kërkohet parimi hyjnor i dhëmb për dhëmb e sy për sy (krhs. Dal. 21, 24; Lp. 19, 21). Lufta në lashtësi zhvillohej kundër brezit të ardhshëm duke vrarë edhe foshnjat (krhs. Hos. 10, 14; 13, 16), dhe në dritën e rr. 8 kjo kishte qenë edhe përjetim i Izraelit. Ndoshta psalmisti citon një profeci (krhs. Is. 13, 16; Jer. 51, 56), duke i kërkuar Zotit që të hakmerret për hir të namit të tij.

PSALMI 138

Himn falënderimi

1 I Davidit.

Me gjithë shpirt të falënderoj, o Zot, sepse i dëgjove fjalët e gojës sime. Të këndoj në praninë e engjëjve,

2 adhuroj në drejtim të Tempullit tënd të shenjtë. E lavdëroj emrin tënd për dashurinë e besnikërinë tënde, sepse e madhërove plotësisht premtimin tënd.

3 Sa herë të thirra në ndihmë, ti më vështrove, shpirtit tim ia kërthndeze fuqinë.

4 Do të të lavdërojnë, o Zot, të gjithë mbretërit e tokës
sepse i dëgjuan premtimet e gojës sate.

5 Do t'i këndojnë udhët e Zotit, sepse e madhe është
lavdia e Zotit;

6 sepse i Lartë është Zoti e i shikon të përvujtët e prej së
largu i dallon krenarët.

7 Kur të më duhet të eci në mes të vështirësive, ti ma ruaj
jetën,

shtrije dorën kundër zemërimit të armiqve të mi e më
shpëto me të djathtën tënde.

8 Çka kam filluar, Zoti do ta kryejë për mua. E
amshueshme është, o Zot, mirësia jote: mos e përbuz
veprën e duarve të tua!

KOMENTARI

Duket qartë se ky psalm është këngë falënderimi. Disa ekspertë e lidhin me mbretin davidik, kurse të tjerë me autorin që flet në emër të komunitetit pas mërgimit, për të falënderuar Zotin.

Psalmisti gjendet në oborrin e Tempullit duke iu drejtuar shenjtërores. (krhs. 1 Mbr. 8, 29) për të shprehur falënderimet e tij. Ndoshta si përgatitja e kushtimit të flisë mirënjohëse, ai dëshmon për plotësimin e lutjes. Mezi pret që të gjithë mbretërit të bien në gjunjë para Perëndisë izraelite dhe ta falënderojnë për veprat e tij të mëdha. Mrekulli është që Zotit suprem mund t'i afrohet me përlujen e duhur (krhs. Lk. 18, 14). Psalmisti tani ka nevojë për përkrahjen e Zotit. Ai i lutet Zotit që të dështojnë qëllimet e persekutuesve të tij. Ai është i bindur se Perëndia, si mbreti i Izraelit dhe kështu edhe gjyqtar suprem, do të ndajë

drejtësi në favor të skamnorëve (besimtarëve). E ardhmja u takon, së bashku me të drejtën e adhurimit në tokën e premtuar.

PSALMI 139

Lavdi të Gjithëdijshtimit

1 Mjeshtrit të korit. I Davidit. Psalm.

O Zot, ti më shqyrton e më njeh,

2 ti di kur rri e kur ngrihem, prej së largu i njeh mendimet e mia.

3 Si në shtegtoj si në pushoj, ti më vëren, ti i di të gjitha udhët e mia.

4 Pa më ardhur ende fjala në majë të gjuhës, dhe, ja, ti, o Zot, i njeh të gjitha! 5 Përpara e pas ti, o Zot, më rrethon, ti e ke vënë mbi mua dorën tënde.

6 E mrekullueshme është dora jote për mua, tepër e lartë, s'jam në gjendje t'ia arrij.

7 Ku mund të shkoj larg prej shpirtit tënd, ku të iki larg prej pranisë sate?

8 Nëse ngjitem në qiell, ti atje je, nëse zbres në Nëntokë, edhe aty je.

9 Po t'i marr krahët e agimit e të shkoj të banoj në skajin e detit,

10 edhe atje dora jote do të më përcjellë e do të më mbajë e djathta jote.

11 Në thënça: »Le të më mbulojë së paku errësira edhe
drita natë le të bëhet mbi mua!«,
12 por as terri s'është aspak terr për ty edhe nata është si
dritë e ndritshme – për ty errësira është porsì drita!
13 Ti je ai që m'i krijove veshkat,
ti më ke endur në kraharorin e nënës!
14 Të lavdëroj pse më krijove kaq mrekullisht,
të mrekullueshme janë veprat e tua, po, shpirti im mirë e
di!

15 Eshtrat e mi nuk të mbetën të fshehur kur unë po
trajtohesha në fshehtësi i endur në thellësinë e tokës.
16 Ende të patrajtuar më panë sytë e tu;
në librin tënd ishin të shkruara të gjitha ditët:
ishin të njehura megjithëse asnj'ë s'ishte ende prej tyre.

17 Tepër të çmueshme janë për mua, O Perëndi,
mendimet e

e panumërueshme është shuma e tyre!

18 Po t'i numëroja, janë më shumë se rëra!
Po t'iu dilja në skaj, më mbeteshe prapë ti!

19 Oh! Sikur Perëndia t'i zhbinte mëkatarët!
Largohuni prej meje, o njerëz gjakatarë!

20 Ata flasin kundër teje me dredhi:
më kot e lartësojnë veten kundër teje.

21 A të mos i urrej, o Zot, ata që të urrejnë ty?
A të mos t'i përbuz ata që ngrihen kundër teje?

22 Unë i urrej me urrejtje të madhe dhe i mbaj për armiq të mi.

23 Më shqyrto, O Perëndi, dhe njihe zemrën time, më sprovo e njihi shtigjet e mia

24 e shiko në mos ka në mua udhë kotësie dhe më kthe në udhën e amshueshme.

KOMENTARI

Ky psalm shihet më mirë nga perspektiva e gjyqit fetar ku autori paditet për idhujtari (krhs. Ps. 109). Psalmisti ngul këmbë në pafajësinë e tij para Zotit, i cili e njeh plotësisht dhe i cili ka kontrolluar jetën e tij qysh nga lindja. Natyrisht ky psalm vlen para së gjithash për Mesinë: s'është një psalm për njerëzimin në përgjithësi. Porsi profeti Jeremi, psalmisti kupton se para se të lindë, Zoti e kishte zgjedhur (fj. njohur). (Jer. 1: 5; krhs. Job 10: 8-12). Apeli i tij i drejtohet këtij Zot, i cili e njeh farë mirë.

15. *në thellësinë e tokës* do të jetë aludim për mitrën e nënës së tij.

24. *udhë kotësie*: do të jetë aludim për idhujtari. Kotësia është shpeshherë term për perënditë pagane.

PSALMI 140

Kundër mëkatarëve

1 *Mjeshtrit të korit. Psalm. I Davidit.*

2 Më shpëto, o Zot, prej njeriut të keq, më mbro prej njeriut mujshar.

- 3 Prej atyre që mendojnë të këqija në zemër, që gjithë ditën sendërgjojnë luftëra.
- 4 Porsi gjarpri e mprehin gjuhën e vet, nën buzë e kanë vretin e shlligës.
- 5 Më ruaj, o Zot, prej kthetrave të mëkatarit, më mbro prej njeriut të derhuzdtë, sepse mendojnë të ma vënë nënkëmbëzën.
- 6 Krenarët ma fshehën grackën me litar ma përgatitin rrjetë n, gjatë udhës m'i ngrehin kurthet.
- 7 I thashë Zotit: »Ti je Perëndia im, dëgjoje, o Zot, britmën e lutjes sime.
- 8 O Zot, o Zot, fuqia e shpëtimit tim, ma mbrojte kryet ditën e përleshjes.«
- 9 Mos lejo të shkojnë në vend dëshirat e keqbërësit, mos premtë t'i çojë në vend synimet e veta
- 10 Çojnë krye ata që më rrethojnë: rëntë mbi ta e keqj a e buzëve të tyre!
- 11 Mbi ta rënçin gacat e zjarrit, i plandossh në gropë e mos dalshin!
- 12 Jetë mos pastë mbi dhe njeriu shpifës, e mujshari u shoftë mbi faqe të dheut.
- 13 E di se Zoti e mbron çështjen e të mjerit dhe ia jep të drejtën të vobektit.
- 14 Po të drejtët do të lavdërojnë emrin tënd, shenjtërit do të jetojnë në praninë tënde.

KOMENTARI

Psalmistin e kanë shpifur dhe me egërsi e kanë vënë nën presion. Në këtë vajtim psalmisti ja sjell problemin e tij Zotit duke kërkuar ndërhyrjen e tij. Stili letrar karakterizohet nga gjuha e

figurshme e nxjerrë nga lufta, gjahu etj. Psalmisti mbaron me një lutje për hakmarrje.

PSALMI 141

Kundër tërheqjes të së keqes

1 Psalm. I Davidit.

O Zot, klitha drejt teje, eja me shpejt tek unë! Dëgjoje zërin tim kur thërras drejt teje!

2 U ngritë lutja ime si tymi i kemit në praninë tënde, lartësimi i duarve të mia porsì flija e mbrëmjes.

3 Vërja rojën, o Zot, gojës sime, edhe rojtarët në derë të buzëve të mia.

4 Mos lejo të priret zemra ime në punë të këqija për të sendërtuar punë të liga me njerëz të paudhë që të mos i shijoj kënaqësitë e tyre.

5 Le të më rrahë i drejti: kjo është mëshirë, le të më qortojë, por vaji i mëkatarit mos e leftë kokën time, por paça uratën përballë mbrapshtisë së tyre!

6 Kur nga gremina t'ì plandosin gjyqtarët e tyre do të shohin sa të ëmbla kishin fjalët e mia.

7 Porsi ashklat e latuesit e të presësit nëpër tokë shpërndahen eshtrat e tyre grykës së Nëntokës!

8 Tek ti, o Zot, o Zot, janë sytë e mi, ty të rashë ndore, mos lejo të birret shpirti im.

9 Më ruaj prej grackës që ma kanë ngrehur, prej pengesave të atyre që bëjnë të keqen.

10 Të gjithë keqbërësit bashkë rënçin në leqe të veta, kurse unë, shëndoshë e kalofsha udhën.

KOMENTARI

Ky psalm është thirrja e njeriut për ndihmë. Ka armiq që janë të dhënë pas shkatërrimit të tij, por e di mirë se brenda vetes ka edhe armiq, mendja që shpesh tundohet për keqbërje. Nga të dy armiqtë kërkon lirim që mund ta japë Zoti. Posaçërisht i kërkon Zotit të ruajë gojën e tij. Pastaj psalmisti hedh një shikim në të ardhmen duke shpresur që armiqtë e tij do të humbin. Siç duket, ai duhet të përballë zemërimin e ish-shokëve të tij: armiqtë e tij janë si gjahtarët dhe ai është objekti i kërkimit të tyre të pamëshirshëm. Vegla e vetëm kundër tyre është lutja e tij që të ndahet drejtësi, kështu që ata të bien viktimat e intrigave të vet, kurse ai të kursehet pa dëm.

PSALMI 142

Urata e një të përndjekuri

1 *Poemë. E Davidit, kur ishte në shpellë. Uratë.*

2 Me gjithë zë e thërras Zotin në kushtrim, me sa zë kam Zotin e përbej,

3 para tij zhgrehem në vajtimin tim, para tij e qes shtrëngimin tim.

4 Megjithëse shpirti im po meket në mua, ti e njeh udhën time.

Udhës nga më duhej të kaloja ma ngrehën grackën.

5 Shikoja djathtas e shihja: s' ishte askush që të më njohë! Askund shteg shpëtimi dhe s'është askush që të kujdeset përjetën time!

6 Atëherë të thirra në, ndihmë, o Zot, e thashë: »Ti je strehimi im, ti je pjesa ime në tokën e të gjallëve.

7 Vështroji britmat e mia, sepse jam përvujtëruar për së tepërmi. Më libro prej salvuesve të mi, sepse janë më të forte, se unë.

8 Nxirre shpirtin tim prej rrethimit që ta lavdëroj emrin tënd. .

Rreth meje do të bashkohen të drejtët nëse mirësisht do të kujdesesh për mua.«

KOMENTARI

Sipas mbishkrimit, prejardhja e këtij psalmi do të jetë përjetimet e Davidit te Adulami. Davidit s'i mbajnë më nervat, por konstaton se duke iu lutur Zotit, gjendja e tij shpirtërore qetësohet. Psalmisti lëviz nga depresioni dhe dështimi në besim te Perëndia. I pranon dobësitë e tij, por edhe gjithëfuqinë e Zotit dhe kërkon rrugëdalje. Premton se me kusht që Zoti ia tregon rrugëdalje, do të sjellë flinë e mirënjohjes në Tempull si dëshmi për besnikërinë e Zotit.

5. Djathtas: Në gjyq mbrojtja rrinte në të djathtën e të paditurit (krhs. 116, 8; 109, 113).

6. *strehimi im*: më mirë: rrugëdalja ime.

PSALMI 143

Përlutje e përvujtë

1 Psalm. I Davidit.

O Zot, dëgjoje lutjen time, vëri vesh sipas besnikërisë sate lutjes sime, më dëgjo në saje të drejtësisë sate.

- 2 Mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënd, se asnjë i gjallë nuk mund të dalë i drejtë përpara teje
- 3 Armiku e salvon shpirtin tim, përdhe e shtroi jetën time, më ka lidhur në errësirë porsi të vdekurit e kahershëm,
- 4 shpirti im po rënkon ne mua, të mpitë e kam zemrën në kraharor.
- 5 Më kujtohen ditët e shkuara, i kujtoj të gjitha veprat e tua, i peshoj veprat që ti i kreve.
- 6 I ngre drejt teje duart e mia, shpirti im si toka pa ujë ka etje për ty-
- 7 Përgjigjmu pa vonesë, o Zot, se mbeta pa frymë, mos e fsheh fytyrën tënde prej meje të mos bëhem si ata që zbresin në varr.
- 8 Bëj ta dëgjoj mëshirën tënde në mëngjes, sepse shpresën e kam vënë në ty.
Ma mëso udhën së cilës duhet të eci, sepse tek ti e kam lartësuar shpirtin.
- 9 Më shpëto prej armiqve të mi, Zot, jam ndore tënde.
- 10 Më mëso ta kryej vullnetin tënd, sepse ti je Perëndia im.
- Shpirti yt i mirë le të më prijë në vend të drejtë,
- 11 më përtërij në jetë, o Zot, pashë emrin tënd.
Pashë drejtësinë tënde nxirre shpirtin tim nga shtrëngi
- 12 pashë mëshirën tënde shpëmdaji armiqtë e mi,
zhduki të gjithë ata që e salvojnë shpirtin tim sepse unë jam shërbëtori yt.

KOMENTARI

Në këtë psalm individi jep vajtimin e tij në Tempull para se të presë profecinë nga prifti mëngjesin tjetër. (rr. 8).

Psalmisti, në nevojë të madhe, e kupton se nuk mund t'i bëjë presion Zotit për ta ndihmuar duke u bërë thirrje meritave të veta, por vetëm marrëdhënies së tij me Perëndinë në kuadër të besëlidhjes. (shih shërbëtor, krhs. rr. 10) Këtë marrëdhënie e ka filluar dhe e mban Zoti. Ai i bën thirrje besnikërisë së Zotit, attributeve të tij dhe gatishmërisë për të vënë (përsëri) në rregull dhe të justifikuar popullin e tij. Psalmisti e di mirë se ka rrezik ta vërë veten në vëmendjen e Zotit dhe kështu t'i zbulohet shqyrtimit të Zotit. Kështu është ndjenja e tij e frikës dhe të paaftësisë.

Psalmisti shpjegon gjendjen e tij të vështirë: ka qenë viktimë e persekutimit të egër. Bën aludim për vdekje: tashmë qëndron në hijën e vdekjes, i dobësuar dhe pa forcë jetësore, si fantazmat e paafte në botën e të vdekurve (krhs. 88, 3-8, 10-12). Ai i lutet Zotit me ngulm të mos refuzojë t'ia plotësojë lutjen.

Siç duket, profecitë e ndihmës i jepnin priftërit mëngjesin tjetër pas lutjeve të individit (krhs. 90, 14), dhe psalmisti e kërkon këtë përgjigje të favorshme. Psalmisti kërkon edhe këshillë dhe mësim nga Zoti. Ai i bën thirrje namit të Perëndisë, d.m.th. personit dhe reputacionit të tij.

PSALMI 144

Himni për luftën e përfitoren.

I Davidit.

Lavdëroftë Zoti, ndihmëtari im që m'i mëson duart për luftim e gishtërinjtë për luftë.

2 Mëshira ime dhe kështjella ime, strehimi im dhe
çlirimtari im,

shqyti im pas të cilit fshihem, ai që popullin tim e vë nën
sundimin tim.

3 O Zot, e ç'është njeriu që t'japësh rëndësi, biri i njeriut
që të kujdesesh për të?

4 Njeriu i përngjan avullit, ditët e tij si hija që kalon.

5 O Zot, priri qiejt e tu e zbrit, preki malet e ato le të
tymojnë.

6 Gjuaj rrufe e shpëmdaji armiqtë, flakëro shigjetat dhe
shpartalloji!

7 Shtrije doren tënde prej së larti më shpëto e më nxirr
prej ujërave të mëdha, prej kthetrave të bijve të huaj,

8 goja e te cileve gënjeshtër veç flet, e djathta e të cilëve
ng'rihet për t'u betuar në rre

9 O Zot, për ty do ta këndoj një këngë të re, për ty do të
luaj në harpën dhjetë kordash,

10 sepse mbretërve ti u jep fitoren, e shpëton Davidin,
shërbëtorin tënd, prej shpatës vrasare.

11 Më shpëto e më liro prej kthetrave të bijve të të huajve,
goja e të cilëve gënjeshtër veç flet, e djathta e të cilëve

ngrihet për t'u betuar në rre

12 Bëj që fëmijët tanë të jenë porsitë që rritet në iininë
e vet, bijat tona porsitë shtyllat e këndeve, të hijshme porsitë
shtyllat e Tempullit.

13 Drithnikët tanë mbushi plotë e përplot me gjithfarë
frytesh me mbushulli, dhentë tona me mijëra u shtofshin,
të panumërta nëpër fushat tona,
14 gjedhet tona të majme e të shëndosha.
Rrëme as sulme mos pastë në muret tona, as vaj e gjëmë
ndër sheshet tona!
15 Lum ai popull që i ka këto të mira, lum ai popull që
Perëndinë e ka Zot!

KOMENTARI

Një mbret i dinastisë davidike flet në rolin e tij si përfaqësues i Izraelit, siç duket në periudhën e mëvonshme të mërgimit. Ai e lavdëron Perëndia dhe i kërkon ndihmë. Në pjesën e dytë thirret për bekimin e tij mbi popullin e tij, rr. 12-15. Si teokraci Izrael i kërkonte Zotit lulëzim dhe sundim të urtë, që ndërmjetësoheshin nëpërmjet mbretit njerëzor. Tani mbreti i kërkon ndërhyrje në një krizë të re. Ai e përfytyron kërkesë për ndihmë hyjnore si teofani. Kjo figurë e fuqisë së Zotit shërben si garanci që, sado të fuqishëm të jenë armiqtë e mbretit, Perëndia e tij është edhe më i madh dhe mund t'i nënshtrojë. Ngushtica e mbretit përshkruhet si ujëra të thellë dhe pastaj më fjalëpërfjalshëm, si presion nga fuqi të huaja që shkelin pa skrupuj traktatë solemn. Betohet të këndojë në Tempull një solo lavdërimi pasi Perëndia t'i ketë shkuar në ndihmë.

Nën ekonominë e DhV bekimet materiale i atribuohen dorës bujare të Perëndisë dhe kërkohen rishtas nga Ai. E ardhmja e kombit përfytyrohet si çunat dhe vajzat e forta që mund të bashkëpunojnë për të ndërtuar një komb më të mirë. Kërkojnë edhe pasuri të përfytyruar nga hambarë të plotë, nga kopë dhe tufa të mëdha. Nënkuptohej që në atë kohë Izraeli nuk gëzonte një lulëzim të tillë.

8, 11. Ngritja e dorës së djathtë ishte gjestë që shoqëronte betimin. (krhs. Lp. 32, 40).

PSALMI 145

Lavdi Zotit – Mbretit të gjithësisë

1 *Himn. I Davidit.*

Alef

Do të të lartësoj, o Mbret, Perëndia im,
dhe do ta lavdëroj emrin tënd
përgjithmonë ejetës.,

Bet

2 Çdo ditë do të të lavdëroj
dhe do ta lavdëroj emrin tënd
përgjithmonë e jetës.

Gimel

3 Zoti është i madh e i lavdërueshëm,
e pashqyertueshme është madhëria e tij!

Dalet

4 Breznia breznisë do t'ia tregojë veprat e tua
dhe do ta shpallin pushtetin tënd.

He

5 Do ta shpallin madhëtinë e shenjtërisë sate,
do t'ia tregojnë mrekullitë e tua.

Vav

6 Do ta tregojnë fuqinë e veprave të tua të tmerrshme,
do t'ia kumtojnë veprat e madhërishme të tuat.

Zain

7 Do ta përhapin kujtimin e hirësisë sate të madhe,
do t'i brohorisin drejtësisë sate.

Het

8 Zoti është vetë butësia e mëshira,
i ngadalshëm në zemërim dhe plot dashuri.

Tet

9 Zoti është i mirë për të gjithë ‘
i dhimbshëm për të gjitha krijesat e veta.

Jod

10 Le të lavdërojnë, o Zot, të gjitha veprat e tua
e le të lavdërojnë shenjtërit e tu.

Kaf

11 Le ta tregojnë lavdinë e Mbretërisë sate,
le të kuvendin për pushtetin tënd,

Lamed

12 për t'ua shpallur njërëzve gjithëpushtetësinë tënde
dhe lavdinë e madhërisë së mbretërisë sate.

Mem

13 Mbretëria jote është mbretëri e amshueshme,
pushteti yt prej breznie në brezni.

Nun

Besnik është Zoti ne të gj'itha premtimet e veta,
i shenjtë në të gjitha veprat e veta.

Samek

14 Zoti ua j ep dorën atyre që u merren këmbët,
i çon ata që rrëzohen.

Ain

15 Sytë e të gjithëve shpresojnë në ty,
ti u jep ushqim në kohën e duhur.

Pe

16 Ti e hap dorën tënde
dhe mbush me të mira çdo gjë të gjallë.

Tsade

17 I drejtë është Zoti në të gjitha udhët e veta
dhe i shenjtë në të gjitha veprat e veta.

Kof

18 Zoti është afër të gjithë atyre që e thërrasin,
të gjithë atyre që e thërrasin me çiltëri.

Resh

19 E plotëson dëshirën e atyre që e druajnë,
ua dëgjon përlutjen dhe i shpëton.

Sin

20 Zoti i ruan të ethë ata që e duan,
kurse të paudhët të gjithë do t'i shuajë.

Tau

21 Goja ime do ta shfaqë lavdinë e Zotit,
çdo njeri do ta lavdërojë emrin e tij të shenjtë
përgjithmonë e jetës.

KOMENTARI

Ky psalm është himn vetëm që e nxit kongregacionin të vlerësojë dhe të lavdërojë mbretërinë e Zotit. Në të theksohet mbretëria e Zotit dhe te rr. 15+ ka aludim për të korrat, dhe kjo do ta lidhë me festën e vreshtës, festën e tëbanave. Zoti i bekon

shtetasit e tij dhe është besnik ndaj përgjegjësive të tij mbretërore (fj. drejtësitë e tij).

Shprehja dashuri e qëndrueshme (hebr. *hesed*) është para së gjithash term i besëlidhjes, por me kalimin e kohës filloi të shënonte hirin e përgjithshëm i Perëndisë drejtuar të gjitha krijesave të tij. Libri i profetit Jona është komentuar mbi këtë temë. Si pasojë të gjitha krijesat e Tij e kanë për detyrë ta lavdërojnë, e jo vetëm besnikët e tij (shenjtërit). Psalmisti ka dëshirë të fortë të qëndrojë midis kongregacionit të përbërë nga njerëzit e të gjitha kombeve.

PSALMI 146

Himn Perëndisë ndihmëdhënës

1 HALELUJA!

Lavdëroje, shpirti im, Zotin!

2 Do ta lavdëroj Zotin gjithë jetën time,
derisa të jem, Perëndisë tim do t'i këndoj.

3 Mos e vini shpresën tuaj në princa,
në njeri që s'është i zoti të shpëtojë.

4 Njeriu jep shpirt e kthehet në tokën e vet,
brenda një dite humbasin synimet e tij.

5 I lumi ai që e ka ndihmën e Perëndisë së Jakobit,
që e ka shpresën në Zotin, Perëndinë e vet,

6 i cili krijoi qiellin e tokën, detin e gjithçka është në ta,
që e mban besnikërinë, për amshim,

7 që u jep të drejtën të nëpërkëmburve,
 u jep ushqimin të uriturve.
 Zoti i çliron robërit,
 8 Zoti u jep dritën e syve të verbërve,
 Zoti i ndreq të kërrusurit,
 Zoti i do të drejtët,
 9 Zoti i mbron ardhacakët,
 i ndihmon bonjakët e të vejat,
 ndërsa mëkatarëve ua pështjellon udhët.
 10 Zoti do të mbretërojë për jetë,
 Perëndia yt, o Cion, nga breznia në brezni.

KOMENTARI

PSALMET 146-150

Psalmet 146-150 formojnë një bllok të veçantë psalmesh që këndoheshin me rastin e festave. Këto quhen psalmet e Hallelit (d.m.th, e lavdërimit) sepse merren eksklusivisht me lavdërime. Ka të ngjarë që Jezusi dhe dishepujt e tij t'i kenë kënduar këto psalme në darkën e fundit. Secili psalm fillon dhe mbaron me brohoritjen Halleluja (Lavdi Zotit). Këto psalme renditen me radhë si vijon:

146 është psalm i individit (rr. 1)

147 është psalm i mbarë bashkësisë (rr. 1. 12)

148 është psalm i qiellit dhe tokës (rr. 1. 7).

Megjithatë, në qoftë se mbarë bota duhet t'i kushtojë Zotit lavdërim për atë që ka bërë për Izraelin (rr. 13-14) atëherë nevojitet lavdërimi i popullit të angazhuar në mision (Ps 149), derisa gjithçka që merr frymë ta lavdërojë Zotin (150,6).

Ky psalm bashkon lavdërimin personal me nxitjen për t'i besuar Zotit. Kështu psalmisti shpreh bindjen e tij se lavdërimi

duhet të jetë fryt i angazhimit në planin e Zotit për ungjillizimin e botës.

Psalmisti e hedh fjalën për përgjegjësinë morale të popullit të tij. Zoti pret nga populli i tij standarde të ndryshme, dhe mërzitja është fryt i atyre që s'çajnë kokën për to. Por psalmisti nuk mund të largohet nga tema e patronatit të Zotit për skamnorët. Ai mendon për tri kategori njerëzish të nevojshëm: i huaj pa të drejtat civile, vejusha dhe jetimët. Cioni, si kryeqytet dhe pikëmbledhës mund të jetë krenar për një Perëndi të lavdërueshme.

4. *tokën e vet. d.m.th'*. 'Toka nga e cila u nxor njeriu. Ka llojë fjalësh në fjalë njeriu ('*adam*) dhe në fjalë toka ('*adamah*), shërben për të dalluar inferioritetin dhe paaftësinë e njeriut (krhs. Gen.3, 19).

PSALMI 147

Himn Perëndisë së gjithëpushtetshëm

1 HALELUJA!

Lavdëroje Zotin, sepse është mirë, është bukur t'i këndosh Perëndisë sonë,
është kënaqësi ta lavdërosh si i ka hije!

2 Zoti e rindërton Jerusalemin, i bashkon izraelitët e mërguar!

3 Ai i shëron zemrat e copëtuara, i lidh plagët e tyre!

4 Ai e njeh numrin e yjeve
dhe e thërret secilin me emër.

5 1 madh është, Zoti ynë, i gjithëpushtetshëm,
e pakufishme është dija e tij.

6 Zoti i lartëson të përvujtët,
kurse përdhe i shtron keqbërësit .

7 Këndojani Zotit këngën e falënderimit,
bità harpës për nder të Perëndisë sonë!

8 Ai me re e mbulon qiellin dhe ia përgatit dheut shiun.
Bën të rritet maleve bari edhe bimë për të mirën e njeriut.

9 Ai u jep ushqime bagëtime,
deri edhe zogjve të korbave kur ia kërkojnë.

10 S'i jep rëndësi fuqisë së kalit,
s'i merr parasysh kërcikët e trimit:
11 Zotit i pëlqejnë atà që e druajnë,
ata që shpresojnë në mirësinë e tij.

12 Lavdëroje, Jerusalem, Zotin,
madhëroje, o Cion, Perëndinë tënd

13 Sepse i forcoi shulat e dyerve të tua, i lavdëroi bijtë e
tu në ty!

14 Ai ua siguron kufijve të tu paqen,
ai të ushqen me palcën e grurit.

15 Ai e dërgon fjalën e vet mbi tokë, lajmi i tij vrapon me
shpejtësi.

16 E hedh borën porsì lesh,

e derdh brymën pors hi.

17 E lëshon breshrin pors kafshatë,
kush mund të qëndrojë para të ftohtit të tij?

18 E dërgon fjalën e vet e ato shkrihen,
çon erën e vet e ujërat rrjedhin.

19 Ai ia zbulon fjalën e vet Jakobit,
drejtësitë e gjyqet e veta Izraelit.

20 Nuk bëri kështu me asnjë komb tjetër:
asnjërit nuk ia zbuloi vendimet e vetà. Haleluja!

KOMENTARI

Ky psalm lavdërimi nga periudha pas mërgimit është përzjerja e fuqisë së madhe të Zotit dhe të mbrojtjes së Izraelit. Skenari do të jetë festa e tëbanave për shkak të aludimit për të korrat (rr. 14) dhe Ligjin (rr. 19; krhs. Lp. 31,10+).

Shpëtimi i Izraelit: (rr. 11-6) Kthimi nga mërgimi zgjidhet si themel për meditimin e qënies dhe qëllimeve të Perëndisë. Komuniteti çifut, i rindërtuar dhe i rimëkëmbur, është dëshmi e gjallë për kujdesin e Zotit.

Pikëllimi i mërgimit (krhs. 137, 11-4) zëvendësohet me ngushëllimin e shtëpisë. Kjo duhet të nxitë lavdërim nga populli i tij mirënjohës. Fuqia transhendente që kontrollon yjet u zbatua për hir të tyre, me përmbytjen e Babilonisë dhe rimëkëmbjen e Izraelit të shypur. (krhs. Is. 40, 26, 28).

Kujdesi i Zotit dhe përgjigjja e Izraelit (rr. 7-11)

Perëndia e besëlidhjes kremtohet si Furnizuesi i madh për zogjët, kafshët dhe njeriun. Dallimi dramatik midis stinave në Izrael dhe peisazhit e ka prejardhjen në kontrollin e tij providencial. Shiu pas muajve të thatësisë dhe manteli i ri i gjelbër për tokën janë dhurata nga duart e tij. Meqë populli i tij

është objekt i kujdesit të tij, përgjigjja e tij e duhur është respekt i thellë dhe besim i vazhdueshëm e jo varësi nga forcat e veta. (krhs. Is. 40, 29 +.). Është vërtetë tragjedi që njerëzit e humbin ndjenjën e vlerave dhe kanë prirje të kenë besim te grumbullimi u armatimeve (krhs. Is. 31, 11). Korrat e kohës së fundit nuk janë fryt i rastësisë, por zbatimi i kujdesit të Zotit. Fjala e gjithëfuqishme që krijoi gjithësinë ende vepron duke drejtuar stinat dhe kohën.

Bora, ngrica dhe breshëri që janë dukuri të rralla në Izrael, e nxitin Izraelin të çuditet edhe të lavdërojë Perëndinë. Por kjo fjalë providenciale nuk mjaftohet: ka ekuivalentin e saj shpirtëror – fjala e veçantë drejtuar Izraelit, zbulimi i vullnetit të Perëndisë për jetat e tyre në ligjet e Sinait që lexohen sipas traditës me rastin e festës së tebanave. Çfarë nderi për Izraelin! Kështu urdhëresat janë nxitje për dëgjuesë.

rr.17b. *kush mund të qëndrojë para të ftohtit të tij? Mund të lexohet më mirë 'uji qëndron i ngrirë'.*

PSALMI 148

Qielli e Toka e lavdërojnë Zotin

HALELUJA!

Lavdëroni Zotin prej qiellit, lavdërojeni Atë në lartësi!

2 Lavdërojeni, të gjithë engjëjt e tij, lavdërojeni, të gjitha ushtritë e tij!

3 Lavdërojeni, diell e hënë, lavdërojeni, të gjitha yjet ndriçuese!

4 Lavdërojeni, qiejt e qiejve edhe ju, o ujëra, që jeni në qiell!

5 Le ta lavdërojnë emrin e Zotit, sepse ai urdhëroi e ato u bënë;

6 i vendosi ato për jetë të jetës sipas ligjit që nuk njih ndryshim.

7 Lavdëroni Zotin, ju që jeni mbi tokë, përbindështa të detit dhe të gjitha humnerat,

8 ti, o zjarr e breshër, borë e mjegull,
ti, o erë e stuhishme, që kryen urdhrin e tij!

9 Male e kodra të gjitha,
lëndë frutore e të gjithë cedrat;

10 egërsira e të gjitha bagëtitë,
zvarranikë e ju, o shpendë me flatra!

11 Ju, o mbretërit e dheut e popuj të gjithë, princa e të gjithë gjykatësit e dheut!

12 Djelmosha e vajza, pleq e foshnja:

13 le ta lavdërojnë emrin e Zotit,
sepse i madhërueshëm është veç emri i tij!

Madhëria e tij tejkalon qiell e dhe,

14 Ai e ngre fuqinë e popullit të vët,
mburrje për të gjithë të drejtët e vet,
për bijtë e Izraelit – popull i afërm i tij. Haleluja!

KOMENTARI

Qiejtë dhe banorët e tyre nxiten të japin kontributin e tyre për lavdërimin e Zotit. Suita engjëllore në tempullin dhe pallatin qiellor bëjnë pjesë në korin që lavdëron Zotin. (krhs. 103, 20; Is.

6, 3). Dritat e qiellit, së bashku me qiejtë shumë të lartë dhe oqeanin qiellor ku magazinohet shiu (krhs. 104, 3; Zan. 11,6 +; 7, 11; 8,2). Të gjithave u bëhet sfidë ta lavdërojnë Zotin për krijimin dhe mbajtjen e tyre, për furnizimin e tyre me funksione të ndryshme dhe rolet e tyre unike nga Krijuesi i madh. Secili mund të flasë për lavdinë e Zotit dhe për veprat e tij (119, 1). Sikurse puna mjeshtërore i jep nder mjeshtrit, ashtu qëllimi i botës së krijuar është lavdërimi i Zotit ndërsa pasqyrojnë fuqinë dhe madhështinë e tij. Ata të gjithë janë dëshmitarë për namin e Zotit, d.m.th. për vetëshfaqjen e tij.

Nga lartësitë psalmisti zbritet deri në thellësitë e oqeanit dhe të tokës

Madje edhe kuçedrat e thellësitë si balenat gjigante janë dëshmitarë për fuqinë e tij. Dukuritë e kohës komunikojnë transhendencën e tij. Duke ardhur te njerëzimi, kulmi i krijimit, psalmisti u thërret të gjithëve ta lavdërojnë Zotin. Te rr. 12 do të ketë aludim për komunitetin fetar të mbledhur për adhurim në Jerusalem. (krhs. Jl 2, 16 +). Izraeli shërben për ta përfaqësuar njerëzimin në lavdërimin e tyre. (krhs. 96, 1-3). Çdo fuqi në tokë është deleguar nga Zoti. Përveç kësaj Zoti i dhuron popullit të tij të zgjedhur fitore dhe gjallëri. (krhs. Ps 92, 10). Ky psalm lavdërimi na sjell ndërmend Apok. 4, 11; 5, 9 +.

PSALMI 149

Himn ngadhënjimi

1 HALELUJA!

Këndoni Zotit një këngë të re,

këndoni lavdi në mbledhjen e shenjtërve!

2 Le t'i gëzohet Izraeli Krijuesit të vet, bijtë e Cionit t'i brohorisin Mbretit të vet!

3 Le ta lavdërojnë emrin e tij në valle,

4 le t'i bien për nder të tij tupanit e citarës, sepse Zoti kënaqet në popullin e vet, të përvujtët i nderon me shpëtim.

5 Le të galdojnë të drejtët në lumturi, le të brohorisin nga shtrojat e veta!

6 E paçin lavdinë e Zotit në gojë, e shpatën dytehëshe në dorë!

7 Për të marre shpagim mbi paganë, për t'u dhënë popujve ndëshkim,

8 për t'i lidhur mbretërit e tyre në pranga, princat e tyre në zinxhirë të hekurt,

9 për ta zbatuar mbi ta dënimin kaherë të shkruar: – ky është nder për të gjithë besnikët e tij. Haleluja!

KOMENTARI

Kompozimi i këtij psalmi ishte, siç duket, frymëzuar nga një fitore kombëtare. Ndërsa populli e lavdëron Zotin për të, ata mezi presin fitoren e tij përfundimtare më të madhe në fund të kohës.

Në pjesën e parë të psalmit, një sukses ushtarak nxit këndimin e një kënge të re, por s'është pasojë e arritjës njerëzore, por e ndërhyrjes hyjnore. Komiteti i adhuruesve sjellin ndërmend që ekzistenca e kombit është mrekulli: Zoti bëri prej një turme të rrëmujshme një komb të ri. (krhs. 95, 6; 100, 3). Perëndia e Daljes ende banon ndër popullin e tij, dhe populli nxitet për të marrë pjesë në vallëzimin në rreth. (krhs. Dal. 15, 20; Gj. 11, 34). Populli bie përmbys para Zotit dhe vijon vallëzim i shpatave.

1, 5, 9. shenjtorët: Heb. *hasidim* shënon ata që janë të lidhur me besëlidhje. Mund të përkthehet edhe besnikët, besimtarët ose njerëz të përshpirtshëm.

PSALMI 150

Himni përfundues

HALELUJA!

Lavdërojeni Perëndinë në Shenjtëroren e tij,
madhërojeni në hapësirën e kupës qiellore!
2 Lavdërojeni për veprat e madhërueshme të tij,
lavdërojeni për madhërinë e madhe të tijën!

3 Lavdërojeni me zë të borisë, lavdërojeni me harpë e me
citarë,

4 lavdërojeni me tupan e valle, lavdërojeni me korda e me
fyej!

5 Lavdërojeni me cimbale tingëlluese, lavdërojeni me
cimbale brohorie!

Gjithçka që merr frymë le ta lavdërojë Zotin!
Haleluja!

KOMENTARI

Ky psalm është kulmi i pjesës së fundit të psalmeve. Nga perspektiva më e gjerë rendi i psalmeve ka sjellë botën në nënshtrim dhe kënga e të shpënguarve po fillon. Shenjtërorja do

të jetë tempulli tokësor, por mund të shënojë edhe tempullin qiellor. Lavdërimet bazohen në veprat e fuqishme të Perëndisë në krijim dhe në histori. Veglat që marrin pjesë në orkestër numërohen sepse fillojnë kur shpallen emrat e tyre dhe vazhdojnë të bien deri në fund. Ata që afrohen për të kënduar nuk janë vetëm priftërinjtë dhe levitët, por edhe mbarë krijimi i Perëndisë.